FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 63

Tiranë – E enjte, 13 prill 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 26/2023, datë 30.3.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të kuvendit", i ndryshuar	6861
Vendim i Kuvendit nr. 27/2023, datë 30.3.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit", i ndryshuar	6861
Rezolutë e Kuvendit datë 30.3.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit për vitin 2022	6861
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 189, datë 5.4.2023	Për miratimin e platformës së monitorimit dhe verifikimit	6864
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 204, datë 7.4.2023	Për miratimin e dokumentit të politikave për standardet e shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë	6917
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 5, datë 4.1.2023	Për një ndryshim në urdhrin nr. 854, datë 31.12.2021, "Për delegim kompetencash", i ndryshuar	6938
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 42, datë 27.3.2023	Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror	6938
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 159, datë 5.4.2023	Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor	7016
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Qemal Skora	7071

VENDIM
Nr. 26/2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 70/2021 "PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Grupit Parlamentar Demokraci dhe Integrim,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 70/2021 "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit", i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

"Deputeti Shpëtim Idrizi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 30.3.2023.

VENDIM
Nr. 27/2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 70/2021 "PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Grupit Parlamentar Demokraci dhe Integrim,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 70/2021 "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit", i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

"Deputeti Shpëtim Idrizi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Ekonominë dhe Financat".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 30.3.2023.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË UJIT PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

Duke vlerësuar se viti 2022 ishte viti i fillimit të një reforme rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, e cila agregon sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale të krijuara si Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP), të regjistruara si shoqëri UK Rajonale, ndërkohë që sektori ka qenë i fragmentarizuar në 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e FU dhe KUN në 61 bashki të vendit;

Duke vlerësuar se objektivi kryesor i procesit të reformës është që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK;

Duke vlerësuar se saktësia e të dhënave të raportuara mbetet sfidë për shoqëritë UK, pasi ato janë elementi bazë i një analize objektive të performancës së shoqërive, si dhe për vendosjen e objektivave nga ERRU-ja për përmirësimin e performancës së tyre në të ardhmen;

Duke vlerësuar faktin se gjendja e sektorit UK për vitin 2022, e paraqitur përmes Treguesve Kryesorë të Performancës, krahasuar me vitin e mëparshëm tregon një performancë të përmirësuar pothuajse në të gjithë treguesit, me përjashtim të treguesit financiar "Mbulimi i kostove O&M";

Duke vlerësuar faktin se kriza globale e energjisë elektrike pati një ndikim të drejtpërdrejtë në përkeqësimin e treguesit "Mbulimi i kostove O&M".

Vlerëson për vitin 2022:

Fillimin e një reforme rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, e cila agregon sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale të krijuara si Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP), të regjistruara si shoqëri UK Rajonale, ndërkohë që sektori ka qenë i fragmentarizuar në 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e FU dhe KUN në 61 bashki të vendit. Reforma ka si objektiv kryesor që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK.

Përmirësimin e lehtë e pothuajse të të gjithë Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, me përjashtim të treguesit "Mbulimi i kostove O&M".

Punën e bërë nga ERRU-ja në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve, ku, përveç zgjidhjes së ankesave ndërmjet konsumatorëve dhe shoqërive UK, është krijuar dhe funksionon tashmë edhe pranimi *online* i ankesave të konsumatorëve nëpërmjet faqes se re zyrtare të ERRU-së, www.erru.al.

Rolin proaktiv që ka luajtur ERRU-ja në kuadër të reformës duke ndërmarrë vendimet e nevojshme në drejtim të licencave dhe tarifave, të cilat i shërbejnë përshpejtimit dhe ecurisë së reformës, duke u dhënë shoqërive UK të drejtën e transferimit të licencave ekzistuese në SKP, si dhe duke i lejuar shoqëritë SKP-UK të përdorin tarifat aktuale për zonat e shërbimit të miratuara nga ERRU-ja deri në miratimin e tarifave të reja.

Shtimin e dy treguesve të rinj të performancës në vlerësimin e shoqërive UK, përkatësisht "Ankesat e klientëve" dhe "Eficienca e energjisë". Treguesi i parë lidhet direkt me cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe në mbrojtje të interesave të tyre, ndërkohë që treguesi i dytë, "Eficienca e energjisë", merr një vëmendje të veçantë në përgjigje të krizës globale të energjisë elektrike.

Punën e bërë nga ERRU-ja në miratimin e licencave për 17 shoqëri UK, nga të cilat 15 shoqëri UK (shoqëritë ekzistuese) dhe 2 shoqëri UK Rajonale të krijuara sipas VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022.

Punën e bërë nga ERRU-ja me rritjen e numrit të monitorimeve të zhvilluara në 26 shoqëri UK, me qëllim nxitjen e përmirësimit të performancës së shoqërive UK dhe të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.

Nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet katër rregullatorëve të sektorit të ujërave në Ballkanin Perëndimor, përkatësisht: Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi dhe Maqedoni, duke rritur nivelin e bashkëpunimit rajonal në adresimin e sfidave të përbashkëta në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, shkëmbimin e eksperiencave pozitive, si dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së në këtë fushë.

Përmirësimin me afro një orë krahasuar me vitin 2021 (duke arritur nivelin 16.3 orë/ditë) të treguesit "Kohëzgjatja e furnizimit me ujë", e cila shpreh mesataren e orëve të furnizimit me ujë. Përmirësimi i këtij treguesi lidhet direkt me investimet e kryera në sektor, ku rritja e orëve të furnizimit me ujë 24/7 është edhe objektiv në planin afatshkurtër 2018–2023.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2023 rekomandon:

1. ERRU-ja në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin UK, e cila agregon sektorin UK në 15 shoqëri, të ketë prioritet në punën e saj bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për të bërë të mundur zbatimin me sukses të kësaj reforme të rëndësishme.

2. ERRU-ja në kuadër të reformës në sektorin UK, të marrë masat e nevojshme për t'iu përgjigjur në kohë pajisjes me licencë të SKP-ve të reja (Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta), të krijuara nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, në përputhje me kategorinë përkatëse të shërbimit të ofruar dhe rishikimin e tarifave ekzistuese.

3. ERRU-ja, duke qenë pjesë e grupit ndërinstitucional të punës të ngritur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas urdhrit nr. 165, datë 8.9.2022 "Për hartimin e strategjisë sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2020-2030, të projektligjit dhe rregullores së standardeve të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri", të ndikojë në rishikimin e ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", duke pasur parasysh forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur dhe të performancës së tij në shërbim të rritjes së performancës së sektorit në përgjithësi.

4. Në kuadër të hapjes së negociatave me BE-në, të kontribuojë dhe të jetë pjesë aktive e grupeve të punës lidhur me kërkesat që Shqipëria duhet të përmbushë në lidhje me Direktivat Europiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe të Llumrave të ITUN .

5. ERRU-ja, gjatë monitorimeve të shoqërive UK në terren, si dhe gjatë procesit të miratimit të tarifave, t'i kushtojë vëmendje të veçantë rritjes së eficiencës së energjisë përmes përdorimit të burimeve alternative të rinovueshme nga shoqëritë UK, si një nga sfidat kryesore për përmirësimin e performancës financiare të shoqërive në kushtet kur rritja e çmimit të energjisë elektrike ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përkeqësimin e treguesit "Mbulimi i kostove të O&M".

6. Të vijojë punën për procesin e monitorimit të shoqërive UK për procedurat e trajtimit të ankesave të konsumatorëve, mekanizmave për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve në drejtim të ofrimit të shërbimit ujësjellës kanalizime, duke lënë rekomandime për t'u realizuar nga ata.

7. ERRU-ja në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, duhet të bashkëpunojë me institucionet kryesore, në mënyrë që të ketë një shpërndarje të drejtë të investimeve për shoqëritë UK, duke i parë ato të lidhura me përmbushjen e objektivave të caktuara nga ERRU-ja dhe duke shërbyer si element nxitës për shoqëritë për përmirësimin e treguesit të ujit pa të ardhura dhe treguesve të tjerë të performancës. Në të njëjtën kohë ERRU-ja, gjatë procesit të aplikimit për nivel të ri tarifor nga shoqëritë UK, të kërkojë vendosjen e objektivave konkretë nga shoqëritë UK në reduktimin e humbjeve administrative dhe fizike si për lidhjet e paligjshme, nën faturime, ashtu edhe për abuzimet e ndryshme për ujitje etj.

8. ERRU-ja në kuadër të reformës, të vijojë të luajë një rol proaktiv duke ndërmarrë vendimet e nevojshme, si dhe duke zhvilluar takime me drejtuesit e rinj të shoqërive UK Rajonale të krijuara, me qëllim diskutimin e pengesave të ndryshme që hasen për zbatimin e reformës gjatë periudhës tranzitore, si dhe rekomandimet për zgjidhjen e tyre në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura".

9. ERRU-ja në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, të ketë në fokus kryesor të vëmendjes reduktimin e stafit të tepërt të shoqërive UK rajonale kur këto do të aplikojnë për tarifa të reja pranë saj, si dhe të monitorojë dhe rekomandojë nivelin e pagave dhe shpërblimeve që ndikojnë në shpenzime.

10. Me hyrjen në fuqi të reformës, ERRU-ja të bashkëpunojë me institucionet përkatëse duke vlerësuar nevojat dhe fondet e nevojshme për realizimin e monitorimeve dhe të sigurisë së veprave të sistemeve të furnizimit me ujë dhe KUN, dhe njëkohësisht të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për rishikimin e legjislacionit për të vendosur në baza konkrete dhe me kosto të arsyeshme garantimin e sigurisë së objekteve me karakter strategjik të sistemeve të furnizimit me ujë.

11. ERRU-ja të kryejë një analizë lidhur me strategjinë dhe mundësinë e tarifave që duhet të propozojnë për miratim shoqëritë e reja rajonale pranë ERRU-së me synim dhe prioritet që ato të jenë të unifikuara për secilën shoqëri UK Rajonale. Kjo analizë të shoqërohet me konkluzione dhe rekomandime për realizimin konkret të strategjisë së mundësisë së unifikimit të tarifave me fokus përmirësimin e performancës së sektorit UK.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 30.3.2023.

VENDIM
Nr. 189, datë 5.4.2023

PËR MIRATIMIN E PLATFORMËS SË MONITORIMIT DHE VERIFIKIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, e të pikës 6, të nenit 8, të ligjit nr. 124/2015, "Për eficiencën e energjisë", të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim krijimin e Platformës së Monitorimit dhe Verifikimit për Eficiencën e Energjinë, në vazhdim PMVEE, e cila shërben si bazë të dhënash për të vlerësuar arritjen e objektivave kombëtarë të eficiencës së energjisë.

2. Termat e përcaktuar në ligjin nr. 124/2015, "Për eficiencën e energjisë", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

a) "PMVEE", baza e të dhënave shtetërore në përgjegjësi administrimi të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë dhe që shërben për monitorimin e planeve kuadër të eficiencës së energjisë apo planeve për zvogëlimin e ndryshimeve klimatike, në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

b) "Sektorët", të gjithë sektorët ku do të realizohet monitorimi i konsumit energjetik dhe monitorimi i zbatimit të masave për rritjen e eficiencës së energjisë, duke përfshirë sektorin e ndërtesave publike apo private, sektorin e industrisë, transportin, ndriçimin publik, furnizimin me ujë dhe trajtimin e ujërave të ndotura e bujqësinë.

c) "Konsumatorët e tjerë të energjisë", konsumatorët të cilët kanë një konsum energjie elektrike ekuivalente më të vogël se 1 milion kWh;

ç) "Shoqëri e shitjes me pakicë të energjisë", një person fizik ose juridik që shet energji te konsumatorët fundorë.

3. Të dhënat parësore të PMVEE-së janë, si më poshtë vijon:

a) formatet e raportimit vjetor të konsumit të energjisë të cilat plotësohen nga konsumatorët e mëdhenj kryesorë të identifikuar në këtë vendim dhe dërgohen tek Agjencia për Eficiencën e Energjisë jo më vonë se data 28 shkurt e çdo viti;

b) metodologjia për llogaritjen e kursimeve sipas shtojcës 3, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) kursimi i energjisë, i llogaritur me metodologjinë, sipas shtojcës 3 dhe e shprehur në reduktimin e emetimit CO_2, në bazë vjetore;

ç) projektet e zbatuara që përfshijnë të dhënat e mëposhtme:

i. emërtimin e masës (projektit);

ii. energjinë e kursyer si rezultat i zbatimit të masës;

iii. emetimet e reduktuara të CO2;

iv. kostot e masave të zbatuara.

4. Të dhënat dytësore të PMVEE-së janë:

a) të dhënat e identifikimit të subjekteve që do të përdorin PMVEE-në si: NIPT-i, emërtimi i subjekti/institucionit;

b) të dhënat e licencave të subjekteve, si nr.licence;

c) të dhënat e ndërtesës, si indeksi i hartës, numri i pasurisë, zona kadastrale, sipërfaqja e gjurmës;

ç) të dhënat e adresës;

d) të dhënat e kontratës me OSHEE-në;

dh) të dhënat mbi rrugët, si emërtimi i rrugës, klasifikimi i rrugës.

5. PMVEE-ja ndërvepron me:

a) Regjistrin Tregtar, administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

b) Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

c) Regjistrin Elektronik të Pasurive të Paluajtshme, administruar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës;

ç) Regjistrin Kombëtar të Adresave, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

d) bazën e të dhënave për detyrimet për energjinë elektrike, administruar nga FSHU-ja (OSHEE);

dh) ARRSH *WEB* – GIS, administruar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Dhënës të informacionit në PMVEE, janë:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) konsumatorët e mëdhenj të energjisë;

c) shpërndarësit e energjisë dhe shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë;

ç) institucioni përgjegjës për statistikat;

d) konsumatorët e tjerë të energjisë të cilëve u kërkohet nga AEE-ja të raportojë të dhënat energjetike.

7. Subjekte të interesuara janë të gjitha subjektet e përmendura në pikën 6, të kreut I, si dhe ministria përgjegjëse për energjinë.

8. PMVEE-ja aksesohet dhe publikohet në faqen zyrtare të AEE-së.

9. Niveli i aksesimit në PMVEE është, si më poshtë vijon:

a) AEE-ja ka të drejta regjistrimi, përpunimi, raportimi, leximi, shkrimi dhe përditësimi për të dhënat e regjistruara;

b) subjektet sipas pikës 6, të kreut I, kanë akses të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në leximin e të dhënave, krijimin e dokumenteve për paraqitjen e raporteve dhe masat e marra sipas këtij vendimi;

c) ministria përgjegjëse për energjinë ka akses të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në leximin e të dhënave.

II. PROCESI I MONITORIMIT DHE DETYRAT E KONSUMATORËVE KRYESORË

1. Procesi i monitorimit dhe verifikimit udhëhiqet nga agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë, në vazhdim AEE, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë.

2. Ky vendim i shtrin efektet e tij për:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) konsumatorët e mëdhenj të energjisë;

c) shpërndarësit e energjisë dhe shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë;

ç) institucionin përgjegjës për statistikat;

d) konsumatorët e tjerë të energjisë të cilëve u kërkohet nga AEE-ja të raportojë të dhënat energjetike.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore:

a) paraqesin raporte vjetore, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi, për konsumin e energjisë sipas sektorëve, në përputhje me afatet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 3, të kreut I;

b) krijojnë llogari në programin kompjuterik PMVEE dhe raportojnë çdo masë të eficiencës së energjisë të zbatuar në territorin e tyre në kuadër të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Eficiencën e Energjisë;

c) përfshijnë në kriteret për marrje shërbimesh, licencash apo lejesh etj. kërkesa që lidhen me raportimin e këtyre masave prej palëve të treta;

ç) punësojnë një menaxher energjie, sipas nenit 10, të ligjit nr. 124/2015, "Për eficiencën e energjisë", të ndryshuar, i cili do të jetë përgjegjës për realizimin e këtij procesi dhe përcjellin të dhënat e kontaktit për të, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, në vazhdim "KME":

a) paraqesin raporte vjetore, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi, në përputhje me afatet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 3, të kreut I;

b) punësojnë një menaxher energjie, sipas nenit 10, të ligjit nr. 124/2015, "Për eficiencën e energjisë", të ndryshuar, i cili do të jetë përgjegjës për realizimin e këtij procesi dhe përcjellin të dhënat e kontaktit për të, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

c) të cilët kanë certifikuar sistemin e menaxhimit të energjisë sipas ISO 50001, krijojnë llogari në programin kompjuterik PMVEE dhe raportojnë çdo masë të eficiencës së energjisë të zbatuar në territorin e tyre, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë.

5. Shpërndarësit e energjisë dhe shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë:

a) raportojnë sipas shtojcës 2 sasinë e energjisë së tregtuar, sipas afateve të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 3, të kreut I;

b) dërgojnë brenda datës 31 janar të çdo viti listën e klientëve fundorë të energjisë elektrike që gjatë vitit paraardhës kanë pasur një konsum më të madh se 0.5 milion kWh energji ekuivalente;

c) raportojnë të dhëna lidhur me energjinë e humbur në rrjetin e shpërndarjes, për arsye teknike dhe joteknike, duke përfshirë dhe investimet e realizuara gjatë vitit të raportimit dhe kursimet e arritura si rezultat i aplikimit të masave për përmirësimin e rrjetit elektroenergjetik.

Raportimet sipas përcaktimeve të kësaj pike duhet të realizohen sipas afateve të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 3, të kreut I.

6. Institucioni përgjegjës për statistikat, në bashkëpunim me AEE-në harton formatet për realizimin e pyetësorëve në nivel kombëtar me qëllim pasurimin e bazës së të dhënave kombëtare mbi konsumin e energjisë, sipas ligjit nr.124/2015, "Për eficiencën e energjisë", të ndryshuar.

7. Konsumatorët e tjerë të energjisë:

a) me kërkesë të AEE-së, janë të detyruar të raportojnë mbi të dhënat energjetike sipas shtojcës 2. Kërkesa për raportim dërgohet në rrugë elektronike ose shkresore;

b) të cilët konsumojnë më shumë se 1 milion kWh energji elektrike ekuivalente duhet të njoftojnë AEE-në për t'i klasifikuar si konsumatorë të mëdhenj brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë:

a) është përgjegjëse për mbarëvajtjen e këtij procesi;

b) përfshin në kriteret për lëshimin e CPE-së kërkesa që lidhen me raportimin nga audituesit e energjisë të të dhënave të nevojshme për masat e zbatuara në kuadër të zhvillimit të këtij procesi;

c) kërkon brenda muajit shkurt të çdo viti nga konsumatorët, që kanë konsumuar 0.5-1 milion kWh gjatë vitit paraardhës, të paraqesin të dhëna lidhur me konsumin e burimeve të tjera të energjisë, nëse kanë, për vitin paraardhës. Konsumatorët i dërgojnë të dhënat e kërkuara sipas kësaj shkronje brenda datës 31 mars;

ç) bën llogaritjet e konsumit total të energjisë nga konsumatorët, subjekt i shkronjës "c" të kësaj pike, i ekuivalentuar në kWh/vit sipas tabelës së konvertimit të aneksit IV të direktivës 2012/27/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 25 tetor 2012 për eficiencën e energjisë dhe përfshin në listën e konsumatorëve të mëdhenj të gjithë konsumatorët me një konsum total të burimeve të energjisë më të madh se 1 milion kWh energji ekuivalente në vit;

d) krijon dhe mban një listë të përditësuar të të gjithë konsumatorëve të mëdhenj të energjisë;

dh) monitoron në terren kryesisht ose me kërkesë të gjitha masat që janë ndërmarrë nga konsumatorët e identifikuar në këtë vendim, në formën e investimeve me qëllim uljen e konsumit të energjisë dhe bën verifikimet përkatëse lidhur me vlerën e reduktimit të energjisë dhe gazeve me efekt serë;

e) gjatë procesit të monitorimit përfshin të paktën 3 nëpunës të autorizuar, ku njëri prej tyre është kryetari dhe 2 anëtarët;

ë) merr masat administrative sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 124/2015, "Për eficiencën e energjisë", të ndryshuar, dhe në këtë vendim;

f) realizon trajnimet e nevojshme të personave përgjegjës për përdorimin e programit kompjuterik (PMVEE) brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

g) në mënyrë të detajuar, AEE-ja dërgon te ministria përgjegjëse për energjinë raportin kombëtar mbi konsumin e energjisë dhe reduktimin e emetimit CO_2 jo më vonë se data 30 qershor e çdo viti.

III. VERIFIKIMI DHE REGJISTRIMI I TË DHËNAVE

1. AEE-ja harton formatin e bazës së të dhënave kombëtare të energjisë e cila miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë.

2. AEE-ja regjistron të gjitha të dhënat e përftuara të konsumit të energjisë në bazën e të dhënave kombëtare.

3. Të dhënat e dërguara nga konsumatorët e mëdhenj të energjisë lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit regjistrohen nga AEE-ja tek programi PMVEE.

4. Pas trajnimit të menaxherit të energjisë, të punësuar pranë konsumatorit të madh të energjisë, AEE-ja me pëlqimin e saj lejon krijimin e llogarisë te PMVEE-ja dhe raportimi realizohet drejtpërdrejt nga konsumatori i madh i energjisë.

5. Bazuar në programin kompjuterik PMVEE, AEE-ja krijon një regjistër për projektet e zbatuara, që përfshin të dhënat e mëposhtme:

a) emërtimin e masës (projektit);

b) energjinë e kursyer si rezultat i zbatimit të masës;

c) emetimet e reduktuara të CO_2;

ç) kostot e masave të zbatuara.

6. Regjistri për projektet e zbatuara duhet të përfshijë të gjithë sektorët dhe një kopje dërgohet te ministria përgjegjëse për energjinë jo më vonë se data 30 qershor e çdo viti.

7. Të dhënat dhe informacioni i marrë e i mbledhur nga AEE-ja sipas këtij vendimi është konfidencial dhe mund të përdoret vetëm për qëllim të kryerjes së aktiviteteve të AEE-së për eficiencën e energjisë. AEE-ja ndërmerr të gjitha masat teknike dhe organizative sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të informacionit të ndjeshëm tregtar, duke siguruar mbrojtjen e këtyre të dhënave gjatë përpunimit, përdorimit apo publikimit të tyre.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia për Eficiencën e Energjisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, shpërndarësit e energjisë dhe shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë, institucioni përgjegjës për statistikat dhe konsumatorët e tjerë të energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

SHTOJCA 1

FORMATI I RAPORTIT TË KONSUMIT TË ENERGJISË ME BAZË MUJORE PËR NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

1. Sektori i ndërtesave

Ndërtesat në administrimin të Bashkisë, përfshirë kopshtet, çerdhet, shtëpitë dhe qendrat sociale, shkollat fillore dhe gjimnazet, konviktet, njësitë, si dhe të gjitha ndërtesat e tjera në pronësi të bashkisë.

	EMËRTIMI		1	2	…
A	Emri i ndërtesës/adresa				
B	Koordinatat e vendndodhjes sipas sistemit KRRGJSH				
C	Bashkia				
D	Funksioni për të cilin përdoret ndërtesa				
E	Indeksi i hartës				
F	Numri i pasurisë				
G	Zona kadastrale				
H	Sipërfaqja e gjurmës				
I	Sipërfaqja totale e kateve të ndërtesës [m²]				
J	Numri i kateve				
K	Vëllimi [m³]				
L	Viti i ndërtimit				
M	Rikonstruktuar	po (viti)			
		Jo			
N	Izolim termik (mm)				
O	Tipologjia e dritareve				
P	Konsumi i energjisë për vitin 2018–2021	Energji elektrike (kWh)			
		Biomasë (kg)			
		Naftë (litra)			
		Gaz (LPG)			
		Qymyr (kg)			
Q	Numri i kontratës me OSHEE-në				
R	Institucioni me përgjegjësi administrative				
S	Enti përdorues statusi juridik				

Përkufizime

A Emri i ndërtesës dhe adresa e vendndodhjes së saj

B Koordinatat e vendndodhjes së ndërtesës të Gjendura përmes ASIG Geoportal, Sistemit koordinativ KRRGJSH - është sistemi koordinativ zyrtar në përputhje me ligjin nr. 72/2012

C Bashkia në territorin e së cilës ndodhet ndërtesa

D Funksioni për të cilin është në përdorim ndërtesa (shkollë, spital, konvikt etj.

E Indeksi i hartës i identifikuar përmes ASIG Geoportal

F Numri i pasurisë i identifikuar përmes ASIG Geoportal

G Sipërfaqja e gjurmës së ndërtesës në m²

H Sipërfaqja totale e secilit kat të ndërtesës që është i izoluar nga ambienti i jashtëm m²

I Numri i kateve të ndërtesës

J Vëllimi m³

K Viti në të cilin ndërtesa ka përfunduar së ndërtuari Rikonstruksioni:

L Po – nëse ndërtesa është rikonstruktuar ndonjëherë dhe në cilin vit
Jo – nëse ndërtesa nuk i është nënshtruar ndonjëherë rikonstruksionit

M Shënoni nëse ndërtesa ka izolim termik apo jo. Nëse njihet lloji i termoizolimit dhe trashësia e tij të shënohet.

N Lloji i dritareve, nëse janë dopio xham apo me një xham.

O Konsumi i energjisë për vitin 2018 në varësi të bartësve të energjisë

P Konsumi i energjisë për vitin 2019 në varësi të bartësve të energjisë

Q Konsumi i energjisë për vitin 2020 në varësi të bartësve të energjisë

R Konsumi i energjisë për vitin 2020 në varësi të bartësve të energjisë

S Numri i kontratës së lidhjes me FSHU (Furnizuesin e Shërbimit Universal) OSHEE

T Institucioni me përgjegjësi administrative (p.sh. Ministria e Shëndetësisë)

U Enti përdorues statusi juridik (p.sh. Drejtoria e Shëndetit Publik Bërat);

2. Sektori furnizimit dhe trajtimit të ujit

A. Të dhëna të përgjithshme

1	Emri i stacionit	
2	Adresa	
3	Person kontakti	
4	Email	
5	Celular	
6	Vendndodhja (koordinatat sipas sistemit koordinativ KRRGJSH)	
7	Niveli i tensionit	
8	Numri i konsumatorëve që u shërben	

B. Të dhëna mbi sistemet ekzistuese

	Emërtimi	Njësia	Pompa 1 (marka)	Pompa 2 (marka)	…
9	Prurja	m3/h			
10	Presioni (H në metra)	metra			
11	Fuqia e elektromotorit	kW			
12	Tensioni	V			
13	Orët e punës në vit	h			
14	Marka/modeli i pompës	-			
15	Lloji i pompës	-			
16	Marka/modeli i elektromotorit	-			
17	Viti i prodhimit të elektromotorit	-			
18	Viti i prodhimit të pompës				
19	Klasi i elektromotorit (IE1, IE2, IE3, IE4)	-			
20	Soft Starter (po/jo)	-			
21	Kontroll Skada (po/jo)	-			

C. Të dhëna energjetike me bazë mujore

	Emërtimi	Njësia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
22	Energjia aktive	kWh												
23	Energjia PIK	kWh												
24	Energjia reaktive	kVAhr												
25	Kosto totale e energjisë aktive	lekë pa tvsh												
26	Kosto totale e energjisë pik	lekë pa tvsh												
27	Kosto totale e energjisë reaktive	lekë pa tvsh												
28	Nr. i ndërprerjeve	nr												
29	Kohëzgjatja e ndërprerjeve	h												
30	Sasia e ujit të humbur	m3												

Përkufizime

1 **Sistemit koordinativ KRRGJSH** – është sistemi koordinativ zyrtar në përputhje me ligjin nr. 72/2012

9 **Prurja** – është vlera e treguar në etiketën e pompës, zakonisht në njësinë m^3/h ose litër/s

10 **Presioni** – është vlera e treguar në etiketën e pompës, zakonisht në njësinë metra, bar ose kpa

11 **Fuqia e elektromotorit** – është vlera e treguar në etiketën e elektromotrit, zakonisht në njësinë kë ose HP

12 **Tensioni** – është tensioni në hyrje të elektromotorit

13 **Orët e punës në vit** – sa orë punon pompa në një vit kalendarik (një vit kalendarik = 8760 orë)

14 **Marka/modeli i pompës** – marka i referohet zakonisht prodhuesit të pompës ndërsa modeli tregohet në etiketën e pompës (mund të përbëhet nga numra dhe shkronja).

15 **Lloji i pompës** – ka të bëjë me mekanizmin e funksionimit të pompës, p.sh. centrifugale, me piston, me burmë etj.

16 **Marka/modeli i elektromotorit** – marka i referohet zakonisht prodhuesit të elektromotorit ndërsa modeli tregohet në etiketën e elektromotorit (mund të përbëhet nga numra dhe shkronja).

17/18 **Viti i prodhimit** – tregohet në etiketën e pompës ose elektromotorit

19 **Klasi i elektromotorit** – ka të bëjë me eficiencën dhe tregohet në etiketën e elektromotorit

28 **Numri i ndërprerjeve** –- i referohet numrit të ndërprerjeve të shërbimit të furnizimit me ujë si pasojë e mungesës së energjisë elektrike

29 **Kohëzgjatja e ndërprerjeve** – i referohet kohës nga momenti i ndërprejres së energjisë elektrike deri në kthimin e energjisë elektrike dhe vënien e sistemit të pompimit në funksionim

30 **Sasia e ujit të humbur** - është diferenca ndërmjet sasisë së ujit të pompuar nga stacioni i furnizimit me ujë dhe sasisë së faturuar tek konsumatorët fundorë

3. Sektori i ndriçimit publik

EMËRTIMI		1	2	…
Emri i rrugës				
Klasifikimi i rrugës				
Numri i shtyllave me ndriçues	copë			
Numri i ndriçuesve	copë			
Lloji i ndriçuesve				
Fuqia	watt			
Kontroll për reduktimin e ndriçimit	Po/jo			
Ora e ndezjes				
Ora e fikjes				
Kontrolli i ndezjes/fikjes	Manual ose automatik			
Panele diellore	po/jo			
Nëse po, fuqia e panelit	watt pik			
Konsumi mujor i energjisë elektrike	janar			
	shkurt			
	mars			
	prill			
	maj			
	qershor			
	korrik			
	gusht			
	shtator			
	tetor			
	nëntor			
	dhjetor			
Person kontakti				
Email				
Celular				

Përkufizime

1 **Klasifikimi i rrugës** – është klasifikimi në varësi të llojit të përdorimit, p.sh.: autostradë, rrugë për këmbësor, rrugë rurale etj.

2 **Lloji i ndriçuesve** – i referohet teknologjisë së ndriçuesit, p.sh. inkandeshente, led, CFL, halogjen etj.

3 **Fuqia** – është fuqia që tregohet në etiketën e ndriçuesit.
Kontroll për reduktimin e ndriçimit – mund të jetë pjesë e integruar e ndriçuesit e cila mund të reduktojë sasinë e ndriçimit dhe si rezultat dhe energjinë e konsumuar.

4. Sektori i transportit publik

A. Të dhëna të përgjithshme

1	Emërtimi i linjës	
2	Person kontakti	
3	Email	
4	Celular	
5	Gjatësia e linjës	
6	Numri i stacioneve	
7	Nr. i autobusëve në pik	

B. Të dhëna mbi automjetet

	Emërtimi	Njësia	Modeli 1	Modeli 2
1	Autobusë MDB	Copë		
2	Viti i prodhimit	-		
3	Fuqia	kW		
4	Bartësi i energjisë	-		

	Emërtimi	Njësia	Modeli 1	Modeli 2
1	Autobusë hibridë	Copë		
2	Viti i prodhimit			
3	Fuqia	kW		
4	Bartësi i energjisë	-		

	Emërtimi	Njësia	Modeli 1	Modeli 2
1	Autobusë elektrikë	Copë		
2	Viti i prodhimit	-		
3	Fuqia	kW		

C. Të dhëna energjetike me bazë mujore për linjën

	Emërtimi	Njësia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Energji elektrike	kWh												
2	Naftë	litra												
3	Benzinë	litra												
4	Gaz lpg	litra												
5	…	…												

Përkufizime

1 **Autobusë MDB –** autobusë me motorë me djegie të brendshme.

2 **Autobusë Hibrid –** Autobusë që përdorin për të funksionuar edhe lëndë djegëse fosile (naftë, benzinë) edhe energji elektrike.

SHTOJCA 2
FORMATI I RAPORTIT TË ENERGJISË SË SHITUR/ KONSUMUAR

	KONSUMI I BURIMEVE ENERGJETIKE													**Fuqia kalorifike**	
	Njësia matjes	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Njësia	Vlera Kal.
En. elektrike	kWh													kWh	
	lek/kwh														
Diezel	litra													kJ/kg	
	lek/litra														
Benzinë	litra													kJ/kg	
	lek/litra														
Solar	ton													kJ/kg	
	lek/ton														
Vajguri	litra													kJ/kg	
	lek/litra														
Gaz i lëngëzuar i naftës (LPG)	ton													kJ/kg	
	lek/ton														
Gaz natyror	1000m³ N													kJ/m³N	
	lek/1000m³ N														
Linjit	ton													kJ/kg	
	lek/ton														
Koks	ton													kJ/kg	
	lek/ton														
Antracit	ton													kJ/kg	
	lek/ton														
Dru zjarri	m³ stere													kJ/m³ stere	
	lek/m³ stere														
Peleta ose briketa druri	ton													kJ/kg	
	lek/ton														
Avull	ton													Kkal	
	lek/ton														
Ujë i ngrohtë	ton													Kkal	
	lek/ton														

SHTOJCA 3
METODOLOGJIA PËR LLOGARITJEN E KURSIMEVE POSHTË – LART
Metodologjia poshtë-lart (M&V) për Shqipërinë
Tiranë, janar 2020

Tabela e përmbajtjes

Hyrje
1. Mbështjellësen e ndërtesës dhe komponentët e saj
2. Sistemet e ajrit të kondicionuar
3. Sistemet e pompimit
4. Ngrohja qendrore
4.1 Eficienca energjetike në sistemet e ngrohjes qendrore pa rikonstruksion të godinave rezidenciale: me rikonstruksion të tyre dhe në blloqet e reja rezidenciale.
5.1 Instalimi i pompave të nxehtësisë në ndërtesat e reja dhe të rikonstruktuara
6. Masat për përmirësimin e sistemit të ngrohjes
6.1 Përmirësimi i prodhuesve të nxehtësisë, shpërndarjes dhe emetimit
6.2 Izolimi termik i rezervuarit të ujit të ngrohtë
6.3 Izolimi termik i tubacioneve në sistemin e ngrohjes
7. Motorët industrialë
7.1 Zëvendësimi i motorëve elektrikë industrialë
7.2 Ripërmasimi i motorëve elektrikë
9.2 *Eko-driving*
9.3 Përmirësimet e eficiencës përmes shfrytëzimit të lubrifikantëve të rinj dhe gomave të reja
9.4 Ndryshimi i mënyrës së transportit për pasagjerë
10. Pajisjet e zyrës
12. Zëvendësimi i kaldajave me rendiment të ulët
12.1 Zëvendësimi i një kaldaje të vjetër me një kaldajë me biomasë me rendiment të lartë
12.2 Kaldajat me biomasë
13. Panelet diellore termike
15. Sistemet e rikuperimit të nxehtësisë në ndërtesa
16.1 Blerja e pajisjeve elektroshtëpiake me eficiencë të lartë
16.2 Zëvendësimi i parakohshëm i pajisjeve elektroshtëpiake
1. Mbështjellësja e ndërtesës dhe komponentët e saj
1.1 Hyrje në kodin e ri të ndërtesave
1.2 Vlerësimi i kursimeve vjetore të energjisë në ndërtesat e reja rezidenciale dhe jorezidenciale duke përdorur mbështjellëse termike
1.4 Metodologjia e llogaritjes së kursimit të energjisë në ndërtesat rezidenciale (ekzistuese) të rinovuara (rikonstruktuar) duke përdorur mbështjellësen termike, pa ndryshuar sistemin e ngrohjes
2. Sistemet e ajrit të kondicionuar
2.1 Sistemet e ajrit të kondicionuar me më pak se 12 kW
3. Sistemet e pompimit
4. Ngrohja qendrore
5. Pompat e nxehtësisë
5.1 Instalimet e pompave të nxehtësisë në ndërtesat e reja dhe ato të rinovuara
6. Implementimi i masave për përmirësimin elementeve të veçanta të sistemit të ngrohjes
7. Përmirësimi (rikonstruktimi) i prodhuesit të nxehtësisë, shpërndarja dhe emetimi i nxehtësisë
8. Izolimi termik i rezervuarëve të ujit të ngrohtë
8.1.1 Identifikimi i vlerave
8.1.2 Jetëgjatësia e masave përmirësuese
8.1.2.1 Izolimi termik i tubacioneve në sistemet e ngrohjes *of pipes in the heating system*
8.1.3 Identifikimi i vlerave
8.1.4 Motorët industrialë
8.1.5 Zëvendësimi i motorëve elektrikë në industri
8.1.6 Jetëgjatësia
9. Ndriçimi
9.1 Ndriçimi në ndërtesat rezidenciale
Një përmbledhje e llambave eficiente LED me konsum të ulët të energjisë jepet në tabelën nr. 19 në aneks
9.2 Ndriçimi në ndërtesat jorezidenciale
9.3 Ndriçimi në sektorin e hoteleri-turizëm
9.4 Ndriçimi publik
9.5 Ndriçimi në ndërtesat industriale
10. Lëvizja (transporti)
10.1 Mjetet lëvizëse alternative
10.2 *Eko-driving*
10.3 Përmirësimet e eficiencës përmes shfrytëzimit të lubrifikantëve të rinj dhe gomave të reja
10.4 Ndryshimi i mënyrës së transportit të pasagjerëve
11. Pajisjet e zyrës
12. Impiantet fotovoltaike

13. Zëvendësimi i kaldajave me rendiment të ulët

13.1 Zëvendësimi i një kaldaje të vjetër me një kaldajë eficiente me biomasë

13.2 Kaldajat me biomasë

14. Panelet diellore termike

14.1 Ngrohja e banesës me anë të paneleve diellore

15. Pajisjet e kontrollit në regjimin *standby* në ndërtesat rezidenciale

16. Sistemet e rikuperimit të energjisë në ndërtesa

17. Pajisjet elektroshtëpiake

17.1 Blerja e pajisjeve elektroshtëpiake me eficiencë të lartë

17.2 Zëvendësimi i parakohshëm i pajisjeve elektroshtëpiake

Hyrje

Direktiva e Shërbimeve të Energjisë (ESD)[1] (Energy Services Directive) është një direktivë kornizë që përfshin një gamë të tërë aspektesh të ndryshme në lidhje me efikasitetin e energjisë. Direktiva e re është quajtur Energy Efficiency Directive (EED). Kjo direktivë (2012/27/EU) përcakton një sere masash detyruese me synim arritjen e targetit të rritjes së eficiencës energjetike në 20% deri në vitin 2020. Qëllimi i direktivës është që, përdorimi përfundimtar i energjisë të jetë më ekonomik dhe efikas lidhur me:

vendosjen e synimeve të arritshme, stimujve dhe kornizave institucionale, financiare dhe ligjore të nevojshme për të eliminuar pengesat dhe papërsosmëritë e tregut që parandalojnë përdorimin efikas të energjisë fundore; dhe

1. krijimin e kushteve për zhvillimin dhe promovimin e një tregu për shërbime energjetike dhe për ofrimin e programeve të kursimit të energjisë dhe masave të tjera që synojnë përmirësimin e efikasitetit të energjisë në përdorimin përfundimtar.

ESD siguron një metodologji të përgjithshme për matjen dhe verifikimin e kursimeve të energjisë, poshtë-lart (*Bottom–up*), për të vlerësuar kursimin e energjisë dhe për të promovuar masat dhe programet më efektive për përmirësimin e eficiencës së energjisë. Metodologjitë e prezantuara në këtë raport ofrojnë një përmbledhje të metodave nga poshtë-lart për llogaritjen e kursimeve të energjisë të zhvilluara me ndihmën edhe të GIZ për kushtet shqiptare, të përqendruara veçanërisht në masat e EE në stokun e ndërtesave (përfshirë të dy sektorët: ato rezidenciale dhe ato të shërbimit).

Treguesit e efikasitetit të energjisë paraqesin shkallen e kursimit të energjisë në lidhje me një vlerë reference. Në përgjithësi, ka tri lloje indikatorësh që shprehin efikasitetin e energjisë:

a) Indikatorët ekonomikë: Intensiteti i energjisë dhe/ose intensiteti i karbonit [kWh/EUR, CO_2 / EUR];

b) Indikatorët teknikë: energjia e konsumuar për njësi të prodhimit fizikisht [kWh/ton prodhimi, kWh/euro etj. (indeksi i prodhimit)]: konsumi specifik [kWh/aplikim, kWh/njësi banimi, kWh/m^2 e sipërf. së ngrohur; litra/100 km etj.;

c) Indikatorë të shpërndarjes: pjesa e tregut të pajisjeve me efikasitet energjetik, e burimeve të rinovueshme të energjisë, e procedurave efikase [p.sh. shkalla e shpërndarjes së tregut të llambave me efikasitet energjetik; pajisjeve shtëpiake A ++, sistemeve termike diellore; ndarjes modale në (transportin e mallrave) etj.].

Për matjen e kursimit të energjisë përmes metodave nga poshtë-lart (B-U) duhet të sigurohen dhe administrohen të gjitha masat që synojnë përmirësimin e efikasitetit në një mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE) duhet të krijojë një bazë të dhënash të cilat shërbejnë në aplikimin e metodologjisë së prezantuar në këtë raport.

Në këtë raport do të prezantohet në mënyrë të thjeshtë metodologjia nga poshtë-lart për vlerësimin e kursimeve të energjisë. Kjo metodologji, e cila mbështetet dhe në përvojat më të mira të BE-së: "Vlerësimi dhe monitorimi i direktivës së BE-së mbi përdoruesit fundore të energjisë dhe shërbimet e energjisë (EMEEES)", synon të jetë e thjeshtë në përdorim edhe nga njësitë e qeverisjes vendore.

Si parakushtet për krijimin e kësaj metodologjie M&V & E, duhen:

a) statistikat e përshtateshe të energjisë; dhe

b) konsumatorët e mëdhenj e përfshirë dhe kornizat ligjore të vendit tonë dhe të EU në lidhje me EE.

[1] Direktiva 2006/32/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 5 prill 2006 "on energy end-use efficiency and energy services" ka zëvendësuar direktivën 93/76/EEC.

Formulat llogaritëse të kësaj metodologjie përdoren kryesisht për gjithë tipat e rinovimit, zëvendësimit ose konstruksionet e reja të ndërtesave ose zëvendësimin e instalimeve energjetike në ndërtesa. Në këtë metodologji janë dhënë edhe formulat llogaritëse të kursimit të energjisë në sektorin e mobilitetit; sektorin shtëpiak; ndriçimin rrugor dhe në ndërtesat industriale, si edhe në sektorin industrial. Tri janë kategoritë ku mund të përdoren formulat e dhëna në këtë metodologji janë:

Kategoria 1: Zëvendësimi i pajisjeve ekzistuese më të reja, me eficiente;

Kategoria 2: Eficienca e energjisë gjatë rinovimit të ndërtesave;

Kategoria 3: Ndërtesa të reja të konstruktuara sipas kodeve të eficiencës energjetike.

Për kategoritë 1 dhe 2 në rast se vlerat "**para**" dhe "**pas**" të konsumit përfundimtar të energjisë (në kWh në vit) janë të njohura p.sh. përmes një auditi energjetik të kryer "para" dhe "pas" rinovimit ose zëvendësimit, për ndërtesën individuale (të vetme), pajisje ose aparate, atëherë këto vlera individuale "para" dhe "pas" mund të përdoren në vend të formulave të rekomanduara në këtë metodologji për të llogaritur kursimet unitare. Formulat e rekomanduara mundësojnë llogaritjen e kursimeve të njësive vjetore përfundimtare të energjisë (UFES) për secilën nga masat ose programet e përmirësimit të efikasitetit të energjisë të listuara më lart.

Ne rastin e disa njësive, llogaritja e kursimit të përgjithshëm të energjisë bëhet bazuar në shumën e kursimeve vjetore të elementeve të njësive përbërëse dhe duke marrë parasysh kohëzgjatjet specifike të jetës së masës së zbatuar. Në rast se, kursimet unike të energjisë përfundimtare janë identike për të gjitha njësitë ose janë mesatarisht të njëjta në njësitë përbërëse, kursimi i përgjithshëm i energjisë llogaritet duke shumëzuar kursimet vjetore të një njësie me numrin e njësive përbërëse që i nënshtrohen së njëjtës masë ose programi. Nëse nuk janë në dispozicion vlerat për njësitë individuale "para" dhe "pas", atëherë UFES llogaritet duke u nisur nga disa vlera bazë të kombinuara nëpërmjet disa koeficienteve me vlerat mesatare kombëtare.

Kjo metodologji përcakton modelin llogaritës për kursimet vjetore të energjisë në rastet e mëposhtme:

1. Mbështjellësen e ndërtesës dhe komponentët e saj

1.1 Hyrje në kodin e ri të ndërtesave

1.2 Vlerësimi i kursimit të energjisë në ndërtesat e reja rezidenciale dhe jorezidenciale duke ndërhyre në mbështjellësen termike të saj.

1.3 Vlerësimi i kursimit të energjisë pas rikonstruksionit të përgjithshëm të veshjes termike dhe të sistemit të ngrohjes në ndërtesat ekzistuese rezidenciale dhe jorezidenciale.

1.4 Metodat e vlerësimit të kursimit të energjisë në ndërtesat ekzistuese rezidenciale dhe jorezidenciale pas rinovimit të tyre vetëm të mbështjellëses termike pa ndryshuar sistemin e ngrohjes.

1.5 Vlerësimi i eficiencës së energjisë në rastet e ndërhyrjeve special në elemente të veçanta të ndërtesës.

2. Sistemet e ajrit të kondicionuar

2.1 Sistemet e ajrit të kondicionuar me më pak se <12 kW

3. Sistemet e pompimit

3.1 Instalimi i sistemeve të reja të pompave.

4. Ngrohja qendrore

4.1 Eficienca energjetike në sistemet e ngrohjes qendrore pa rikonstruksion të godinave rezidenciale: me rikonstruksion të tyre dhe në blloqet e reja rezidenciale.

5. Pompat e nxehtësisë

5.1 Instalimi i pompave të nxehtësisë në ndërtesat e reja dhe të rikonstruktuara

6. Masat për përmirësimin e sistemit të ngrohjes

6.1 Përmirësimi i prodhuesve të nxehtësisë, shpërndarjes dhe emetimit

6.2 Izolimi termik i rezervuarit të ujit të ngrohtë

6.3 Izolimi termik i tubacioneve në sistemin e ngrohjes

7. Motorët industrialë

7.1 Zëvendësimi i motorëve elektrikë industrialë

7.2 Ripërmasimi i motorëve elektrikë

7.3 Motorët me shpejtësi variabile VSD

8. Ndriçimi

8.1 Ndriçimi në ndërtesat rezidenciale

8.2 Ndriçimi me eficiencë të lartë në ndërtesat jorezidenciale

8.3 Ndriçimi eficient në hoteleri-turizëm

8.4 Ndriçimi publik

8.5 Ndriçimi në ndërtesat industriale

9. Lëvizja

9.1 Mjetet lëvizëse alternative

9.2 *Eko-driving*

9.3 Përmirësimet e eficiencës përmes shfrytëzimit të lubrifikantëve të rinj dhe gomave të reja

9.4 Ndryshimi i mënyrës së transportit për pasagjerë

10. Pajisjet e zyrës

11. Impiantet fotovoltaike

12. Zëvendësimi i kaldajave me rendiment të ulët

12.1 Zëvendësimi i një kaldaje të vjetër me një kaldajë me biomasë me rendiment të lartë

12.2 Kaldajat me biomasë

13. Panelet diellore termike

13.1 Ngrohja e banesës me anë të paneleve diellore

14. Pajisjet e kontrollit në regjimin standby në ndërtesat rezidenciale

15. Sistemet e rikuperimit të nxehtësisë në ndërtesa

16. Pajisjet elektroshtëpiake

16.1 Blerja e pajisjeve elektroshtëpiake me eficiencë të lartë

16.2 Zëvendësimi i parakohshëm i pajisjeve elektroshtëpiake

Bottom-up **metodologji për Shqipërinë**

"Eficienca e energjisë" nënkupton raportin në përqindje, të energjisë në dalje me energjinë në hyrje, në të njëjtin sistem energjetik, që në rastin tonë është ndërtesa. Ky është përcaktim teorik i saj. Më thjesht do të thoshim se "eficiencë energjie" kemi atëherë kur në një proces energjetik arrijmë rezultate të njëjta duke përdorur më pak energji. Teprica e energjisë në këtë rast është energjia e kursyer nga marrja e masave për të ulur sasinë e përdorur në këtë proces. [*Shërbimet e Konsulencës së IFC në Evropë dhe Azinë Qendrore-Tiranë]*

1. Mbështjellësja e ndërtesës dhe komponentët e saj

Sektori i targetuar: ndërtesa rezidenciale: ndërtesa publike dhe ndërtesa të shërbimit privat (ndërtesa terciare)

Në këtë kapitull do të paraqesim një metodologji për llogaritjen e kursimit të energjisë nëpërmjet implementimit të masave të eficiencës energjetike në ndërtesat 1) rezidenciale të reja 2) rezidenciale të rinovuara 3) ndërtesave jorezidenciale, pra të shërbimit privat (ndërtesat terciare).

1.1 Hyrje në kodin e ri të ndërtesave

Më poshtë po japim një metodë të përgjithshme për llogaritjen e kursimeve vjetore të energjisë në rastin e implementimit të kërkesave për nxehtësi në përputhje me eficiencën e energjisë (EE) për ndërtesat e reja rezidenciale dhe terciare.

Bu Formula
TFES = $A \cdot \left(\frac{SHD_{inocod}}{\eta_{inocod}} - \frac{SHD_{newcod}}{\eta_{newcod}}\right)$
përcaktime
TFES – Energjia totale e kursyer vjetore [kWh/vit]
A- Sipërfaqja e godinës së re [m²]
SHD_{inocod}-Kërkesa për nxehtësi specifike për ndërtesat e reja sipas kodit energjetik të vitit 2002 ligji nr. 8937 të shprehur në kWh/m²/vit
SHD_{newcod} - Kërkesa për nxehtësi specifike për ndërtesat e reja sipas kërkesave të eficiencës energjetike kWh/m²/vit
η_{inocod} – Eficienca e përdorimit vjetor të sistemit të ngrohjes në ndërtesat e reja sipas kodit të vjetër
$\eta_{newcod-}$ Eficienca e përdorimit vjetor të sistemit të ngrohjes në ndërtesat e reja sipas kodit të ri
Të dhënat fillestare për nisjen e procedurës
Kërkesat specifike për nxehtësi merren në bazë të kodit të banesave duke iu referuar vitit përkatës. Nëse mungojnë të dhënat sipas kodit atëherë merret një vlerë mesatare e kërkesave për nxehtësi. Në rast se kërkesat e eficiencës së energjisë tejkalojnë kërkesat e kodit atëherë si vlerë fillestare në formulën e mësipërme merret e dhëna nga kodi energjetik i banesës sipas ligjit nr. 8937, datë 12.9.2002, "Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 16.1.2003, "Për miratimin e normave, rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa", dhe si *newcode* merren të dhënat nga kërkesat e eficiencës së energjisë. Ndërkohë, nëse kodi imponon kërkesa lidhur me eficiencën e energjisë, atëherë këto duhen pasqyruar në formulën e mësipërme. Kërkesa për energji specifike për ngrohje duhet të korrigjohet në lidhje me GDN.

Vlerat:

Vlefshmëria në kohë e masave të aplikuara rekomandohet ose merret sipas projektit specifik

Sipërfaqja ngrohëse, e dhënë ose sipas një projekti specifik

Eficienca e përdorimit vjetor të sistemit të ngrohjes në ndërtesat e reja sipas kodit të vjetër, rekomandohet ose merret sipas një projekti specifik

Eficienca e përdorimit vjetor të sistemit të ngrohjes në ndërtesat e reja sipas kërkesave të eficiencës së energjisë, rekomandohet ose merret sipas një projekti specifik

1.1.1 Vlera të dhëna

Aplikimi i formulave të mësipërme kërkon një model të ndërtesës duke specifikuar sipërfaqen përkatëse: kërkesat mesatare për energji specifike për tipin e ndërtesës: (sipas kodit dhe sipas kërkesave të eficiencës së energjisë): kërkesat për ujë të ngrohtë sanitar, si edhe rendimentin e sistemit të ngrohjes bazuar në konsideratat për strukturat ngrohëse në vend.

Jetëgjatësia e masave të aplikuara: të dhënat e mëposhtme bazohen në dokumentin: *"Recommandations on Measurment and Verification methods in framework of directive 2006/32/EC on Energy End-Use Efficiency and Energy Services".*

- Veshja termike: mbështjellësja termike e ndërtesës – izolimi termik i mureve kavitative dhe çdo izolim tjetër i konstruksionit (solid / druri) rekomandohet 30 vjet;

- izolimi termik i papafingove/tarraca dhe dysheme rekomandohet 25 vjet;

- bojlerë të vegjël deri në 30 kW fuqi në dalje rekomandohet 20 vjet;

- bojlerë të mëdhenj mbi 30 kW fuqi në dalje parazgjidhet 25 vjet;

- dritaret me vlerë të ulët të U rekomandohet 30 vjet;

- kontrolli i sistemit të ngrohjes, modernizim me zëvendësim të bojlerëve rekomandohet 15 vjet.

Sipërfaqja që merr nxehtësi: kjo madhësi përcaktohet sipas modelit të ndërtesës. Sipërfaqja mesatare mund të llogaritet sipas të dhënave statistikore kombëtare ose nga analiza e certifikatës së energjisë ose nga database kombëtare e energjisë.

Kërkesa për nxehtësi specifike (Kodi i vjetër dhe i ri i ndërtesës): mund të përdorim si *default* të dhënat e tab. 1 ose nëse ne kemi të dhëna për konstruksionin e ndërtesës nëpërmjet një auditi që mund të jetë bërë mund të përdorim tabelën tab. 2 dhe 3.

Eficienca e përdorimit vjetor të sistemit të ngrohjes: përcaktohet nga raporti midis energjisë se përdorur për ngrohje plus energjinë e nevojshme për ujë të ngrohtë me energjisë e prodhuar nga prodhuesi i energjisë (bojleri). Tab. 4.

Kursimet e energjisë primare P.E.S.

P.E.S. llogaritet mbi bazën e FES dhe duke bërë korrigjimin përkatës me anë të faktorit të konvertimit.

$$PES = \left(\frac{SHD_{ini}}{\eta_{ini}} \cdot f_{PES}^{ini} - \frac{SHD_{new}}{\eta_{new}} \cdot f_{PES}^{new}\right) \cdot A_k$$

Në formulën e mësipërme madhësitë f_{PES}^{ini} dhe f_{PES}^{new} janë faktoret e konvertimit të energjisë që varen nga tipi i lëndës djegëse të përdorur përpara dhe pas rikonstruksionit pra pas implementimit të masave që parashikon projekti i EE. Në rast se nuk kemi ndryshim të llojit të lëndës djegëse, pra përdoret e njëjta lëndë djegëse si para dhe pas projektit atëherë ky faktor mbetet i njëjte. Faktori i konvertimit në PES është dhënë në tab. 5 dhe 5/1.

1.2 Vlerësimi i kursimeve vjetore të energjisë në ndërtesat e reja rezidenciale dhe jorezidenciale duke përdorur mbështjellëse termike

1.2.1 Ndërtesat e reja konsiderohen eficencë nga pikëpamja e energjisë nëse ato plotësojnë një standard më të lartë të EE sesa përcaktohet në kodin kombëtar të ndërtimeve të reja.

Formulat e mëposhtme vlejnë për të gjitha ndërtesat e banimit të reja, vila ose pallate me shumë apartamente ose për blloqe të mëdha banimi, si edhe për ndërtesat jorezidenciale:

Formula për llogaritjen e TFES është:

$$TFES = A \cdot \left(SHD_{ref} - SHD_{Eff}\right) \cdot \frac{1}{\eta_{Eff}}$$

Elementet në formulën e mësipërme përfaqësojnë:

$\boldsymbol{TFES}\left(\frac{kWh}{vit}\right)$	Kursimi final i përgjithshëm i energjisë në vit (**T**otal **F**inal **E**nergy **S**aving - *FES*)
η_{Eff}	Rendimenti i sistemit të ngrohjes në ndërtesën e re
$SHD_{ref}\left(\frac{kWh}{m^2}/vit\right)$	Kërkesa për nxehtësi specifike në ndërtesën referente (të re)
$SHD_{Eff}\left(\frac{kWh}{m^2}/vit\right)$	Kërkesa për nxehtësi specifike në ndërtesë sipas kushteve të EE
$A(m^2)$	Sipërfaqja totale e ndërtesës së re që ngrohet në m²

1.2.2 Parametrat hyrës

Siç shihet nga formula e mësipërme për llogaritjen e TFES duhet të njihet kërkesa për sasinë e nxehtësisë që duhet në ndërtesën e re sipas kushteve të EE. Ne mund të përdorim vlerat e tab. 1

1.2.3 Eficienca e përdorimit vjetor të sistemit të ngrohjes

Përdorim të dhënat e tab. 4

Jetëgjatësia e masave të aplikuara: të dhënat e mëposhtme bazohen në dokumentin *"Recommandations on Measurment and Verification methods in framework of directive 2006/32/EC on Energy End-Use Efficiency and Energy Services"*.

- Veshja termike: mbështjellësja termike e ndërtesës – izolimi termik i mureve kavitative dhe çdo izolim tjetër i konstruksionit (solid / druri) rekomandohet 30 vjet;
- izolimi termik i papafingove/tarraca dhe dysheme rekomandohet 25 vjet;
- bojlerë të vegjël deri në 30 kW fuqi në dalje rekomandohet 20 vjet;
- bojlerë të mëdhenj mbi 30 kW fuqi në dalje parazgjidhet 25 vjet;
- dritaret me vlerë të ulët të U rekomandohet 30 vjet;
- sistemi i kontrollit të ngrohjes, modernizim me zëvendësim të bojlerëve rekomandohet 15 vjet.

Reduktimi vjetor i CO_2 llogaritet:

$$E_{CO_2} = \frac{FES \cdot e}{1000}$$

ku:

$E_{CO_2}(\frac{ton}{annum})$	Emisionet e reduktuara të CO_2
$e\left(\frac{kg_{CO_2}}{kWh}\right)$	Emisionet e reduktuara të CO_2 **tab. 5**

1.3 Rikonstruksioni i përgjithshëm i mbështjellëses termike në ndërtesat ekzistuese rezidenciale dhe jorezidenciale dhe rikonstruksioni i sistemit të ngrohjes.

Në këtë rast kemi të bëjmë me një rikonstruksion integral të ndërtesës në veshjen termike (mure, dritare, çati), si edhe me rikonstruksion të sistemit të ngrohjes.

1.3.1 Metoda llogaritëse

Kursimi final i energjisë për njësi të sipërfaqes llogaritet si diferencë ndërmjet sasisë së nxehtësisë së kërkuar para dhe pas implementimit të masave të eficiencës së energjisë. Nocioni "para" dhe "pas" përcaktohet në dokumentacionin e implementimit ose prej vlerave referente siç përshkruhet në kapitujt e mësipërm. Formula që përdoret është si më poshtë:

$$FES = \left(\frac{SHD_{ini}}{\eta_{ini}} - \frac{SHD_{new}}{\eta_{new}}\right) \cdot A_k$$

Ku:

$\boldsymbol{FES}\left(\frac{kWh}{vit}\right)$	Kursimi final i energjisë
η_{ini}	Rendimenti i sistemit të ngrohjes para implementimit
η_{new}	Rendimenti i sistemit të ngrohjes pas implementimit
$\frac{SHD_{ini}}{\eta_{ini}}\left(\frac{kWh}{m^2}\right)$	Kërkesa specifike për nxehtësi në ndërtesë përpara ndërhyrjeve për EE
$\frac{SHD_{new}}{\eta_{new}}\left(\frac{kWh}{m^2}\right)$	Kërkesa specifike për nxehtësi në ndërtesë pas ndërhyrjeve për EE
$A_k(m^2)$	Sipërfaqja që përdor nxehtësi në ndërtesë (Sipërfaqja totale që ngrohet)

Formula e përmendur më sipër sugjerohet të përdoret në konstruksionet komplekse që inkuadrojnë si rikonstruksionin e mbështjellëses termike të ndërtesës ashtu edhe rikonstruksionin e sistemit të ngrohjes.

1.3.2 Parametrat hyrës

Siç shihet nga formulat e mësipërme, për llogaritjen e FES dhe PES është e domosdoshme të njihen vlerat e sipërfaqes që ngrohet e cila i nënshtrohet rikonstruksionit të projektit të EE. Nuk ka vlera reference për këtë parametër dhe ai duhet përcaktuar ekzaktësisht prej dokumentacionit të projektit ose auditit energjetik. Ajo që duhet vlerësuar me shumë kujdes është eficienca (rendimenti /efikasiteti) i sistemit të ngrohjes para dhe pas implementimit të projektit, bazuar në të dhënat e disponueshme nga prodhuesi dhe nga dokumentacioni i projektit. Nëse ndërtesa është e detyrueshme për t'iu nënshtruar auditimit energjetik të dhënat për sasinë e nxehtësisë së kërkuar mund të jenë të disponueshme në raportin e auditit të energjisë. Në këto raporte mund të gjenden shumë të dhëna të besueshme përpara dhe pas implementimit të projektit. Nëse nuk është e mundur që të dhënat të gjenden në raportet e auditit, ose në të dhënat e projektit të EE siç mund të ndodhë në shumë raste, atëherë do të bazohemi në disa vlera referuese. Në tabelën e mëposhtme është dhënë një pasqyrë e parametrave hyrës (të dhënat hyrëse) për metodën llogaritëse BU gjatë një rikonstruksioni total të ndërtesës.

Parametrat hyrës për metodën llogaritëse BU gjatë një rikonstruksioni total të mbështjellëses së ndërtesës dhe sistemit të ngrohjes në ndërtesat ekzistuese.

Identifikatori	*Parametrat*	*Burimi i mundshëm i të dhënave*
$\frac{SHD_{ini}}{SHD_{new}}$	Kërkesa për nxehtësi specifike në ndërtesë përpara/pas ndërhyrjes së projektit të EE	Raporti i auditit të energjisë, dokumentacion i projektit ose vlera referuese
$\frac{\eta_{ini}}{\eta_{new}}$	Rendimenti i sistemit të ngrohjes përpara/pas ndërhyrjes së projektit të EE	Raporti i auditit të energjisë, dokumentacion i projektit ose vlera referuese
A_k	Shpërfaqja ngrohëse e ndërtesës	Raporti i auditit të energjisë, dokumentacion i projektit ose vlera referuese

Rendimenti i sistemit të ngrohjes përpara/pas ndërhyrjes së projektit të EE mund të gjendet në dokumentacionin e projektit si një vlerë e rendimentit të përgjithshëm të të gjithë sistemit tab. 4.

$\eta_{ini} = \eta_{boi(ini)} \cdot \eta_{dis(ini)} \cdot \eta_{em\,(ini)}$

dhe për sistemin e rikonstruktuar

$\eta_{new} = \eta_{boi(new)} \cdot \eta_{dis(new)} \cdot \eta_{em\,(new)}$

Madhësitë e mësipërme shprehin:

η_{boi}	Rendimenti (eficienca) e bojlerëve (gjeneratorët e prodhimit të nxehtësisë) para/pas	Burimi i informacionit: Raporti i auditit të energjisë; dokumentacioni i projektit ose vlera referuese.
η_{dis}	Rendimenti (eficienca) e sistemit të shpërndarjes së nxehtësisë (para/pas)	
η_{em}	Rendimenti i sistemeve të emetimit (këmbyesit e nxehtësisë dhe sistemet e kontrollit) para/pas	

1.3.3 Vlerat referuese

Siç përmendem më lart, nëse të dhënat hyrëse nuk gjenden në raportet e audit, si edhe në dokumentacionin e projektit atëherë bazohemi në vlera referuese si më poshtë:

Kërkesa me nxehtësi specifike. (Sasia e nxehtësisë për njësi të sipërfaqes.) Këtë madhësi do ta shënojmë me SHD, siç e kemi shënuar më lart duke pranuar germat e para të shprehjes në gjuhën angleze (*Specific Heat Demande*). Vlerat referente të SHD përpara fillimit të projektit dhe pas implementimit të masave për Shqipërinë jepen në tab. 2 dhe tab. 3 sipas tipit të ndërtesës.

Rendimenti (eficienca) e sistemit të ngrohjes

Rendimenti i sistemit të ngrohjes mund të gjendet produkt i tri rendimenteve të ndryshme të komponentëve të sistemit që janë njësia e prodhimit të nxehtësisë: sistemi i shpërndarjes së nxehtësisë (tubacionet, valvulet, shpërndarësit), si edhe njësitë e këmbimit të nxehtësisë dhe sistemet e kontrollit automatik. Formula e përgjithshme është: $\eta_{ini} = \eta_{boi} \cdot \eta_{dis} \cdot \eta_{em}$

Në këtë formulë madhësitë e paraqitura shprehin:

η	Rendimenti i përgjithshëm i sistemit të ngrohjes
η_{boi}	Rendimenti i njësisë së prodhimit të nxehtësisë (kaldaje dhe çdo burim tjetër nxehtësie)
η_{dis}	Rendimenti i sistemit të shpërndarjes (tubacione; valvola etj.)
η_{em}	Rendimenti i këmbyesve të nxehtësisë (këmbyesit e nxehtësisë, valvolat e kontrollit etj.)

Duke përdorur formulat e mësipërme jemi në gjendje të përcaktojmë rendimentin e përgjithshëm të sistemit të ngrohjes para dhe pas implementimit të projektit duke marrë parasysh çdo ndërhyrje të bërë në rikostruksionin e këtij sistemi. P.sh. nëse nëpërmjet projektit të ndërhyrjes për EE, parashikohet vetëm përmirësimi (zëvendësimi) i tubacioneve të shpërndarjes së bartësit të nxehtësisë, kjo do të reflektohet vetëm në ndryshimin e rendimentit të këtij elementi (tubacionit). Nga ana tjetër, nëse projekti i ndërhyrjes parashikon ndryshime në të gjitha elementet përbërëse të këtij sistemi, atëherë rendimenti i përgjithshëm llogaritet duke marrë parasysh përmirësimin e rendimentit të çdo elementi.

Vlerat referuese për rendimentin e përgjithshëm për tipa të ndryshëm të elementeve përbërëse të sistemit të nxehtësisë jepen në tab. 4. Kombinimi i elementeve përbërëse mund të jetë i çfarëdoshëm kështu që, ne duhet t'i referohemi në çdo rast sistemeve konkrete që i nënshtrohen rikonstruksionit.

Nëse rendimenti i përgjithshëm i sistemit të ngrohjes, nuk është e mundur të llogaritet me metodën e mësipërme, atëherë mund të përdorim vlera referuese të dhëna në tab. 4, të cilat janë shumë të rrumbullakosura dhe që përdoren për vendet e EU dhe rekomandohen të përdoren vetëm në rastet e mungesës totale të burimeve të tjera të të dhënave.

1.3.4 Reduktimi i emisioneve të CO_2

Vlerësimi vjetor i reduktimit të emisioneve të CO_2 do të bëhet në varësi të llojit të lëndës djegëse që përdoret për prodhimin e nxehtësisë. Si rezultat i implementimit të projektit të EE duhet të presim edhe reduktimin e emisioneve të CO_2. Formula llogaritëse e këtij reduktimi merret si produkt i energjisë së kursyer si rezultat i implementimit të projektit me koeficientin e emetimit të emisioneve ndotëse nga lënda djegëse e përdorur për prodhimin e nxehtësisë në ndërtesë dhe jepet nga formula:

$$E_{CO_2} = \frac{FES \cdot e}{1000}$$

where:

$E_{CO_2}(\frac{ton}{annum})$	Emisionet e reduktuara të CO_2
$e\left(\frac{kg_{CO_2}}{kWh}\right)$	Koeficienti i emetimit të emisioneve ndotëse nga lënda djegëse e përdorur sipas tab. 5.

Në rast se gjatë implementimit të projektit ka ndryshim të llojit të lëndës djegëse llogaritja e reduktimit të CO_2 bëhet me formulën e mëposhtme:

$$E_{CO_2} = \left(\frac{SHD_{ini}}{\eta_{ini}} \cdot e_{ini} - \frac{SHD_{new}}{\eta_{new}} \cdot e_{new}\right) \cdot \frac{A_k}{1000}\ (ton)$$

Si edhe më lart indekset "*ini* " dhe "*new*" përfaqësojnë madhësitë e parametrave respektive para dhe pas implementimit të projektit.

Koeficienti i emetimit të emisioneve CO_2 "e" në varësi të lëndës djegëse e përdorur jepen në tab. 5.

Nëse është e pamundur të gjenden vlera të përshtateshe për llojin e lëndës djegëse që do të përdoret në implementimin e projektit atëherë përdoret vlera e koeficientit "e" të dhënë në tabelën 5 për gazin natyror.

Kjo formulë do të jetë e njëjta për të gjitha metodat e tjera.

1.3.5 Jetëgjatësia e masave të aplikuara

Jetëgjatësia e matjeve të një rikonstruksioni integral të mbështjellëses termike të një ndërtese dhe të sistemit të ngrohjes përcaktohet si më poshtë:

Ndërtesa rezidenciale	20 vjet
Ndërtesa jorezidenciale	25 vjet

1.4 Metodologjia e llogaritjes së kursimit të energjisë në ndërtesat rezidenciale (ekzistuese) të rinovuara (rikonstruktuar) duke përdorur mbështjellësen termike, pa ndryshuar sistemin e ngrohjes

1.4.1 Kjo metodologji parashikon vlerësimin e kursimit të energjisë pas rinovimit të banesës me mbështjellëse termike dhe nuk parashikon zëvendësimin e sistemit ekzistues të ngrohjes. Formulat vlejnë si për banesat një dhe shumë familjare ashtu edhe për blloqet e banimit.

Formulat llogaritëse BU
$FES = A \cdot \left(\frac{SHD_{ref} + HWD}{\eta_{Ref}} - \frac{SHD_{Eff} + HWD}{\eta_{Eff}}\right)$
A Sipërfaqja që ngrohet nga rikonstruksioni i veshjes termike
$SHD_{ref}\ \left(\frac{kWh}{m^2}/vit\right)$ Kërkesa për energji specifike për ngrohje në ndërtesën referuese para rinovimit
$SHD_{Eff}\ \left(\frac{kWh}{m^2}/vit\right)$ Kërkesa për energji specifike për ngrohje në ndërtesën referuese ku janë zbatuar masat e EE (pas rinovimit)
HWD $\left(\frac{kWh}{m^2}/vit\right)$ Kërkesat specifike për energji për ujë të ngrohtë në vit $\left(\frac{kWh}{m^2}/vit\right)$

η_{Ref} rendimenti (eficienca) (përdorimi vjetor) i sistemit të ngrohjes në godinën referuese
η_{Eff} rendimenti (eficienca)(përdorimi vjetor) i sistemit të ngrohjes në godinën referuese ku janë zbatuar masat e EE (pas rinovimit)
Të dhëna fillestare
Jepen kërkesat për energji specifike për ngrohje përpara rinovimit të veshjes termike $\left(\frac{kWh}{m^2}/vit\right)$

1.4.2 Sqarime të nevojshme

Jetëgjatësia e kësaj ndërhyrjeje nga pikëpamja e EE (parazgjidhet ose merret sipas një projekti specifik). *"Recommandations on Measurment and Verification methods in framework of directive 2006/32/EC on Energy End-Use Efficiency and Energy Services".*

- Veshja termike: mbështjellësja termike e ndërtesës – izolimi termik i mureve kavitative dhe çdo izolim tjetër i konstruksionit (solid/druri) rekomandohet 30 vjet;
- Izolimi termik i papafingove/tarraca dhe dysheme rekomandohet 25 vjet;
- Bojlerë të vegjël deri në 30 kW fuqi në dalje rekomandohet 20 vjet;
- Bojlerë të mëdhenj mbi 30 kW fuqi në dalje parazgjidhet 25 vjet;
- Dritaret me vlerë të ulët të U rekomandohet 30 vjet;

Kontrolli i sistemit të ngrohjes, modernizim me zëvendësim të bojlerëve rekomandohet 15 vjet

Sipërfaqja që rinovohet, duke vendosur mbështjellësen termike: kërkesa për energji specifike për ngrohje në ndërtesën referuese para rinovimit dhe kërkesa për energji specifike për ngrohje në ndërtesën referuese pas rinovimit (duke vendosur mbështjellësen termoizoluese) janë të paravendosura ose llogariten sipas projektit. Tab. 2 dhe tab. 3.

Rendimenti (eficienca) (përdorimi vjetor) i sistemit të ngrohjes në godinën referuese, si edhe rendimenti (eficienca) (përdorimi vjetor) i sistemit të ngrohjes në godinën referuese pas rinovimit (duke vendosur mbështjellësen termoizoluese) janë të paravendosura ose llogariten sipas rastit konkret ose nga një bilanc auditi. Kërkesa specifike për nxehtësi për ujë të ngrohtë sanitar HWD, është e paracaktuar ose llogaritet sipas projektit (shih: Kërkesa për ujë të ngrohtë sanitar).

1.4.3 Vlerat referente

Sipërfaqja mesatare bruto mund të llogaritet bazuar në statistikat kombëtare për godinat e banimit ose mund të jetë e disponueshme nga analizat e certifikatave të energjisë ose bazat e të dhënave të ndërtesave etj.

Kërkesa për energji specifike për ngrohje në ndërtesën referuese para rinovimit dhe kërkesa për energji specifike për ngrohje në ndërtesën referuese pas rinovimit (duke vendosur mbështjellësen termoizoluese) mund të përcaktohen nga database e bilanceve energjetike; nga studimet e kryera shih (*Gj.Simaku, Studim doktorature*, 2019 etj.) ose nga raportet e audit. Mund të përdoren edhe tab. 7 dhe tab. 8.

Kërkesa për ujë të ngrohtë sanitar HWD. Në ndërtesat ekzistuese, kërkesat specifike për energji për ujë të ngrohtë në vit $\left(\frac{kWh}{m^2}/vit\right)$ për qëllime sanitare, realizohen nga ngrohësit me energji elektrike (kryesisht 80 l dhe fuqi 2,5 kw, por ka edhe një pjesë që përdorin drutë e zjarrit. Sasia neto e nxehtësisë për DHW është llogaritur bazuar në konsumin ditor të ujit të ngrohtë për person duke e marrë në konsideratë numrin mesatar të personave në familje. Në Shqipëri pranohet sasia prej 20-40 l/ditë/person Mesatarisht pranohet 30l/ditë/person. Temperatura e ujit të ngrohtë është marrë 45°C. Duke marrë në konsideratë numrin e njerëzve për tipin e ndërtesës dhe numrin e familjeve sipas tipit të banesës, rezultati mesatar për vendin ka dalë 18 kWh/m^2 vit. Kjo shifër mesatare është përdorur për të gjitha përllogaritjet e mëtejshme. [*Gj.Simaku, Studim doktorature, Tiranë, 2019*].

Rendimenti i sistemit të ngrohjes para dhe pas rinovimit. Ky element përcaktohet si raport ndërmjet sasisë së energjisë për ngrohje të prodhuar nga prodhuesi i energjisë kundrejt shumës totale të energjisë të përdorur (energjia e prodhuar nga prodhuesi (bojler/kaldajë) shumëzuar me rendimentin e sistemit) plus sasinë e energjisë që duhet për DHW.

$$\eta_{sng} = \frac{Q_{ngrohje}}{Q_{ngrohje}+DHW}$$

η_{sng} përfaqëson rendimentin e sistemit të ngrohjes.

Si të dhëna imput janë:

- Energjia specifike që duhet për ngrohje duke marrë parasysh humbjet në sistem si para rikonstruksionit dhe pas rikonstruksionit (humbjet

në bojler, në rrjetin shpërndarës dhe në pajisjet e kontrollit);

- Energjia specifike vjetore që duhet për HWD.

Energjia e përdorur për ngrohje llogaritet nga energjia specifike e prodhuar nga prodhuesi shumëzuar me rendimentin (eficienca) e sistemit.

$$Q_{ngrohje} = Q_{prodhuesit} \cdot \eta_t$$

Eficienca e sistemit (η_t) për sistemet e furnizimit me energji llogariten: $\eta_t = \eta_b \cdot \eta_p \cdot \eta_c$

ku η_b = eficienca e bojlerit (burimi)

η_p = eficienca e rrjetit të tubacioneve (shpërndarja)

η_c = eficienca e kontrollit (rregullimi)

Duke marrë në konsideratë se nuk ka të dhëna të tjera lidhur me karakteristikat e pajisjeve për ngrohje sipas tipit të ndërtesës (nuk është kryer ndonjë studim lidhur me këto të dhëna në Shqipëri), në modelet e tipave të ndërtesave janë përfshirë sistemet më të shpeshta. Eficienca e supozuar e bojlerëve jepet në mënyrë të përmbledhur në tab. 6 [*Gj.Simaku, Studim doktorature*].

Në zonat klimatike A dhe B, janë të shpeshtë të dy llojet e ngrohësve: ngrohës elektrikë të drejtpërdrejtë dhe pompat e nxehtësisë. Për të thjeshtësuar modelimin, të dy këto sisteme janë modeluar së bashku me një eficiencë virtuale të llogaritur sipas raportit të banesave me ngrohës të drejtpërdrejtë dhe me pompa të nxehtësisë, duke supozuar eficiencën e barabartë me 1 për ngrohësit drejtpërdrejtë dhe 2.2 për pompat e nxehtësisë.

1.4.4 Jetëgjatësia e masave

Jetëgjatësia e masave të aplikuara: të dhënat e mëposhtme bazohen në dokumentin *"Recommandations on Measurment and Verification methods in framework of directive 2006/32/EC on Energy End-Use Efficiency and Energy Services".*

- Veshja termike: mbështjellësja termike e ndërtesës – izolimi termik i mureve kavitative dhe çdo izolim tjetër i konstruksionit (solid / druri) rekomandohet 30 vjet;

- izolimi termik i papafingove/tarraca dhe dysheme rekomandohet 25 vjet;

- bojlerë të vegjël deri në 30 kW fuqi në dalje rekomandohet 20 vjet;

- bojlerë të mëdhenj mbi 30 kW fuqi në dalje parazgjidhet 25 vjet;

- Dritaret me vlerë të ulët të U rekomandohet 30 vjet;

- Kontrolli i sistemit të ngrohjes, modernizim me zëvendësim të bojlerëve rekomandohet 15 vjet.

1.4.5 Shkarkimet vjetore të CO_2 për ngrohjen e hapësirës dhe HWD janë llogaritur si vijon:

$$m_{CO_2} = \sum Q_{prodhuesit} \cdot f_{CO_2,source\ i} \left[{}^{kg}/_{year} \right]$$

ku: $f_{CO_2,source\ i}$ = faktori i shkarkimeve të CO_2 i energjisë që përdor gjeneratori i nxehtësisë.

Faktori i shkarkimeve specifike të CO_2 për mbartësin e energjisë jepen në tab. 9.

1.4.6 Të dhëna për llogaritjen TFES

$\boldsymbol{SHD_{ref}}$, kërkesat për nxehtësi specifike në ndërtesën referente [kWh/m^2 /a].

Tab. 7 dhe tab. 8 jep SHD_{ref} përpara rikonstruksionit për tipa të ndryshëm ndërtesash jorezidenciale.

Është gjithashtu e domosdoshme të dihen vlerat e rendimentit të sistemit të ngrohjes në ndërtesën referente η_{Ref} - dhe η_{Eff} - në ndërtesën me eficiencë energjetike.

Tab. **10** jep të dhëna për vlerat e tyre pra para dhe pas implementimit të masave të eficiencës:

Parametri i fundit që nevojitet për llogaritjen e FES është SHD_{Eff}, kërkesa për nxehtësi specifike në ndërtesën me eficiencë energjetike [kWh/m^2 /a]. Do të analizojmë tri masat e implementimit të eficiencës energjetike:

a) përdorimi i veshjes termike të godinës nga jashtë me kapotë termike;

b) izolimi termik i tarracës dhe/ose çatisë;

c) zëvendësimi i dritareve të zakonshme me dritare *double/triple* xham.

Në tabelat 11 dhe 12 jepen kërkesat për energji specifike në godinat me implementim të tri masave të përmendura më sipër.

Ndërkohë tab. 13 jep kërkesat për energji specifike me kombinim të dy masave për eficiencën e energjisë atë të izolimit termik të mureve me kapotë termike dhe zëvendësimin e prodhuesit të nxehtësisë me lëndë djegëse diesel kundrejt atij me qymyr.

1.5 Përmirësimi i eficiencës termike nëpërmjet ndërhyrjeve në elemente të veçanta të ndërtesës

Kjo metodologji jep sasinë e energjisë së kursyer nëpërmjet implementimit të përmirësimit termik të elementeve të veçanta të ndërtesës si dritare dhe/ose çatisë. Në këtë metodologji supozojmë se sistemi i ngrohjes nuk ndryshon, por eficienca vjen vetëm nga përmirësimet që bëhen në elemente të veçanta.

1.5.1 Formulat bazë

BU Formula
a)izolimi termik i murit $\mathbf{TFES_{wall}} = (U_{Ref-wall} - U_{Eff-wall}) \cdot A \cdot HDD \cdot f \cdot \frac{1}{\eta_{ref}}$ b)Zëvendësimi i dritareve $\mathbf{TFES_{window}} = (U_{Ref-window} - U_{Eff-window}) \cdot A \cdot HDD \cdot f \cdot \frac{1}{\eta_{ref}}$ c)izolimi I catise $\mathbf{TFES_{roof}} = (U_{Ref-roof} - U_{Eff-roof}) \cdot A \cdot HDD \cdot f \cdot \frac{1}{\eta_{ref}}$

Përcaktime
TFES: Kursimi final i energjisë [kWh/a]
$U_{Ref-murr}$ U- Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë për murin; dritaren dhe çatinë në ndërtesën ekzistuese (W/m²K) $U_{Ref-dritare}$ $U_{Ref-catise}$
$U_{Eff-murr}$ U- Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë për murin; dritaren dhe çatinë në ndërtesën me zbatim të masave të eficiencës së energjisë. (W/m²K) $U_{Eff-dritare}$ $U_{Eff-catise}$ A - Sipërfaqja e elementeve të zëvendësuara në m²
HDD - grade ditët e ngrohjes [k ditë/vit]
f faktori i konvertimit të kWh/[kh/d]
η_{ref} - Rendimenti i sistemit të ngrohjes në godinën referente
U -i referohet koeficientit të transmetimti të nxehtësisë për çdo element që rinovohet

Vlerat:
Jetëgjatësia e masave që ndërmerren për eficiencën energjetike (rekomandohet ose sipas specifikave të projektit) U – e dhënë ose sipas specifikave të projektit si për godinën ekzistuese ashtu edhe për atë të rinovuarën A – sipërfaqja e elementeve rinovuese sipas specifikave të projektit HDD – e dhënë f- Faktori i konvertimit i dhënë η_{ref} – rendimenti i sistemit të ngrohjes në godinën referente i dhënë ose sipas specifikave të projektit

Kërkesat për energji specifike në ndërtesat ekzistuese mund të llogariten nga balancat energjetike të statistikave kombëtare për tipa të ndryshëm ndërtesash. Kjo mund të përcaktohet nga studime specifike kombëtare nëse ekzistojnë, analiza e certifikatave të energjisë, database stokut të godinave ose kodet *Rendimenti i sistemit të ngrohjes*. Ky element përcaktohet si raport ndërmjet sasisë së energjisë për ngrohje të prodhuar nga prodhuesi i energjisë kundrejt shumës totale të energjisë të përdorur (energjia e prodhuar nga prodhuesi (bojler/kaldajë) shumëzuar me rendimentin e sistemit) plus sasinë e energjisë që duhet për DHW.

$$\eta_{ref} = \frac{Q_{ngrohje}}{Q_{ngrohje+DHW}}$$

η_{ref} përfaqeson rendimentin e sistemit të ngrohjes.

f- Faktori i konvertimit i dhënë merret 0,024 kilo orë/ditë (kh/d) nëse sistemi i ngrohjes punon 24 orë. Ky koeficient reduktohet nëse sistemi i ngrohjes punon me kohë të pjesshme, p.sh., nga ora 6.00 a.m. deri 22.p.m. pranohet 0.024*0.67=0.01606

Vlerat e koeficientit U të transmetimit të nxehtësisë llogaritet sipas procedurës së mëposhtme: (VKM nr. 38, datë 16.1.2003 "Për miratimin e normave, të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa".

a) Për mure të thjeshta me faqe të rrafshëta dhe paralele të përbëra nga material homogjen me koeficient të përcjellshmërisë termike λ dhe trashësi δ kemi:

$$U = \frac{1}{\frac{1}{\alpha_j} + \frac{\delta}{\lambda} + \frac{1}{\alpha_b}}$$

b) Për mure të përbëra nga disa shtresa homogjene me plane të rrafshëta dhe paralele respektivisht 1.2,3,...n, me koeficient të përcjellshmërisë termike respektivisht λ1, λ 2, λ 3,.., λn dhe trashësi respektivisht δ1, δ2, δ3,..... δn kemi:

$$U = \frac{1}{\frac{1}{\alpha_j} + \frac{\delta_1}{\lambda_1} + \frac{\delta_2}{\lambda_2} + \cdots \frac{\delta_n}{\lambda_n} + \frac{1}{\alpha_b}}$$

ku:

U- koeficienti total i transmetimit të nxehtësisë

δ- trashesia e shtresës; λ-keficienti i përcjellshmërisë termike për shtresës i (shih shtojcat në VKM nr. 38, datë 16.1.2003;

α_j - koeficienti i përcjellshmërisë termike me konveksion dhe radiacion nga shtresa në ambientin e jashtëm dhe α_b koeficienti i përcjellshmërisë termike me konveksion dhe radiacion nga brenda ambientit në drejtimin të shtresës.

Vlera e koeficientëve të mësipërm mund të gjendet në (VKM nr. 38, datë 16.1.2003 "Për miratimin e normave, të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa" pika 7.

Po kështu vlera e koeficientit U për sipërfaqet e dritareve dhe çatisë i referohet VKM nr. 38, datë 16.1.2003 "Për miratimin e normave, të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa", faqe 40 shtojca B4. Tab. 14 dhe 15.

1.5.2 Jetëgjatësia e masave

a) izolimi termik me anë të mbështjellëses termike – mure kavitative dhe izolime të tjera rekomandohet 30 vjet;

b) izolimi termik i papafingove/çative dhe dyshemeve, rekomandohet 25 vjet;

c) dritare dhe elemente të tjera xhami me koeficient të ulët U rekomandohet 30 vjet;

d) materialet mbushëse nëpër dritare, dyer etj. – e dhënë 5 vjet.

2. Sistemet e ajrit të kondicionuar

2.1 Sistemet e ajrit të kondicionuar me më pak se 12 kW

Kjo metodologji jep algoritmin e llogaritjes së kursimit të energjisë si rezultat i zëvendësimit të sistemeve të ajrit të kondicionuar të decentralizuar me sisteme të ajrit të kondicionuar të centralizuar.

Formulat llogaritëse:

BU –Formula
Opsioni 1. Për ndërtesa jo të rinovuara: $TFESA = (P_c \cdot h_{FL} \cdot u_f) \cdot (\frac{1}{ESEER_{ref}} - \frac{1}{ESEER_{EFF}}) \cdot n$ **Opsioni 2. Për ndërtesa të rinovuara**. $A \cdot \left(SCD_{Ref} \cdot \frac{1}{ESEER_{Ref}} - SCD_{Eff} \cdot \frac{1}{ESEER_{Eff}}\right)$
Përcaktime:
TFEES: Total Final Energy Savings – Energjia totale vjetore e kursyer [KWh/vit]
P_c – Fuqia e instaluar e sistemit të ftohjes [kW]
h_{FL} - orët me ngarkesë të plotë (orët e punës së sistemit që punon me maksimumin e fuqisë së instaluar)
u_f –Faktori i ngarkesës së pjesshme
$ESEER_{Ref}$ – Raporti i eficiencës së energjisë në sistemin ekzistues: (energji e sistemit të ftohjes / energjisë elektrike të pajisje) mesatare
$ESEER_{Eff}$ - Raporti i eficiencës së energjisë në sistemin eficient (të ri): (energji e sistemit të ftohjes / energjisë elektrike të pajisje) mesatare
n – numri i sistemeve ftohëse të instaluar
A – Sipërfaqja që ftohet në ndërtesë [m²]
SCD_{Ref} - Kërkesa për ftohje specifike në ndërtesën referente [kWh/m²/vit]
SCD_{Eff} - Kërkesa për ftohje specifike në ndërtesën e re eficiente [kWh/m²/vit]

2.2 Vlerat referuese:

$\boldsymbol{ESEER_{Ref}}$ – raporti i eficiencës së energjisë në sistemin ekzistues: (energji e sistemit të ftohjes / energjisë elektrike të pajisje) mesatare. Nga survejimet për sisteme të ndryshme AC kjo vlerë për Shqipërinë është 3.2

$\boldsymbol{ESEER_{EFF}}$ – raporti i eficiencës së energjisë në sistemin eficient: (energji e sistemit të ftohjes / energjisë elektrike të pajisje). Nga survejimet për sisteme të mira AC në tregun shqiptar kjo vlerë për Shqipërinë është 4.6.

P_c – Fuqia e instaluar e sistemit të ftohjes [kW] – Duke marrë në konsideratë një njësi për një dhomë 20 m² ose 60 m³ volum: kjo fuqi është 3,75 kW

h_{FL} - orët me ngarkesë të plotë (orët e punës së sistemit që punon me maksimumin e fuqisë së instaluar) mund të pranohet për Shqipërinë 4 muaj x 30 ditë x 6 orë/ditë = 720 orë.

u_f – Faktori i ngarkesës së pjesshme, jepet e dhënë: 51% bazuar në disa llogaritje të thjeshta prej konsultave. Madhësitë e tjera do t'i referohen projektit specifik. Duke zëvendësuar vlerat e mësipërme mund të marrim për një njësi AC vlerën e $TFESA$ si më poshtë:

$$TFESA = \left(\frac{1}{3,2} - \frac{1}{4,6}\right) \cdot 3,75 \cdot 720 \cdot 1 \cdot 0,51 = 109,13 \text{ kW/njësi/vit}$$

Metodologjia e mësipërme jep kursimin vjetor të energjisë që vjen si rezultat i zëvendësimit të pajisjeve kondicionuese të ajrit si në godinat rezidenciale ashtu edhe ato terciale. Metodologjia bazohet në vlerat e EER për njësi në vit. Vlera totale kWh/vit llogaritet duke shumëzuar vlerën e mësipërme me numrin e të gjitha pajisjeve të zëvendësuara.

2.3 Jetëgjatësia mesatare vlerësohet të jetë 10 vjet

3. Sistemet e pompimit

Sektori i targetuar: ndërtesa rezidenciale, ndërtesa shërbimi privat dhe publik

Kjo metodologji llogarit kursimin e energjisë gjatë instalimit të sistemeve të reja të pompave të ujit të ngrohtë me pompa eficiente.

BU- Formula
TFES=$n \cdot \left(\frac{P_{ref} \cdot t_a - P_{eff} \cdot t_a \cdot f_{LPr}}{1000}\right)$ Llogaritja e profilit të ngarkesës $f_{LPr} = t_{Q100\%} \cdot Q_{100\%} + t_{Q75\%} \cdot Q_{75\%} + t_{Q50\%} \cdot Q_{50\%} + t_{Q25\%} \cdot Q_{25\%}$
Përcaktime
TFES –Kursimi total vjetor i energjisë [kWh/vit]
n- Numri i pompave të instaluara
P_{ref} –Fuqia elektrike e një pompe të promovuar nga *tregu* [W]
P_{eff} - Fuqia elektrike e një pompe eficiente të promovuar nga tregu në [W]
t_a – Orët vjetore mesatare punuese të pompave [h/vit]
f_{LPr} – faktori i profilit të ngarkesës
Q- Prurja e pompës
t_Q -koha e punës relativisht ngarkesës
Elemente bazë në llogaritje
Fuqia elektrike e një pompe e promovuar nga tregu

Vlerat:
Numri i pompave të instaluara sipas projektit specifik;
Fuqia elektrike e një pompe të promovuar nga tregu sipas modelit të pompave të zgjedhura;
Fuqia elektrike e një pompe me eficiencë të lartë të promovuar po nga tregu;
Orët vjetore mesatare punuese të pompave sipas të dhënave të projektit dhe/ose të konsumatorit;
Prurja e pompës – e dhënë në karakteristikat e pompës;
Koha e punës relativisht ngarkesës e dhënë nga projektit dhe/ose konsumatori.

Shënim. E njëjta metodologji vlen edhe nëse zëvendësojmë një pompë joeficiente me një pompë eficiente.

3.2 Jetëgjatësia e një sistemi pompash varet nga prodhuesi. Sipas rasti dhe projektit specifik do të japim edhe jetëgjatësinë. Në prodhimet e BE-së është mesatarisht 15 vjet. *[Recommendation on measurement and verification methods in the framework of directive 2006/32.EC on Energy and –use Efficiency and Energy services, faqe 87]*

Profilin e ngarkesës mund të përdoret tabela e mëposhtme: [http://www.eci.ox.ac.uk/research/energy/downloads/eusave-pump-t2.pdf

Prurja e pompës [Q]	*Koha relative e punës kundrejt prurjes*
%	%
100	6
75	15
50	35
25	44

Orët vjetore mesatare punuese të pompave merret 4320 orë/vit (Shqipëri 180 ditë për ngrohje x 24 orë).

4. Ngrohja qendrore

Sektori i targetuar: ndërtesa rezidenciale. Metoda është e vlefshme si për ndërtesat rezidenciale ekzistuese ashtu edhe për ndërtesa rezidenciale të reja, të rinovuara termikisht ose jo të cilat lidhen me sistemin qendror të ngrohjes.

4.1 Eficienca e energjisë në rrjetin që lidh sistemin e ngrohjes qendrore me ndërtesa rezidenciale jo të rinovuara

Kjo metodologji përdoret për llogaritjen e kursimit vjetor të energjisë në rastet e: i) ndërtesave jo të rinovuara termikisht; ii) ndërtesave rezidenciale të rinovuara termikisht; dhe iii) blloqeve të reja rezidenciale kur zëvendësojmë sistemin e ngrohjes. Të dyja sistemet, i vjetri dhe i riu (në ndërtesat rezidenciale) prodhojnë nxehtësi për ujë të ngrohtë. Metoda përdoret si për ndërtesa të vetme ashtu edhe për ndërtesa për shumë familje.

BU – Formulat bazë
$TFES = A \cdot \left(\frac{SHD+HWD}{\eta_{ref}} - \frac{SHD+HWD}{\eta_{Eff}}\right)$
A-Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtesës që ngrohet e lidhur me stacionin e ngrohjes qendrore [m²]
SHD – kërkesa për nxehtësi specifike [kWh/m²/vit]
HWD- kërkesa specifike për ujë të ngrohtë [kWh/m²/vit]
η_{ref} – Rendimenti i sistemit ekzistues të ngrohjes
η_{Eff} – Rendimenti i sistemit të ri të ngrohjes
Të dhënat fillestare
Sistemi, si i ri dhe i vjetër prodhon nxehtësi për ngrohje dhe ujë të ngrohtë
Të bëhen korrigjimet sipas HDD (*heating degree days*)
Vlerat: Jetëgjatësia e masave të marra jepet si *default* ose sipas një projekti specifik. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtesës që ngrohet përcaktohet sipas një projekti konkret. Kërkesat për nxehtësi dhe për ujë të ngrohtë jepen /ose sipas një projekti konkret. Eficienca e përdorimit vjetor të sistemit ekzistues/të ri të ngrohjes jepet ose sipas një projekti ekzistues.

Në rastin e një *blloku apartamentesh* (*multi family homes*) formula do të jetë:

$$TFES = n \cdot A_{DU} \cdot \left(\frac{SHD+HWD}{\eta_{ref}} - \frac{SHD+HWD}{\eta_{Eff}}\right)$$

Shënojmë se: madhësitë në formulën e mësipërme përfaqësojnë:

Metodologjia vlen si për banesë *single* ashtu edhe për pallate me shumë apartamente.

BU – formulat bazë
n – numri i njësive të ndërtesave rezidenciale të lidhura me sistemin e ngrohjes qendrore
A_{DU} – sipërfaqja e përgjithshme e një njësie (të parinovuar) në bllokun që ngrohet e lidhur me stacionin e ngrohjes qendrore [m²]
SHD – kërkesa për nxehtësi specifike [kWh/m²/vit]
HWD – kërkesa specifike për ujë të ngrohtë [kWh/m²/vit]
η_{ref} – Eficienca e përdorimit vjetor të sistemit ekzistues të ngrohjes
η_{Eff} - Eficienca e përdorimit vjetor të sistemit të ri të ngrohjes

Lidhur me vlerat shënojmë se:

n – përcaktohet nga projekti konkret; për sa u përket madhësive të tjera i referohemi informacionit të dhënë më lart për një apartament të vetëm.

4.2 Identifikimi i vlerave

a) Jetëgjatësia e masave të marra: i referohemi dokumentit *[Recommendation on measurement and verification methods in the framework of directive 2006/32.EC on Energy and –use Efficiency and Energy services faqe 85]* – rekomandohet 30 vjet.

b) Rendimenti i sistemit të ngrohjes merret si raport i nxehtësisë së përdorur për ngrohje në banesë plus energjinë e përdorur për prodhimin e ujit të ngrohet kundrejt energjisë së prodhuar nga djegia e lëndës djegëse (këtu futet edhe eficienca e prodhuesit të energjisë që është trajtuar më përpara në rendimentin e kaldajës, bojlerit).

5. Pompat e nxehtësisë

5.1 Instalimet e pompave të nxehtësisë në ndërtesat e reja dhe ato të rinovuara

Kjo metodologji përcakton sasinë e energjisë së kursyer si rezultat i aplikimit të pompave të nxehtësisë për ngrohje dhe për prodhimin e ujit të ngrohtë si në ndërtesat rezidenciale ashtu edhe ato terciale të reja dhe të rinovuara. Sistemi prodhon nxehtësi për ngrohje dhe për ujë të ngrohtë.

Formula bazë është:

$$TFES = A\left(\frac{SHD+HWD}{\eta_{Ref}} - \frac{SHD+HWD}{\eta_{Eff}}\right)$$ [kWh/ndërtesë/vit]

Përcaktime:
TFES: Total Final Energy Savings – Energjia totale vjetore e kursyer [KWh/vit/ndërtesë]
A – Sipërfaqja mesatare që përdoret në ndërtesë [m²]
SHD [kWh/m²/vit] kërkesa vjetore për nxehtësi në ndërtesë
HWD [Kwh/ndërtesë/vit] kërkesa vjetore për ujë të ngrohtë
η_{Ref} – Eficienca e energjisë në sistemet konvecionale (rekomandohet 0,65)
η_{Eff} – Eficienca e energjisë në sistemet eficiente të pompave të nxehtësisë

Kursimi vjetor i energjisë [kWh/vit] llogaritet si shumë e kursimeve të veçanta të çdo ndërtese ku është aplikuar pompa e nxehtësisë.

$FES = \sum_{i=1}^{n} TFES_i$ [kWh/vit]

Më poshtë jepen vlerat e rekomanduara për η_{Eff}

	Burimi i nxehtësisë		
	Nëntoka	Ujë	Ajër
η_{Eff}	3.8	3.5	3.0

5.2 Jetëgjatësia e masave të rekomanduara është si më poshtë:

- 10 vjet për pompat e nxehtësisë me burim nxehtësie ajrin;
- 15 vjet për pompat e nxehtësisë me burim nxehtësie ujin;
- 25 vjet pompat e nxehtësisë me burim nxehtësie nëntokën.

Kjo metodologji llogarit kursimin vjetor të energjisë që vjen si rezultat i instalimit të pompave të nxehtësisë (burim i nxehtësisë është energjia gjeotermale; uji ose ajri). Si sistem referimi (i vjetër) konsiderojmë një sistem për prodhimin e nxehtësisë për ngrohje dhe ujë të ngrohtë. Në rastin e aplikimit të formulave llogaritëse duhet të kemi parasysh që të plotësohen:

Kriteri i minimumit të SPF (***S**easonal **P**erformance **F**actor*) i cili sipas aneksit VII të *Renewable Energy Directive 2009/28/EC* llogaritet: SPF > 1,15 * 1/η ku, η- është raporti ndërmjet prodhimit bruto të energjisë elektrike dhe konsumit primar të energjisë dhe që llogaritet nga Eurostat (https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/indicators/overview-of-the-electricity-production-2/asswssment-4

- Funksionimi normal nga pikëpamja teknike e sistemit të pompës së nxehtësisë.

6. Implementimi i masave për përmirësimin elementeve të veçanta të sistemit të ngrohjes

Sektori i targetuar: banesat rezidenciale dhe të shërbimit publik dhe sektorit privat

Kjo metodologji do të përdoret për llogaritjen e kursimit vjetor të energjisë në rastin e aplikimit të masave që merren për një përmirësim (rikonstruksion) të pjesshëm ose total të sistemeve të nxehtësisë. Këto përmirësime konsistojnë në:

- Përmirësimi (rikonstruktimi) i izolimit termik të rezervuarëve të ujit të ngrohtë.
- Izolimi termik i tubacioneve të sistemit të ngrohjes.
- Instalimi i valvuleve termostatike në radiator.

7. Përmirësimi (rikonstruktimi) i prodhuesit të nxehtësisë, shpërndarja dhe emetimi i nxehtësisë

Formulat përdoren për sistemin rezidencial dhe jorezidencial. Opsionet e mundshme mund të jenë:

- zëvendësimi i bojlerëve të vjetër më të rinj;
- zëvendësimi në mënyrë periodike i bojlerëve të vjetër në fund të kohës së përdorimit të tyre më të rinj me eficiencë të lartë;
- zëvendësimi i hershëm i elementeve të defektuara në bojlerët e vjetër me pjesë të reja dhe jo riparimi i tyre;
- zëvendësimi i bojlerëve të vjetër me përpara se fundi i kohës së përdorimit të tyre me bojlerë të rinj me eficiencë të lartë;

- në ndërtesat e reja: instalimi i bojlerëve me eficiencë të lartë në vend të atyre standard;
- zëvendësimi i pjesshëm ose tërësor i pajisjeve ngrohëse;
- zëvendësimi i pjesshëm ose tërësor i rrjetave shpërndarëse;
- instalime të reja ose përmirësimi i sistemeve të kontrollit.

Kjo metodologji na lejon të llogaritim kursimin e energjisë edhe në nënsistemet (pjesët përbërëse të sistemit tërësor të ngrohjes) (prodhuesi i nxehtësisë: shpërndarësit dhe emetuesit duke inkluduar edhe kontrollin e tyre) nëpërmjet krahasimit të humbjeve termike në sistem dhe përcaktimit të faktorëve të kursimi vjetor i energjisë në këtë metodologji i referohet përdoruesit fundor në një instalim me bojlerë me kondensim ku, temperaturë e ujit të kthyer nuk kalon 60°C dhe që mund të shoqërohet ose jo me përmirësim të shpërndarjes së nxehtësisë.

BU Formula
$TFES = A \cdot SHD \cdot \left(\frac{1}{\eta_{rp}} - \frac{1}{\eta_{cp}}\right)$ $\eta_{rp} = \eta_{rb} \cdot \eta_{re} \cdot \eta_{rd}$ $\eta_{cp} = \eta_{eb} \cdot \eta_{ee} \cdot \eta_{rd}$
TFES - Total Final Energy Savings – Energjia totale vjetore e kursyer [KWh/vit]
A – Sipërfaqja që përdoret në ndërtesë [m²]
SHD [kWh/m²/vit] kërkesa vjetore për nxehtësi në ndërtesë shih (tab.6 dhe 7)
η_{rp} – rendimenti i sistemit të vjetër të ngrohjes
η_{cp} - rendimenti i sistemit të ri të ngrohjes
η_{rb} - rendimenti i bojlerit të vjetër
η_{re} - rendimenti i pajisjeve ngrohëse të vjetra
η_{rd} - rendimenti i sistemit të vjetër të shpërndarjes
η_{eb} - rendimenti i bojlerit të ri eficient
η_{ee} - rendimenti i pajisjeve ngrohëse të reja
η_{rd} - rendimenti i sistemit të ri të shpërndarjes
Të dhënat fillestare
Zëvendësimi i bojlerëve të vjetër në përfundim të kohës së tyre të përdorimit; përshpejtimi i këtij zëvendësimi me instalime të reja eficiente. Kërkesa për nxehtësi duhet të korrigjohet sipas HDD (*heating degree days*).

Vlerat
Jetëgjatësia e masave të marra jepet si default ose sipas një projekti specifik.
SHD merret si rekomandim /ose sipas një projekti konkret.
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtesës që ngrohet përcaktohet sipas një projekti konkret ose rekomandohet.
Kërkesat për nxehtësi dhe për ujë të ngrohtë rekomandohen /ose sipas një projekti konkret
Rendimenti i sistemit referent/eficient të ngrohjes jepet si e dhënë fikse ose sipas një projekti ekzistues.

7.1.1 Identifikimi i vlerave

Jetëgjatësia e masave të aplikuara:

Bojlerëve: 17 vjet e rekomanduar

Pajisjet e kontrollit të nxehtësisë: 5 vjet, e rekomanduar

Panele radiatorësh, 18 vjet

Izolimi i tubave të ujit të ngrohtë > 25 vjet

Zëvendësimi rezervuarëve të ujit të ngrohtë 15 vjet.

SHD përcaktohet nga modeli i ndërtesës. *(tab. 2, 3, 7, 8)*

a) vendimi nr. 584, datë 2.11.2000, "Për kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë në ndërtime".

b) ligji nr. 8937, datë 12.9.2002, "Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa",

c) vendimi nr. 38, datë 16.1.2003, "Normat, rregullat dhe kushtet e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa".

Për ndërtesat ekzistuese SHD llogaritet mbi bazën e statistikave kombëtare bazuar në balancën energjetike: analiza e certifikatës së energjisë, *database* e ndërtesës etj. Kur ndërtesa është e rinovuar termikisht SHD mund të përcaktohet edhe prej udhëzimeve të subvencionit që është dhënë për këtë rinovim *(tab. 2, 3, 7, 8).*

Rendimenti i sistemit referent/eficient merret si raport i nxehtësisë së përdorur për ngrohje në banesë plus energjinë e përdorur për prodhimin e ujit të ngrohet kundrejt energjisë së prodhuar nga prodhuesi i energjisë. Referuar "EMEEES *bottom–up case application 4: page 14,* mund të përdorim vlerat sipas tabelës së mëposhtme për bojlerët me kondensim:

Sistemi	Stoku %	Tregu joeficient %	Eficienca minimale për zgjidhjet eficiente %
Prodhuesi i nxehtësisë	82,0	89,0	94,0
Emetimi	78,0	83,0	93,0
Shpërndarja	93,0		97,0

8. Izolimi termik i rezervuarëve të ujit të ngrohtë

Metodologjia llogaritëse vlen si për rezidencat individuale ashtu edhe për ato shumëfamiljesh apo bllok banimi. Volumi i rezervuarit të ujit të ngrohtë do të jepet në litra, trashësia e materialit izolues në cm dhe do të kihet parasysh vendi i rezervuarit.

BU Formula për njësi individuale
$TFES = \frac{Q_{hum-vjet} - Q_{hum-re}}{\eta}$
Përcaktime
$TFES$ – Kursimi final i energjisë [kWh/vit]
$Q_{hum-vjet}$ - Humbjet vjetore të nxehtësisë në një rezervuar të paizoluar [kWh/vit]
Q_{hum-re} – Humbjet vjetore të nxehtësisë në një rezervuar të izoluar [kWh/vit]
η – Rendimenti i sistemit ekzistues të ngrohjes
Të dhënat fillestare
Humbjet vjetore të nxehtësisë në një rezervuar të izoluar jo në mënyrë eficiente

Vlerat
Jetëgjatësia e masave të marra jepet si default ose sipas një projekti specifik.
Numri i rezervuarëve të izoluar merren sipas projektit konkret
Humbjet vjetore të nxehtësisë në një rezervuar të paizoluar/të izoluar sipas projektit konkret ose rekomandohet
Rendimenti i sistemit referent të ngrohjes jepet si e dhënë fikse ose sipas një projekti ekzistues.

8.1.1 Identifikimi i vlerave

Duhet të kemi parasysh që, gjatë llogaritjeve për kursimin e energjisë kur aplikojmë masat për eficiencën e energjisë, duhet t'i referohemi një ndërtese konkrete, e cila ka një sipërfaqe konkrete: një kërkese konkrete për nxehtësi specifike dhe për ujë të ngrohtë, si edhe një rendiment konkret të sistemit të ngrohjes (si për ndërtesën referente ashtu edhe për atë ku aplikojmë masat e eficiencës së energjisë). Këto vlera mund të përdoren për llogaritje, por duhet kujdes që nëse përdorim edhe vlera të rekomanduara ato nuk duhet të përzihen me njëra-tjetrën.

8.1.2 Jetëgjatësia e masave përmirësuese

Referuar: [*Recommendation on measurement and verification methods in the framework of directive 2006/32.EC on Energy and –use Efficiency and Energy services faqe 85*]

Rekomandohet për izolimin e rezervuarëve të ujit të ngehtë 15 vjet.

Humbjet vjetore të nxehtësisë në rezervuar rekomandohen nga prodhuesi.

Rendimenti i sistemit referent merret si raport i nxehtësisë së përdorur për ngrohje në banesë plus energjinë e përdorur për prodhimin e ujit të ngrohet kundrejt energjisë së prodhuar nga prodhuesi i energjisë.

8.1.2.1 Izolimi termik i tubacioneve në sistemet e ngrohjes of pipes in the heating system

Metodologjia vlen si për ndërtesat rezidenciale ashtu edhe për ato të shërbimit publik.

BU Formula
$TFES = \frac{(q_{filles} - q_{ri}) \cdot L \cdot HD \cdot 24 \cdot c}{1000}$
TFES Total Final Energy Savings – Energjia totale vjetore e kursyer [KWh/vit] -
q_{filles} – humbjet e nxehtësisë në tubacionin e paizoluar [W/m]
q_{ri} – humbjet e nxehtësisë në tubacion e izoluar ku janë implementuar masat e EE [W/m]
l – gjatësia e tubacionit të izoluar [m]
c – koeficienti i ndërprerjes së procesit të punës së sistemit të ngrohjes
HD - ditët e ngrohjes

Të dhënat fillestare
Në instalimin e ri, ku aplikohen masat e EE, krahasohen vlerat e *q* me atë të instalimit të vjetër.

Vlerat
Jetëgjatësia e masave të marra jepet si default ose sipas një projekti specifik.
Humbjet e nxehtësisë në tubacionin referent / të izoluar jepen si default ose llogariten sipas një projekti konkret
Gjatësia e tubacionit jepet sipas projektit konkret.
Koeficienti i ndërprerjes rekomandohet ose merret sipas projektit konkret
HD rekomandohet

8.1.3 Identifikimi i vlerave

Referuar: [*Recommendation on measurement and verification methods in the framework of directive 2006/32.EC on Energy and –use Efficiency and Energy services faqe 85*]

Jetëgjatësia e masave të mara në kuadër të EE për izolimin e tubacioneve të ujit të ngrohtë rekomandohet 20 vjet

Humbjet vjetore të nxehtësisë në tubacionet referente/të izoluara rekomandohet të llogariten sipas EN 15316-2-3.

Koeficienti i ndërprerjes së procesit të punës së sistemit të ngrohjes llogaritet sipas EN ISO 13790

HD rekomandohet për Shqipërinë 160 ditë

8.1.4 Motorët industrialë

Sektori: Industri

Kjo metodologji përcakton mënyrën e llogaritjes kursimit të energjisë vjetore nga zëvendësimi i motorëve elektrikë me motorë elektrikë me shpejtësi të rregullueshme me përdorim në industri me eficiencë të lartë.

8.1.5 Zëvendësimi i motorëve elektrikë në industri

Gjatë kësaj procedure komponentët e tjerë si kontrolli apo ngarkesa e motorit mbetet konstantë. Kushtet e zbatimit të kësaj procedure janë që konsumatori i energjisë mbetet i njëjtë dhe motori po ashtu.

BU - Formula
$TFES = P \cdot t \cdot f_l \cdot \left(\frac{1}{\eta_{ref}} - \frac{1}{\eta_{eff}}\right) \cdot n_m$
P - Fuqia elektrike e instaluar në motor [kW]
t- orët mesatare vjetore të punës së motorit [h/vit]
f_l – Faktori mesatar i ngarkesës %
η_{ref} – rendimenti i motorit ekzistues %
η_{eff} – rendimenti i motorit të ri %
n_m – numri i motorëve të zëvendësuar
Të dhënat fillestare për nisjen e procedurës
Si e dhënë fillestare shërben një motor elektrik ekzistues

Vlerat:
Vlefshmëria në kohë e procedurës (e dhënë ose sipas projektit specifik)
Fuqia elektrike e instaluar në motor [kW] (sipas një projekti konkret)
Orët mesatare vjetore të punës së motorit [h/vit] (e dhënë ose sipas një projekti konkret)
Faktori mesatar i ngarkesës % (e dhënë ose sipas një projekti specifik)
Rendimenti i motorit ekzistues % (sipas një projekti konkret)
Rendimenti i motorit të ri % (sipas një projekti konkret)
Numri i motorëve të zëvendësuar (sipas një projekti konkret)

8.1.6 Jetëgjatësia

Jetëgjatësia e një sistemi motorësh elektrikë industrialë varet nga prodhuesi. Sipas rastit dhe projektit specifik do të japim edhe jetëgjatësinë. Në prodhimet e BE-së është mesatarisht 12 vjet.

Për vlera më të sakta mund të përdorim tabelën e mëposhtme:

Fuqia mesatare kW	Jetëgjatësia mesatare në vite
1-7,5	12
7,5-75	15
75-250	20

[Recommendation on measurement and verification methods in the framework of directive 2006/32.EC on Energy and –use Efficiency and Energy services faqe 63]

Fuqia elektrike e instaluar në motor [kW]: për një projekt konkret kjo vlerë mund të gjendet direkt në dokumentacionin që shoqëron motorin.

Orët mesatare vjetore të punës së motorit [h/vit]. Kjo vlerë mund të jepet për një projekt konkret. Dhe varion sipas fushave të ndryshme të përdorimit të motorit elektrik. Referuar *[EUP Lot 11 Final report Motors faqe 64],* orët e punës për një motor AC mund të pranohen 92.600 orë.

Për motorët elektrikë DC që veprojnë me shpejtësi të moderuar (750-1300 rpm) kanë një jetëgjatësi 7500 orë. Jeta minimale mund të jetë 2000-5000 orë dhe maksimumi 10000 h. *[EUP Lot 11 Final report Motors, faqe 64]*

Faktori mesatar i ngarkesës, mund të merret nga një projekt konkret ose si vlerë e dhënë duke iu referuar në funksion të ngarkesës së motorit pranohet efiecienca e tij *[EUP Lot 11 Final report Motors, faqe 63].*

Eficienca e motorit të zëvendësuar: sipas një projekti konkret ose në të dhënat teknike të motorit.

Eficienca e motorit të ri: sipas një projekti konkret ose mund t'u referohemi tabelave të mëposhtme sipas EU Regulation 640/2009 (http://eur-lex.europa.eu/legal) lidhur me kërkesat e projektimit *eco design* për motorët elektrikë. (neni 3, pikat 1, 2, 3) tab.

Numri i motorëve të zëvendësuar: merret sipas projektit konkret.

8.1.7 Ridimesionimi i motorëve elektrikë

Kjo metodologji përcakton mënyrën e llogaritje së kursimit të energjisë vjetore nga zëvendësimi i motorëve elektrikë të cilët punojnë pjesën më të madhe të orëve punuese me ngarkesë të ulët me motorë elektrikë me shpejtësi të rregullueshme me përdorim në industri me eficiencë të lartë.

Motorë që punojnë shumë orë në vit me ngarkesë të ulët, p.sh., nën 20%, duhet të zëvendësohet nga motorë më të vegjël me efikasitet të lartë energjetik. Rekomandohet që motorët e rinj të punojnë shumicën e kohës mbi 20% të ngarkesës nominale.

Formula BU
$$TFES = t \cdot \left(\frac{P_{ref} \cdot f_{ref}}{\eta_{ref}} - \frac{P_{Eff} \cdot f_{Eff}}{\eta_{eff}} \right) \cdot n_m$$
Përcaktime
$TFES -$ energjia finale totale e kursyer [kWh/vit]
$P_{ref} -$ fuqia mekanike në motorin ekzistues [kW]
P_{Eff-} fuqia mekanike në motorin e ri eficient [kW]
t - orët mesatare të punës [h/vit]
f_{ref} – faktori mesatar i ngarkese në motorin ekzistues [%]
f_{Eff} – faktori mesatar i ngarkesës në motorin e ri eficient [%]
η_{ref} – rendimenti i motorit të ekzistues [%]
η_{eff} – rendimenti i motorit të ri eficient [%]
n numri i motorëve të zëvendësuar me motorë të rinj eficient.
Të dhënat fillestare për nisjen e procedurës
Klasifikimi sipas IE. [Report on Study on International Efficiency (IE) Efficiency Classes for Low Voltage AC Motors]. Rekomandohet që të dhënat të rishikohen pas tre vjetëve për të bërë *update* ndryshimet eventuale.

Klasifikimi IE jepet nga IEC 60034-30-1. Versioni i fundit i IEC (*The latest version of IEC 60034-30-1).* Është publikuar në qershor 2014, sipas tabelës së mëposhtme:

Klasa e eficiencës	**Numri i klasës**
Motorë me eficiencë standarde	IE1
Motorë me eficiencë të lartë	IE2
Motorë me eficiencë premium	IE3
Motorë me eficiencë superpremium	IE4

Vlerat:
Vlefshmëria në kohë e procedurës (e dhënë ose sipas projektit specifik)
Fuqia mekanike në motorin ekzistues [kW] (sipas një projekti konkret)
Fuqia mekanike në motorin e ri eficient [kW] (sipas një projekti konkret)
Orët mesatare vjetore të punës së motorit [h/vit] (e dhënë ose sipas një projekti konkret)
Faktori mesatar i ngarkesës % për motorin ekzistues (e dhënë ose sipas një projekti specifik)
Faktori mesatar i ngarkesës % për motorin e ri eficient (e dhënë ose sipas një projekti specifik)
Rendimenti i motorit ekzistues % (sipas një projekti konkret)
Rendimenti i motorit të ri eficient % (sipas një projekti konkret)
Numri i motorëve të zëvendësuar (sipas një projekti konkret)

8.1.8 Udhëzime për identifikimin e madhësive që hyjnë në llogaritje

Jetëgjatësia. *[Recommendation on measurement and verification methods in the framework of directive 2006/32.EC on Energy and –use Efficiency and Energy services page 87]***.**

Pranohet 12 vjet

Fuqia mekanike e motorëve të instaluar: merret sipas projektit specifik dhe mund të gjendet në pasaportën teknike të motorit.

Orët mesatare vjetore të punës së motorit [h/vit]. Kjo vlerë mund të jepet për një projekt konkret. Dhe varion sipas fushave të ndryshme të përdorimit të motorit elektrik. Referuar [*EUP Lot 11 Final report Motors, faqe 64*], orët e punës për një motor AC mund të pranohen 92.600 orë. Për motorët elektrikë DC që veprojnë me shpejtësi të moderuar (750-1300 rpm) kanë një jetëgjatësi 7500 orë. Jeta minimale mund të jetë 2000-5000 orë dhe maksimumi 10000 h. *[EUP Lot 11 Final report Motors, faqe 64]*.

Faktori mesatar i ngarkesës, mund të merret nga një projekt konkret ose si vlerë e dhënë duke iu referuar në funksion të ngarkesës së motorit pranohet eficienca e tij *[EUP Lot 11 Final report Motors, faqe 63]*.

Eficienca e motorit të zëvendësuar: sipas një projekti konkret ose në të dhënat teknike të motorit.

Eficienca e motorit të ri: sipas një projekti konkret ose mund t'u referohemi tabelave të mëposhtme sipas EU rregullorja 640/2009 (http://eur-lex.europa.eu/legal) lidhur me kërkesat e projektimit *eco design* për motorët elektrikë. (Neni 3, pikat 1, 2, 3) *tab. 21 dhe tab. 22.* Ose i referohemi standardit IEC 60034-30-1 (shih tabelat në aneks.)

Numri i motorëve të zëvendësuar: merret sipas projektit konkret.

8.1.9 Motorët VSD (Variable Speed Drives)

Kjo metodologji përcakton mënyrën e llogaritje së kursimit të energjisë vjetore nga pajisja e motorëve ekzistues në industri me rregullues shpejtësie. Motori vetë dhe ngarkesa mbeten të njëjtë. Zëvendësohet vetëm njësia e kontrollit. (CU-**C**ontrol **U**nit). Kjo procedurë është e vlefshme për sistemet e pompave dhe të ventilatorëve dhe përdoret vetëm kur sistemi mbetet i njëjtë, por shtojmë vetëm sistemin VSD.

Formula BU
$TFES = P \cdot t \cdot f_{VSD} \cdot \frac{1}{\eta} \cdot n_{VSD}$
Përcaktime
$TFES$ – Energjia finale totale e kursyer [kWh/vit]
P - Fuqia elektrike e instaluar në motor [kW]
t- orët mesatare vjetore të punës së motorit [h/vit]
f_{VSD} –Faktori i ruajtjes së energjisë si rezultat i instalimit të VSD [%]
η – rendimenti i motorit të instaluar [%]
n_{VSD} – numri i VSD të instaluar
Të dhënat fillestare për nisjen e procedurës
Motori ekzistues (p.sh. **IE 1**) me kontroll mekanik

Vlerat:
Vlefshmëria në kohë e procedurës (e dhënë ose sipas projektit specifik);
Fuqia elektrike në motorin ekzistues [kW] (sipas një projekti konkret);
Orët mesatare vjetore të punës së motorit [h/vit] (e dhënë ose sipas një projekti konkret);
Faktori i kursimit të energjisë si rezultat i instalimit të VSD [%] (e dhënë ose sipas një projekti specifik);
Rendimenti i motorit ekzistues % (sipas një projekti konkret);
Numri i VSD-ve të instaluara (sipas një projekti konkret).

8.1.10 Udhëzime për identifikimin e madhësive që hyjnë në llogaritje

Jetëgjatësia. *[Recommendation on measurement and verification methods in the framework of directive 2006/32.EC on Energy and –use Efficiency and Energy services page 87]***.**

Pranohet 12 vjet

Fuqia elektrike në motorin ekzistues [kW] (sipas një projekti konkret) ose në të dhënat teknike të motorit.

Orët mesatare vjetore të punës së motorit [h/vit]. Kjo vlerë mund të jepet për një projekt konkret. Dhe varijon sipas fushave të ndryshme të përdorimit të motorit elektrik. Referuar *[EUP Lot 11 Final report Motors, faqe 64],* orët e punës për një motor AC mund të pranohen 92.600 orë. Për motorët elektrikë DC që veprojnë me shpejtësi të moderuar (750-1300 rpm) kanë një jetëgjatësi 7500 orë. Jeta minimale mund të jetë 2000-5000 orë dhe maksimumi 10000 h. *[EUP Lot 11 Final report Motors, faqe 64]*

Faktori i kursimit të energjisë si rezultat i instalimit të VSD [%] (e dhënë ose sipas një projekti specifik) *[EUP Lot 11 Final report Motors, faqe 87]* dhe mund të pranohet në vlerat 1,15-1,35.

Rendimenti i motorit të instaluar mund të merret nga një projekt konkret ose nga të dhënat teknike të motorit.

Numri i VSD të instaluar sipas projektit konkret.

9. Ndriçimi

Sektorët që paraqesin interes: ndërtesat rezidenciale, sektori i shërbimeve (ndërtesat jorezidenciale, hoteleri dhe turizëm), sektori publik (ndriçimi publik) dhe industria. Metodologjia llogaritëse BU për ndriçimin ka si synim zëvendësimin e llambave joeficiente (inkandeshentë konvencionalë, halogjenë) me llamba më eficiente nga ana e konsumimit të energjisë siç janë CFL dhe LED.

9.1 Ndriçimi në ndërtesat rezidenciale

Shfrytëzimi i energjisë elektrike për ndriçim në sektorin rezidencial në vendin tonë vlerësohet rreth 7% e totalit të energjisë elektrike në banesë sipas një studimi të vitit 2005 (Burimi: *Regular Energy Efficiency in Albania,* 2007). Megjithatë disa studime vlerësojnë që në vendet e BE-së dhe SHBA konsumi i energjisë elektrike për ndriçim arrin 11% për ndërtesat rezidenciale dhe 18% për ndërtesat komerciale. Në të dyja rastet shfrytëzimi racional i energjisë dhe adoptimi i teknologjive të reja do të rezultonte në kursim të konsiderueshëm të energjisë elektrike.

Kjo masë ndërhyrëse ka si qëllim zëvendësimin e llambave ndriçuese në ndërtesat rezidenciale me llamba me konsum të ulët të energjisë sikundër janë ato LED. Formula llogaritëse për kursimin total të energjisë jepet si më poshtë:

$$TFES = \frac{n \cdot (P_{Stock_Average} - P_{Best_Market_promoted}) \cdot t}{1000}$$

Ku:

TFES	Kursimi total vjetor i energjisë [kWh/vit]
n	Numri i llambave të zëvendësuara/shitura
$\mathbf{P}_{\mathbf{stock_Average}}$	Fuqia mesatare e llambës ekzistuese [W]
$\mathbf{P}_{\mathbf{Best_market_promoted}}$	Fuqia e llambës me eficiencë energjetike e promovuar në treg [W]
t	Koha mesatare vjetore e punës së llambës [h/vit]

Vlerat:
Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese në vite (*default* ose sipas projektit specifik);
Numri i llambave të zëvendësuara/shitura (sipas projektit);
Fuqia mesatare e llambës ekzistuese (*default* ose sipas projektit specifik);
Fuqia e llambës eficiente të promovuar në treg (*default* ose sipas projektit specifik);
Koha mesatare vjetore e punës së llambës (*default* ose sipas projektit specifik).

Vlerat referuese sipas "DIRECTIVE 2006/32/EC ON ENERGY END-USE EFFICIENCY AND ENERGY SERVICES"

Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese rekomandohet: 6000 h për llambat fluoreshente

15 vjet për ndriçues eficientë

t	**1000 h/vit**	**Numri i orëve të punës në vit**
$\mathbf{P}_{\mathbf{stock_Average}}$	100 W	Fuqia mesatare e llambës ekzistuese
$\mathbf{P}_{\mathbf{Best_market_promoted}}$	25 W	Fuqia e llambës me eficiencë energjetike e promovuar në treg [W]
Burimi: DIRECTIVE 2006/32/EC ON ENERGY END-USE EFFICIENCY AND ENERGY SERVICES		
Një përmbledhje e llambave eficiente LED me konsum të ulët të energjisë jepet në tabelën nr. 19 në aneks.		

9.2 Ndriçimi në ndërtesat jorezidenciale

Kjo masë përmirësuese e EE kryesisht aplikohet në sektorin jorezidencial (p.sh., zyra) ku ndriçimi joeficient duhet të zëvendësohet më një sistem ndriçimi eficient që kursen energjinë. Formula llogaritëse për kursimet vjetore të energjisë jepet si më poshtë:

$$TFES = \frac{A \cdot n \cdot (P_{\mathrm{Re}\,f} - P_{Eff} \cdot F_{red}) \cdot t}{1000}$$

TFES	Kursimi total vjetor i energjisë [kWh/vit]
A	Sipërfaqja e dyshemesë së ndërtesës në të cilën është rinovuar sistemi i ndriçimit [m²]
P_{Ref}	Fuqia e instaluar për ndriçim për njësi të sipërfaqes përpara zëvendësimit [W/m²]
P_{Eff}	Fuqia e instaluar për ndriçim për njësi të sipërfaqes pas zëvendësimit [W/m²]
F_{red}	Faktor korrigjues për masa ndërhyrëse shtesë (errësimi) Errësim i pjesshëm Kohëmatës interval Sensor i okupancës Adaptor automatik për dritën natyrale
t	Koha mesatare vjetore e punës së llambës [h/vit]

Kontrolli	*Kursimet tipike të energjisë*	*Kursimet e supozuara të energjisë*	*Fc*	*Fd*
Kontroll manual	0 (*base*)	0	0	
Errësim i pjesshëm	10-20%	10%	0.1	
Kohëmatës interval	10-35%	10%	0.1	
Sensor i okupances	20-30%	20%	0.2	
Drita natyrale	20-30%	20%		0.2

Vlerat:
Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese në vite (*default* ose sipas projektit specifik);
Sipërfaqja e dyshemesë së ndërtesës ku është rinovuar sistemi i ndriçimit (sipas projektit);
Fuqia e ndriçimit para zëvendësimit për m² (*default* ose sipas projektit specifik);
Fuqia e ndriçimit pas zëvendësimit për m² (*default* ose sipas projektit specifik);
Faktori korrigjues/reduktues për masa shtesë (errësimi) (*default* ose sipas projektit specifik);
Koha mesatare vjetore e punës së llambës (*default* ose sipas projektit specifik).

Vlerat referuese:

- Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese rekomandohet 12 vjet për sistemet e ndriçimit në zyrat e reja ose të rinovuara;

- Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese rekomandohet 15 vjet për sistemet eficient të ndriçimit në hapësirat publike;

- Koha mesatare vjetore e punës rekomandohet t =2580 h/vit duke u mbështetur në *http://www.evaluate-energy-savings.eu/;"Task 4.2: harmonised bottom-up evaluation methods; Method 9, Improvement of lightingsystems (Tertiary Sector) – Final draft for consultation"*

Burimi: DIRECTIVE 2006/32/EC ON ENERGY END-USE EFFICIENCY AND ENERGY SERVICES

Mbështetur në standardin EN 15193 *"Energy përformance of buildings - Energy requirements for lighting* "i cili na shërben si referencë për tipologjinë e ndërtesave, fuqinë e instaluar për ndriçim, si edhe orët vjetore të punës të sistemit të ndriçimit. Fuqia e instaluar për ndriçim për njësi të sipërfaqes për disa kategori ambientesh jepet në mënyrë të përmbledhur në tab. 20.

Sa i takon fuqisë së instaluar në stokun e llambave të ndriçimit për ndërtesat jorezidenciale sipas DEFU 2001, pranohet mesatarja e ponderuar për llambat inkandeshente me fuqi 40W, 60W, 75W dhe 100W. Një shpërndarje e llambave inkandeshnte në përqindje sipas sektorëve jepet në tabelën nr. 22.

Në të njëjtën mënyrë është llogaritur edhe fuqia e llambave eficiente CFL në sektorin jorezidencial duke marrë kështu vlerën bazë (*Market efficient value*) 14.8 W.

9.3 Ndriçimi në sektorin e hoteleri-turizëm

Kjo masë përmirësuese e EE kryesisht aplikohet në sektorin e shërbimeve, gastronomi, hoteleri-turizëm ku ndriçimi joeficent duhet të zëvendësohet më një sistem ndriçimi eficient që kursen energjinë. Formula llogaritëse për kursimet vjetore të energjisë jepet si më poshtë:

$$TFES = \frac{n \cdot (P_{stock,Average} - P_{Best_Market_promoted}) \cdot t}{1000}$$

TFES	Kursimi total vjetor i energjisë [kWh/vit]
n	Numri i llambave të zëvendësuara ose të shitura
$\mathbf{P_{stock_Average}}$	Fuqia mesatare e llambës ekzistuese [W]
$\mathbf{P_{Best_market_promoted}}$	Fuqia e llambës me eficiencë energjetike e promovuar në treg [W]
t	Koha mesatare vjetore e punës së llambës [h/vit]

Si burim informacioni mbështetemi në dokumentet e mëposhtme: *"Evaluation and Monitoring for the EU Directive on Energy End-Use Efficiency and Energy Services"*, *Method 9, Improvement of Lighting Systems (tertiary sector), si edhe në rregulloret prEN 15193 "Energy përformance of Building – Energy Requirements for lighting"*

Directive 2000/55/EC on Energy Efficiency requirements for ballast for fluorescent lighting etj

Vlerat referuese

- Koha e punës për sektorin e jorezidencial rekomandohet 2500 h/vit, megjithëkëtë një pasqyrë e detajuar me orët e punës për ndriçim bazuar në EN 15193 jepet tab. 21;

- Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese rekomandohet 12 vjet për ndërtesat e reja apo të rinovuara komerciale dhe publike sipas DIRECTIVE 2006/32/EC ON ENERGY END-USE EFFICIENCY AND ENERGY SERVICES;

- Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese rekomandohet 10 vjet për sistemet e kontrollit të ndriçimit në sektorin komercial dhe publik;

- Fuqia mesatare e llambës ekzistuese $\mathbf{P_{stock_Average}}$ rekomandohet të merret duke u mbështetur në tab. nr. 23 në aneks.

- Fuqia e llambës me eficiencë të lartë energjetike në treg $\mathbf{P_{Best_market_promoted}}$ rekomandohet të merret duke u mbështetur në vlerat e paraqitura në tab. 24.

- Në *website*-in www.topten.eu mund të gjenden referenca mbi produktet me cilësore dhe eficiente në treg sa i përket konsumit të energjisë elektrike.

Burimi: Rregullorja e BE-së për klasifikimin e llambave dhe ndriçuesve "Regulation (EU) No 874/2012 of 12 July 2012"

9.4 Ndriçimi publik

Direktiva 2012/27/EC, nxit shtetet anëtare të miratojnë mjete për të përmirësuar eficiencën e energjisë dhe për të reduktuar konsumin e energjisë. Kjo direktivë fton sektorin publik për të qenë lider në miratimin e masave për përmirësimin e eficiencës së energjisë, masat që strukturat administrative apo individët duhet të marrin në bazë të përkatësisë kombëtare, rajonale dhe/ose lokale për rritjen e eficiencës së kësaj energjie. Në zbatim të këtyre detyrimeve, në nëntor 2015 Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 124, datë 5.11.2015, "Për eficiencën e energjisë", si mekanizëm për transpozimin e direktivës 2012/27 të BE-së "Për eficiencën e energjisë", si hap të parë drejt transpozimit të plotë të direktivave të BE-së për eficiencën e energjisë. Po kështu në këtë frymë janë edhe dy vendimet e qeverisë përkatësisht: VKM nr. 619, datë 7.9.2011, "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për eficiencën e energjisë 2011-2018" VKM nr. 628, datë 15.7.2015, "Për miratimin e Rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve". Sipas të dhënave ndriçimi publik konsumon 14% të të gjithë energjisë elektrike të Bashkimit Evropian, 19% në mbarë botën (sipas *International Energy Agency 2014*).

Përmirësimi i eficiencës së energjisë në ndriçimin e rrugëve realizohet duke kryer zëvendësimin e teknologjive të vjetra me sisteme më të reja dhe eficiente. Kjo ndërhyrje përmirësuese kushtëzon intensitetin e ndriçimit për natën në intervalin 50%-100% duke reduktuar në këtë mënyrë konsumin e energjisë. Formula për llogaritjen e kursimit të energjisë do të ishte:

$$TFES = ((L_{\mathrm{Re}f} \cdot P_{\mathrm{Re}f}) - (L_{Eff} \cdot P_{Eff} \cdot F_{\mathrm{Re}d})) \cdot t$$

TFES	Kursimi total vjetor i energjisë [kWh/vit]
L_{Ref}	Numri i pikave joeficiente në sistemin e ndriçimit të rrugëve
$\mathbf{L_{eff}}$	Numri i pikave eficiente të ndriçimit në sistemin e ndriçimit të rrugëve
$\mathbf{P_{Ref}}$	Fuqia në dalje për çdo pikë ndriçuese të sistemit joeficient [W]
$\mathbf{P_{Eff}}$	Fuqia në dalje për çdo pikë ndriçimi të sistemit eficient [W]
$\mathbf{F_{red}}$	Faktor korrigjues për masa ndërhyrëse shtesë (errësimi): - pa sensor të natës (0% reduktim);

	- me sensor pjesor për natën (50% reduktim p.sh., midis 11PM dhe 6AM); - me sensor të plotë për funksionim natën (100% reduktim të fuqisë).
t	Orët vjetore të punës [h/vit]
Fuqia mesatare e instaluar për ndriçim në vitin XX	

Vlerat:
Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese në vite (*default* ose sipas projektit specifik);
Numri i pikave joeficiente në sistemin e ndriçimit të rrugëve (sipas projektit specifik);
Fuqia në dalje për çdo pikë ndriçuese të sistemit joefiçent të ndriçimit (*default* ose sipas projektit);
Fuqia në dalje për çdo pikë ndriçimi të sistemit eficient të ndriçimit (*default* ose sipas projektit specifik);
Faktori korrigjues/reduktues për masa shtesë (*default* ose sipas projektit specifik);
Orët vjetore të punës (*default* ose sipas projektit specifik).

Vlerat referuese

t	365d x12h=4272 h/vit	Numri i orëve të punës në vit
L_{Ref}		Numri i ndriçuesve joeficiente
L_{Eff}		Numri i ndriçuesve eficiente
$\mathbf{P_{Reff}}$		Fuqia e ndriçuesit joeficiente
$\mathbf{P_{Eff}}$		Fuqia e ndriçuesit eficiente
Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese vlerësohet	15 vjet	DIRECTIVE 2006/32/EC ON ENERGY END-USE EFFICIENCY AND ENERGY SERVICES

Shembull. Zëvendësimi i ndriçuesve aktualë të zakonshëm me fuqi 250W me ndriçues LED me fuqi 40W në një rrugë në qytetin e Tiranës. Kjo praktikë ka disa përparësi të cilat janë:

- kursimi i energjisë nga 50% deri në 80% në krahasim me ndriçuesit aktualë me natrium apo merkur;
- cilësia më e mirë e ndriçimit për shkak të dritës së bardhë të ftohtë;
- jetëgjatësi 50,000-100,000 orë pune ose mbi 10 vjet për funksionim 12h/ditë;
- mirëmbajtje minimale, emetim minimal i nxehtësisë, dhe nuk lëshon rrezatim UV.

P.sh. ndriçues G360 LED SON me fuqi [6W, 10W, 20W, 30W, 40W, 60W] dhe eficiencë ndriçimi 140 lm/W, dhe orë punë 50,000 h.

Në një vit konsumi i energjisë elektrike nga një sistem i përbërë nga 30 ndriçues të zakonshëm do të ishte:

$$E = P_{Eff} \cdot t \cdot n = 250\frac{W}{llampë} \cdot 4272\frac{h}{vit} \cdot 30llampa = 32{,}040kWh/vit$$

Kostoja e energjisë elektrike në një vit:

$$C = E \cdot çmimi = 32{,}040\frac{kWh}{vit} \cdot 14\frac{Lek}{kWh} \cdot 1.2(T.V.SH) = 538{,}272Lekë$$

Pas zëvendësimit me llambat LED energjia e konsumuar do të vlerësohej:

$$E = P_{Eff} \cdot t \cdot n = 40\frac{W}{llampë} \cdot 4272\frac{h}{vit} \cdot 30llampa = 5126.4kWh/vit$$

Kostoja e energjisë elektrike në një vit:

$$C = E \cdot çmimi = 5126.4\frac{kWh}{vit} \cdot 14\frac{Lek}{kWh} \cdot 1.2(T.V.SH) = 86{,}123.52Lekë$$

Kursimi neto=538,272 lekë- 86,123 lekë=**452,149 lekë**

9.5 Ndriçimi në ndërtesat industriale

Për ndërtesat industriale do të merret në konsideratë që sistemi joeficient i ndriçimit të zëvendësohet me një ndriçim më eficient duke reduktuar konsumin e energjisë në ndërtesat industriale. Formula për llogaritjen e kursimit të energjisë jepet si vijon:

$$TFES = \frac{(P_{\mathrm{Re}f} - P_{Eff} \cdot F_{\mathrm{Re}d}) \cdot t}{1000} \cdot n$$

TFES	Kursimi total vjetor i energjisë [kWh/vit]
P_{Ref}	Fuqia e instaluar për ndriçim përpara ndërhyrjes [W]
P_{Eff}	Fuqia e instaluar për ndriçim pas ndërhyrjes [W]
F_{red}	Faktor korrigjues për masa ndërhyrëse shtesë (errësimi)

Kontrolli	*Kursimet tipike t e energjisë*	*Kursimet e supozuara të energjisë*	*Fc*	*Fd*
Kontroll manual	0 (base)	0	0	
Errësim i pjesshëm	10-20%	10%	0.1	
Rele kohe	10-35%	10%	0.1	
Sensor i lëvizjes	20-30%	20%	0.2	
Drita natyrale	20-30%	20%		0.2

t	Orët vjetore të punës [h/vit]
n	Numri i sistemeve të ndriçimit me eficiencë të përmirësuar
Fuqia e instaluar për ndriçim dhe orët e punës krahasohen me fuqinë e re dhe orët e reja të punës.	

Vlerat referuese sipas *"EMEEES bottom-up case application 9: Improvement of LightingSystems (Tertiary Sector)":*
Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese **rekomandohet 15 vjet** ose sipas projektit specifik)
Fuqia në dalje për çdo pikë ndriçuese të sistemit joeficient të ndriçimit (*default* ose sipas projektit)
Fuqia në dalje për çdo pikë ndriçimi të sistemit eficient të ndriçimit (*default* ose sipas projektit specifik)
Faktori korrigjues/reduktues për masa shtesë (*default* ose sipas projektit specifik)
-Faktori korrigjues për vlerat bazë nëse ndriçuesit kontrollohen në mënyrë manual është F_{red}=1;
-Nëse sistemi i ndriçimit kontrollohet në mënyrë automatike atëherë faktorët korrigjues jepen tek tabela e mësipërme.
Orët vjetore të punës (*default* ose sipas projektit specifik)
Numri i sistemeve të përmirësuara të ndriçimit (projekti specifik)

Bazuar në direktivën e BE-së për EcoDesign Directive 2009/125/EC dhe rregulloren "EU Regulation No 874/2012" më poshtë në aneks në tabelën nr. 24 jepen nivelet e eficiencës së energjisë për llambsat e ndriçimit.

10. Lëvizja (transporti)

Sektorët me interes të veçantë: kompanitë, *households*

Metodat e vlerësimit në këtë fushë përfshijnë blerjen e mjeteve lëvizëse të reja, zëvendësimin e makinave me mjete më eficiente (makina me gaz, CNG, makina elektrike), *eko-driving*, përmirësim i eficiencës nëpërmjet përdorimit të lubrifikantëve dhe gomave të reja, si edhe "*modal shift*" në transportin e pasagjerëve. Direktiva 2009/33/EC e KE-së dhe PE-së, datë 23.4.2009 mbi promovimin e mjeteve të transportit rrugor me eficiencë energjie.

10.1 Mjetet lëvizëse alternative

Kjo metodë i referohet blerjes së një mjeti me lëndë djegëse alternative, duke marrë në konsideratë zëvendësimin apo jo të mjetit me karburant fosil. Formula llogaritëse për vlerësimin e kursimit të energjisë do të kishte formën e mëposhtme:

$$TFES = n \cdot (sFEC_{REF} - sFEF_{Eff}) \cdot \frac{Mil}{100}$$

TFES	Kursimi total vjetor i energjisë [kWh/vit]
n	Numri i mjeteve eficiente të shitura në një vit
FEC_{Ref}	Konsumi specifik i energjisë referuar mjetit referencë të pasagjerëve [kWh/100km]
FEC_{Eff}	Konsumi specifik i energjisë referuar mjetit eficient të pasagjerëve [kWh/100km]
Mil	Kilometrat e përshkruar mesatarisht në vit [km/vit]

Vlerat referuese:
Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese rekomandohet 100,000 km *default* ose sipas projektit specifik;
Numri i mjeteve eficiente të shitura (sipas projektit specifik);
Kursimi përfundimtar i energjisë për mjetet referencë të pasagjerëve (vlera mesatare) (*default*);
Kursimi përfundimtar i energjisë për mjetet eficiente të pasagjerëve (vlera mesatare) (*default*);
Mesatarja e kilometrave të përshkruar në një vit (*default* ose specifike sipas projektit);
-Mil=100 000 km për mjetet eficiente me konsum të ulët të burimeve primare të energjisë;
-Mil= 50 000 km për mjetet me goma me rezistencë të ulët;
-Mil= 10,000 km për kamionët me goma me rezistencë të ulët;
Mil =50,000 km për mjetet me kontroll automatik të presionit të gomave.

- Konsumi specifik i lëndës djegëse për mjetet eficiente sipas standardeve të BE-së jepet në tabelën nr. 25 dhe tab. nr. 28 në aneks.

- Konsumi specifik i lëndës djegëse për mjetet referencë të transportit të pasagjerëve do të merret nga Ministria e Transportit.

- Kategoritë e mjeteve kryesore të transportit dhe jetëgjatësia e tyre e shprehur në km të përshkruara jepen në tabelën nr. 27.

Sa i përket vendit tonë është me rëndësi të theksohen disa të dhëna kryesore për flotën e mjeteve në vendin tonë sipas kategorive përkatëse. Të dhënat e mëposhtme i përkasin vitit 2018 dhe janë përshtatur nga *OpenData Albania*. Numri total i mjeteve në vendin tonë për kategorinë M1 (për pasagjerë) është 500,894 mjete gjithsej. Numri i mjeteve motorike është në rritje vit pas viti. Numri i autoveturave për 1000 banorë në vendin tonë vazhdon të mbetet më i ulëti në rajon, me një rritje të lehte krahasuar me vitin 2015 nga 121 automjete/1000 banorë në 160 automjete/1000 banorë në vitin 2018. Në Tiranë gjenden 179,167 automjete të transportit rrugor të cilat përbejnë 31% të totalit në të gjithë vendin. Në Tiranë, numri i autoveturave për 1000 banorë rezulton të jetë 220 autovetura. Siç dihet vendi ynë, prej 1.1.2019 ka ndaluar importin për mjetet motorike mbi 10 vjet nga data e prodhimit të cilat nuk i përkasin kategorive euro 5. Vlerësohet që vetëm 3.3 % e flotës së mjeteve në vendin tonë përafërsisht 14,000 mjete plotësojnë standardet e euro 5 dhe euro 6.

10.2 Eko-driving

Trajnimet për *eco-driving* janë shfaqur me interes vitet e fundit dhe në disa vende kjo praktikë është implementuar si pjesë e detyrueshme në mësimet e autoshkollës. Një grup i rëndësishëm për *eco-driving* përpos personave të ndryshëm privatë përbëjnë edhe shoferët profesionistë. Në mënyrë që të ndryshohet sjellja në shoferim është e rëndësishme që shoferet të marrin pjesë rregullisht në seanca trajnimi teorik dhe praktikë në rrugë automobilistike, ku këto seanca udhëhiqen nga instruktorë të kualifikuar. *Eco-driving* konsiderohet një ndër mundësitë për kursim të karburantit gjatë shoferimit. Në Austri janë përgatitur manuale të posaçme për autoveturat, mjetet komerciale dhe traktorët, të cilat shërbejnë si bazë për njohjen e trajnimeve të *eko-driving*.

Për trajnimet *eko-driving* në lidhje me makinat private;

$$TFES = \frac{n_{EP,0}}{n_{TP,0}} \cdot n_{vehicles,0} \cdot FEC_{ave,0} \cdot S_{ee,0}$$

Për trajnimet brenda vendit, në lidhje me flotën e mjeteve komerciale të kompanive të ndryshme formula e llogaritjes së kursimit të energjisë do të ishte:

$$TFES = \sum_{i=1}^{3} \frac{n_{EP,i}}{n_{TP,i}} \cdot n_{vehicles,i} \cdot FEC_{ave,i} \cdot S_{ee,i}$$

TFES	Kursimi total vjetor i energjisë i një flote të vetme automjetesh (kompanie) ose i një numri të caktuar banesash privatë [kWh/vit]
I	Kategoria e automjetit: •0=mjete private •1=mjete komerciale •2=automjete me peshë nën 3.5 t •3=autobusë dhe kamionë (mbi 3.5 t)
$\mathbf{n_{EP,i}}$	Numri i pjesëmarrësve në trajnimet *eko-driving* sipas një kategorie të caktuar automjeti
$\mathbf{n_{TP,i}}$	Numri total i personave që ngasin një kategori mjeti të caktuar (të trajnuar +të patrajnuar)
$\mathbf{n_{vehicles,i}}$	Numri total i mjeteve sipas kategorisë që posedon flota e një kompanie, ose numri i banesave privatë me pjesëmarrës të trajnuar
$\mathbf{FEC_{ave,i}}$	Konsumi mesatar final vjetor i energjisë i një mjeti specifik përpara trajnimit *eko-driving* [kWh/vit]
$\mathbf{S_{ee,i}}$	Faktor i kursimit në lidhje me konsumin final të energjisë sipas kategorisë së mjetit [%]

Vlerat:
Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese në vite sipas direktivës 2006/32/EC është **2 vjet** (*default* ose sipas projektit specifik);
Numri i pjesëmarrësve në trajnim *eco-driving*, në një kategori të caktuar mjetesh (sipas projektit specifik);
Numri total i personave që përdorin një kategori specifike mjetesh (të trajnuar + të patrajnuar) (sipas projektit specifik);
Numri total i mjeteve në një kategori specifike, në flotën e një kompanie, ose numri i rezidencave me pjesëmarrës të trajnuar (sipas projektit specifik);
Faktori i kursimit në lidhje me konsumin final të energjisë të një kategori të caktuar mjetesh transporti (*default* ose sipas projektit);
Konsumi i përgjithshëm final i energjisë për një kategori specifike mjetesh transporti (veturë, kamion) para trajnimit (*default* ose sipas projektit specifik).

		Shofer privat	*Shofer profesional*
S_{ec}	Kursimet pas një trainingu *eco-driving* për mjetet e pasagjerëve (8 leksione)	10%	10%
S_{ec}	Kursimet pas një trainingu *eco-driving* për mjetet e pasagjerëve (1 leksion)	5%	55
S_{ec}	Kursimet pas një trajnimi *eco-driving* për mjetet komerciale	-	6.5%

10.3 Përmirësimet e eficiencës përmes shfrytëzimit të lubrifikantëve të rinj dhe gomave të reja

Kjo metodë llogaritëse dallon mjetet e transportit të pasagjerëve komerciale dhe të vogla. Mjetet e vogla janë makina me të paktën katër rrota, me ulëse 8+1. Mjetet komerciale, përfshijnë mjetet e lehta komerciale, autobusët, kamionët etj.

Lubrifikantët dhe gomat që reduktojnë konsumin e karburantit konsiderohen:

Lubrifikantë të përshtatshëm: 5W-30, ose 10W-30

Goma të përshtatshme: etiketa *"blue angel" RAL-UZ 89*

Bazuar në *"EMMEES bottom-up case application 14: Vehicle Energy Efficiency, April 2009"*

$$TFES = ES_{uga} \cdot n_i$$

$$ES_{uga} = En_{\mathrm{Re}\,f} \cdot (1 - \frac{En_{Eff}}{En_{\mathrm{Re}\,f}} \cdot EV_{\mathrm{lub}} \cdot EV_{tyr}) \cdot \frac{Mil}{100}$$

TFES	Kursimi total vjetor i energjisë [kWh/vit]
n_i	Numri i automjeteve të pajisur me lubrifikant dhe goma për kursim të karburantit
i	Tipi i automjeteve
ES_{uga}	Kursimet vjetore bruto të energjisë [kWh/vit]
En_{Ref}	Konsumi specifik mesatar i karburantit në automjetin referencë [kWh/100 km]
En_{Eff}	Konsumi specifik mesatar i karburantit për automjetin eficient [kWh/100 km]
EV_{lub}	Vlera e eficiencës për lubrifikantët për kursim të karburantit [0;1]
EV_{tyr}	Eficienca për e gomave për kursim të karburantit [0;1]
Mil	Mesatarja e kilometrave në vit [km/vit]
Mjetet e pasagjerëve: Komisioni Evropian ka vendosur një target për emetimet e CO_2 prej vitit 2012 në 130 gCO_2/km.	

Vlerat referuese:

- Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese rekomandohet 2 vjet ose sipas projektit specifik;
- Numri i automjeteve të pajisur me lubrifikant dhe goma për kursim të karburantit zgjidhet sipas rastit specifik;
- Konsumi specifik mesatar i karburantit në automjetin referencë [kWh/100 km].

Konsumi specifik En_{Ref} për emetime 130g CO_2/km
0.489 kWh/km për lëndë djegëse benzinë
0.498 kWh/km për lëndë djegëse benzinë super
0.487 kWh/km për mjetet me lëndë djegëse diesel
0.618 kWh/km për mjetet me gaz natyral

- Konsumi specifik mesatar **En_{Eff}** i karburantit për automjetin eficient [kWh/km] mund t'i referohemi tab. 25 dhe tab. 28, për vlerat e konsumit energjetik për mjetet e reja. Informacion shtesë mund të zgjidhet në *website* https://www.indicators.odyssee-mure.eu/online-indicators.html
- Eficienca për lubrifikantët dhe gomat për mjetet (EV_{lub} dhe EV_{tyr})

Lubrifikantë	**Lubrifikantë**	**Goma**	**Goma**
Mjete për pasagjerë	Mjete komerciale	Mjete për pasagjerë	Mjete komerciale
0.973	0.973	0.975	0.950

- Mesatarja e kilometrave në një vit mund t'u referohemi vlerave të paraqitura në IX.I.

10.4 Ndryshimi i mënyrës së transportit të pasagjerëve

Zgjedhja e një mënyre të caktuar transporti përcaktohet kryesisht nga distanca që duhet të përshkohet dhe nga rrethana të tjera gjeografike apo socio-ekonomike. Ndryshimi i mënyrës së transportit për pasagjerët mund të përcaktohet si distancë që mund të përshkohet, megjithatë me mjete me konsum më të ulët energjie, rrjedhimisht sipas një sistemi transporti më të qëndrueshëm. Natyrisht, distanca e përshkuar mbetet e njëjtë. Sa u përket udhëtimeve të shkurtra, qëllimi i Direktivës është forcimi i sistemeve të transportit jomotorike dhe transportit urban. Sa u përket distancave të mëdha, sistemi hekurudhor i transportit shihet si sistem më i qëndrueshëm sesa mjetet motorike individuale të

transportit ose sistemi ajror i transportit. Mjetet për lehtësimin dhe rritjen e masës së transportit të qëndrueshëm vardojnë nga planifikimi urban, politika rregullatore, stimuj fiskale po kështu edhe masa motivuese dhe kualifikuese.

$$TFES = Np_{\text{Re gion}} \cdot \sum_{i=1}^{N} Mil_i \cdot (MC_{\text{Re f},i} - MC_{Eff,i}) \cdot En_i$$

Vlerat:
Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese në vite (*default* ose sipas projektit specifik);
Mesatarja e kilometrave të përshkuar në vit sipas mënyrës së transportit (*default* ose sipas projektit specifik);
Pjesa e mënyrës së transportit i (*Modal choice*) *baseline* (sipas projektit specifik);
Pjesa e mënyrës së transportit i të përdorur (*Modal choice*) i ri (sipas projektit specifik);
Konsumi specifik i energjisë për mënyrën i të transporti (*default* ose repsektivisht projektit);
Numri i mënyrave të transportit të marrë në konsideratë (respektivisht sipas projektit).

TFES	Kursimi total vjetor i energjisë për person [kWh/vit]
Np_{region}	Numri i personave mbi të cilën është bazuar vlerësimi i miksit të mobilitetit
Mil	Mesatarja e kilometrave të përshkuar për një mënyrë transporti në vit [km/vit]
I	Mënyra e transportit
$MC_{Ref,i}$	Pjesa e mënyrës së transportit i (*Modal choice*) *baseline* [0;1]
$MC_{Eff,i}$	Pjesa e mënyrës së transportit i të përdorur (*Modal choice*) I ri [0;1]
$En_{,i}$	Konsumi specifik i energjisë për mënyrën i të transportit [kW h/person.km]
N	Numri i mënyrave të transportit të trajtuar
Baza është konsumi specifik mesatar i energjisë të mënyrës së transportit të konsideruar, si edhe distanca vjetore e përshkuar.	

- Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese sipas "DIRECTIVE 2006/32/EC ON ENERGY END-USE EFFICIENCY AND ENERGY SERVICES" rekomandohet 5 vjet.

- Vlerat e konsumit specifik të energjisë $En_{,I}$ sipas mënyrës së transportit paraqiten në tab. 27.

Bazuar në *"EMEES Bottom-up case application 15: Modal Shift in Passenger Transport"* formula llogaritëse për kursimin vjetor të energjisë për person referuar mënyrës së transportit të pasagjerëve jepet si më poshtë:

$$ES_{UGA} = \sum_{i=1}^{N} \Delta ADT_i \cdot En_i$$

$$\sum_{i=1}^{N} \Delta ADT_{bas,i} = \sum_{i=1}^{N} \Delta ADT_{new,i}$$

ES_{UGA}- Kursimet vjetore bruto të energjisë [kWh/person/vit]

En-konsumi specifik i energjisë për një mënyre transporti;

ΔADT-ndryshimi vjetor i distancës së përshkuar për një mënyrë transporti në [km/vit] (ADT_{Base}-ADT_{new})

i- Mënyra e transportit;

N- numri i mënyrave të transportit të trajtuar;

Duke u mbështetur të https://www.indicators.odyssee-mure.eu/online-indicators.html mund të nxjerrim të dhëna të vlefshme sa i përket konsumit specifik të lëndës djegëse km të përshkruar. Konsumi specifik i lëndës djegëse në vendet e BE-së jepet në tabelën 25, në aneks.

11. Pajisjet e zyrës

Pajisjet e zyrave përbejnë një pjesë të rëndësishme ndihmese gjatë punës sonë të përditshme duke na mundësuar dhe lehtësuar mjaft procese të cilat shkurtojnë kohë, por njëkohësisht konsumojnë edhe mjaft energji.

Sektorët që paraqesin interes e veçantë janë: sektori publik, dhe sektori privat i shërbimeve

Formula llogaritëse siguron vlerësimin vjetor të kursimit të energjisë nga instalimi i pajisjeve të reja të zyrave ose zëvendësimi i tyre me pajisje me eficiencë më të lartë. Kursimi fundor i energjisë duhet të llogaritet sipas tipit të pajisjes (PC, monitor, printera, fotokopjues, fakse, skanera etj.).

Formula llogaritëse BU mundëson vlerësimin e kursimit të energjisë për tri mënyra të punës së pajisjeve të zyrës:

- kursimi fundor i energjisë për mënyrën aktive të punës;
- kursimi fundor i energjisë për mënyrën *standby*;
- kursimi fundor i energjisë për ndryshime të mënyrës së punës; duke iu referuar përmirësimeve të ndryshme nëpërmjet programeve speciale.

Formula llogaritëse për mënyrën aktive të funksionimit:

$$TFES = n \cdot \frac{PA_{referenceyearstockaverage} - PA_{referenceyearbestpermarket})}{1000} \cdot h_{active}$$

Mënyra Standby:

$$TFES = n \cdot \frac{PS_{referenceyearstockaverage} - PS_{referenceyearbestpermarket})}{1000} \cdot h_{standby}$$

Mënyra e përmirësuar e punës:

$$TFES = n \cdot (\frac{PA_{referenceyearstockaverage} \cdot h_{active} + PS_{referenceyearbestpermarket} \cdot h_{standby})}{1000} - (\frac{PA_{new} \cdot h_{active} + PS_{new} \cdot h_{standby}}{1000})$$

TFES	Kursimi total vjetor i energjisë për person[kWh/vit]
n	Numri I pajisjeve të reja të instaluar, apo atyre të zëvendësuara
$PA_{referenceyearstockaverage}$	Fuqia elektrike e pajisjes në funksion aktiv në [W]
$PA_{referenceyearbestpërmarket}$	Fuqia elektrike e pajisjes eficiente në treg në funksionin aktiv
$PS_{referenceyearstockaverage}$	Fuqia elektrike e pajisjes në funksionin *standby* në [W]
$PS_{referenceyearbestpërfmarket}$	Fuqia elektrike e pajisjes eficiente në treg në funksionin *standby* [W]
PA_{new}	Fuqia e pajisjes në funksionin aktiv, pas modifikimit të pajisjes ekzistuese [W]
PS_{new}	Fuqia elektrike në funksionin *standby*, pas modifikimit të pajisjes ekzistuese në [W]
h_{active}	Numri i orëve në funksionin aktiv [h/vit]
$h_{standby}$	Numri i orëve në funksionin *standby* [h/vit]
Baseline	
Për funksionin aktiv: llogaritet si diferencë midis konsumit të energjisë elektrike në funksion aktiv për stokun e pajisjeve në vitin referencë dhe konsumit të energjisë elektrike në funksion aktiv të pajisjeve eficiente të shitura në treg, shumëzuar me numrin e orëve të punës në funksionin aktiv. Për *standby*: llogaritet si diferenca midis energjisë elektrike të konsumuar në funksion *standby* për stokun e pajisjeve në vitin referencë dhe konsumit të energjisë të pajisjeve eficiente të shitura në treg shumëzuar me numrin e orëve në funksion aktiv;	

Vlerat referuese:

- Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese rekomandohet 3 vjet;
- Numri i pajisjeve të zyrës të zëvendësuara apo të instaluara rishtas merret sipas projektit specifik;
- Fuqia e pajisjeve të ndryshme shtëpiake në funksionin aktiv në [W] dhe *standby* jepen në tab. 30 dhe tab. 37 në aneks.
- Numri i orëve të pajisjeve të zyrës në funksionin aktiv dhe *standby* jepen në tab. 32. Performanca më e mirë energjetike për pajisjet e zyrës mund të vlerësohet edhe me formulën llogaritëse të mëposhtme dhe vlerat përkatëse mbështetur në www.topten.eu paraqiten në tab. 29;

$$E_{TEC} = \frac{8760}{1000} \cdot (0.55 \cdot P_{OFF} + 0.05 \cdot P_{Sleep} + 0.4 \cdot P_{Idle}) \text{ [kWh/vit]}$$

P_{OFF}- fuqia në [W] në regjimin OFF;
P_{sleep}- fuqia në [W] në regjimin sleep;
P_{Idle}- fuqia e pajisjes në regjimin Idle;

12. Impiantet fotovoltaike

Sektorët që paraqesin interes për kursimet e energjisë: banesat rezidenciale, sektori i shërbimit publik dhe privat.

Formula llogaritëse e BU vlerëson kursimet e energjisë nga instalimi i impianteve fotovoltaike për të përballuar konsumin vetjak nevojat për energji. Nuk do të merret në konsideratë sasia e energjisë që hidhet në rrjet.

Kjo masë përmirësuese rezulton në reduktimin e energjisë elektrike të shitur konsumatorëve të saj fundore dhe, rrjedhimisht, në reduktim të mundshëm të energjive primare.

Sipas një studimi nga AKBN-ja (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore) në territorin e vendit tonë kemi një potencial energjetik diellor të konsiderueshëm, ku shumë zona të saj i ekspozohen një rrezatimi që shkon nga 1185 kWh/^{m2} në vit deri më 1700 kWh/m^2 në vit. Vlen të përmendet që pjesa perëndimore e Shqipërisë, veçanërisht jugperëndimi i saj ka një energji diellore të konsiderueshme që shkon deri me 2200 kWh në vit. Shpërndarja territoriale e diellzimit (sasisë së orëve me diell) dhe sidomos ajo e dellëzimit relativ, që në të tilla raste përdoret si tregues sasior i vranësirës, është në të gjithë territorin rreth 2400 orë, ndërsa në pjesën perëndimore është mbi 2500 orë dhe në fushën e Myzeqesë arrin mbi 2700 orë. Vlerat më të larta të sasive ditore të rrezatimit diellor vërehen në periudhën e ngrohtë të vitit dhe sidomos në muajt e verës. Konkretisht në muajin dhjetor sasia ditore e rrezatimit diellor është rreth 2.3 kWh/m^2 në ditë, ndërsa në muajin korrik kjo vlerë është rreth 8.030kWh/m^2 në ditë. Diellzimi ditor në pjesën perëndimore të Shqipërisë është më shumë se 5.5 orë. Në vendin tonë, numri i ditëve me diell ndryshon nga një mesatare 240-260 ditë në vit deri në një maksimum 280-300 ditë në vit, në pjesën jugperëndimore.

Varianti 1

$$TFES = P_{PV} \cdot t \cdot PR \cdot (1 - ee_{grid})$$

Opsioni 2.

$$TFES = P_{PV} \cdot \frac{1}{sPV} \cdot Hm \cdot \eta_{el} \cdot (1 - P_{Loss}) \cdot (1 - ee_{grid})$$

TFES	Reduktimi i sasisë së energjisë të shpërndarë nga rrjeti publik [kWh/vit]
P_{PV}	Fuqia peak e instaluar e sistemit PV [kW_{peak}]
t	Kohëzgjatja e rrezatimit diellor e 1000W/m^2 (ngarkesa e plotë) në site [h/a]
PR	Shkalla e performancës së impiantit PV; raporti midis energjisë aktuale të prodhuar me atë teorike nga impianti PV [%]
ee_{grid}	Pjesa e energjisë elektrike që futet në rrjetin publik dhe nuk mund të vlerësohet si reduktim i energjisë së shitur [%]
sP_{PV}	Fuqia specifike e sistemit PV [kW_{peak}/m^2 të modulit fotovoltaik]
H_m	Shuma mesatare e rrezatimit diellor për njësi të sipërfaqes të përftuar nga modulet PV të një sistemi të caktuar me një kënd pjerrësie të caktuar (p.sh. 35º) dhe kënd të azimuthit (kWh/m^2)
η_{el}	Eficienca elektrike mesatare e moduleve PV
P_{Loss}	Humbjet e sistemit të kombinuar PV [%]: - humbjet e llogaritura në sajë të temperaturës dhe rrezatimit të ulët: 8.1% (duke përdorur temperaturën e mjedisit); - humbjet e llogaritura në sajë të efekteve këndore të reflektimit: 2.9%; - humbje të tjera (kabllo, inverter etj.).
Asnjë sistem PV nuk është i instaluar. E gjithë sasia e energjisë e kërkuar nga konsumatori fundor sigurohet nga rrjeti publik.	

Vlerat:
Fuqia peak e instaluar e sistemit PV (*default* ose sipas projektit specifik);
Kohëzgjatja e rrezatimit diellor e 1000W/m^2 (ngarkesa e plotë) në site (*default* ose sipas projektit);
Shkalla e performancës së impiantit PV; raporti midis energjisë aktuale të prodhuar me atë teorike nga impianti PV [%] (*default* ose sipas projektit);
Pjesa e energjisë elektrike që futet në rrjetin publik dhe nuk mund të vlerësohet si reduktim i energjisë së shitur [%] (*default* ose sipas projektit specifik);
Fuqia specifike e sistemit PV [kW_{peak}/m^2 të modulit fotovoltaik] (*default* ose sipas projektit specifik)
Shuma mesatare e rrezatimit diellor për njësi të sipërfaqes të përftuar nga modulet PV të një sistemi të caktuar (*default* ose sipas projektit specifik);
Eficienca mesatare elektrike e moduleve PV (*default* ose sipas projektit specifik);
Humbjet e përgjithshme të sistemit fotovoltaik (*default* ose sipas projektit specifik).

Vlerat referencë për të dhënat e mësipërme paraqiten si vijon:

- Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese sipas direktivës 2006/32/EC është 23 vjet ose sipas projektit specifik.

ee_{grid-} sasia e energjisë elektrike e hedhur në rrjetin energjetik e shprehur në përqindje [%]

- PR -Shkalla e performancës së impiantit fotovoltaik (*performance ratio*), shpreh faktorin e cilësisë së impiantit PV. Kjo shkallë performance mund të vlerësohet si raport i energjisë reale të përftuar nga impianti kundrejt sasisë së energjisë teorike të përftuar.

$$PR = \frac{E_{Aktuale}}{E_{Nominale}}[\%]$$

Ku: $E_{Aktuale}$- është energjia reale e prodhuar nga impianti PV e matur në fund të vitit në kWh/vit.

$E_{Nominale}$- është energjia e llogaritur që mund të prodhojë impianti fotovoltaik dhe vlerësohet me formulën:

$$E_{Nominale} = I \cdot A \cdot \eta_{module}$$

Prej ku: I- është intensiteti i rrezatimit diellor që jepet në tabelë.

A- Sipërfaqja e moduleve fotovoltaike; η- eficienca e moduleve PV

Eficienca e paneleve fotovoltaike varet nga një seri faktorësh, duke filluar nga prodhuesi, materiali etj. Eficienca e moduleve fotovoltaike varion nga vlerat minimale rreth 14% deri në 20.7% apo kompani të ndryshme si ***SunPower*** kanë arritur edhe eficiencë më të lartë deri në 22.80%. Gjithsesi duhet të kemi parasysh që modulet fotovoltaike kanë edhe një shkallë degradimi të rendimentit të tyre nga viti në vit.

Vlerat e intensitetit të rrezatimit diellor vjetor për vendin tonë jepen në tabelën nr. 33, ndërsa ato të këndit optimal të paneleve fotovoltaike në tab. 34 në aneks.

13. Zëvendësimi i kaldajave me rendiment të ulët

Kjo masë përmirësuese ka si target të saj këta sektorë: banesat rezidenciale, sektorin e shërbimeve privat dhe publik (ndërtesat jorezidenciale).

Metoda llogaritëse ofron vlerësimin sasior të kursimit të energjisë nga zëvendësimi i kaldajave të vjetra me kaldaja me eficientë me gaz, naftë apo biomasë. Kjo metodë merr në konsideratë banesat monofamiljare apo shumëfamiljare, si edhe blloqet e apartamenteve dhe mund të përshtatët edhe për ndërtesat komerciale nëse sigurohen të dhënat e duhura.

1. Zëvendësimi i një tipi të vjetër kaldaje gaz/naftë me një të ri gaz/naftë

Formula llogaritëse jepet si vijon:

Opsioni 1

$$TFES = n \cdot A \cdot \left((SHD + HWD) \cdot EF_{Ref} - (SHD + HWD) \cdot EF_{Eff}\right)$$

Opsioni 2

$$TFES = n \cdot A \cdot (SHD + HWD) \cdot \left(\frac{1}{\eta_{Ref}} - \frac{1}{\eta_{Eff}}\right)$$

TFES	Kursimi final vjetor i energjisë [kWh/vit]
n	Numri i bojlerëve të zëvendësuar
A	Sipërfaqja bruto e dyshemesë së ngrohur [m²]
SHD	Kërkesa specifike e nxehtësisë për ngrohjen e ambientit [kWh/m².vit]
HWD	Kërkesa specifike për ujë të ngrohtë sanitar [kWh/m².a]
EF_{Ref}	Faktori i shfrytëzimit të sistemit aktual të ngrohjes
EF_{Eff}	Faktori i shfrytëzimit të sistemit të ri të ngrohjes
η_{Ref}	Eficienca e shfrytëzimit të sistemit aktual të ngrohjes
η_{Eff}	Eficienca e shfrytëzimit të sistemit të ri të ngrohjes
Zëvendësimi në fund të jetëgjatësisë së kaldajës	

Vlerat referuese:

- Jetëgjatësia e masës përmirësuese sipas direktivës 2006/32/EC rekomandohet:
- Kaldaja me fuqi deri në 30kW: 20 vjet
- Kaldaja me fuqi mbi 30 kW: 25 vjet

A- Sipërfaqja bruto e dyshemesë së ngrohur merret specifikisht nga projekti

- Kërkesa specifike vjetore për nxehtësi SHD merret sipas projektit specifik ose rekomandohet duke u mbështetur respektivisht në tabelën nr. 1, tab. nr. 2 dhe tab. nr. 3.

- HWD- paraqet kërkesën vjetore për ujë të ngrohtë sanitar dhe vlerat referuese paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën nr. 35.

- Eficienca e sistemit aktual dhe atij të ri të ngrohjes η_{ref} jepet me formulën e mëposhtme:

$$\eta_{\mathrm{Re}\,f} = \frac{(SHD + HWD)}{Q_{Ngrohje}}$$

$$Q_{Ngrohje} = Q_{prodhuesit} \cdot \eta_{ini}$$

Eficienca e sistemit aktual (η_{ini}) për sistemet e furnizimit me energji llogariten:

$$\eta_{ini} = \eta_{boiler} \cdot \eta_p \cdot \eta_c$$

ku η_b = eficienca e bojlerit (burimi)

η_p = eficienca e rrjetit të tubacioneve (shpërndarja)

η_c = eficienca e kontrollit (rregullimi)

Eficienca e sistemit të ri të ngrohjes:

$$\eta_{Eff} = \frac{(SHD + HWD)}{Q_{Ngrohje}}$$

$$Q_{Ngrohje} = Q_{prodhuesit} \cdot \eta_{new}$$

$$\eta_{new} = \eta_{boiler} \cdot \eta_p \cdot \eta_c$$

SHD- Vlera referencë në vendet e EU është 86kWh/m^2/vit; megjithatë të dhëna plotësuese mund të nxirren nga dokumentacioni i projektit, auditimi i energjisë etj.;

Rendimenti i kaldajave me kondensim rekomandohet η=94%;

Rendimenti i kaldajave të programuara për t'u zëvendësuar η=89%;

***Burimi**: EMEES bottom-up case application 4: Residential condensing boilers in space heating*

13.1 Zëvendësimi i një kaldaje të vjetër me një kaldajë eficiente me biomasë

Formula e mëposhtme llogaritëse mund të shfrytëzohet për banesat monofamiljare dhe ato shumëfamiljare, si dhe për blloqet e apartamenteve.

Opsioni nr. 1

$$TFES = n \cdot A \cdot ((SHD + HWD) \cdot EF_{\mathrm{Re}\,f} - (SHD + HWD) \cdot EF_{Eff})$$

Opsioni nr. 2

$$TFES = n \cdot A \cdot ((SHD + HWD) \cdot (\frac{1}{\eta_{\mathrm{Re}\,f}} - \frac{1}{\eta_{Eff}})$$

TFES	Kursimi final vjetor i energjisë [kWh/vit]
N	Numri i bojlerëve të zëvendësuar
A	Sipërfaqja bruto e dyshemesë së ngrohur [m2]
SHD	Kërkesa specifike për energji për ngrohjen e ambientit [kWh/m2.vit]
HWD	Kërkesa specifike e energjisë për ujë të ngrohtë sanitar [kWh/m^2.a]
EF_{Ref}	Faktori i shfrytëzimit të sistemit aktual të ngrohjes
EF_{Eff}	Faktori i shfrytëzimit të sistemit të ri të ngrohjes
η_{Ref}	Eficienca e shfrytëzimit të sistemit aktual të ngrohjes
η_{Eff}	Eficienca e shfrytëzimit të sistemit të ri të ngrohjes
Zëvendësimi në fund të jetëgjatësisë së bojlerit: me naftë mesatar, me gaz, apo biomasë duke prodhuar ujë të ngrohtë dhe nxehtësi; Zëvendësimi para kohe: eficienca mesatare e bojlerëve me gaz dhe naftë në gjendje; Vlerat e sasisë së nxehtësisë për ngrohje duhen korrigjuar me gradë ditët përkatëse.	

Vlerat referuese:

- Jetëgjatësia e masës përmirësuese sipas direktivës 2006/32/EC rekomandohet:
- kaldaja me fuqi deri në 30kW: 20 vjet;
- kaldaja me fuqi mbi 30 kW: 25 vjet.

Të dhënat e tjera plotësuese mund të merren si referencë vlerat e paraqitura në 12.1.

13.2 Kaldajat me biomasë

Kjo masë përmirësuese ka për qëllim zëvendësimin e kaldajave me lëndë djegëse fosile nga ato me biomasë. Kaldaja me biomasë përfaqëson dy raste:

a) sistemin e vetëm të ngrohjes së ndërtesës;

b) një sistem alternativ shtesë për ngrohjen e ndërtesës.

Kaldaja ekzistuese me lëndë djegëse ekzistuese, fosile e shënuar me (FFB) plotësohet me një kaldajë me biomasë (BMB). Konsumi vjetor i nxehtësisë (Q) në këtë rast ndahet në dy pjesë sipas raportit të nxehtësisë së prodhuar (zakonisht: BMB=regjimi bazë; FFB=regjimi peak/rezervë). Vlerat default referuese për kërkesën e nxehtësisë do të ishin për shembull: $Q_{Biomasë}$=90%; Q_{Fossil}=10%)

Formula llogaritëse për kaldajën ekzistuese me lëndë djegëse fosile plotësuar me një kaldajë eficiente me biomasë:

Varianti 1

$$TFES = n \cdot A \cdot ((SHD + HWD) \cdot EF_{\mathrm{Re}\,f} - (Q_{Fossil}(SHD + HWD) \cdot EF_{\mathrm{Re}\,f} + Q_{Biomass} \cdot (SHD + HWD) \cdot EF_{Eff}))$$

Varianti 2

$$TFES = n \cdot A \cdot \left(\frac{(SHD + HWD)}{\eta_{\mathrm{Re}\,f}} - \left(\frac{Q_{Fossil} \cdot (SHD + HWD)}{\eta_{\mathrm{Re}\,f}} \right) + \left(\frac{Q_{Biomass} \cdot (SHD + HWD)}{\eta_{Eff}} \right) \right)$$

Ose:

$$TFES = n \cdot A \cdot Q_{Biomass} \left(\frac{(SHD + HWD)}{\eta_{\mathrm{Re}\,f}} - \frac{(SHD + HWD)}{\eta_{Eff}} \right)$$

TFES	Kursimi final vjetor i energjisë [kWh/vit]
n	Numri i bojlerëve (kaldajave) të zëvendësuara
A	Sipërfaqja bruto e dyshemesë së ngrohur [m²]
SHD	Kërkesa specifike për ngrohjen e ambientit [kWh/m².vit]
HWD	Kërkesa specifike për ujë të ngrohtë sanitar [kWh/m².a]
EF_{Ref}	Faktori i shfrytëzimit të sistemit aktual të ngrohjes
EF_{Eff}	Faktori i shfrytëzimit të sistemit të ri të ngrohjes
η_{Ref}	Eficienca e shfrytëzimit të sistemit aktual të ngrohjes
η_{Eff}	Eficienca e shfrytëzimit të sistemit të ri të ngrohjes
Eficienca mesatare e sistemit të ngrohjes të zëvendësuar nga kaldaja me biomasë: Mesatarja e tregut për një kaldajë ineficiente me biomasë. Vlerat e sasisë së nxehtësisë për ngrohje duhet të korrigjohen me të dhënat e gradë ditëve të caktuara.	

Jetëgjatësia e masës përmirësuese sipas direktivës 2006/32/EC rekomandohet:

- kaldaja me fuqi deri në 30kW: 20 vjet;
- kaldaja me fuqi mbi 30 kW: 25 vjet.

Si vlera referuese edhe në këtë rast mund të shfrytëzojmë të dhënat në aneks.

14. Panelet diellore termike

E destinuar për: ndërtesat rezidenciale, sektorin publik dhe provat të shërbimeve;

Për këtë përdoren dy metoda sa i takon shfrytëzimit të paneleve diellore;

a) Panelet diellore për ngrohje të banesave;

b) Përgatitja e ujit të ngrohtë sanitar.

14.1 Ngrohja e banesës me anë të paneleve diellore

Kjo masë i referohet instalimit të paneleve diellore për ujë të ngrohtë dhe sistem mbështetës për ngrohjen e banesave të reja apo atyre ekzistuese. Nxehtësia e prodhuar në panelet diellore do të reduktonte sasinë së prodhuar nga sistemi ekzistues i ngrohjes.

Kjo metodë përfshin panelet me kolektorë të sheshtë dhe atyre me tuba të cilët kanë një diferencë sa i përket prodhimit të nxehtësisë:

Opsioni 1

$$TFES = A \cdot Q_{ave,yield} \cdot EF_{\mathrm{Re}\,f}$$

Opsioni 2

$$TFES = A \cdot Q_{ave,yield} \cdot \frac{1}{\eta_{\mathrm{Re}\,f}}$$

TFES	Kursimi final vjetor i energjisë [kWh/vit]
A	Sipërfaqja e instaluar e kolektorëve diellorë [m²]
Q_{ave_yield}	Nxehtësia mesatare vjetore e gjeneruar, për njësi të sipërfaqes së kolektorit [kWh/m².vit]

EF_{Ref}	Faktori i shfrytëzimit për sistemin aktual të ngrohjes
η_{Ref}	Eficienca e shfrytëzimit të sistemit aktual të ngrohjes
Sistemi aktual i ngrohjes me lëndë djegëse gaz, naftë, biomasë etj.	

Vlerat referuese:
Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese merret **20 vjet** sipas direktivës së BE-së, direktiva 2006/32/EC ose sipas projektit specifik);
Sipërfaqja e kolektorëve diellorë të instaluar (sipas projektit);
Nxehtësia mesatare vjetore e gjeneruar, për njësi të sipërfaqes së kolektorit të rrafshët apo atyre me tuba (*default*);
Faktori i kostos së sistemit aktual të ngrohjes (*default* ose sipas projektit specifik);
Eficienca e shfrytëzimit të sistemit aktual të ngrohjes (*default* ose sipas projektit specifik).

Konsumi specifik i ujit të ngrohtë në banesë

Standard i ulët	10-20 litra/person.ditë
Standard mesatar	20-40 litra/person.ditë
Standard i lartë	40-80 litra/ person.ditë

Sasia e nxehtësisë e nevojshme për ngrohjen e ujit nga literatura mund të llogaritet me formulën përkatëse si vijon:

$$Q_{UNGS} = \frac{V_{UNGS} \cdot \rho \cdot c_u \cdot (t_1 - t_2)}{3.6 \cdot 10^3} [kWh]$$

Q_{UNGS}- sasia e nxehtësisë e nevojshme për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar në [kWh];
V_{UNGS}- konsumi mesatar ditor i ujit të ngrohtë (m^3/ditë)
c_u- nxehtësia specifike e ujit (4.187 kJ/kgK)
t_1- temperatura e ujit të ngrohtë (60^oC)
t_2- temperaturë e ujit të ftohtë (15^oC)

Duke u mbështetur në literaturë nxehtësia mesatare vjetore e gjeneruar, për njësi të sipërfaqes së kolektorit llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$Q_{ave_yield} = I \cdot \eta_{sol_col} \cdot \eta_{sol_boiler} \cdot \eta_{pipes}$$

Rendimenti i kolektorëve diellore bazuar në tipin e tyre paraqitet në tabelën nr. 36 në aneks.

15. Pajisjet e kontrollit në regjimin standby në ndërtesat rezidenciale

Sektori: Rezidencial

Kjo metodë siguron llogaritjen dhe vlerësimin e kursimeve të energjisë në sajë të instalimit të pajisjeve të kontrollit të cilat sigurojnë regjimin *standby*, njohur ndryshe si "*standby killer*" në banesat rezidenciale.

Konsumi i energjisë elektrike në regjimin *standby* i korrespondon pajisjeve të fikura, por jo të shkëputura nga energjia elektrike. Të ashtuquajturit *standby killer* janë kontrollues të cilët dallojnë fuqinë *standby* dhe ndërpresin konsumin e energjisë nga pajisja në gjendjen OFF.

Standby killers në banesat tona ulin konsumin e energjisë elektrike duke eliminuar në këtë mënyrë konsumin për gjendjen *standby* të pajisjes. Megjithëkëtë, për një vlerësim të plotë të kursimeve të energjisë duhet të marrim në konsideratë edhe konsumin e kontrollorit "*stand* by *killer*" duke ulur paksa kursimin total.

Formula llogaritëse do të ishte si vijon:

$$TFES = n_{SBK} \cdot \frac{P_G \cdot t_{SB} - P_{SBK} \cdot t_a}{1000}$$

TFES	Kursimi final vjetor i energjisë [kWh/vit]
n_{SBK}	Numri total i kontrollorëve *standby* të instaluar
P_G	Fuqia në regjimin *standby* të pajisjes elektrike respektive [W]
P_{SBK}	Konsumi i energjisë nga kontrolluesi *standby killer* [W]
t_a	Numri i orëve në vit të kontrollorit *standby* në shfrytëzim [h/vit]
t_{SB}	Numri i orëve në vit të pajisjes në regjim *standby* [h/vit]
Pajisja elektrike operon në regjim *standby,* por pa një kontrollues *standby*.	

Vlerat referuese:
Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese në vite rekomandohet **2 vjet** ose sipas projektit specifik;
Numri i kontrollueseve *standby* të instaluar mund të vlerësohet specifkisht sipas projektit të caktuar;
Konsumi i energjisë nga vetë kontrolluesi i regjimit *standby* mund të pranohet **0.5W** sipas vlerësimeve të *www.topten.ch* ose mund të

llogaritet sipas projektit specifikisht.
Duke u mbështetur në një raport të JEITA (*Japan Electronics and Information Technology Industries Association*) numri i orëve në vit të kontrollorit *standby* për TV vlerësohet **t_a=7117.5 h/vit** në shfrytëzim, ndërsa si maksimum mund të merret: t_a=8,760 h/vit.
(Burimi: https://www.eup-network.de/fileadmin/user_upload/Produktgruppen/Lots/Final_Documents/Lot_5_Final_Report_1-8.pdf)
Numri i orëve në vit t_{SB} të pajisjes në regjim *standby* gjithashtu jepet mund të referohet në tabelën nr. 37.

Metoda llogaritëse mbështetet duke shfrytëzuar ekuacionin e mëposhtëm:

$$P_g = \frac{\sum_{i=1}^{n} P_i}{n}$$

Ku:

P_G=fuqia mesatare, konsumi i energjisë në regjimin *standby* për pajisjen *i*; [W, kWh/vit]

P = fuqia, energjia e konsumuar për pajisjen *i*;

i=tipi i pajisjes (DVD, TV, laptop etj.);

n- numri total i pajisjeve;

Vlerat referuese:

- Fuqia mesatare në regjimin *standby* për disa prej pajisjeve kryesore paraqitet hollësisht në aneks, në tab. 37.

- Fuqia ose konsumi specifik i energjisë prej disa prej pajisjeve *standby* jepet në tab. 38. Duhet theksuar që ky konsum është vlerësuar duke u mbështetur në disa studime në nivel kombëtar për vende të ndryshme në BE dhe rekomandime e rregullore: rregullorja (EC) nr. 801/2013, si edhe EC nr. 1275/2008.

Mbështetur në Censusin e vitit 2011, në Raportin përfundimtar të përpiluar nga INSTAT-i, në vendin tonë rezultojnë 722 262 njësi ekonomike familjare (privatë *households*), prej të cilave 56.7% ndodhen në qendrat urbane dhe 43.3% në zonën rurale. Në tab. nr. 42 jepet numri i pajisjeve elektroshtëpiake sipas zonave rurale dhe urbane për vitin 2011. Natyrisht, është e pritshme që numri aktual i pajisjeve elektroshtëpiake në vendin tonë të jetë më i madh.

16. Sistemet e rikuperimit të energjisë në ndërtesa

Vlerësimi i kursimit të energjisë bazohet në sasinë e nxehtësisë së transferuar nga ajri i larguar në ajrin primar për në ndërtesë. Kursimet e energjisë përcaktohen në lidhje me sipërfaqen e ndërtesës e pajisur me sistem ventilues duke shfrytëzuar parametrat e njohur për numrin e këmbimeve të ajrit, kohën e funksionimit të sistemit të ngrohjes gjatë sezonit të dimrit, lartësinë e ndërtesës, diferencën e temperaturave të ajrit, densitetin e ajrit dhe shkallën e këmbimit të nxehtësisë.

Kursimet e energjisë që rezultojnë nga instalimi i një sistemi ventilimi me rikuperim nxehtësie llogariten me formulën e mëposhtme:

$$TFES = A \cdot h \cdot \beta \cdot t \cdot c \cdot \rho \cdot \Delta T \cdot \eta \cdot n$$

TFES	Kursimi final vjetor i energjisë [kWh/vit]
A	Sipërfaqja bruto e ndërtesës së kondicionuar [m^2]
h	Lartësia e zonës së ventiluar të ndërtesës [m]
β	Numri i këmbimeve të ajrit [h^{-1}]
t	Orët e funksionimit në vit të sistemit të ventilimit [h/vit]
c	Nxehtësia specifike e ajrit [kWh/kgK]
ϱ	Dendsiteti i ajrit [kg/m^3]
ΔT	Diferenca e temperaturave midis ajrit të brendshëm dhe të jashtëm gjatë sezonit të ngrohjes në (°C)
η	Shkalla e rikuperimit të nxehtësisë
n	Numri i njësive ventiluese të instaluara
Ndërtesa ngrohet nga një sistem konvencional.	

Vlerat reference:

- Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese rekomandohet 17 vjet – për sistemet e rikuperimit të nxehtësisë në ndërtesa duke u mbështetur në direktivën e BE-së, direktiva 2006/32/EC.

- Sipërfaqja bruto e ndërtesës së kondicionuar (sipas projektit);
- Lartësia e zonës së ventiluar të ndërtesës (sipas projektit specifik);
- Numri i këmbimeve të ajrit në orë β sipas tipologjisë dhe aktivitetit paraqitet në tab. 40 në pjesën Aneks.
- Nxehtësia specifike e ajrit: c=1.0 kJ/kg.K;
- Densiteti i ajrit, vlera referuese: ϱ=1.293 kg/m^3;
- Diferenca e temperaturave ΔT midis ajrit të brendshëm dhe të jashtëm gjatë sezonit të ngrohjes në varësi të ambientit dhe temperaturës së jashtme llogaritëse mund të vlerësohet duke u mbështetur në tab. 41, ku jepen temperatura e brendshme llogaritëse për tipa të ndryshëm ambienti.
- Shkalla e rikuperimit të nxehtësisë nga rekuperatorë të ndryshëm bazuar në eksperiencën e projektuesve në vendin tonë varion: **η=60 - 85%.**
- Orët e funksionimit në një ditë të sistemit të ventilimit sipas ambienteve rekomandohen:
- për spitalet t=24 h/ditë;
- shkollat, kopshte t=8 h/ditë;
- lokale, bare t=12 h/ditë.

17. Pajisjet elektroshtëpiake

Sektori rezidencial:

Formula llogaritëse jepet për vlerësimin e reduktimit të energjisë si rezultat i instalimit dhe zëvendësimit të pajisjeve elektroshtëpiake të mëdha. Këto pajisje përfshijnë:

- makinat larëse (lavatriçe);
- makinat tharëse;
- pjatalarëse (pajisjet për larjen e enëve);
- frigoriferë;
- ngrirës.

17.1 Blerja e pajisjeve elektroshtëpiake me eficiencë të lartë

Formula llogaritëse gjen zbatim tek masat ndërhyrëse në lidhje me blerjen e elektroshtëpiakeve të mëdha si frigorifera, ftohës, lavatriçe etj., me eficiencën (klasën e energjisë) më të lartë në treg (A++, ose A+++) krahasuar me pajisjet ekzistuese me klasë më të ulët të energjisë.

$$TFES = n \cdot (E_{ave} - E_{eff})$$

TFES	Kursimi final vjetor i energjisë [kWh/vit]
n	Numri i pajisjeve elektroshtëpiake me eficiencën më të lartë në treg të blera
E_{ave}	Konsumi mesatar vjetor i energjisë i pajisjes elektroshtëpiake më pak eficiente në treg [kWh/vit]
E_{eff}	Konsumi mesatar vjetor i energjisë për pajisjet me klasën më të lartë të energjisë në treg aktualisht (A+++) [kWh/vit]
Konsumi vjetor mesatar i energjisë për pajisjen elektroshtëpiake më pak eficiente në treg (me klasën më të ulët të energjisë)	

Vlerat referuese:

- Jetëgjatësia e ndërhyrjes përmirësuese rekomandohet 12 vjet për të gjitha pajisjet e mëdha elektroshtëpiake, si: pjatalarëse, lavatriçe, tharëse etj. me klasë energjie A dhe lart.
- Sa u përket ngritësve, frigoriferëve etj., me klasë energjie A dhe sipër ndërhyrja përmirësuese rekomandohet me jetëgjatësi 15 vjet bazuar në direktivën e Bashkimit Evropian, DIRECTIVE 2006/32/EC ON ENERGY END-USE EFFICIENCY AND ENERGY SERVICES.
- E_{ave} –Konsumi mesatar vjetor i energjisë për pajisjet elektroshtëpiake më pak eficiente në treg. Për këtë rast mund të marrim në konsideratë vlerat specifike të elektroshtëpiakeve sipas projektit të caktuar. Mënyra e dytë është shfrytëzimi i vlerave bazë të marra nga një studim i ERE-s (Enti Rregullator i Energjisë) për konsumin mujor të energjisë për elektroshtëpiaket në vendin tonë. Nga një studim i realizuar nga ERE me temë: "Konsumi i energjisë elektrike në familje" rezulton që kërkesa maksimale

për energji elektrike në një familja në rajonin e Tiranës në vitin 2015 të jetë sipas tab. 42, në të cilën jepen vlerat referuese të konsumit të energjisë në kWh/muaj për tipa të ndryshëm elektroshtëpiakesh.

- Konsumi mesatar vjetor i energjisë për pajisjet me klasën më të lartë të energjisë në treg aktualisht (A+++) jepen në mënyrë të përmbledhur në tab. 43 dhe tab. 44.

17.2 Zëvendësimi i parakohshëm i pajisjeve elektroshtëpiake

Metoda llogaritëse gjen zbatim tek masat ndërhyrëse në lidhje me zëvendësimin e parakohshëm të elektroshtëpiakeve të mëdha, si: frigoriferë, ftohës, lavatriçe etj., para përfundimit të ciklit të tyre, me pajisje elektroshtëpiake me eficiencë (klasën e energjisë) më të lartë në treg (A++, ose A+++).

$$TFES = n \cdot (E_{STOCK} - E_{Eff})$$

TFES	Kursimi final vjetor i energjisë [kWh/vit]
n	Numri i pajisjeve elektroshtëpiake me eficiencën më të lartë në treg të blera
E_{Stock}	Konsumi mesatar vjetor i energjisë i pajisjes elektroshtëpiake ekzistuese në stok [kWh/vit]
E_{eff}	Konsumi mesatar vjetor i energjisë për pajisjet me klasën më të lartë të energjisë në treg aktualisht (A+++) [kWh/vit]

Në tabelën nr. 44 mbështetur në www.topten.eu jepen konsumi mesatar vjetor i energjisë për disa elektroshtëpiake me klasën më të lartë të energjisë në treg aktualisht (A+++) [kWh/vit]

ANEKS I TABELAVE

Tab. nr. 1. Vlerat referuese të SHD si default "introducing new building code"

Tipi i ndërtesës	SHD (kWh/m²/a) kodi i vjetër (2010-2017)	SHD (kWh/m²/a)) kodi i ri (2017 -)
Publik	95	80
Rezidencial	110	95

Tab. nr. 2. SHD përpara aplikimit të masave të EE (SHDref- [kWh/m^2 /vit]

Residential Buildings	*Zone A*	*Zone B*	*Zone C*	*Average in Albania*
vila 1	140	170	240	165,47
vila 2	148	175,10	254,40	173,66
Me konstruksion parafabrikat	172,20	250,77	295,20	217,73
Me konstruksion me tulla solide	127,40	189,12	218,40	162,31
Me konstruksion me tulla me vrima	123,20	183,48	211,20	157,16
Mesatare sipas zonave	138,28	176,77	239,33	166,80

Tab. nr. 3. SHD pas aplikimit të masave të EE (SHD_{Eff}- [kWh/$^{m^2}$ /vit])

Residential Buildings	*Zone A*	*Zone B*	*Zone C*	*Average in Albania*
Vila 1	100,00	130,00	180,00	122,42
Vila 2	106,00	175,10	254,40	152,17
Me konstruksion parafabrikat	123,00	202,50	295,20	176,33
Me konstruksion me tulla solide	91,00	152,72	218,40	131,46
Me konstruksion me tulla me vrima	88,00	148,16	211,20	127,28
Mesatare sipas zonave	98,77	149,55	211,73	133,30

Tab. nr. 4. Vlerat referuese për rendimentin e përgjithshëm të sistemit të ngrohjes para dhe pas implementimit të projektit të EE

Heating sytem components	*System efficiency before project implementation*	*System efficiency after project implementation*
Heat generator (bojler) η_{boi}	0,82	0,94
Distribution system η_{dis}	0,93	0,97
Heat emiter η_{em}	0,78	0,93
Total system efficiency	0,595	0,848

Tab. nr. 5. Koeficienti i emetimit të misioneve të CO_2 "e" sipas llojit të lëndës djegëse koeficienti i konvertimit të FES në PES.

CO_2 emission factor for final energy	*Conversion factor from Final to Primary energy*		
English	Shqip	FES	PES
Diesel	Naftë	0,272	1,1
Heavy oil (mazut)	Mazut	0,276 0,406	1,3

LPG	GLN	0,225	1,1
Lignite	Linjit	0,353	1,2
Hard coal	Antracit	0,394	1
Natural gas	Gaz natyror	0,201	1,22
Electricity	Energji elektrike	1,438	3,07
Heating energy – fuel oil	Energji e nxehtësisë – naftë	0,406	1,3
Heating energy – cogeneration	Energji e nxehtësisë – kogjenerimit	0,353	0,5
Solar energy	Energjia solare	0	1
Firewood	Dru zjarri	0,031	1,01
Pellet	Pellet	0,031	1,01
Other biomass	Biomasë tjetër	0,031	1,01
Biogas	Biogas	0,098	1,1
Dual fuel (mineral + wood)	Karburant i dyfishtë (fosil + dru)	0,226	1,02

Tab. nr. 5/1. Koeficienti i emetimit të misioneve të CO_2 "e" sipas llojit të lëndës djegëse transport

CO_2 emission factor for final energy	*Conversion factor from Final to Primary energy*		
English	Albanian	FES	PES
Diesel	Naftë	0,272	1,1
Motor gasoline	Benzinë	0,249	1,1
LPG	GLN	0,225	1,1
CNG	CNG (gaz natyral i kompresuar)	0,201	1,22
Electricity	Energji elektrike	1,438	3,07
Hybrid	Hybrid	0,222	1,1
Biogas	Biogas	0,098	1,1

Tab. nr. 6. Eficienca e sistemeve të ujit të ngrohtë para dhe pas implementimit të masave të EE

	Tipi i ndërtesës	**Gjendja e tanishme**	**BAU**	**Rinovim standard**	**Rinovim ambicioz**
Zonat klimatike A dhe B	Shtëpi individuale	Bojler elektrik 90%, η_b=1	Bojler elektrik 100%, η_b=1	Pompa të nxehtësisë 30%, SCOP=3	Pompa të nxehtësisë 30%, SCOP=3
		Sobë me dru 90%, η_b=0,6		Panel diellor 70%	Panel diellor 70%
	Shtëpi në varg dhe pallate me shumë apartamente	Bojler elektrik 100%, η_b=1	Bojler elektrik 100%, η_b=1	Pompa të nxehtësisë 60%, SCOP=3	Pompa të nxehtësisë 60%, SCOP=3
				Panel diellor 40%	Panel diellor 40%
Zonat klimatike C	Shtëpi individuale	Bojler elektrik 60%, η_b=1	Bojler elektrik 100%, η_b=1	Bojler me pellet 30%, η_b=0,85	Bojler me pellet druri 30%, η_b=0,90
		Wood stove 40%, η_b=0.6		Panel diellor 70%	Panel diellor 70%
	Shtëpi në varg dhe pallate me shumë apartamente	Bojler elektrik 60%, η_b=1	Bojler elektrik 100%, η_b=1	Bojler me pellet 60%, η_b=0,85	Bojler me pellet druri 60%, η_b=0,90
		Sobë me dru 40%, η_b=0,6		Panel diellor 40%	Panel diellor 40%

Tab. nr. 7. SHD përpara rinovimit në ndërtesat jorezidenciale [kWh/m² /a]

Ndërtesa	*Zona I*	*Zona II*	*Zona III*	*Albania*
Objekte rekreacioni (pishina: qendra sportive)	210.06	279.92	379.10	259.64
Hotele relativisht të reja	221.11	294.65	399.06	273.30
Hotele ekzistues në sektorin turistik	234.38	303.49	423.00	286.69
Spitalet, shtëpitë e banimit (për të moshuar) dhe shtëpi pleqsh	271.97	353.58	490.84	333.15
Ndërtesa tregtare (qendra biznesi, dyqane, restorante)	201.21	266.66	363.14	248.20
Shkolla, universitete, konvikte, çerdhe dhe kopshte	68.10	115.09	156.20	97.55
Të gjitha ndërtesat e tjera publike	194.58	258.70	351.17	240.31
Vlera mesatare për secilën zonë	163.08	227.55	307.11	207.01

Tab. nr. 8. Kërkesa për energji specifike në ndërtesa publike dhe private me implementim të veshjes termike të godinës me kapotë termike nga jashtë: [kWh/m² / vit]

Ndërtesa	*Zona I*	*Zona II*	*Zona III*	*Albania*
Objekte rekreacioni (pishina: qendra sportive)	168.62	226.03	307.85	209.42
Hotele relativisht të reja	177.50	237.93	324.06	220.44
Hotele ekzistues në sektorin turistik	188.15	245.07	343.50	231.23
Spitalet, shtëpitë e banimit (për të moshuar) dhe shtëpi pleqsh	218.32	285.52	398.59	268.71

Ndërtesa tregtare (qendra biznesi, dyqane, restorante)	161.52	215.33	294.89	200.19
Shkolla, universitete, konvikte, çerdhe dhe kopshte	54.67	92.94	126.84	78.71
Të gjitha ndërtesat e tjera publike	156.20	208.90	285.17	193.82
Vlera mesatare për secilën zonë	130.91	183.75	249.39	166.59

Tab. nr. 9. Faktori i shkarkimeve të CO_2 për Shqipërinë (IPCC dhe Szabo et al.2015)

Lënda energjetike	**Shkarkimet specifike të CO_2 [kg/kWh]**
Biomasë druri	0
Energji elektrike	0
Gazi i lëngët	0,227

Tab. nr. 10. Rendimenti mesatar i sistemit të ngrohjes në Shqipëri para dhe pas zbatimit të masave të eficiencës energjetike

Rendimenti mesatar i sistemit të ngrohjes në Shqipëri para dhe pas zbatimit të masave të eficiencës energjetike			
Rendimenti	η_{Ref}	η_{Eff}	
Niveli i eficiencës energjetike		EE Class B	EE Class A
Elektrik	90.00%	92.00%	94.00%
Dru	48%	80%	88%
LPG	68%	85%	94%
Qymyr	60%	80%	88%
Diesel	65%	83%	92%
Solar	52%	58%	70%
Gaz natyral	70%	88%	95%
Heating Oil	64%	82%	90%
Kerosene	65%	84%	93%

Tab. nr. 11. Kërkesa për energji specifike në ndërtesa publike dhe private me implementim të izolimit termik dhe/ose tarracës: [kWh/m² / vit]

Ndërtesa	*Zona I*	*Zona II*	*Zona III*	*Albania*
Objekte rekreacioni (pishina: qendra sportive)	187.54	252.60	345.74	233.83
Hotele relativisht të reja	197.41	265.89	363.94	246.14
Hotele ekzistues në sektorin turistik	209.26	273.87	385.77	258.19
Spitalet, shtëpitë e banimit (për të moshuar) dhe shtëpi pleqsh	242.82	319.07	447.64	300.03
Ndërtesa tregtare (qendra biznesi, dyqane, restorante)	179.64	240.63	331.18	223.53
Shkolla, universitete, konvikte, çerdhe dhe kopshte	60.80	103.86	142.45	87.92
Të gjitha ndërtesat e tjera publike	173.72	233.45	320.27	216.42
Vlera mesatare për secilën zonë	145.60	205.34	280.09	186.02

Tab. nr. 12. Kërkesa për energji specifike në ndërtesa publike dhe private me implementim të zëvendësimit të dritareve të zakonshme me dritare double/triple xham [kWh/m² / vit] (publike dhe private)

Ndërtesa	**Zona I**	**Zona II**	**Zona III**	**Albania**
Objekte rekreacioni (pishina: qendra sportive)	188.63	251.93	343.09	233.75
Hotele relativisht të reja	198.56	265.19	361.15	246.05
Hotele ekzistues në sektorin turistik	210.47	273.14	382.81	258.11
Spitalet, shtëpitë e banimit (për të moshuar) dhe shtëpi pleqsh	244.23	318.22	444.21	299.94
Ndërtesa tregtare (qendra biznesi, dyqane, restorante)	180.69	239.99	328.64	223.46
Shkolla, universitete, konvikte, çerdhe dhe kopshte	61.16	103.59	141.36	87.84
Të gjitha ndërtesat e tjera publike	174.73	232.83	317.81	216.35
Vlera mesatare për secilën zonë	146.45	201.38	277.00	185.07

Tab. nr. 13. Kërkesat për energji specifike me kombinim të dy masave për eficiencën e energjisë atë të izolimit termik të mureve me kapotë termike dhe zëvendësimin e prodhuesit të nxehtësisë me lëndë djegëse diesel kundrejt atij me qymyr [kWh/m² / vit] (publike dhe private)

Ndërtesa	*Zona I*	*Zona II*	*Zona III*	*Albania*
Objekte rekreacioni (pishina: qendra sportive)	136.60	180.51	242.52	167.71
Hotele relativisht të reja	143.79	190.02	255.28	176.54
Hotele ekzistues në sektorin turistik	152.41	195.72	270.60	185.19
Spitalet, shtëpitë e banimit (për të moshuar) dhe shtëpi pleqsh	176.86	228.02	313.99	215.20
Ndërtesa tregtare (qendra biznesi, dyqane, restorante)	130.85	171.96	232.30	160.33

Shkolla, universitete, konvikte, çerdhe dhe kopshte	44.29	74.22	99.92	62.97
Të gjitha ndërtesat e tjera publike	126.53	166.83	224.65	155.23
Vlera mesatare për secilën zonë	106.05	146.74	196.46	134.15

Tab. nr. 14. Vlerat maksimale të lejuara të koeficientit të transmetimit të nxehtësisë U për komponentë të veçantë të ndërtesës për ndërtesa ekzistuese gjatë rinovimit të përgjithshëm

U-vlerat e U-së për një ndërtesë ekzistuese të rinovuar (W/m².K)			
Komponentët strukturalë të ndërtesës	**Zona A: +5 < T_j <-1°C;**	**Zona B: -1 < T_j < -5°C;**	**Zona C: -5 < T_j << -15°C**
Muret e jashtme	0,5	0,45	0,4
Çatia (e pjerrët ose tarrace)	0,45	0,4	0,35
Papafingo	0,45	0,4	0,35
Dysheme	0,9	0,75	0,7
Komponentë xhami (dritare me kornizë izoluese alumin, plastike ose druri etj.)	2,6	2,5	2,0

Tab. nr. 15. U-value për ndërtesa të reja

Vlera e U-së për ndërtesa të reja pas 2020 (W/m².K)			
Komponentë strukturalë të ndërtesës	**Zona A: +5 < T_j <-1°C;**	**Zona B: -1 < T_j < -5°C;**	**Zona C: -5 < T_j << -15°C**
Mure të jashtme	0,4	0,38	0,35
Çatia (e pjerrët ose tarracë)	0,38	0,35	0,33
Papafingo	0,4	0,38	0,35
Dysheme	0,8	0,75	0,65
Komponentë xhami (dritare me kornizë izoluese alumin, plastikë ose druri etj.)	2,2	2,0	2,0

Tab. nr. 16. GDN në Shqipëri

Nr.	**Zona**	**Qyteti**	**Temperatura e jashtme llogaritëse T_j^{llog}**	**Pragu i GDN, 20°C**
1	Zona A	Delvinë, Finiq, Konispol Sarandë, Himarë	**3**	**1432**
2		Selenicë, Vlorë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Shijak,	**1**	**1797**
3		Belsh, Divjakë, Lushnjë, Mallakastër, Memaliaj, Kuçovë	**0**	**1900**
4		Fier, Patos, Peqin, Roskovec, Ura Vajgurore	**0**	**2060**
5	Zona B	Bërat, Kamzë, Tiranë, Vorë, Elbasan, Kurbin, Këlcyrë, Tepelenë, Cërrik, Lezhë	**-1**	**2200**
6		Gramsh, Shkodër, Vau i Dejës, Përmet, Poliçan, Skrapar, Dropull, Gjirokastër, Libohovë, Krujë	**-3**	**2350**
7		Librazhd, Pogradec	**-4**	**2500**
8	Zona C	Bulqizë, Klos, Përrenjas, Pustec	**-6**	**3120**
9		Mirditë, Tropojë	**-9**	**3320**
10		Devoll, Kolonjë, Korçë, Maliq	**-10**	**3450**
11		Fushë-Arrëz, Pukë	**-11**	**3570**
12		Has, Kukës, Malësi e Madhe, Mat	**-12**	**3690**

VKM nr. 38, datë 16.1.2003, "Për miratimin e normave, rregullave dhe kushteve të projektimit dhe ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa" (i amenduar).

Tab. nr. 17. Eficienca energjetike në motorët elektrikë (M.E) me premium eficiencë IE3

Fuqia (kW)	*Numri i poleve*		
	2	4	6
0,75	80,7	85,2	78,9
1,1	82,7	84,1	81,0
1,5	84,2	85,3	82,5
2,2	85,9	86,7	84,3
3	87,1	87,7	85,6
4	88,1	88,6	86,8
5,5	89,2	89,6	88,0
7,5	90,1	90,4	89,1
11	91,2	91,4	90,3
15	91,9	92,1	91,2
18,5	92,4	92,6	91,7
22	92,7	93,0	92,2
30	93,3	93,6	92,9

37	93,7	93,9	93,3
45	94,0	94,2	93,7
55	94,3	94,6	94,1
75	94,7	95,0	94,6
90	95,0	95,2	94,9
110	95,2	95,4	95,1
132	95,4	95,6	95,4
160	95,6	95,8	95,6
200 to 375	95,8	96,0	95,8

Tab. nr. 18. Vlera e eficiencës energjetike në ME me eficiencë të lartë IE2

Fuqia në kW	*Numri i poleve*		
	2	4	6
0,75	77,4	79,6	75,9
1,1	79,6	81,4	78,1
1,5	81,3	82,8	79,8
2,2	83,2	84,3	81,8
3	84,6	85,5	83,3
4	85,8	86,6	84,6
5,5	87,0	87,7	86,0
7,5	88,1	88,7	87,2
11	89,4	89,8	88,7
15	90,3	90,6	89,7
18,5	90,9	81,2	90,4
22	91,3	91,6	90,9
30	92,0	92,3	91,7
37	92,5	92,7	92,2
45	92,9	93,1	92,7
55	93,2	93,5	93,1
75	93,8	94,0	93,7
90	94,1	94,2	94,0
110	94,3	94,5	94,3
132	94,6	94,7	94,6
160	94,8	94,9	94,8
200 to 375	95,0	95,1	95,0

Tabela nr. 19. Klasifikimi i llambave LED me eficiencë të lartë sipas intensitetit dhe fuqisë në W

Llamba klasike LED, tipi	*Fluksi lumen*	*Fuqia në W*	*Burimi: www.topten.eu*
A	210 ≤ 200-400 lm	25 W	Minimumi i cikleve=20,000 cikle; Klasa e energjisë: A+ dhe A++
B	401-750 lm	40W	
C	751-900 lm	60 W	
D	901-1200 lm	75-100 W	
E	200-500 lm	25 -40 W	
F	100-300 lm	25 W	
G	301-806 lm	40 W	

Tabela nr. 20. Fuqia mesatare e instaluar për ndriçim për njësi të sipërfaqes referuar standardit EN 15193-1

Ambienti/aktiviteti	P_{Ref} *Fuqia e instaluar për ndriçim [W/m²]*
Linja prodhimi/industri	8.7 W/m²
Ambiente teknike shërbimi	5.8 W/m²
Dyqane <30m²	9.9 W/m²
Dyqane >30m²	7.6 W/m²
Magazinë	2.3 W/m²
Hotel/dhomë	6.5 W/m²
Recepsion	3.8 W/m²
Bar/ kafene/diskoteka	4.3W/m²
Kuzhina restoranti	13 W/m²
Klasa mësimi	8.3 W/m²
Biblioteka	9.0 W/m²
Spitale	7.3 W/m²
Dhome trajtimi/ekzaminimi	11.3 W/m²
Laboratorë	12.4 W/m²

Zyra	9.8 W/m²
Salla sportive	7.7 W/m²
Aeroporte/stacione	6.5 W/m²
Ambiente argëtimi (teatër, kinema)	6.2 W/m²
Burgje	5.7W/m²
Ambiente fetare (kisha, xhami etj.)	3.5 W/m²
Parking	1.3 W/m²

Tabela nr. 21. Orët mesatare vjetore të punës në sektorin jorezidencial sipas standardit EN15193

Zyra/Office	2500 h
Shkolla/arsimi	2000 h
Spitale	5000 h
Hotele	5000 h
Restorante	2500 h
Qendra sportive	4000 h
Shitje me pakicë/retail	5000 h

Tabela nr. 22. Shpërndarja në % e llambave inkandeshente

	Llamba inkandeshente				*Mesatare e ponderuar*
Fuqia e llambës	*40W*	*60W*	*75W*	*100W*	*W*
Shkolla/arsim	26.3%	47.4%	7.5%	18.8%	63.4
Shëndetësi	10.1%	15.8%	62.7%	11.4%	72.0
Zyra	21.1%	61.7%	6.5%	10.6%	61.0
Dyqane	26.3%	47.4%	7.5%	18.8%	70.2
Fuqia e llambave inkandeshente në stok: **65.7 W**					

Tabela nr. 23. Llambat karakteristike me eficiencën përkatëse të ndriçimit

Tipi i ndriçimit	***Eficienca në [lm/W]***
Llamba me filament inkandeshent me material tungsteni	12.5-17.5 lm/W
Llamba halogjene	16-24 lm/W
Llamba fluoreshente	45-75lm/W
Llamba LED	30-90 lm/W
Llambat "metal-halide"	75-100 lm/W
	85-150 lm/W
Llamba me natrium me presion të ulët (LPS)	100-200 lm/W
Llamba me merkur me presion të lartë	35/65 lm/W

Tabela nr. 24. Klasat e energjisë për llambat e ndriçimit bazuar në www.topten.eu

EEI (Indeksi i energjisë)		**Tipi i llambës**	**Fuqia e llambës [W]**	**Konsumi [kWh/vit]**
A++	≤0.11	LED më të mira	10 W	10 kWh/vit
A+	0.11<EEI≤0.17	LED të mira, CFL, LFL.		
A	0.17<EEI≤0.24	LED, CFL mesatare, LFL pak eficiente		
B	0.24<EEI≤0.6	LED dhe CFL më pak eficiente, halogjenët më të mirë		
C	0.6<EEI≤0.80	LV Halogjenë		
D	0.8<EEI≤0.95	Inkandeshentet më të mira, halogjenë konvencinalë		
E	>0.95	Inkandeshente		

Tabela nr. 25. Konsumi specifik në mjetet në vendet e BE-së referuar vitit 2015

Indikatori	**Vlera referuese**	**Njësia**	**Referenca**	
N				*https://www.indicators.odyssee-mure.eu/online-indicators.html*
Konsumi specifik për mjetet e reja në vitin 2015	4.8	Litra/km	42.66 kWh/km	Benzina
			47.99 kWh/km	Diesel
			43.99 kWh/km	Biodiesel
Konsumi specifik mesatar në vendet e BE në vitin 2015	6.9	Litra/km	61.33 kWh/km	Benzina
			68.98 kWh/km	Diesel
			63.24 kWh/km	Biodiesel

Tabela nr. 26. Fuqia kalorifike e lëndës djegëse për transportin rrugor

Lënda djegëse	**Fuqia kalorifike**
Benzina	32MJ/liter
Diesel	36MJ/litra
Gaz natyral/biogaz	33-38MJ/litra
LPG	24MJ/Litra
Etanol	21 MJ/liter
Biodiesel	33 MJ/liter
Hidrogjeni	11 MJ/Nm^3

Tabela nr. 27. Jetëgjatësia e mjeteve në kilometra sipas katëgorive të tyre

Kategoria e mjetit	*Jetëgjatësia në (km)*
Mjete pasagjerësh (M1)	200 000 km
Mjete të lehta transporti (N1)	250 000 km
Mjete transporti të rënda (N2,N3)	1 000 000 km
Autobusët (M2,M3)	800 000 km

Tabela nr. 28. Konsumi specifik i lëndës djegëse referuar vitit 2017

Konsumi specifik i lëndës djegëse	0.53 kWh/km
Konsumi mesatar i flotës së mjeteve	7.5 litra/100km
Konsumi mesatar për makinat e reja	5 litra/100km
Konsumi specifik sipas mënyrës së transportit (ajror)	0.044 toe/pasagjer
Konsumi specifik sipas mënyrës së transportit (ajror)	0.73 toe/mjet ekuivalent

Tabela nr. 29. E_{TEC} performanca më e mirë aktualisht për pajisjet e zyrave sipas kategorive përkatëse

		E_{TEC} (kWh/vit)
Kompjuter desktop	Kategoria A	33,4
	Kategoria B	28,7
	Kategoria C	75,8
	Kategoria D	63,5
Laptop	Kategoria A	10,9
	Kategoria B	18,1
	Kategoria C	26,3

Tabela nr. 30. Fuqia në sleep-mode për printerat

Tipi	*Energjia në sleep mode [W]*	*Kostoja e energjisë në 5 vjet*
Epson, XP-8500	0.6	5 euro
Epson XP-6000	0.7	6 euro
Canon Maxify	0.9	8 euro
HP officejet 7110	Standby=1.92 Sleep mode=1.04	11 euro

Tabela nr. 31. Jetëgjatësia e pajisjeve kompjuterë në vite

Pajisja	*Jetëgjatësia mesatare ekonomike*
Desktop	6
Laptop	5
CRT	6
LCD	6

Tabela nr. 32. Koha mesatare e përdorimit të kompjuterit në një vit sipas regjimit përkatës

Desktop	Office	Off	3285 h/vit	37%
		Sleep	3196 h/vit	36%
		Active	2279 h/vit	26%
	Home	Off	4305 h/vit	49%
		Sleep	2873 h/vit	33%
		Active	1582 h/vit	18%
Laptop	Office	OFF	3153 h/vit	36%
		Sleep	2995 h/vit	34%
		Active	2613 h/vit	30%
	Home	Off	4468 h/vit	51%
		Sleep	2904 h/vit	33%
		Actove	1388 h/vit	16%
Monitor	Office	Off	2375 h/vit	27%

		Sleep	3798 h/vit	43%
		Active	2586 h/vit	30%
	Home	Off	4835 h/vit	55%
		Sleep	2636 h/vit	30%
		Active	1289 h/vit	15%

Tabela nr. 33. Intensiteti i rrezatimit diellor vjetor në vendin tonë në disa qytete (kWh/m²)

Muaji/Qyteti	Shkoder	Peshkopi	Tirane	Vlore	Erseke	Sarande
Janar	1.7	1.55	1.8	2.15	1.9	1.9
Shkurt	2.3	2.3	2.5	2.85	2.7	2.4
Mars	3.35	3.25	3.4	3.9	3.4	3.6
Prill	4.5	4.15	4.2	5	4.4	4.8
Maj	5.45	5.25	5.55	6.05	5.6	5.8
Qershor	6.1	5.85	6.4	6.8	6.4	6.8
Korrik	6.5	6.25	6.7	7.2	6.8	6.1
Gusht	5.55	5.45	6.05	6.4	5.9	4.8
Shtator	4.45	4.35	4.7	5.15	4.7	3.6
Tetor	2.9	2.9	3.2	3.5	3.1	3.2
Nentor	2.1	1.85	2.15	2.4	2.1	2.1
Dhjetor	1.7	1.5	1.75	1.85	1.8	1.8

Tabela nr. 34. Këndi optimal i vendosjes së paneleve fotovoltaike sipas sezonit

Qyteti	Shkoder	Peshkopi	Tirane	Durres	Vlore	Sarande
Kendi optimal vjetor	38.57	37.43	37.87	38.33	37.72	36.23
Kendi optimal sezonal (verë)	29.53	28.24	28.98	29.24	28.78	27.41
Kendi optimal sezonal(dimer)	57.72	75.2	57.28	57.67	57.22	55.52

Tabela nr. 35. Konsumi i ujit të ngrohtë sanitar për tipologji të ndryshme ndërtesash

Tipi i ndërtesës		Konsumi i UNGS	Temperatura e UNGS
Spitale		110l/ditë.pacient	45°C
Ndërtesa shërbimi (publike dhe private)		20 l/ditë.person	45°C
Qendra tregtare		20 l/ditë.person	45°C
Shkolla	Pa dushe	10 l/ditë.person	45°C
	Me dushe	40 l/ditë.person	45°C
Restorante		15 l/ditë.klient	60°C
Hotele	Dhoma me vaskë	120 l/ditë.person	60°C
	Dhoma me dushe	70 l/ditë.person	60°C
	Dhoma me lavamanë	10 l/ditë.person	60°C
Shtëpia e të moshuarve		35 l/ditë.person	60°C
Industriale		50 l/ditë.punonjës	40°C

Tabela nr. 36. Eficienca e komponentëve të paneleve diellore

Komponenti		Parametri	Vlera	Q_{ave_yield} [kWh/m².vit]
Kolektori diellor	Kolektor i sheshtë	η_{sol_col}	0.55	941 kWh/m2.vit
	Kolektor me tuba vakumi	η_{sol_col}	0.65	844 kWh/m2.vit
Akumuli		η_{sol_boiler}	0.70	
Sistemi i shpërndarjes		η_{pipes}	0.90	

Tabela nr. 37. Fuqia mesatare për pajisjet elektroshtëpiake sipas regjimit në [W]

Pajisja	Standby power (W)			Standby Usage (h/day)			Konsumi specifik i energjisë (kWh/year)		
	Min.	Avg.	Max.	Min.	Avg.	Max.	Min.	Avg.	Max.
TV LCD	0.0	1.8	13.6	0.0	13.0	23.0	0	7.9	109.2
TV CRT	0.0	5.1	21.9	0.0	8.9	24.0	0	16.6	175.2
TV LED	0.0	0.3	0.9	0	9.9	19.0	0	1.2	3.9
TV Plasma	0.4	4.7	19.0	0.	13.3	23.6	0	22.5	90.5
DVD Player	0.0	2.7	12.5	0	14.3	24	0	8.8	77.1
Home Theatre System	0.5	1.7	7.5	0	9.4	22	0	5.2	19.2

Computer Monitor	0.2	2.4	12.4	0	12.2	24	0	9.6	99.6
Laptop	0.3	3.0	20.0	0	5.7	24	0	3.9	39.4
Alarm Clock	0.0	1.9	4.4	0	1.9	4	0	15.9	32.1
Printer/Scanner	0.2	2.6	8.2	0	13	24	0	12.3	71.8
Satëllite receiver	0.0	7.5	23.1	0	14.5	24	0	40.5	142.6
Radio	0.0	1.9	5.1	0	14.5	24	0	9.9	29.4
Desktop PC	0.1	3.4	15.0	0	12.6	24	0	12.5	44.2
Modem/Router	0.1	4.6	8.3	0	15.5	24	0	25.9	59.2
Clothe washer	0.9	1.5	2	0	3.8	24	0	1.7	7.9
Clothe dryer	2.0	2.0	2.0	3	3	3	2.2	2.2	2.2
Dishwasher	1.0	2.0	3.0	0	2.0	3.0	0	1.9	3.0
Microwave	0.1	1.4	2.4	24	23.9	24	1.0	12.4	21.0
Oven	0.7	1.6	3.2	1	22.3	24	0.4	13.1	28.0
Air Conditioner	2.1	2.1	2.1	24	24	24	18.4	18.4	18.4
Furnace	1.5	2.5	4.5	0	22.9	24	0	21.0	37.8
Home Audio System	0.2	3.3	12.4	0	18.3	24	0	18.6	56.9
Vacuum cleaner	0.9	3.2	5.8	0	20.2	24	0	23.0	50.8

Tabela nr. 38. Konsumi specifik i energjisë elektrike në banesa nga pajisjet në gjendjen standby sipas vendeve të ndryshme

Vendi/rajoni	*Numri i banesave të studiuara*	*Fuqia në regjim standby [W]*	*Konsumi specifik [kWh/vit]*
Belgjika	10	40-50	274-435
Franca	178	38	235
Danimarka	30	67	120-980
Mbreteria e Bashkuar	32	32	277
Greqia	100	50	424
Italia	100	57	472
Portugali	100	46	377
Rumania	30	14	340
Hungaria	39	30	709
BE (studim i 2011)	1300	39.8	305
Turqia	201	27	130

Tabela nr. 39. Numri i pajisjeve elektroshtëpiake në vendin tonë sipas Censusit të vitit 2011 (Burimi INSTAT)

Pajisja elektroshtëpiake	Zona urbane	Zona rurale	Gjithsej
Frigorifer	386 063	281 127	667 190
Ngrirës	31 500	14 118	45 618
Lavatriçe	360 606	218 650	579 256
Tharëse rrobash	14 531	6 305	20 836
Makine pjatalarëse	21 236	3 589	24 825
Bojler elektrik	261 389	102 777	364 166
Mikrovale	107 902	19 481	127 383
TV	379 170	288 538	667 708
TV dekoder	98 221	35 086	133 307
Telefon fiks	180 839	24 865	205 704
Celular	351 214	275 868	627 082
Kompjuter	119 546	25 749	145 295
Lidhje interneti	78 342	10 832	89 174
Panel diellor	7 188	12 474	19 662
Kondicioner	72 903	8 829	81732

Tabela nr. 40. Numri i këmbimeve të ajrit në orë sipas tipologjisë së ambientit (Burimi: R.Alushaj, Impiante termoteknike)

Tipologjia e ambientit		Numri i këmbimeve të ajrit në orë (β)
Hapësira të mëdha industriale, konstruksion i rëndë	300-1000 m^3	3/4
	3000-10000 m^3	1/2
	Mbi 10000 m^3	1/4
Konstruksion fletësh të padekoruara	300-1000 m^3	1 1/2
	3000-10000 m^3	1

	Mbi 10 000 m^3	3/4
Zyra dhe banesa	Me dritare të ekspozuara në një anë	1
	Me dritare të ekspozuara në dy anë	1 ½
	Me dritare të ekspozuara në shumë anë	2
Mjedise të përziera	Salla leksionesh dhe mbledhjesh	1/2
	Hapësirë qarkulluese	1 ½ deri 2
	Laboratorë	1 deri 2
	Banja	2

Tabela nr. 41. Temperatura e ajrit të brendshëm llogaritëse për ngrohje në varësi të aktivitetit (R.Alushaj, Impiante termoteknike)

Ambienti	T_{ab}	T_{aj} *(referuar kushteve të jashtme klimaterike)*	ΔT
Apartamente dhe zyra	20°C		
Kuzhina industriale	15-16 °C		
Korridore	12-15 °C		
Shkolla	18-20 oC		
Palestra	14-18 °C		
Salla mbledhjesh	16-18°C		
Salla muzeu, ekspozita	14-16°C		
Pishina të mbuluara	27-30°C		
Salla emergjence, spitale	22-24°C		
Kisha	10-14°C		
Dyqane	15-18°C		
Hotele, restorante	20°C		
Salla pritjesh	12-16°C		
WC i posaçëm, banja	15-20°C		
Kapanon industrial, fabrika	16-18°C		

Tabela nr. 42. Konsumi i energjisë elektrike nga disa pajisje elektroshtëpiake sipas Censusit 2011 (INSTAT)

Lloji i shërbimit	*Konsumi në zonat e analizuara në kWh/muaj*		
	Tirana	*Zonat e tjera urbane*	*Zonat rurale*
Ndriçimi elektrik	50	50	50
Ftohja me frigorifer	45	45	45
Informacion me TV&Video	35	35	35
Larje rrobash në makinë larëse	30	30	27
Informacion me sistem audio	20	20	20
Konsumi në mjedise të përbashkëta	15	15	5
Hekurosje rrobash	10	10	10
Freskim me ventilator	15	15	15
Fshesa elektrike	8	8	8
Kondicioner (freskimi)	40	30	15

Tabela nr. 43. Konsumi i energjisë në pajisjet TV

Tipi i TV	*Konsumi i energjisë*	*Kosto në 10 vjet*
Philips A+	24kWh/vit Standby=0.30 W	48 euro
Samsung A	29kWh/vit Standby =0.50 W	58 euro
Sony A+	70 kWh/vit	140 euro
Samsung UE43"	79 kWh/vit Standby= 0.50W	158 euro
LG A+ 49"	92kWh/vit Standby=0.5 W	184 euro

Tabela nr. 44. Konsumi mesatar i energjisë për tipa të ndryshëm lavatriçe dhe klasa përkatëse e energjisë

Elektroshtëpiake	*Marka*	*Konsumi mesatar vjetor i energjisë kWh/vit*	*Klasa e energjisë*
Lavatriçe	Miele	109 kWh/vit	A+++
Lavatriçe	Samsung	119 kWh/vit	A+++
Lavatriçe	Electrolux	130 kWh/vit	A+++
Figorifer	Gorenjë	143 kWh/vit	A+++
Frigorifer	Liebherrr	162kWh/vit	A+++
Frigorifer	Bosch	190 kWh/vit	A+++

Lavapjata	V-Zug	155 kWh/vit	A+++
Lavapjata	Siemens	234 kWh/vit	A+++
Fshesë elektrike	Electrolux	18.2 kWh/vit	
Fshesë elektrike	Hoover	23.4 kWh/vit	

Referencat:

1. Method 9, Improvement of Lighting Systems (tertiary sector), si edhe në rregulloret prEN 15193 "Energy përformance of Building – Energy Requirements for lighting"

2. Regulation (EC) No 244/2009: eco-design requirements for non-directional household lamps

3. Regulation (EC) No 245/2009: eco-design requirements for fluorescent lamps without integratëd ballast, for high intensity discharge lamps, and for ballasts and luminaires able to opëratë such lamps: http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri

4. EN 15193-1 "Energy përformance of buildings - Energy requirements for lighting "

5. Regulation (EU) NO874/2012 with regard to energy labelling of lighting products https://ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/Implementation%20Guide%20Lighting.pdf

6. Regulation (EC) No 245/2009: eco-design requirements for fluorescent lamps without integratëd ballast, for high intensity discharge lamps, and for ballasts and luminaires able to opëratë such lamps: http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2009:076:0017:0044:en:PDF

7. http://www.indicators.odyssee-mure.eu/onlineindicators.html

8. (http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2009:120:0005:001 EN:PDF, Annex Table 1: Energy content of motor fuels, p.8)

9. EMEES Bottom-up case application 15: Modal Shift in Passenger Transport http://www.emeees.eu/emeees/downloads/EMEEES_WP42_15_Modal_Shifts_Final.pdf

10.https://www.ise.fraunhofer.de/de/veroeffentlichungen/konferenzbeitraege/konferenzbeitraege-2013/28th-eupvsec/woyte.pdf

11. International Energy Agency: Analysis of Long-Term Përformance of PV Systems:Different Data Resolution for Different Purposës, Report IEA-PVPS T13-05:2014;

12. EMEES bottom-up case application 4: Residential condensing boilers in space heating http://www.evaluatë-energysavings.eu/emeees/downloads/EMEEES_WP42_Method_4_resboilers_080609.pdf.

13. Energy savings potential from simple standby reduction devices in Central Eastern Europe, Valentova, M., Barabanova,Y., Harrington, Ll., Boza-Kiss, B.

14. Determining Appliance Standby Electricity Consumption for Turkish Households: Cagri Sahin, M., Gugul, G.N., and Koksal, M.A., Hacettepe University

VENDIM
Nr. 204, datë 7.4.2023

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE PËR STANDARDET E SHËRBIMEVE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të politikave për standardet e shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, ministritë e linjës dhe institucionet e agjencitë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

DOKUMENT I POLITIKAVE
PËR STANDARDET E SHËRBIMEVE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE
1. HYRJE
2. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS
2.1 Vizioni
2.2 Objektivat e politikës
2.3 Fusha dhe koha e veprimit
2.4 Rezultatet e pritshme
3. PARIMET KRYESORE DHE STANDARDET E SHËRBIMEVE
3.1 Parimet e Qeverisjes së Mirë dhe ofrimi i shërbimeve publike
3.2 Transformimi digjital në Shqipëri
3.3 Kërkesat dhe standardet kryesore për ofrimin e shërbimit
3.4 Standardet dhe rregulloret e BE-së mbi shërbimet
3.5 Ndërhyrjet kryesore për arritjen e standardeve
3.6 Planifikimi i ndërhyrjeve
4. MBËSHTETJE PËR ZBATIM
4.1 Strukturat drejtuese dhe zbatuese
4.2 Modelet e financimit
4.3 Monitorimi dhe vlerësimi (M&V)
4.4 Komunikimi dhe angazhimi i aktorëve
ANEKS 1: Lidhja parim, dimension, tregues, nëntregues
ANEKS 2: Fjalor i termave dhe i përkufizimeve

LISTA E SHKURTIMEVE

ADB	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
ADISA	Agjencia për Ofrimin e Shërbimeve të Integruara
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
BE	Bashkimi Evropian
BI	*Business Intelligence* – Mekanizmat e Inteligjencës së Biznesit
CAF	*Common Assessment Framework* – Korniza e Përbashkët e Vlerësimit
CFM	*Citizens Feedback Mechanism* – Mekanizmi i reagimit të qytetarëve
ISO	*International Organisation for Standardisation* –Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
KPI	*Key Performance Indicators* – Treguesit kryesorë të performancës
M&V	Monitorimi dhe vlerësimi
MCT	Menaxhimi i cilësisë totale
OECD	*The Organisation for Economic Co-operation and Development* – Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
IShO	Indeksi i Shërbimeve *Online*
PAR	*Public Administration Reform* – Reforma e Administratës Publike
QMS	*Quality Management System* – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë
SIGMA	*Support for Improvement in Governance and Management* –Mbështetje për përmirësim në qeverisje dhe menaxhim
SMP	Sistemi i monitorimit të performancës
SMSH	Standardi minimal i shërbimit
SOP-PSV	*Standard Operational Procedure* – Procedurat standarde të veprimit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

1. HYRJE

Integrimi Evropian është objektivi gjeostrategjik dhe politik i Shqipërisë, që qëndron në thelb të politikës së brendshme dhe të jashtme të vendit dhe avancimi në këtë objektiv kryesor, nëpërmjet çeljes së negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian në korrik të vitit 2022, mbetet prioriteti kryesor.

Digjitalizimi i shërbimeve publike ka qenë një prioritet kyç në agjendat e Qeverisë. Prioritet ky, të cilin pandemia COVID-19 e përshpejtoi, duke bërë urgjente nevojën për ofrimin e shërbimeve vetëm *online*. Ndaj, qeveria ka prioritizuar përmirësimet në shërbimet thelbësore digjitale për qytetarët dhe për bizneset, me synimin për të ofruar shërbime të përqendruara te përdoruesit dhe lehtësisht të aksesueshme.

Digjitalizimi është tashmë një progres i pakthyeshëm i çdo institucioni shqiptar. Nga viti 2022 ka nisur një proces i ri për shërbimet publike,

ai i ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët dhe për bizneset vetëm *online*. Qytetarët dhe bizneset aplikojnë vetëm përmes platformës *e-Albania* dhe janë punonjësit e administratës publike ata që mbledhin të gjitha dokumentet e nevojshme dhe u ofrojnë atyre një shërbim final. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet shtetërore tashmë përdoren dhe ripërdoren, duke i çliruar qytetarët nga barra e grumbullimit fizik të tyre në letër në sportelet shtetërore.

Platforma unike qeveritare *e-Albania.al* shërben si një portë e centralizuar, përmes së cilës çdo individ i interesuar mund të marrë nëpërmjet internetit, shërbimet elektronike të ofruara nga institucionet publike në Shqipëri dhe në këtë mënyrë funksionon si e vetmja pikë aksesi për qytetarët 24/7. Sot, 1227 shërbime publike ofrohen *online* nëpërmjet portalit unik *e-Albania,* ose rreth 95% e të gjitha shërbimeve publike, krahasuar me vitin 2013 ku jepeshin vetëm 14 shërbime ose 1% e shërbimeve *online* në atë kohë.

Sot, synimi është transformimi i shërbimeve publike përmes një qasjeje të vëmendshme për qytetarët dhe për bizneset, që përbën thelbin e vizionit të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën e Administratës Publike 2018–2022 dhe të Strategjisë Ndërsektoriale "*Agjenda për Shqipërinë Digjitale*" 2022–2026.

Nga ana tjetër, Reforma në Administratën Publike është një proces thelbësor i lidhur ngushtë me rrugëtimin e vendit drejt Bashkimit Evropian. Vizioni është: "*Zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime me cilësi të lartë për qytetarët dhe për bizneset në mënyrë transparente, efektive dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative dhe përputhet me kërkesat e integrimit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave eficiente.*"

"*Të kemi shërbime digjitale gjithëpërfshirëse dhe pa kufij për qytetarët dhe për bizneset*" – ky është vizioni i Strategjisë Digjitale të Shqipërisë 2022–2026. Për periudhën kohore 2022–2026, Qeveria e Shqipërisë synon të digjitalizojë më tej shërbimet publike për të marrë një përgjigje *online* me nënshkrim ose vulë elektronike për të gjitha kërkesat në *e-Albania.*

Qeveria e Shqipërisë ka arritur të krijojë një histori suksesi të transformimit digjital në rajon. Raportet e organizatave më prestigjioze në botë, nga Komisioni Evropian, OECD, OKB dhe Departamenti i Shtetit i SHBA-së, i japin Shqipërisë vlerësimin maksimal në qeverisjen digjitale. Raporti i OECD 2020 "*Qeveria në një vështrim: Ballkani Perëndimor*", e renditi Shqipërinë në vend të parë në mesin e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, për sa i përket qeverisjes digjitale, pasi ka plotësuar pozitivisht numrin më të madh të treguesve që matin këtë arritje.

Shqipëria ka qenë e para në rajon që ka zhvilluar dhe zbatuar një Platformë Qeveritare të Ndërveprimit. Kjo Platformë Qeveritare e Ndërveprimit ofron arkitekturën bazë që mundëson shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit në kohë reale ndërmjet institucioneve të administratës publike në mënyrë të sigurt dhe të besueshme.

Në kuadër të iniciativës së Partneritetit për Qeverisje të Hapur, e cila në thelb ka nxitjen e politikëbërjes së hapur dhe gjithëpërfshirëse, në planin e veprimit për 2020–2022, qeverisja digjitale dhe aksesueshmëria në shërbimet publike është një nga katër shtyllat kryesore të këtij plan veprimi.

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 22.9.2021, i cili përcakton fushën e përgjegjësisë shtetërore, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton, zhvillon dhe monitoron politikat shtetërore dhe strategjitë, për:

a) sigurimin e standardeve në ofrimin e shërbimeve publike;

b) rritjen e cilësisë së shërbimeve në çdo sektor publik;

c) lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike;

ç) rritjen e efektivitetit të shërbimeve për të garantuar aksesin e qytetarëve në marrjen e shërbimeve publike.

Gjithashtu, ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve koordinon dhe, rast pas rasti, udhëheq procesin e riinxhinierimit dhe derregullimit, me qëllim thjeshtimin, rritjen e eficiencës dhe të efikasitetit të shërbimeve publike të ofruara nga institucionet e administratës shtetërore.

Nga qershori 2022, pjesë e përgjegjësive të ministrit të Shtetit, përveç bashkërendimit të politikave shtetërore, që synojnë standarde të larta të shërbimeve publike, është shtuar përmbushja e parimeve të Qeverisjes së Mirë.

Në rrafshin institucional, aktorë kryesorë të përfshirë në zbatimin e politikave mbi standardet e shërbimeve janë: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Agjencia për Dialog

dhe Bashkëqeverisje (ADB), Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), si dhe institucionet e administratës shtetërore shërbim-ofruese në fokus.

Me qëllim detajimin e objektivave, parimeve dhe ndërhyrjeve kryesore për realizimin e vizionit dhe harmonizimin e veprimtarive mes të gjithë aktorëve të përfshirë, ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve paraqet këtë dokument politikash, i cili ka si veçori kryesore kërkesën që institucionet dhe agjencitë qeveritare të krijojnë dhe zbatojnë standardet e shërbimit dhe më pas të monitorojnë performancën kundrejt këtyre standardeve. Këto standarde do të përdoren në menaxhimin e pritshmërive të përdoruesit, për të plotësuar më mirë kënaqësinë e tij. Standardet e shërbimit u komunikohen edhe qytetarëve në mënyrë që ata të jenë të vetëdijshëm, se çfarë niveli të shërbimit të presin nga Qeveria.

2. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS

2.1 Vizioni

Shqipëria 2030 do të jetë një Shqipëri plotësisht e digjitalizuar në funksion të qytetarëve, sipërmarrjes dhe brezit të ri. Qeveria do të përmirësojë dhe modernizojë sistemet elektronike në të gjithë sektorët, me synim automatizimin dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve dhe biznesit, si dhe veprimtarisë së administratës publike.

"*Shërbime digjitale gjithëpërfshirëse dhe pa kufij për qytetarët dhe për bizneset*" është vizioni, i cili është përfshirë edhe në Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2022–2026.

2.2 Objektivat e politikës

Objektivi 1

Të mundësojë vlerësimin e performancës së ofruesve të shërbimeve përkundrejt standardeve dhe **monitorimin** e cilësisë së shërbimeve.

Objektivi 2

Të mbështesë përditësimin dhe **korrektimin** e standardeve bazuar në evidenca dhe politika të tjera që influencojnë standardet.

Objektivi 3

Të vijojë **automatizimin** e proceseve, me qëllim lehtësimin e jetës së qytetarëve dhe të bizneseve, si edhe të veprimtarisë së administratës publike.

2.3 Fusha dhe koha e veprimit

Nisur nga objektivat e cituar më sipër në periudhën e parë *(afatshkurtër*) në fokus do të jetë shtrirja dhe përdorimi i platformës "*Me ty për Shqipërinë që duam*" nga të gjithë qytetarët, si dhe shtrirja e përdorimi i saj nga njësitë e pushtetit vendor. Gjithashtu, SQDNE do të përdoret edhe për të monitoruar dhënien e shërbimeve publike nga organet e pushtetit vendor të ofruar në portalin *e-Albania.*

Në një periudhë të mëvonshme (*afatmesme*) parashikohet, në bashkëpunim me AKSHI-n, hartimi dhe miratimi i një instrumenti të matjes së cilësisë së dhënies së shërbimeve digjitale si edhe *BI.*

Në një periudhë *afatgjatë* parashikohet marrja e ISO 9001 nga ana e institucioneve që ofrojnë shërbime administrative, shoqëruar me zbatimin e procedurave standarde të veprimit. Kjo fazë do të shoqërohet me kryerjen e anketimeve për matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve dhe bizneseve si përdorues të shërbimeve.

2.4 Rezultatet e pritshme

Lidhur me objektivat e mësipërm, rezultat e pritshme janë:

1. Vlerësim dhe monitorim i vazhdueshëm i treguesve të cilësisë, nëpërmjet:

- Matja e treguesve të cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet instrumentit të matjes së cilësisë dhe shtrirjes horizontale të standardit;
- Krijimi i 6 *life-events.*

2. Përmirësimi i treguesve të cilësisë si një mjet për uljen e korrupsionit në shërbimet publike.

3. Performancë më e mirë e agjencive publike shërbim-ofruese/individë.

4. Forcimi i **qasjes së përqendruar te qytetari** nëpërmjet KPI, në përputhje me rrethanat, si krijimi i bazës së të dhënave për të ndërtuar një pamje gjithëpërfshirëse të nevojave të qytetarëve mbi parimin "**vetëm një herë**".

3. PARIMET KRYESORE DHE STANDARDET E SHËRBIMEVE

3.1 Parimet e Qeverisjes së Mirë dhe ofrimi i shërbimeve publike

Ofrimi i shërbimeve publike administrative ka të bëjë me grupin e gjerë të ndërveprimeve të qytetarëve me agjencitë shërbim-ofruese, si: bërjen e kërkesave, kërkesat, regjistrimet dhe pagesat, marrjen e informacionit, dokumentacionit, vendimeve dhe fondeve. Këto kontakte i lejojnë përdoruesve të shërbimeve të ushtrojnë të drejtat e tyre, pra të kenë akses (p.sh., shtesat, pensionet), të ekzekutojnë detyrimet e tyre (p.sh., taksat, mbrojtja

e mjedisit) dhe të arrijnë ambiciet e tyre (p.sh. studimi, vetëpunësimi) sipas ligjit. Ato, gjithashtu, u mundësojnë qeverive të zbatojnë politika, të mbledhin të ardhura, të shpenzojnë buxhete, të mbledhin të dhëna dhe të aplikojnë rregulla, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

OECD/SIGMA në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian ka hartuar "Parimet e administratës publike"[2], një grup parimesh të cilat bazohen në kriteret e përgjithshme të mirëqeverisjes dhe rrjedhin nga standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, si dhe nga praktikat e mira në BE dhe vendet anëtare të OECD-së. Këto Parime mbulojnë gjashtë fusha kryesore përmes të cilave Komisioni Evropian ka përcaktuar: 1. kuadri strategjik për reformën e administratës publike; 2. zhvillimi dhe koordinimi i politikave; 3. shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore; 4. llogaridhënia; 5. ofrimi i shërbimit; 6. menaxhimi i financave publike. Parimet përcaktojnë kërkesa të hollësishme për një mirëfunksionim të administratës në secilën nga këto gjashtë fusha kryesore. Një kornizë monitorimi e këtyre parimeve është zhvilluar për të mundësuar analiza të rregullta të progresit të bërë në zbatimin e Parimeve dhe në përcaktimin e standardeve dhe në mënyrë peridioke raporton edhe progresin e bërë në Shqipëri.

Gjatë monitorimit të ofrimit të shërbimeve OECD/SIGMA përdori këto kritere:

Kriteri 1: Politika për administratën shtetërore e orientuar drejt qytetarit ekziston dhe zbatohet.

Kriteri 2: Administrata e mirë është një element kyç i politikës, që mbështet ofrimin e shërbimit publik, i miratuar me legjislacionin përkatës dhe i zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në praktikë.

Kriteri 3: Ekzistojnë mekanizma për sigurimin e cilësisë së shërbimit publik.

Kriteri 4: Sigurohet aksesueshmëria e shërbimeve publike.

Në ofrimin e shërbimeve administrative agjencitë shërbim-ofruese u vlerësuan mbi bazën e zbatimit praktik të këtyre kritereve, duke përdorur në total 52 tregues, 350 nëntregues dhe 1000 kritere. Disa shërbime janë përsëritëse për nga vetë natyra, si: pagesat e taksave, ndërsa disa të tjera janë të zakonshme në faza të ndryshme jete, si: gjetja e një pune ose marrja në punë nga institucioni, ndaj pavarësisht nga lloji i shërbimit, agjencitë shërbim-ofruese duhet të bashkëhartojnë dhe bashkim-plementojnë me përdoruesit zgjidhje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT).

Transformimi i shpejtë dhe revolucioni digjital paraqesin sfida si për agjencitë shërbim-ofruese ashtu dhe për të ardhmen e shërbimeve publike. Teknologjia është një pjesë kritike e këtij transformimi, por ajo duhet të shkojë paralelisht me qasjet inovative, aksesin në platformë dhe eksperiencën e përdoruesve.

3.2 Transformimi digjital në Shqipëri

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka dëshmuar një ndryshim të konsiderueshëm në mendësinë e ofrimit të shërbimeve. Përqafimi i digjitalizimit dhe i mjeteve digjitale në ndërveprimin me qytetarët dhe biznesin ka rezultuar të jetë mekanizmi i duhur për rritjen e cilësisë dhe uljen e nivelit të korrupsionit në ofrimin e shërbimeve.

Zbatimi i mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit kontribuon në mënyrë të qenësishme në ofrimin e shërbimeve publike cilësore, si dhe rrit besimin tek institucionet e administratës shtetërore, duke përmbushur pritshmëritë e qytetarëve në drejtim të transparencës, integritetit, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të administratës publike.

Gjithashtu, mjetet e qeverisjes digjitale ridimensionojnë mënyrën mbi bazën e së cilës regjistrohen, ruhen dhe vihen në dispozicion të dhënat e gjeneruara nga veprimtaria e institucioneve publike. Menaxhimi i shërbimeve në mënyrë digjitale përmirëson gjurmimin, zbulimin, monitorimin dhe hetimin e parregullsive.

Shërbimet *online* të ofruara në portalin *e-Albania* mundësojnë pajisjen me dokumente elektronike, si dhe kryerjen e pagesave elektronike për qytetarët dhe për bizneset. Ato ndahen në 12 kategori të ndryshme, si në vijim: familja, arsimi, puna, shëndetësia dhe mbrojtja sociale, kontributet dhe pensioni, gjendja gjyqësore, biznesi im, leje dhe licenca, transport dhe automjete, pasuri e paluajtshme, shërbimet konsullore *online* dhe shërbimet doganore.

Në Shqipëri, digjitalizimi i ndërveprimit të drejtpërdrejtë dhe të automatizuar ndërmjet qytetarëve dhe nëpunësve civilë përbën një nga shtyllat kyçe të masave antikorrupsion. Procedurat

[2] https://www.sigmaweb.org/publications/principles-public-administration.htm

automatike eliminojnë plotësisht nevojën për kontakt të drejtpërdrejtë midis qytetarëve dhe nëpunësve, si dhe ulin/rrisin transparencën në ofrimin e shërbimeve publike.

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve është një proces i vazhdueshëm për qeverinë dhe hapat e ndërmarrë dhe institucionet e përfshira në këtë proces transformimi janë:

- ADISA

Që nga viti 2013, Qeveria e Shqipërisë ka ndjekur një reformë novatore që risjell mënyrën se si administrata publike u ofron shërbime qytetarëve të saj drejt ofrimit të shërbimeve publike *online* dhe digjitalizimit të plotë të proceseve të punës së administratës. Kjo reformë mbështet inovacionin në përdorimin e teknologjisë së informacionit (TI) për të përmirësuar standardet, procedurat dhe organizimin e ofrimit të shërbimeve.

Qeveria e Shqipërisë, në vitin 2014, nisi një program të përgjithshëm për përmirësimin e shërbimeve publike. Reforma me ritme të shpejta përfshiu etapa të rëndësishme, si: ngritja e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve të Integruara në Shqipëri (ADISA), si një agjenci e dedikuar për të garantuar standardet e kujdesit ndaj përdoruesve në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe për bizneset; ngritja e një mekanizmi për reagimin qytetar; rinovimi i portalit eAlbania; nisja e një procesi standardizimi dhe thjeshtimi në ofrimin e shërbimeve dhe pilotimin e ndarjes së sporteleve pritëse të qytetarëve *Front Office* (FO) dhe zyrave mbështetëse përgjegjëse për përpunimin e të dhënave dhe finalizimin e shërbimeve publike *Back Office* (BO) dhe menaxhimit të FO nga ADISA; hapja e një qendre të thirrjeve telefonike *Call Center* në mbarë vendin në 0800 0118 për informacion mbi shërbimet. Kjo reformë ishte gjithëpërfshirëse dhe përfshin disa ndërhyrje të ndërlidhura në nivele ligjore, institucionale dhe operacionale. Ligji për ofrimin e shërbimeve publike në sportelet pritëse të qytetarëve në Republikën e Shqipërisë ishte instrumenti kryesor ligjor që përcaktoi rregullat për ofrimin e shërbimeve publike duke hequr barrierat administrative dhe duke ofruar shërbim të shpejtë, efikas, transparent dhe më cilësor në Shqipëri.

Që nga momenti i mbylljes së zyrave të sporteleve pritëse *front-office*, pas afatit të datës 1 maj 2022, personeli i ADISA-s në seli, si dhe në rrethe janë përshtatur me realitetin e ri dhe krah për krah me koordinatorët e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, po kryejnë çdo ditë operacionet për menaxhimin e ankesave të platformës *online*, në nivel qendror dhe lokal, si dhe monitorimin e kërkesave në të gjithë Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrime Elektronike. Qendra e thirrjeve ADISA është plotësisht funksionale dhe me anë të linjës së saj të gjelbër (telefon, *chat*, *e-mail)* asiston çdo ditë qytetarët dhe biznesi për të marrë shërbime publike. Sa herë që ka raste të qytetarëve dhe bizneseve që adresojnë një ankesë përmes *call center*, kjo e fundit u referohet koordinatorëve të cilët kontaktojnë menjëherë qytetarin/biznesin dhe ndjekin rastin në platformë. Pas mbylljes së zyrave të pritjes, qytetarët dhe/ose bizneset përdorin në masë të madhe qendrën e thirrjeve të ADISA-s për të marrë mbështetje për të marrë shërbime *online*.

- AKSHI – AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Portali *e-Albania*, ngritur mbi Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, është kthyer në portën kryesore, përmes së cilës çdokush mund të marrë shërbimet elektronike të ofruara nga institucionet publike në Shqipëri nëpërmjet internetit.

Aktualisht, plot **2.8 milionë** shqiptarë janë të regjistruar si përdorues të këtyre shërbimeve dhe kanë akses të menjëhershëm në informacionin e tyre personal.

Janë **39.8 milionë aplikime** për përdorimin e këtyre shërbimeve; **58** baza të dhënash dhe regjistra elektronikë që ndërveprojnë dhe shkëmbejnë informacion në kohë reale nëpërmjet **275 milionë** transaksioneve. **23 milionë** dokumente që janë të vulosura në mënyrë elektronike janë nxjerrë përmes platformës *e-Albania*.

Në total qytetarëve u është kursyer:

Më shumë se **990** vjet kohë pritjeje në radhë pas sporteleve, **mbi 10 milionë** euro tarifa shërbimi në anë të dokumenteve të lëshuar elektronikisht, të cilat lëshohen pa kosto.

Bizneset përfitojnë nga një gamë e gjerë shërbimesh, duke përfshirë: regjistrimin, lejet, licencat, pagesat e taksave që janë tërësisht pa letra. Qytetarët e huaj mund të aplikojnë dhe marrin vizën e tyre me anë të platformës *e-Viza* pa pasur nevojë të vizitojë një konsullatë. Proceset e brendshme po ashtu janë digjitalizuar, duke implementuar *software* dhe baza të dhënash që lejojnë administratën publike të ndërveprojë në distancë dhe të shkëmbejë dokumente. Kjo, nga

ana tjetër, kursen kohë dhe është më eficiente e më e besueshme se sa shërbimet verbale dhe, gjithashtu, redukton edhe përdorimin e letrës, duke fotokopjuar numër të madh dokumentesh.

Në vitin 2021, Shqipëria u nderua me çmimin për qeverisjen digjitale nga ReSPA dhe OECD/SIGMA për zbatimin e praktikave, iniciativave, shërbimeve *online* dhe masave efektive për të përballuar krizën e koronavirusit.

Së fundmi, Shqipëria pësoi një sulm kinerbetik, jo nga një individ apo *hacker* i zakonshëm, por një sulm i koordinuar dhe mirorganizuar nga një shtet tjetër. Nëpërmjet suportit të partnerëve strategjikë përgjigjja ndaj tij ka qenë e menjëhershme dhe e plotë, në mënyrë që të uleshin dëmet e këtij sulmi dhe të rritej siguria e sistemit digjital.

Qeveria shqiptare mbetet e përkushtuar në zhvillimin e një infrastrukture digjitale të sigurt dhe për të ndërmarrë aktivitete për mundësimin e bashkëpunimit për sigurinë kinerbetike brenda rrjetit, duke pritur mbrojtjen e infrastrukturës kritike, kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin rajonal të sigurisë kinerbetike, me fokus parandalimin dhe zbulimin e kërcënimeve kinerbetike, si edhe rikuperim të shpejtë edhe efektiv.

Në këtë kuadër, janë marrë masa për mbrojtjen e infrastrukturave dhe sistemeve qeveritare, duke filluar nga më të thjeshtat si: *antivirus*-i, *firewalls*, e deri te sistemet e zbulimit dhe përgjigjes (*Endpoint Detection & Response*), platforma për mbrojtjen e avancuar të trafikut të avancuar *e-mail* dhe izolimin e kërcënimeve (ATP), sisteme *HoneyPo*t, analiza sjelljesh përmes ndërlidhjes së të gjithë informacioneve në një platformë të vetme, kalimi në modelin *zero-trust*. Gjithashtu, AKSHI, *e-Albania* dhe Platforma Qeveritare e Ndërveprimit janë certifikuar me standarde ndërkombëtare ISO 27001 dhe 20000-1 për sigurinë e informacionit në të dyja nivelet teknike dhe ISO 9001 për menaxhimin cilësor të sistemeve.

Për periudhën kohore 2022–2026, Qeveria e Shqipërisë synon të digjitalizojë më tej shërbimet publike, duke integruar teknologjitë e reja, si *blockchain* dhe inteligjenca artificiale, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së ofrimit të shërbimit. Për të rritur numrin e shërbimeve që merren në kohë reale me vulë elektronike, synohet të vazhdohet me investimet për digjitalizimin e arkivave fizikë dhe rritjen e numrit të sistemeve elektronike që ndërveprojnë me njëri-tjetrin në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit.

- AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

Ligji nr. 107/2021, "Për bashkëqeverisjen", është një legjislacion i ri që forcon rolin e qeverisjes me platformën qytetare: www.shqiperiaqeduam.al, duke ofruar një mjet kuptimplotë në duart e qytetarëve dhe bizneseve dhe trajton ankesat e tyre për ofrimin e shërbimeve të kryera nga administrata publike, si dhe parashikon grupin e sanksioneve, financiare dhe administrative që do të ndërmerren sa herë që inspektimet për keqbërje rezultojnë me probleme.

Ligji parashikon, gjithashtu, rregullën që dritarja e vetme për të raportuar korrupsionin në administratën publike është përmes seksionit "Denonconi korrupsionin" në platformën "Shqipëria që duam".

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 29.4.2022, "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve *online* nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre", sistemi i qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik, është sistemi i cili bën të mundur komunikimin, shkëmbimin e dokumenteve shoqëruese të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimit, kërkimi i të cilit realizohet nëpërmjet platformës *e-Albania*, deri në lëvrimin e tij dhe lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik, si dhe monitorimin e lëvrimit të shërbimit sipas afateve ligjore. Sistemi i ri i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrime Elektronike, prej vitit 2020 pakëson barrën e qytetarëve dhe të bizneseve për të marrë dokumente dhe vërtetime nga çdo zyrë e mundshme në administratën publike. Është vetë institucioni ku ofrohet shërbimi publik që siguron plotësimin e të gjithë dosjes së aplikimit. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është institucioni përgjegjës për monitorimin e raportimin e zbatimit të afateve dhe përdorimit të SQDNE-së, në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve deri në ofrimin e shërbimit dhe të dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik në platformën *e-Albania*, sipas afateve ligjore.

Shqipëria ka qenë e para në rajon që ka zhvilluar dhe ka zbatuar një Platformë Qeveritare të

Ndërveprimit. Kjo platformë ndërveprimit ofron arkitekturën bazë që mundëson shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit në kohë reale ndërmjet institucioneve të administratës publike, në mënyrë të sigurt dhe të besueshme. Platforma e ndërveprimit ka qenë një hap i domosdoshëm për të thjeshtuar shërbimet që shteti ofron për qytetarët, bizneset dhe institucionet e administratës shtetërore, si dhe reduktimin e numrit të dokumenteve që kërkohen nga qytetarët apo biznesi për të marrë shërbime publike. Gjithashtu, ky sistem u mundëson koordinatorëve të Agjencisë që të kryejnë monitorimin e përditshëm të shërbimeve që ofrohen nga institucionet shtetërore dhe të kontrollojnë nëse janë respektuar afatet.

Përpjekjet për të përmirësuar aksesin në shërbimet publike digjitale edhe për grupet vulnerabël, kërkojnë zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, duke synuar mundësimin e këtij shërbimi në çdo cep të Shqipërisë për qytetarët, pavarësisht gjendjes së tyre sociale ose ekonomike.

Integrimi i teknologjive të reja në sistemet qeveritare do të mundësojë në vitet në vijim, përmirësimin e ofrimit të cilësisë së shërbimeve dhe automatizimin e mëtejshëm të tyre.

Njëkohësisht, nëpunësit e administratës publike po aftësohen për të përqafuar një ndryshim të tillë. Me qëllim rritjen e produktivitetit të këtyre mjeteve në frenimin e praktikave të korrupsionit do të intensifikohet analiza e të dhënave për gjurmimin e modeleve të sjelljes dhe riskut të integritetit edhe përmes aftësimit të nëpunësve për të përdorur mjete digjitale për funksionimin e brendshëm të administratës publike.

3.3 Kërkesat dhe standardet kryesore për ofrimin e shërbimit

Në përgjithësi, cilësia e një shërbimi varet nga një sërë faktorësh, disa të dukshëm dhe disa jo, të cilët në varësi të ofruesit ose marrësit të shërbimit shprehin cilësitë e tij të ndryshme:

- cilësia e pritshme shërbimit përcaktohet nga vetitë, që përdoruesit e atij shërbimi presin të marrin;

- cilësia e ofruar përcaktohet nga vetitë, që matin shkallën e efektivitetit të ofrimit të një shërbimi kundrejt standardeve të vendosura;

- cilësia e perceptuar e shërbimit përcaktohet nga vetitë, që shprehin perceptimin e shërbimit të ofruar.

Standardet e shërbimit janë të rëndësishme: a) për të përcaktuar cilësinë, pra për të matur përputhshmërinë; b) për të formuar pritshmëritë, sepse duke qenë të qartë mbi standardet (nëpërmjet statutit të standardeve të shërbimit) përdoruesit e dinë se çfarë të presin dhe çfarë jo; c) nxisin performancën, sepse institucionet/stafi duhet t'i përdorin këto standarde si angazhime për të drejtuar sjelljen e tyre dhe (përmirësuar) performancën.

Hartimi dhe ofrimi i shërbimit duhet të menaxhohen për lehtësinë e përdoruesit, duke filluar me të kuptuarit e nevojave të qytetarëve dhe bizneseve, duke u mundësuar atyre të aksesojnë një shërbim të personalizuar përmes kanalit *online* dhe të rregullohen bazuar në reagimet e ndryshimit të nevojave. Në thelb të konceptit "qytetari në qendër" qëndron besimi i thellë, se dëgjimi i qytetarëve/përdoruesve dhe sigurimi i një pasqyre të plotë të nevojave, pritshmërive dhe vlerave të grupeve të ndryshme të përdoruesve mund të ketë ndikim në nivelin e kënaqësisë, performancën e ofruesve të shërbimeve dhe marrëdhëniet ndërmjet përdoruesve dhe ofruesve të shërbimeve të sektorit publik.

Matja e cilësisë efektive të një shërbimi kërkon:

i. krijimin e një liste treguesish të matshëm, të përshtatshëm për këtë qëllim;

ii. hartimin e një sistemi për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave/treguesve;

iii. përpunimin dhe analizimin e informacionit të mbledhur për të paraqitur cilësinë e arritur;

iv. përdorimin e një mekanizmi korrigjues, i cili merr në konsideratë të gjithë informacionin për të identifikuar problemet dhe për të propozuar përmirësime;

v. sigurimin e gjithëpërfshirjes së përdoruesve në përcaktimin e cilësisë (dhe treguesve).

Në hartimin e treguesve të matshëm, dimensionet e mëposhtme konsiderohen si kategori të cilësisë:

i. Përqendrimi te përdoruesit:

- Në çfarë mase ofrohen shërbimet *online*?

- Sa miqësore me celularin janë ato?

- Dhe çfarë mekanizmash të mbështetjes dhe reagimit në internet ekzistojnë?

ii. Transparenca:

- A ofrojnë institucionet e administratës shtetërore informacion të qartë dhe të komunikuar hapur për mënyrën se si ofrohen shërbimet e tyre?

- A janë ata transparentë në lidhje me përgjegjësitë dhe performancën e institucioneve të tyre publike dhe mënyrën se si përpunohen të dhënat personale të njerëzve?

iii. Mundësuesit kryesorë:

Çfarë mundësuesish teknologjikë ekzistojnë për ofrimin e shërbimeve të *e-Qeverisjes?*

iv. Lëvizshmëria ndërkufitare:

- Sa lehtë mund t'i qasin dhe përdorin shërbimet *online* qytetarët nga jashtë?[3] (Shih aneksin 1.)

3.4 Standardet dhe rregulloret e BE-së mbi shërbimet

Në nivel evropian, drejtimet me të cilat ofrohen shërbimet dhe vendosen standardet, janë renditur më poshtë:

1. Direktiva e Shërbimit[4]. Kjo është një nismë që vendos kuadrin e përgjithshëm në nivelin e Bashkimit Evropian për rritjen e aksesueshmërisë dhe cilësisë së të gjitha llojeve të shërbimeve si për qytetarët ashtu edhe për bizneset në të gjithë territorin e tij. Rëndësia e kësaj direktive është se ajo ofron bazën për inicimin e një qasjeje të përbashkët në formësimin e përmbajtjes dhe procesit të ofrimit të shërbimeve publike për përdoruesit nga vende të ndryshme. Direktiva e Shërbimeve u miratua nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli më 12 dhjetor 2006 dhe u zbatua nga të gjitha vendet e BE-së në vitin 2009. Sipas direktivës, Shtetet Anëtare janë të detyruara të krijojnë "*pika të vetme kontakti*", përmes të cilave ofruesit e shërbimeve mund të marrin të gjitha informacionin përkatës dhe të merret me të gjitha formalitetet administrative pa pasur nevojë të kontaktojë disa autoritete. Komisioni Evropian po punon me vendet e BE-së për të përmirësuar më tej tregun e përbashkët për shërbimet.

2. Kuadri i përbashkët në ofrimin e shërbimeve publike në nivel të Bashkimit Evropian (Korniza e ndërveprimit)[5]. Në lidhje të ngushtë me iniciativat e shteteve të ndryshme anëtare të BE-së, duke dëshmuar përpjekjet e përbashkëta për zbatimin e direktivës së shërbimeve të BE-së, u ndërmorën një sërë veprimesh të ndërlidhura për të rritur nivelin e ndërveprimit ndërmjet strukturave të ndryshme institucionale për ofrimin e shërbimeve publike nga administrata publike të shteteve anëtare. Kjo çoi në miratimin e objektivit të krijimit të Kornizës Evropiane të Ndërveprimit (EIF), duke synuar përmirësimin e ndërveprimit ndërkufitar ndërmjet administratave publike brenda Bashkimit Evropian.

3. Direktivat për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit në sektorin publik (PSI). Një qasje e zakonshme në zhvillimin dhe sigurimin e shërbimeve, si dhe veprimet për të siguruar një nivel të lartë të ndërveprimit ndërmjet administratës publike të vendeve anëtare, deri në vitin 2019 fokusohej në rrjedhën e informacionit ndërmjet institucioneve të ndryshme, si pjesë e së njëjtës strukturë të administratës publike. Direktiva PSI vendoste për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik (direktiva 2003/98/EC, e njohur si "Direktiva PSI") dhe fokusohej në aspektet ekonomike të ripërdorimit të informacionit dhe jo në aksesin e qytetarëve në informacion. Kjo direktivë është shfuqizuar nga direktiva 2019/1024 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e cila ka hyrë në fuqi në datën 20 qershor 2019 dhe fokusohet në të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit në sektorin publik.

4. Autentifikimi elektronik – rregullorja eIDAS[6]. Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm ofron një mjedis rregullator të parashikueshëm për të mundësuar ndërveprime elektronike të sigurta dhe të pandërprera ndërmjet bizneseve, qytetarëve dhe autoriteteve publike. Në këtë drejtim, rregullorja eIDAS: a) siguron që njerëzit dhe bizneset të mund të përdorin skemat e tyre kombëtare të identifikimit elektronik (eID) për të hyrë në shërbimet publike në vendet e tjera të BE-së, ku disponohen eID; b) krijon një treg të brendshëm evropian për shërbimet e besimit elektronik – domethënë nënshkrimet elektronike, vulat elektronike, vulën kohore, shërbimin e dorëzimit elektronik dhe vërtetimin e faqes në internet, duke siguruar që ato do të punojnë përtej kufijve dhe do të kenë të njëjtin status ligjor, si proceset tradicionale të bazuara në letër.

[3] Research Network on EU Administrative Lawhttp://reneual.eu/projects-and-publications/reneual-2-0?view=article&id=31&catid=2

[4] https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32006L0123&from=EN

[5] https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=COM:2017:134:FIN

[6] https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2014/910/oj

5. Rregullorja e standardizimit[7] ofron një bazë ligjore për të përdorur standardet evropiane, si për produktet, ashtu edhe për shërbimet, për të identifikuar specifikimet teknike të TIK-ut dhe për të financuar procesin e standardizimit evropian. Standardizimi evropian bazohet në parimet e njohura nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) në fushën e standardizimit, përkatësisht koherenca, transparenca, hapja, konsensusi, aplikimi vullnetar, pavarësia nga interesat e veçantë dhe efikasiteti ("parimet themeluese").

6. Strategjia e BE-së mbi standardizimin[8]. Strategjia e re e BE-së për standardizimin, e prezantuar nga Komisioni Evropian (KE) në shkurt 2022, përcakton standardet globale në mbështetje të një tregu të vetëm të qëndrueshëm, të gjelbër dhe digjital të BE-së. Qëllimi i kësaj strategjie është të rrisë qëndrueshmërinë e ekonomisë evropiane, ta bëjë atë më digjitale dhe më të gjelbër, të përmirësojë konkurrencën dhe të ruajë vlerat demokratike në aplikimet e teknologjisë. Strategjia e BE-së për standardizimin ilustron qasjen e BE-së ndaj standardeve në lidhje me tregun e vetëm dhe globalisht, duke propozuar pesë veprime kryesore:

- Parashikim, prioritizim dhe adresim i nevojave të standardizimit në fushat strategjike;
- Përmirësimi i qeverisjes dhe integritetit të sistemit evropian të standardizimit;
- Rritja e lidershipit evropian në standardet globale;
- Mbështetje e inovacionit;
- Krijimi i gjeneratës së ardhshme të ekspertëve të standardizimit.

7. Strategjia e Tregut Unik Digjital për Evropën[9] ka nevojë të:

a) krijohet mjedisi i duhur, që rrjetet dhe shërbimet digjitale të lulëzojnë – kjo kërkon infrastruktura dhe shërbime me shpejtësi të lartë, të sigurta dhe të besueshme. Shqetësimet kryesore përfshijnë sigurinë kibernetike, mbrojtjen e të dhënave/privatësinë elektronike, drejtësinë dhe transparencën e platformave *online*.

b) maksimizimi i potencialit të rritjes së Ekonomisë Digjitale Evropiane – veçanërisht duke përmirësuar aftësitë digjitale, të cilat janë thelbësore për një shoqëri digjitale gjithëpërfshirëse dhe duke investuar në infrastrukturat dhe teknologjitë e TIK-ut.

8. Akti Evropian i Shërbimeve Digjitale (DSA) synon të përcaktojë një standard të ri për llogaridhënien e platformave *online,* në lidhje me përmbajtjen e paligjshme dhe të dëmshme. Ai siguron mbrojtje më të mirë për përdoruesit e internetit dhe të drejtat e tyre themelore.

Zhvillimi i Tregut Unik Digjital të BE-së kontribuon në transformimin e shërbimeve publike. Disa pika të tjera kanë kontribuar në ofrimin e shërbimeve publike të BE-së dhe standardet përmes të cilave ofrohen këto shërbime.

Në tetor 2017, të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë nënshkruar Deklaratën e Talinit për **"Deklaratën e qeverisjes elektronike"**, duke shënuar një moment historik për një qeveri elektronike të orientuar drejt shërbimeve, të besueshme dhe inovative në Evropë, duke siguruar shërbime publike digjitale me cilësi të lartë, të përqendruara te përdoruesit për qytetarët dhe shërbime publike ndërkufitare pa probleme për bizneset. Shtetet anëtare të BE-së riafirmuan angazhimin e tyre për përparim në lidhjen e shërbimeve të tyre publike elektronike dhe zbatimin e rregullores eIDAS dhe parimit të vetëm një herë në mënyrë që të ofrojnë shërbime publike digjitale efikase dhe të sigurta që do t'ua bëjnë jetën më të lehtë qytetarëve dhe bizneseve.

Parimet themelore në formësimin e të ardhmes digjitale të Evropës (2020) theksojnë, se: "*Qeveria digjitale mundëson vendime të orientuara nga të dhënat, shërbime dhe procese efikase dhe të përgjegjshme – në të gjithë qeverinë*". Suksesi i strategjisë digjitale të Evropës do të matet nëpërmjet shkallës se sa mirë do të funksionojnë mjetet digjitale në shpërndarjen e të mirave publike për qytetarët evropianë. Që ky transformim digjital të jetë plotësisht i suksesshëm, ka nevojë të krijohen kornizat e duhura për të siguruar teknologji të besueshme dhe për t'u dhënë bizneseve besimin, kompetencat dhe mjetet për t'u digjitalizuar.

Direktivat dhe rregulloret e BE-së janë baza mbi të cilën po hartohen dhe përditësohen parimet e BE-së për administratën publike. Këto parime, për sa u përket shërbimeve dhe ofrimit të shërbimeve kërkojnë shërbime administrative të thjeshtuara dhe me cilësi të lartë, të hartuara dhe të ofruara me

[7] https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2012/1025/oj

[8] https://ec.europa.eu/docsroom/documents/48598

[9] Miratuar më 6 maj 2015 dhe është një nga 10 prioritetet politike të Komisionit Evropian. Bruksel, 6.5.2015 COM (2015) 192 final.

qytetarët/përdoruesit në qendrën e tyre; ato, gjithashtu, kërkojnë për shërbime administrative të cilat janë lehtësisht të aksesueshme *online* dhe *offline,* për të gjithë përdoruesit, duke marrë parasysh nevojat e ndryshme dhe që qeveria digjitale të mundësojë vendime të bazuara në të dhëna, shërbime dhe procese efikase dhe të përgjegjshme – në të gjithë qeverinë.

Në një botë digjitale që ndryshon me shpejtësi, modelet e mundshme të ardhshme të qeverisë, administratat publike dhe institucionet publike në Bashkimin Evropian duhet të jenë të hapura, efikase dhe gjithëpërfshirëse, duke ofruar shërbime publike digjitale pa kufij, të personalizuara, miqësore për të gjithë qytetarët dhe bizneset në BE. Ky vizion i BE-së reflektohet edhe në politikën e zgjerimit, me fokus të qartë në *e-Qeverisjen* si një nga gjashtë nismat kryesore të Strategjisë së Ballkanit Perëndimor[10], si dhe në strategjitë shqiptare.

9. Deklarata e Berlinit *"Digital Society and Value-Based Digital Government"* (8.12.2020) njeh rolin e sektorit publik si një element thelbësor për Tregun e Vetëm Evropian dhe një forcë shtytëse për zgjidhje të reja dhe inovative teknologjike për shërbimet publike dhe sfidat shoqërore. Konkluzionet e Deklaratës së Berlinit parashikojnë parimet dhe fushat dhe masat (planet e veprimit) të politikave kombëtare, si më poshtë:

- Respektimi i të drejtat themelore dhe i parimeve demokratike në botën digjitale;
- Promovimi i përfshirjes dhe pjesëmarrjes;
- Nxitja e shkrim-leximit dhe fuqizimit digjital;
- Rritja e besimit dhe lejimi i pjesëmarrjes së sigurt në botën digjitale;
- Forcimi i sovranitetit digjital të Evropës dhe lehtësimi i ndërveprimit;
- Krijimi i sistemeve të inteligjencës artificiale që fokusohen në vlera me në qendër njeriun;
- Kultivimi i një shoqëri digjitale elastike dhe të qëndrueshme.

10. Rregullorja (BE) 2018/1724 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 2.10.2018 mbi një portë të vetme digjitale për ofrimin e aksesit në informacion, procedura, asistencë dhe shërbimet e zgjidhjes së problematikave dhe që ndryshon rregulloren (BE) 1024/2012.

Në muajin dhjetor 2022, Shqipëria zhvilloi mbledhjen bilaterale me Komisionin, lidhur me parimet e administratës publike, gjatë të cilës, lidhur me rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike u morën angazhimet, si më poshtë:

- Rritja e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në shërbimet elektronike të ofruara në platformën *e-Albania*: Synohet arritja e këtij objektivi nëpërmjet transpozimit të direktivës (BE) 2016/2102 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 26 tetor 2016 për aksesueshmërinë e faqeve të internetit, si dhe aplikacionet celulare të organeve të sektorit publik (deri në fund të vitit 2024);
- Përafrimi i direktivës së BE-së 2019/1024, "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" (e cila hyn në fuqi më 29 prill 2023);
- Përafrimi i Rregullores Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ("GDPR") dhe Direktivës së Policisë;
- Korniza Kombëtare e Ndërveprueshmërisë është krijuar në përputhje me parimet e Kornizës Evropiane të Ndërveprueshmërisë (EIF).

3.5 Ndërhyrjet kryesore për arritjen e standardeve

Si pjesë e politikave afatgjata për standardizimin e shërbimeve dhe matjes e cilësisë së tyre janë identifikuar disa kategori ndërhyrjesh të renditura në tabelën e mëposhtme.

[10] https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

#	Ndërhyrjet/parimet bazë	Plotësimi i nevojave të përdoruesve	Sigurimi i një shërbimi të mirë	Përdorimi i teknologjive të përshtatshme	Kuadri ligjor	Qeverisje e Mirë
1	Miratimi i standardeve minimale	✓			✓	✓
2	Hartimi i metodologjisë së matjes së cilësisë së shërbimeve		✓	✓	✓	✓
3	Marrja e opinioneve të qytetarëve dhe bizneseve	✓				✓
4	Pilotimi i ISO në disa agjenci shërbim-ofruese		✓			✓
5	Hartimi i SOP në agjencitë shërbim-ofruese, që janë pajisur me ISO		✓			✓
6	Trajnim dhe forcim kapacitetesh		✓	✓		✓
7	Hartimi i KPI për agjencitë shërbim- ofruese				✓	✓
8	Funksioni i sistemit të performancës së agjencive shërbim-ofruese/punonjësve	✓		✓		✓
9	Hartimi i instrumenteve të BI-së			✓		✓
10	Ndjekje e parimeve të Qeverisjes së Mirë	✓	✓	✓	✓	✓

- Miratimi i standardeve minimale

Standardi Minimal i Shërbimit (SMSH) nënkupton ato veçori cilësore të shërbimit që janë të detyrueshme për t'u garantuar nga agjencitë shërbim-ofruese. Pra, standardi minimal është në fakt një grup karakteristikash që i detyron ofruesit e shërbimeve të përmbushin detyrimet minimale ndaj qytetarëve në shërbimet që ofrojnë.

Hartimi i standardeve minimale për ofrimin e shërbimeve administrative publike shënon një hap të rëndësishëm në rrugën e transformimit në ofrimin e shërbimeve publike, garantimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kënaqësisë së qytetarëve në ofrimin e tyre. Hartimi duhet të fillojë duke u angazhuar që në fillim me përdoruesit, duke forcuar përqendrimin te qytetarët. Modeli i ndjekur në hartimin e paketës së standardeve minimale është në përputhje me standardet e kërkuara ndërkombëtare dhe përbën një hap të rëndësishëm në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Miratimi i Standardeve Minimale do të bëhet nëpërmjet një akti nënligjor dhe do të shërbejë jo vetëm për standardet e shërbimeve qendrore, por do të orientojë edhe shërbimet në nivel lokal. (Shih aneksi 1.)

- Hartimi i metodologjisë së matjes së cilësisë së shërbimeve

Cilësia e shërbimeve është me natyrë shumëdimensionale dhe si e tillë kërkon që një grup treguesish të merren parasysh gjatë vlerësimit. Matja e cilësisë së shërbimit nënkupton identifikimin e atyre treguesve/karakteristikave që mund të përkthehen në tregues të matshëm. Në praktikë, cilësia e shërbimit do të matet duke përdorur një indeks cilësie, i cili është zakonisht një masë me shumë pika, që vlerëson dimensionet kryesore të cilësisë operacionale dhe të shërbimit.

Për të përfaqësuar cilësinë me shumë tregues, indeksi i cilësisë së shërbimit është konceptuar si një indeks sintetik. Indeksi i cilësisë është i përbërë në mënyrë të tillë që të përfshijë informacione për dimensione të ndryshme të cilësisë, të cilat llogariten në funksion të disa treguesve të matshëm dhe përmbledhja e tyre e ponderuar jep vlerën e indeksit. Pasja e një indeksi unik mundëson krahasimin e lehtë me kalimin e kohës, ndërmjet shërbimeve të ndryshme ose dimensioneve të ndryshme.

Përcaktohen dimensione, tregues dhe nëntregues. Vetë treguesit dhe nëntreguesit përmbajnë kritere specifike të matshme, të cilat vlerësohen me pikë. Pikët që merr secili tregues përcaktohen në varësi të peshës që ka ai tregues. Gjithashtu, për secilin prej dimensioneve përcaktohet pesha që zë ai në llogaritjen e indeksit përfundimtar.

Formula e llogaritjes së indeksit të shërbimit është: $\sum \frac{I_i \times P_i}{100}$; ku I_i janë pikët që ka marrë dimensioni dhe P_i pesha për dimensionin e zgjedhur.

- Marrja e opinioneve të qytetareve dhe bizneseve

Ndërveprimi me qytetarët në mënyrë më proaktive, duke kërkuar opinionin e tyre për çdo kërkesë për shërbim.

Për rritjen e numrit të qytetarëve, që japin opinion për marrjen e shërbimeve, do të mundësojë akses në çdo kohë dhe çdo vend në mekanizmin e marrjes së mendimeve e sugjerimeve të tyre, duke vënë në dispozicion një sërë kanalesh:

i. Dritarja digjitale; përmes formularëve/pop-up të posaçëm të shfaqur online në momentin e marrjes së shërbimit, çdo qytetar jep vlerësimin me yje për shërbimin e marrë.

ii. Nota ime; në platformën "Shqipëria që duam" çdo qytetar mund të vlerësojë cilësinë e shërbimit të marrë nëpërmjet rubrikës nota ime.

iii. Nëpërmjet "Mekanizmit të Reagimit të Qytetarëve (CFM)" për marrjen e mendimeve mbi vlerësimin, korrektimin dhe lehtësimin e shërbimeve.

- Pilotimi i ISO 9001 i kornizës së cilësisë së menaxhimit në disa agjenci shërbim-ofruese

Menaxhimi i cilësisë totale për sektorin publik arrihet nëpërmjet disa modeleve.

ISO 9001:2015 është një standard i njohur ndërkombëtarisht për krijimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e një Sistemi të Menaxhimit të Cilësisë për institucionet/agjencitë apo kompanitë. ISO 9001 përdoret për këto agjenci, pavarësisht nga madhësia e tyre apo llojet e shërbimeve që ofrojnë. Si standard ndërkombëtar, ai përbën bazën e krijimit të një sistemi për ndjekjen e kënaqësisë së klientit dhe metodat e korrigjimit të shërbimit.

Gjithashtu, Korniza e Përbashkët e Vlerësimit (CAF) është një mjet unik menaxhimi për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e performancës për institucionet e sektorit publik. Konsiderohet si mjeti evropian i cilësisë për qeverisje të mirë dhe përsosmëri në sektorin publik, me fokus në digjitalizim, përshtatshmëri, qëndrueshmëri, diversitet dhe inovacion.

Standardet ISO 9001:2015 apo edhe Korniza e Përbashkët e Vlerësimit, do të shtrihen në agjencitë shërbim ofruese në varësi të buxheteve në dispozicion, por qëllimi mbetet të certifikohen të gjitha.

- Hartimi i Procedurave Standarde të Veprimit/SOP në agjencitë shërbim-ofruese

Hartimi i Procedurave Standarde të Veprimit për të gjitha shërbimet siguron për qytetarin dhe biznesin një përvojë të njëtrajtshme, të parashikueshme dhe me cilësi të lartë gjatë marrjes së tyre, pavarësisht se cili është institucioni përgjegjës apo kanali i përdorur. Kjo nënkupton, nga njëra anë, standarde të përbashkëta shërbimi bazuar në parimet e kujdesit për klientin dhe nga ana tjetër, procedura pune të përcaktuara qartë në të gjitha institucionet e administratës shtetërore.

SOP do të hartohen fillimisht në disa agjenci shërbim-ofruese. Këto agjenci janë ato agjenci që janë përzgjedhur për t'u pajisur me certifikatën ISO 9001, në bazë të numrit të shërbimeve që ofrojnë. ADISA do të përfshihet në proces.

Kalendari i punës për hartimin e *Hartimi i Procedurave Standarde të Veprimit* do të bëhet nga vetë agjencitë.

- Trajnim dhe forcim kapacitetesh

Rritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve kërkon angazhimin e vazhdueshëm të punonjësve të administratës publike në trajnime të personalizuara dhe rritje kapacitetesh. Do të synohet gjatë trajnimeve të rriten aftësitë e tyre në përdorimin e mjeteve inovative, platformave dhe cilësisë së kryerjes së detyrës.

Çdo punonjës i administratës publike i lidhur me fushën e ofrimit të shërbimeve do të pajiset edhe me aftësi të menaxhimit të riskut dhe qëndrueshmërisë për t'iu përshtatur rrethanave të reja që mund të paraqiten.

- Hartimi i treguesve kryesorë të performancës për agjencitë shërbim-ofruese

Treguesit kryesorë të performancës janë statistika që përdoren për të monitoruar dhe për të matur efektivitetin e çdo agjencie shërbim-ofruese. Megjithëse disa prej tyre janë pothuajse universale, agjencitë do të ftohen të propozojnë edhe treguesit e tyre kryesorë të performancës.

- Funksionimi i sistemit të performancës

Statistikat e prodhuara do të shërbejnë për të dhënë një panoramë të agjencive shërbim-ofruese.

TREGUESI	LLOGARITJA
Lehtësia e shërbimit ndaj qytetarit	# i ankesave për 100 kërkesa të X shërbimi # i kërkesave të refuzuara për 100 kërkesa
Cilësia e shërbimit	# i gabimeve për 100 kërkesa nga institucioni # i yjeve raportuar për shërbimet *online*
Korrupsioni/çështje të etikës profesionale	% e kërkesave që trajtohen sipas radhës (FIFO)

	# i ankesave për korrupsion/çështje etike lidhur me X shërbim
Respektimi i afateve ligjore	Koha mesatare e lëvrimit të një shërbimi X, nga kërkesa te lëvrimi % e kërkesave të lëvruara brenda afateve ligjore
Përgjigjshmëria (FCR)	# i kërkesave që marrin përgjigje që në kontaktin e parë
Transparenca	# Numri i shërbimeve vendosur edhe në faqet web e agjencive
Aksesueshmëria	# i kërkesave digjitale/bashki/1000 banorë sipas rezidencës së kërkuesit % e përputhjes së profilit të "përdoruesit" me qytetarin për të cilin është hartuar shërbimi

- Hartimi i instrumenteve të BI-së në çdo agjenci shërbim-ofruese

Instrumentet e ashtuquajtura BI-*Bussiness Intelligence* janë aplikacione të zhvilluara në sistemet elektronike dhe synojnë të përpunojnë ose kombinojnë të dhënat e disponueshme të sistemit për të informuar përdoruesin me një sërë treguesish të përmbledhur. Pra, nëse një mjet BI do të zbatohej mbi të dhënat e menaxhimit të shërbimit, ankesave etj., ky mjet mund të nxirrte lehtësisht informacione të rëndësishme për një shërbim të caktuar. Këto instrumente inteligjente do të garantonin plotësimin pothuajse automatikisht të të dhënave sasiore të kërkuara nga indeksi i matjes së cilësisë.

- Ndjekja e parimeve të Qeverisjes së Mirë

Parimet e Qeverisjes së Mirë do të monitorohen përsëri nga OECD-SIGMA për periudhën e mëtejshme. Institucionet e administratës publike shqiptare do të jenë të angazhuara për t'ju përgjigjur pyetësorit të vlerësimit të hartuar nga OECD-SIGMA. Burimet e informacionit do të përfshijnë, gjithashtu, të dhëna administrative, si dhe statistika të mbledhura nga të gjitha institucionet.

Vlerësimi do të bëhet mbi bazën e një grupi treguesish, që aplikohen për të matur arritjet në reforma (kuadri ligjor, politikat dhe procedurat si dhe burimet njerëzore dhe funksionimi/ performanca në administratën publike).

3.6. Planifikimi i ndërhyrjeve

Ndërhyrjet e parashikuara më sipër kanë shkallë të ndryshme kompleksiteti, çka ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në kohën e fillimit të tyre, kohëzgjatjen dhe përpjekjet e nevojshme për t'i zbatuar ato. Në tabelën e mëposhtme kategoritë e ndërhyrjeve, së bashku me nënkategoritë e evidentuara janë renditur sipas nivelit të kompleksitetit, nga më i ulëti tek më i larti, në bazë të katër parametrave në vijim[11]:

i. Shtrirja: që ka të bëjë me madhësinë dhe diapazonin relativ të çdo ndërhyrjeje e që është në përpjesëtim të drejtë me nivelin e kompleksitetit;

ii. Objekti: që ka të bëjë me detyrat dhe veprimtaritë të cilat duhen kryer për zbatimin me sukses të një ndërhyrjeje e që është në përpjesëtim të drejtë me nivelin e kompleksitetit;

iii. Varësia: që ka të bëjë me numrin e faktorëve nga të cilët është e varur një ndërhyrje e që është në përpjesëtim të drejtë me nivelin e kompleksitetit;

iv. Gatishmëria: që ka të bëjë me hapat e hedhur tashmë nga qeveria shqiptare për zbatimin e një ndërhyrjeje e që është në përpjesëtim të zhdrejtë me nivelin e kompleksitetit.

[11] Çdo ndërhyrje është vlerësuar në momentin e përgatitjes së kësaj DPA-je, sipas nivelit "i ulët", "mesatar" ose "i lartë" për çdo parametër, duke e krahasuar me të tjerat dhe duke përcaktuar kështu një renditje relative. Niveli i kompleksitetit në total është përllogaritur, si një mesatare e nivelit individual të kompleksitetit që lidhet me katër parametrat e identifikuar.

#	Ndërhyrjet/ parimet bazë	Parametrat e kompleksitetit				Niveli i kompleksitetit
		Shtrirja	Objekti	Varësia	Gatishmëria	
1	Miratimi i standardeve minimale	E lartë	I lartë	E ulët	E lartë	Mesatar
2	Hartimi i metodologjisë së matjes së cilësisë së shërbimeve	E lartë	I lartë	E ulët	Mesatare	E lartë
3	Marrja e opinioneve të qytetarëve dhe bizneseve	E lartë	I ulët	Mesatare	Mesatare	Mesatare
4	Pilotimi i ISO në disa agjenci shërbim-ofruese	Mesatare	Mesatar	Mesatare	Mesatare	Mesatar
5	Hartimi i SOP në agjencitë shërbim-ofruese që pajisen me ISO	Mesatare	Mesatar	Mesatare	Mesatare	Mesatar
6	Trajnim dhe forcim kapacitetesh	E lartë	Mesatar	E ulët	E lartë	Mesatare
7	Hartimi i KPI për agjencitë shërbim-ofruese	Mesatare	I lartë	E ulët	E lartë	Mesatare
8	Funksionimi i sistemit të performancës së agjencive shërbim-ofruese/punonjësve	Mesatare	I lartë	E ulët	E lartë	Mesatare
9	Hartimi i instrumenteve të BI-së	Mesatare	I lartë	E lartë	E lartë	I lartë
10	Ndjekje e parimeve të Qeverisjes së Mirë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	I lartë

4. MBËSHTETJE PËR ZBATIM

4.1 Strukturat drejtuese dhe zbatuese

Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve në zbatim të fushës së përgjegjësisë po harton këtë dokument strategjik. Gjithashtu, ai është përgjegjës dhe për:

a) sigurimin e standardeve në ofrimin e shërbimeve publike;

b) rritjen e cilësisë së shërbimeve në çdo sektor publik;

c) lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike;

ç) rritjen e efektivitetit të shërbimeve për të garantuar aksesin e qytetarëve në marrjen e shërbimeve publike.

Gjithashtu, ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve koordinon dhe, rast pas rasti, udhëheq procesin e riinxhinierimit dhe derregullimit, me qëllim thjeshtimin, rritjen e eficiencës dhe të efikasitetit të shërbimeve publike të ofruara nga institucionet e administratës shtetërore.

Prej vitit 2022, pjesë e përgjegjësive të ministrit është dhe përmbushja e parimeve të Qeverisjes së Mirë.

Përgjegjësinë për procesin e monitorimit të ofrimit të shërbimeve e kanë institucionet e mëposhtme:

- Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) – Me ligjin 107/2021, "Për bashkë-qeverisjen", Agjencia për Dialog dhe Bashkë-qeverisje ka marrë një rol më të madh në monitorimin e ofrimit të shërbimeve;

- ADISA: Që nga data 1 maj 2022, personeli i ADISA-s në bashkëpunim me ADB-në po kryejnë operacione të përditshme për menaxhimin e ankesave në platformën *online*, në nivel qendror dhe lokal, si dhe në monitorimin e SQDNE-së.

- AKSHI përgatit raportin për digjitalizimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre, si të dhënat për numrin dhe përqindjen e aplikimeve *online*, nëpërmjet portalit *e-Albania*.

- Departamenti i Administratës Publike: është përgjegjës, për:

a) menaxhimin dhe zbatimin e shërbimit civil administratën qendrore;

b) hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e pagave dhe zhvillimin e institucioneve;

c) hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të përgjithshme të trajnimit të zbatueshme për administratën publike në përgjithësi.

Trajnimi dhe rritja e kapaciteteve të nëpunësve civilë është përgjegjësi e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).

4.2 Modelet e financimit

Modelet e financimit për përmirësimin e standardeve të shërbimeve administrative, me në qendër qytetarin dhe biznesin, konsistojnë në:

- Financim nga buxheti i shtetit;
- Financim nga partnerët e zhvillimit.

Partnerët e zhvillimit, si: Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe Kombet e Bashkuara etj. do të mbështesin me asistencë teknike dhe ndërhyrje të drejtpërdrejta.

4.3 Monitorimi dhe vlerësimi (M&V)

Monitorimi dhe vlerësimi do të luajnë një rol vendimtar në matjen e ndikimit të politikave të reformës së ofrimit të shërbimeve me qendër qytetarin, vlerësimin e arritjes së objektivave dhe identifikimin e drejtimeve kryesore për përmirësime në nivel politikash. Si pjesë e procesit të M&V, do të prodhohen rregullisht raporte vjetore të bazuara në kornizën e rezultateve dhe treguesit përkatës që përshkruajnë edhe strategjitë e miratuara. Ato do të mbulojnë progresin e zbatimit të ndërhyrjeve të parashikuara, si dhe aspektet e buxhetimit ose rishpërndarjes së buxhetit.

Nga pikëpamja e përgjithshme strategjike, dokumenti i politikave do të rishikohet dhe rivlerësohet në baza trevjeçare, duke u mbështetur në vlerësimin e ndikimit si një instrument, i cili do të ndihmojë në vlerësimin nëse qëllimet e përcaktuara janë përmbushur, si dhe do të udhëzojë e detajojë më tej hapat e mëtejshëm.

Ky vlerësim do të jetë, gjithashtu, instrumental në identifikimin dhe përcaktimin sasior të ndikimit social të reformës.

4.4 Komunikimi dhe angazhimi i aktorëve

Strategjia e komunikimit do të trajtojë aspektet e mëtejshme të reformës së ofrimit të shërbimeve me qendër qytetarin, duke synuar publikun e gjerë dhe punonjësit e institucioneve:

Rritja e ndërgjegjësimit dhe informacionit për vizionin, objektivat dhe rezultatet;

- Ndërtimi i mbështetjes për ndryshime, d.m.th. procese të riinxhinieruara, kanale të reja dhe të transformuara të ofrimit të shërbimeve etj.;
- Krijimi i besimit te qytetarët që ndërveprojnë me institucionet qeveritare për përdorimin e teknologjisë dhe shërbimeve elektronike;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i shkëmbimit të informacionit;
- Angazhimi i qytetarëve, si përfituesit kryesorë, në proceset e reformës dhe motivimi i punonjësve për të kontribuar në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme në arritjen e objektivave.

Në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur, Shqipëria punon me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë për të pasur një qeverisje më të hapur, më të përgjegjshme dhe më llogaridhënëse për qytetarët. Pjesëmarrja e publikut e përmirëson cilësinë e shërbimeve publike, ku çdonjëri ka të drejtën e reagimit dhe agjencitë shërbim-ofruese duhet ta marrin në konsideratë dhe ta përshtatë në praktikën e punës.

Qeveria e Shqipërisë do të vazhdojë të zbatojë një platformë të gjerë të angazhimit të përfituesve, me konsideratën e duhur për pjesëmarrjen e grupeve të pafavorizuara dhe vulnerabël, për të siguruar reagime dhe kontribute në aspektin e politikave, si dhe në prioritizimin dhe vlerësimin e ndërhyrjeve.

ANEKS 1
LIDHJA PARIM–DIMENSION–TREGUES–NËNTREGUES

PARIME	***DIMENSIONE***	***TREGUES***	***NËNTREGUES***
PËRQENDRIMI TE PËRDORUESI	***Aksesueshmëria:*** Sipas parimit që të gjithë qytetarët duhet të kenë akses të barabartë në shërbime, treguesit nën këtë dimension matin nivelin e aksesueshmërisë *online* dhe fizike (për shërbimet ku kontakti fizik është i nevojshëm). *E-Albania* është i vetmi kanal aksesi përmes të cilit duhet të kalojnë të gjitha aplikimet për shërbime. Prandaj, për këtë qëllim, në këtë portal duhet të renditen të gjitha shërbimet e një institucioni. Disponueshmëria e informacionit që lejon përdoruesit e shërbimit të gjejnë lehtësisht kanalet (fizike ose *online*) për të hyrë në shërbim.	1. Njohja e nevojave të përdoruesve. 2. Zgjidhja e problemeve të përdoruesit. 3. Ofrimi i përgjigjeve standarde. 4. Ofrimi i shërbimit të shpejtë. 5. Sigurimi i përdorimit të mundshëm nga të gjithë.	1.1 Kartela e Shërbimeve është publike në *web.* 1.2 Shërbimi është i aksesueshëm nëpërmjet platformës *e-Albania.* 1.3 Shërbimi gjendet lehtësisht në w*eb,* duke kërkuar me fjalët çelës deri në tri klikime.
			2.1 Ekziston një sistem që informon qytetarin mbi statusin e kërkesës/ose ekziston mundësia e gjurmimit nga vetë qytetari. 2.2 Procedurat Standarde të Veprimit që lidhen me shërbimin janë të mirëpërcaktuara.
			3.1 Shërbimi kudo në *web* ka një link te portali *e-Albania.* 3.2 Të dhënat e hapura të shërbimit janë publike në opendata.gov.al.
			4.1 Shërbimi mund të asistohet nëpërmjet telefonit. 4.2 Shërbimi mund të gjurmohet.
			5.1 Shërbimi merret në disa pajisje, si: *laptop*, celular, *tablet*. 5.2 Disponueshmëria e mekanizmave asistues për kërkesat *online* (guida, FAQ apo *text-to speech*).
	***Eficienca*:** Treguesit e performancës së shërbimit janë krijuar për të matur shkallën e reagimit të shërbimit ndaj nevojave të përdoruesve të tij. Në këtë kuptim, një shërbim do të quhet eficient nëse është i aksesueshëm *online*, pa shumë dokumente të nevojshme, pa ridrejtim, me një numër të ulët refuzimesh etj.		
	1. ***Transparenca*:** Disponueshmëria e 2. informacionit në lidhje me shërbimin për kohën e ofrimit të shërbimit, mënyrat për të hyrë në shërbim, tarifat e shërbimit, mekanizmate ankesave. Për barometrin, një shërbim është transparent nëse informacioni për të është publik, i plotë, i përditësuar dhe i njëjtë në të gjitha kanalet. Gjithashtu, informacioni nëlidhje me shërbimet duhet të jetë i njëjtë në të gjitha kanalet e komunikimit me publikun.		

SHËRBIM I MIRË	***Përgjigjshmëria*:** Pajtueshmëria me afatin ligjor të një shërbimi konsiderohet kur "koha që duhet nga aplikimi deri në ofrimin e shërbimit" është më e ulët ose e barabartë me kohën e përcaktuar me ligj. Nga një perspektivë me qytetarin në qendër, shpërndarja në kohë është gjithashtu e bashkë-projektuar/përcaktuar nga/me përdoruesit.	6. Lëvrim i shërbimit të shpejtë. 7. Unifikimi dhe përmirësimi në mënyrë të vazhdueshme. 8. Mbrojtja e të dhënave personale. 9. Matja e performancës.	6.1 Shërbimi ofrohet sipas afatit ligjor. 6.2 Implementimi i një sistemi, që mund të lejojë qytetarin të kontrollojë vetë statusin e aplikimit nëpërmjet numrit të aplikimit
			7.1 *Web Analytics* 7.2 Zgjidh një nga metodat për menaxhimin e shpejtë të shërbimeve (*Csrum, Camban, Lean* etj.)
			8.1 Sitet e institucioneve e kanë ndërtuar faqen sipas parimeve të mbrojtjes së të dhënave. 8.2 Siguria e shërbimit në institucion duhet të jetë e ndarë në formë hierarkike. 8.3 Mbro shërbimin nga *fraud*. 8.4 Puno me *cookies* ose me teknologji të ngjashme. 8.5 Testo dobësitë përkarshi ndërhyrjeve
			9.1 Procedurat Standarde të Veprimit që lidhen me shërbimin janë të mirëpërcaktuara. 9.2 Hartimi nga çdo agjenci shërbim-ofruese i IKP (Indikatorët Kyç të Performancës)
	Mbrojtja e të dhënave: Projektuar për të matur shkallën e përputhshmërisëme legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale gjatë gjithë ciklit të përpunimit të të dhënave të kryera me mjete të automatizuara ose manuale. Kjo përfshin: mbledhjen e të dhënave, mjaftueshmërinë (vetëm të dhënat e nevojshme) dhe përshtatshmërinë, regjistrimin e të dhënave, ruajtjen e të dhënave, konsultimin dhe ndryshimin e të dhënave, përpunimin e të dhënave për qëllime historike dhe statistikore, transmetimin dhe shkëmbimin e të dhënave, përpunimin e të dhënave		
	3. ***Mekanizmat e Monitorimit dhe Korrektimit*:** Mat shkallën në të cilën institucionet "investojnë" ose kanë investuar në mekanizmat e brendshëm të monitorimit për të përmirësuar cilësinë në ofrimin e shërbimeve publike. 4. Institucionet pritet të kenë hartuar dhe monitoruar matjet e KPI për matjen e performancës së vetë institucionit në lidhje me shërbimin që ofron. Metrikat e kërkuara si analiza e kostos/		

	shërbimit, përqindja e shërbimeve të ofruara brenda afatit, analiza e përdoruesve të tyre do të mundësonte hartimin e politikave apo strategjive institucionale me qytetarin në qendër.		
	5. ***Gjurmueshmëria*:** I referohet disponueshmërisë së informacionit që lejon përdoruesin të gjurmojë shërbimin përmes të gjithë zinxhirit të ofrimit të shërbimit nga aplikimi në dorëzim. Informacioni i dhënë duhet të jetë në gjendje t'u përgjigjet pyetjeve: Çfarë po ndodh? Kur do ta marr shërbimin?, Ku është aplikimi, në çfarë faze? dhe Pse u refuzua?).		
TEKNOLOGJIA E DUHUR/MUNDËSUESIT KRYESORË	***Digjitalizimi:*** Mat nivelin e digjitalizimit të shërbimeve publike, zbatimin e sistemeve të TI-së, ndërveprimin me *e-Albania* ose sisteme të tjera. Si mundësues i modernizimit janë konsideruar edhe Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) dhe për këtë qëllim janë përfshirë indikatorët që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e tyre.	10. Zgjedhja e teknologjisë së përshtatshme. 11. Hapja e kodeve burimore. 12. Përdorim në standarde të hapura komponentë dhe modele të përbashkëta.	10.1 Minimizimi i kostove duke eliminuar ofrues të veçantë. 10.2 Agjencitë bëjnë një analizë të kostos për shërbim. 10.3 Përdorimi i komponentëve të standardeve të teknologjisë qeveritare sa herë që është e mundur. 10.4 Përdorimi i ndërfaqeve të aplikacioneve. 10.5 Sigurimi i kontrollit mbi të dhënat, që ruhen në bazën e të dhënave.
			11.1 Shkëmbimi i të dhënave midis shërbimeve dhe sistemeve. 11.2 Ripërdorimi i komponentëve të *software*-ve të ndërtuar më pare. 11.3 Ulja e kostove të shërbimeve digjitale 11.4 Ndryshimi i herëpashershëm i hartimit të shërbimit për ta lehtësuar.
			12.1 Përdorimi i shtatë parimeve të zgjedhjes së standardeve të hapura - Plotësimi i nevojave të përdoruesve. - Akses të barabartë për ofruesit në kontratat qeveritare. - Mbështetje për fleksibilitet dhe ndryshim. - Ofrimi i kostove të pranueshme etj.
LËVIZSHMËRIA NDËRKUFITARE	**Lëvizshmëria**: Sa lehtë mund t'i qasen dhe përdorin shërbimet *online* qytetarët nga jashtë	13. Krijimi i skuadrave mulitifuksionale. 14. Forcimi i besimit te shërbimi. 15. Ndërveprimi me agjencitë shërbim-ofruese.	13.1 Krijimi i skuadrave me ekspertizë mbi dhënien e shërbimeve *online* dhe fizike, *back-end-system* dhe *front offices* 13.2 Përcaktimi/dhënia e rolit për çdo anëtar të skuadrës (menaxheri i produktit, pronari i

			shërbimit, menaxheri i dërgesave, përdorues, hartues i përmbajtjes, projektues dhe zhvillues)
			14.1 Përqindja e aplikimeve të sakta. 14.2 Përqindja e ankesave të zgjidhura. 14.3 Përqindja e kërkesave, që janë trajtuar sipas radhës FIFO. 14.4 Sistemi IT funksionon në 99% të kohës.
			15.1 Statistika javore SQDNE. 15.2. Nisma mujore "nota ime". 15.3 Agjencitë monitorojnë në mënyrë periodike PSV.

ANEKS 2
FJALOR I TERMAVE DHE I PËRKUFIZIMEVE

BI-Business Intelligence	Është procesi nëpërmjet të cilit, institucionet përdorin strategji dhe teknologji për analizimin e të dhënave aktuale dhe historike me objektiv përmirësimin e procesit të vendimmarrjes dhe si rrjedhim performancën në sektorin e shërbimeve publike.
Dimension	Një "Dimension" përfaqëson ose është një grup cilësish të klasifikueshme të shërbimit, dhe llogaritet si funksion i një ose disa treguesve specifikë, p.sh.: Transparenca, Aksesueshmëria etj.
Digjital që në hartim	Administrata publike duhet të përfshijë digjitalizimin në planet dhe proceset e saj, që në krye të herës, për të shfrytëzuar plotësisht potencialin e saj, për të lehtësuar dhe transformuar hartimin dhe ofrimin e shërbimeve, pavarësisht nga kanali i zgjedhur.
Efikasiteti dhe afati kohor	Shërbimi duhet të jetë i aksesueshëm në një kohë dhe vend, sipas nevojës së përdoruesit (brenda arsyes) dhe të përfundohet me sa më pak hapa që të jetë e mundur.
Korniza e përbashkët e vlerësimit	Një mjet menaxhimi për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e performancës për institucionet e sektorit publik.
Indeksi i cilësisë së shërbimit	Një instrument i menaxhimit të cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet të cilit do të matet dhe monitorohet niveli i performancës së agjencive shërbim-ofruese dhe cilësia e shërbimeve që ato ofrojnë. Me matjen e cilësisë së shërbimeve pritet të përmirësohet cilësia e shërbimeve të ofruara për qytetarët.
ISO 9001	Standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë (QMS). Agjencitë shërbim-ofruese përdorin standardin për të demonstruar aftësinë për të ofruar vazhdimisht shërbime publike që plotësojnë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve dhe bizneseve.
Life-events-ngjarje/ndodhi të jetës	Janë ngjarje që kanë një ndikim të rëndësishëm në jetën e një qytetari/pale të interesuar dhe që garantojnë ndërgjegjësimin ose përfshirjen e Qeverisë. Një ngjarje e jetës mund të jetë lindja e një fëmije, lidhja e martesës, ndarja nga jeta, ndryshimi i statusit të punësimit, një lëndim ose sëmundje serioze, një blerje shtëpie ose ndjekja e një cikli shkollimi.
Llogaridhënia	Institucionet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë transparente dhe me përgjegjësi. Përdoruesit e shërbimeve duhet të njoftohen mbi vendimin e institucionit publik së bashku me arsyetimin përkatës dhe në çdo rast duhet të njihet e drejta për të ushtruar të gjitha mjetet e ankimit për kundërshtimin apo rishikimin e tij.
Ndërveprimi	Aftësia e institucioneve për të bashkëvepruar drejt qëllimeve të dobishme reciproke, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit dhe njohurive ndërmjet këtyre institucioneve, nëpërmjet proceseve të biznesit që ato mbështesin, me anë të shkëmbimit të të dhënave ndërmjet sistemeve të tyre TIK.
Ofrimi i shërbimit	Të gjitha kontaktet me administratën publike gjatë të cilave përdoruesit/qytetarët dhe bizneset (kërkojnë ose japin të dhëna, gjejnë zgjidhje për çështjet dhe plotësojnë detyrimet e tyre.
Përdoruesi i shërbimit	Termi ombrellë që përfshin qytetarët, bizneset dhe institucionet e tjera, të cilave mund t'i

	referohemi edhe si "përdorues" ose "klientë", por duke qenë se qeveria përfaqëson dheu shërben qytetarëve preferohet përdorimi i termit më neutral "përdorues i shërbimit".
Përqendrimi drejt përdoruesit	Hartimi dhe ofrimi i shërbimit duhet të kryhet për lehtësinë e përdoruesit, e cila fillon me të kuptuarit e nevojave (të ndryshme) të qytetarëve dhe bizneseve dhe duke u mundësuar atyre të aksesojnë një shërbim të personalizuar, dhe të rregullohen me ndryshimin e nevojave dhe rrethanave në bazë të reagimeve.
Procedurat standarde të veprimit	Procedura Standarde e Veprimit (PSV) është një procedurë specifike ose një grup udhëzuesish e procedurash që dokumentojnë një aktivitet a proces rutinë ose përsëritës pune që kryhet brenda një ose në një situatë të caktuar për të rritur cilësinë, duke ndjekur një procedurë të standardizuar të punës.
Qeverisja elektronike dhe digjitale	Qeverisja elektronike përfshin zëvendësimin e sistemeve të bazuara në letër me sisteme kompjuterike, automatizimin e proceseve të brendshme dhe kalimin e ndërveprimeve *online*. Qeveria digjitale përfshin shfrytëzimin e fuqisë së teknologjisë dhe të dhënave për të përmirësuar administratën publike (strukturat, kulturën, aftësitë, proceset) dhe hartimin dhe ofrimin e shërbimeve për të përmbushur më mirë nevojat e qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve të tjera, ato *online* ose *offline*.
Sistemi i qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik	Sistem, i cili mundëson komunikimin dhe shkëmbimin e dokumenteve shoqëruese të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimit/aplikimit.
Shërbimet digjitale	Shërbimet që përdorin teknologjinë digjitale, të cilat zakonisht kanë tre komponentë kryesorë: ofruesin e shërbimit, marrësin e shërbimit dhe kanalet e ofrimit të shërbimit (teknologjinë).
Shërbimet publike	Shërbimet publike mund të kuptohen si të gjitha ndërveprimet midis Qeverisë dhe qytetarëve, bizneseve dhe përdoruesve të tjerë të shërbimeve, qoftë drejtpërdrejt ose me përfaqësues nëpërmjet një ndërmjetësi.
Shërbime administrative	Një term ombrellë për dhënien/transferimin e informacionit ose financave nga administrata publike, duke përfshirë kërkesat, aplikimet, njoftimet, dokumentacionet, regjistrimet, deklaratat, vendimet, lejet, refuzimet, vërtetimet, licencimet, pagesat dhe arkëtimet e fondeve.
Standard	Një specifikim teknik i miratuar nga një entitet i njohur standardizimi, për zbatim të përsëritur ose të vazhdueshëm për të cilin pajtueshmëria nuk është e detyrueshme.
Standardi minimal i shërbimit	Një grup karakteristikash që i detyron ofruesit e shërbimeve të përmbushin detyrimet minimale ndaj qytetarëve në shërbimet që ofrojnë.
Transparencë	Shërbimi duhet të jetë i aksesueshëm dhe përmes të gjitha modaliteteve (*offline* dhe *online)* për të gjithë përdoruesit që kanë të drejtë, janë të kualifikuar ose të detyruar ta marrin atë, pa dallim. Për të demonstruar trajtim të barabartë, baza mbi të cilën merren vendimet dhe ofrohen shërbimet nga administrata publike duhet të jetë e qartë si për përdoruesin e shërbimit, ashtu edhe për vetë administratën, bazuar në informacionin e disponueshëm publikisht, për të shmangur vendimmarrjen arbitrare dhe abuzimin e diskrecionit.
Treguesit kyç të performancës	Treguesit kyç të performancës ofrojnë një fokus për përmirësimin strategjik dhe operacional, krijojnë një bazë analitike për vendosjen e objektivave (nivelin e dëshiruar të performancës) dhe ndjekjen e progresit kundrejt atij objektivi.
Parimi "Vetëm një herë"	Një shtrirje logjike e parimit të proporcionalitetit, administrata publike duhet të vendosë sisteme dhe rregullime të tjera për të siguruar që qytetarëve dhe bizneseve nuk u kërkohet të ofrojnë të njëjtat informacione më shumë se një herë për çdo organ publik në çdo nivel të qeverisjes.

URDHËR
Nr. 5, datë 4.1.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 854, DATË 31.12.2021, "PËR DELEGIM KOMPETENCASH", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të pikës 2, të nenit 73, kreu IX, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.5.2020, "Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore", i ndryshuar, dhe të udhëzimit nr. 269, datë 11.8.2020, të ministrit të Kulturës, "Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në pikën 2, të urdhrit nr. 854, datë 31.12.2021, "Për delegim kompetencash", i ndryshuar, togfjalëshi *"deri më 31.12.2022"* zëvendësohet me togfjalëshin *"deri më 31.12.2023"*.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

URDHËR
Nr. 42, datë 27.3.2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË PËRBASHKËTA TË AJRIT DHE DISPOZITAT OPERACIONALE NË LIDHJE ME SHËRBIMET DHE PROCEDURAT NË LUNDRIMIN AJROR[1]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 81, të ligjit nr. 96/2020, datë 23.7.2020, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" dhe në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Urdhri i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 327, datë 29.8.2019, "Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror", i ndryshuar dhe urdhri nr. 252, datë 15.9.2014, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave mbi cilësinë e të dhënave aeronautike dhe të informacionit aeronautik", shfuqizohen.

[1] Ky urdhër përafron plotësisht Rregulloren e Zbatimit (BE) nr. 923/2012 e datës 26 shtator 2012, për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror, ndryshon Rregulloren e Zbatimit (BE) nr. 1035/2011, rregulloret (KE) nr. 1265/2007, (KE) nr. 1794/2006, (KE) nr. 730/2006 (KE) nr. 1033/2006 dhe (BE) nr. 255/2010; e ndryshuar nga Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 2015/340 dhe Rregullore e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2016/1185, nr. 2020/469 (ndryshuar nga Rreg. nr. 2020/1177) dhe Rregullore e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2021/666, botuar në Fletoret Zyrtare të BE-së: L 281, datë 13.10.2012; L 63, datë 6.3.2015, L 196, datë 21.7.2016, L 104, datë 3.4.2020 dhe L 139, datë 23.4.2021.

3. Ngarkohet Autoritetit i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
MBI PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË PËRBASHKËTA TË AJRIT DHE DISPOZITAT OPERACIONALE NË LIDHJE ME SHËRBIMET DHE PROCEDURAT NË LUNDRIMIN AJROR

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë rregullat e përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror që janë të zbatueshme për trafikun ajror të përgjithshëm brenda fushëveprimit të udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin nr. 7, datë 3.6.2010, "Mbi organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore brenda qiellit të vetëm Evropian", apo çdo përditësimi të tij në fuqi në kohën e zbatimit.

2. Kjo rregullore do të zbatohet në mënyrë të veçantë për përdoruesit e hapësirës ajrore dhe avionët të angazhuar në trafik ajror të përgjithshëm:

a) që operojnë nga, brenda apo për në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) që kanë kombësi dhe shenjat e regjistrimit të Republikës së Shqipërisë, që operojnë në çdo hapësirë ajrore për aq kohë sa ato nuk bien në kundërshtim me rregullat e publikuara nga shteti që ka juridiksionin në territorin mbi të cilin po kryhet fluturimi.

3. Kjo Rregullore do të zbatohet gjithashtu nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC), si autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë, Ofruesit e Shërbimeve të Lundrimit Ajror (OSHLA), operatorët e aerodromeve dhe personeli përkatës në tokë i angazhuar me operimet e avionëve.

4. Kjo rregullore nuk do të jetë e zbatueshme për avion model dhe avion lodër. Megjithatë, Autoriteti i Aviacionit Civil do të bashkëpunojë në përshtatjen e rregullave kombëtare që do të garantojnë operimin e mjeteve fluturuese model dhe lodër në një mënyrë të tillë që do t'i minimizojë rreziqet e lidhura me sigurinë e aviacionit civil, me njerëzit, pronën ose mjetet e tjera fluturuese.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllim të kësaj rregulloreje do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "**Adresa e avionit**" nënkupton një kombinim të veçantë të 24 bit në dispozicion për caktimin ndaj një mjeti fluturues me qëllim të komunikimeve tokë-ajër, lundrimit dhe mbikëqyrjes;

2. "**Aeroplan**" nënkupton një mjet fluturues me fuqi shtytëse, më i rëndë se ajri, që arrin të ngrihet kryesisht nga reagimet aerodinamike në sipërfaqe të cilat mbeten të fiksuara sipas kushteve të caktuara të fluturimit;

3. "**Aerodrom**" nënkupton një zonë të përcaktuar (duke përfshirë çdo ndërtesë, instalim dhe pajisje) në tokë ose ujë ose në një strukturë në det të hapur ose lundruese, i destinuar të përdoret plotësisht apo pjesërisht për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen mbi sipërfaqe të avionit;

4. "**Aerodrom alternativ**" (*alternate aerodrome)* nënkupton një aerodrom në të cilin një mjet fluturues mund të procedojë kur bëhet e pamundur ose e pakëshillueshme për të proceduar ose për t'u ulur në aerodromin e destinuar të uljes, ku shërbimet dhe infrastrukturat e nevojshme janë të disponueshme, ku kriteret e performancës së mjetit fluturues mund të arrihen dhe aerodromi është operacional në kohën që pritet të përdoret.

Aerodromet alternative përfshijnë si në vijim:

a) "aerodrom alternativ pas ngritjes" nënkupton një aerodrom alternativ në të cilën një mjet fluturues do të ishte në gjendje të ulet nëse kjo bëhet e nevojshme brenda një kohe të shkurtër pas nisjes dhe nuk është e mundur që të përdoret aerodromi i nisjes;

b) "aerodrom alternativ në fazën mbi kaluese" nënkupton një aerodrom alternativ në të cilën një mjet fluturues do të jetë në gjendje të ulet në rastin që një devijim bëhet i nevojshëm ndërkohë që është gjatë rrugëtimit;

c) "aerodrom alternativ pas uljes" nënkupton një aerodrom alternativ drejt të cilit mund të

procedojë një mjet fluturues nëse ulja në aerodromin e destinuar të uljes është e pamundur ose e pakëshillueshme.

5. "**Aerodrom i kontrolluar**" nënkupton një aerodrom në të cilin ofrohet shërbimi i kontrollit të trafikut ajror për trafikun e aerodromit;

6. "**Anëtar i ekuipazhit të fluturimit**" nënkupton një anëtar të licencuar të ekuipazhit të ngarkuar me detyra thelbësore për operimin e një avioni që nga momenti i marrjes së detyrës;

7. "**Autoritet kompetent**" nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil i caktuar në bazë të ligjit nr. 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e kësaj rregulloreje;

8. "**Avion i humbur**" (*strayed aircraft)* nënkupton një avion i cili ka devijuar në mënyrë të konsiderueshme nga trajektorja e destinuar ose që raporton se ka humbur;

9. "**Avion lodër**" (*toy aircraft)* nënkupton një mjet fluturues pa pilot e dizajnuar dhe me qëllimin për t'u përdorur, ekskluzivisht ose jo, për të luajtur nga fëmijët nën moshën 14 vjeç;

10. "**Avion model**" nënkupton një mjet fluturues pa pilot, jo mjet fluturues lodër, i cili ka përmasa operuese që nuk i tejkalojnë limitet e përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, që është në gjendje të fluturojë në mënyrë të qëndrueshme në atmosferë dhe që përdoret vetëm për shfaqje ose aktivitete rekreacionale;

11. "**Avion i paidentifikuar**" (*unidentified aircraft)* nënkupton një mjet fluturues i cili është vërejtur apo raportuar duke operuar në një zonë të caktuar, por identiteti i tij nuk është përcaktuar;

12. "**Baza e reve**" (*ceiling*) nënkupton lartësinë mbi tokë ose ujë, të bazës së shtresës më të ulët të resë nën 6 000 m (20 000 ft) që mbulon më shumë se gjysmën e qiellit;

13. "**Balonë e lirë pa pilot**" (*unmanned free balloon)* nënkupton një mjet fluturues pa fuqi shtytëse, pa pilot, më të lehtë se ajri, në fluturim të lirë;

14. "**E dhënë**" (*datum)* nënkupton çdo sasi ose grupin e sasive që mund të shërbejnë si referencë ose bazë për llogaritjen e sasive të tjera;

15. "**Fluturim aerobatik**" (*aerobatic flight*) nënkupton manovrat e kryera me qëllim nga një avion që përfshin një ndryshim të menjëhershëm në qëndrimin e tij, një qëndrim të parregullt, ose një ndryshim jo normal në shpejtësi, jo të nevojshme për fluturime normale ose për udhëzime për licencat ose kategoritë të ndryshme nga kategoritë aerobatike;

16. "**Fluturime të kontrolluara**" (*controlled flight*) nënkupton çdo fluturim i cili është subjekt i një leje nga kontrolli i trafikut ajror;

17. "**Fluturim IFR**" nënkupton një fluturim të kryer në përputhje me rregullat instrumentale të fluturimit;

18. "**Fluturim VFR**" nënkupton një fluturim të kryer në përputhje me rregullat e fluturimit vizual. Ky përkufizim do të ketë këtë kuptim në të gjitha aktet nënligjore në të cilat përdoret;

19. "**Fluturimi special VFR**" nënkupton një fluturim VFR të lejuar nga kontrolli i trafikut ajror për të vepruar brenda një zone të kontrollit në kushte meteorologjike poshtë VMC;

20. "**Hapësira ajrore këshilluese**" (*advisory airspace)* nënkupton një hapësirë ajrore të dimensioneve të përcaktuara ose rrugë të përcaktuara, brenda së cilës ofrohet shërbimi këshillues i trafikut ajror;

21. "**Hapësirë ajrore e kontrolluar**" (*controlled airspace)* nënkupton një hapësirë ajrore të dimensioneve të përcaktuara brenda të cilit shërbimet e kontrollit të trafikut ajror ofrohen në përputhje me klasifikimin e hapësirës ajrore;

22. "**Hapësirat ajrore të shërbimeve të trafikut ajror**" (*air traffic services (ATS) airspaces*) nënkupton hapësira ajrore me dimensione të përcaktuara, të dizajnuara sipas shkronjave të alfabetit, brenda të cilave mund të operojnë tipa specifikë fluturimesh, dhe për të cilët janë përcaktuar shërbimet e trafikut ajror dhe rregullat e operimit.

23. "**Helikopter**" nënkupton një mjet fluturues më të rëndë se ajri i cili fluturon kryesisht falë veprimeve të ajrit me një apo më shumë helika me fuqi shtytëse në akset vertikale;

24. "**Hapësirë ajrore mbi ujërat ndërkombëtare**" (*high seas airspace)* nënkupton hapësirën ajrore përtej territorit tokësor dhe ujërave detare, siç specifikohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit (Montego Bay, 1982);

25. "**IFR**" nënkupton simbolin e përdorur për përcaktimin e rregullave instrumentale të fluturimit. Ky shkurtim do të ketë këtë kuptim në të gjitha aktet nënligjore në të cilat përdoret;

26. "**IMC**" nënkupton simbolin e përdorur për përcaktimin e kushteve meteorologjike instrumentale;

27. "**Informacion** SIGMET" nënkupton informacionin e lëshuar nga një zyrë vëzhgimi meteorologjike në lidhje me ngjarjet ose ngjarjet e pritshme të fenomeneve specifike atmosferike në mbikalim të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e operimeve të avionëve;

28. "**Informacioni i trafikut**" nënkupton informacionin e dhënë nga një njësi e shërbimeve të trafikut ajror për të paralajmëruar një pilot për trafikun për të cilin ka informacion ose atë të vrojtuar dhe që mund të jetë në afërsi të pozicionit ose rrugës së fluturimit, për ta ndihmuar pilotin që të shmangë përplasjen;

29. "**Informacion AIRMET**" nënkupton një informacion të lëshuar nga një zyrë e vëzhgimit meteorologjik në lidhje me ngjarjet ose ngjarjet e pritshme të fenomeneve atmosferike të specifikuar në rrugë ajrore të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e operimeve të mjetit fluturues në nivel të ulët dhe i cili nuk ishte përfshirë në parashikimin e lëshuar për fluturimet në nivel të ulët në rajonin e informacionit të fluturimit përkatës ose nënzonën e tij;

30. "**Instruksion i kontrollit të trafikut ajror**" nënkupton instruksionet e lëshuara nga kontrolli i trafikut ajror për t'i kërkuar një piloti që të kryejë një veprim specifik;

31. "**Karburanti në minimum**" nënkupton një term i cili përdoret për të përshkruar një situatë në të cilën gjendja e karburantit të mjetit fluturues ka arritur në një nivel të tillë ku mjeti fluturues duhet të ulet në një aerodrom specifik dhe nuk lejohen më vonesa të tjera;

32. "**Këshillim për shmangien e trafikut**" (*traffic avoidance advice)* nënkupton një këshillë të dhënë nga një njësi e shërbimeve të trafikut ajror duke specifikuar manovrat për të ndihmuar një pilot që të shmangë një përplasje;

33. "**Kod (SSR)**" nënkupton numrin e vendosur për një sinjal të veçantë të shumëfishtë të kthimit të përgjigjes të transmetuar nga një transponder në Mode A ose Mode C;

34. "**Komunikimi tokë-ajër**" (*air-ground communication)* nënkupton dy rrugë komunikimi midis mjetit fluturues dhe stacioneve apo pozicioneve në sipërfaqen e tokës;

35. "**Kontratë marrëveshje (ADS-C) për mbikëqyrje automatike të ndërvarur**" (*automatic dependent surveillance-contract agrement)* nënkupton një plan raportimi i cili përcakton kushtet e raportimit të të dhënave ADS-C (të dhënat e kërkuara nga njësia e shërbimeve të trafikut ajror dhe frekuenca e raporteve ADS-C për të cilat duhet të bihet dakord përpara përdorimit të ADS-C në ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror);

36. "**Koha e udhëtimit nga një pikë në një pikë tjetër**" (*estimated elapsed time)* nënkupton kohën e parashikuar të nevojshme për të proceduar nga një pikë e rëndësishme në një tjetër;

37. "**Koha e parashikuar e fillimit të lëvizjes**" (*estimated off-block time)* nënkupton kohën e parashikuar në të cilën një avion do të fillojë lëvizjen me qëllim fillimin e nisjes;

38. "**Koha e parashikuar e mbërritjes**" (*estimated time of arrival (ETA*) në lidhje me fluturimet IFR nënkupton, kohën në të cilën është vlerësuar se avioni do të mbërrijë mbi atë pikë të caktuar, e përcaktuar duke iu referuar pajisjeve ndihmëse navigacionale, nga e cila është planifikuar fillimi i procedurës instrumentale të afrimit ose nëse nuk ka pajisje ndihmëse navigacionale në aerodrom, koha në të cilën avioni do të mbërrijë mbi aerodrom. Për fluturimet VFR, koha e parashikuar për mbërritjen e avionit mbi aerodrom;

39. "**Koha e parashikuar e afrimit**" (*expected approach time)* nënkupton kohën në të cilën Kontrolli i Trafikut Ajror pret që një avion në ardhje, pas një vonese, të lërë pikën e pritjes për të kompletuar afrimin e tij për ulje. Koha e lënies së pikës së pritjes do të varet nga dhënia e lejes së afrimit;

40. "**Koha totale e parashikuar e fluturimit"** (*total estimated elapsed time)* do të thotë:

a) për fluturimet IFR, koha e llogaritur e nevojshme nga ngritja për të arritur mbi atë pikë të caktuar, e përcaktuar duke iu referuar pajisjeve ndihmëse të navigimit, nga e cila është menduar që të fillojë një procedurë e afrimit instrumentale, ose, nëse nuk ka pajisje ndihmëse navigacionale të lidhura me aerodromin e destinuar, për të arritur mbi aerodromin e destinuar;

b) për fluturimet VFR, kohën e llogaritur të nevojshme nga ngritja për të arritur mbi aerodromin e destinuar;

41. "**Komunikimet me transmetim të dhënash pilot-kontrollor** (CPDLC)" *(controller-pilot*

data link communications (CPDLC) nënkupton një mënyrë komunikimi ndërmjet kontrollorit dhe pilotit, duke përdorur transmetim të dhënash për komunikimet e kontrollit të trafikut ajror;

42. "**Komunikimet me transmetim të dhënash"** (*data link communications*) nënkuptojnë një formë të komunikimit që kanë për qëllim shkëmbimin e mesazheve nëpërmjet data link;

43. "**Korridor këshillues**" (*advisory route)* nënkupton një korridor të përcaktuar përgjatë së cilës ofrohet shërbimi këshillues i trafikut ajror;

44. "**Korridor ATS/SHTA**" (*ATS route*) nënkupton një korridor specifik të dizajnuar për kanalizimin e fluksit të trafikut sipas nevojës për ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror;

45. "**Kufiri i lejes**" (*clearance limit*) nënkupton pikën për të cilën një avioni i është dhënë leje nga kontrolli i trafikut ajror;

46. "**Kursi**" (*heading)* nënkupton kursin në të cilin është drejtuar boshti gjatësor i avionit, zakonisht e shprehur në gradë nga veriu (i vërtetë, magnetike, busull ose rrjeti koordinativ);

47. "**Kulla e kontrollit të aerodromit"** (*aerodrome control tower*) nënkupton një njësi të caktuar për të ofruar shërbimin e kontrollit të trafikut ajror në trafikun e aerodromit;

48. "**Kushtet meteorologjike instrumentale** (IMC)" (*instrument meteorological conditions)* nënkupton kushtet meteorologjike të shprehura në terma të shikueshmërisë, distancës; nga reja dhe baza e reve, më pak se ndarja minimale e specifikuar për kushtet meteorologjike vizuale;

49. "**Kushtet meteorologjike vizuale**" (*visual meteorological conditions)* nënkupton kushtet meteorologjike të shprehura në terma të shikueshmërisë, të distancës nga reja dhe baza e reve, të barabarta me ose më të mira se minimumi i përcaktuar;

50. "**Lartësi tranzitore**" (*transition altitude)* nënkupton lartësinë në të cilën ose nën të cilën pozicioni vertikal i një mjeti fluturues kontrollohet duke iu referuar lartësive barometrike;

51. "**Lartësia gjeometrike**" (*height*) nënkupton distancën vertikale të një niveli, pike ose objekti të konsideruar si një pikë, e matur nga një e dhënë specifike;

52. "**Lartësi barometrike**" (*altitude*) nënkupton distancën vertikale të një niveli, një pike apo një objekti të konsideruar si një pikë, të matur nga niveli mesatar i detit (MSL);

53. "**Leja e Kontrollit të Trafikut Ajror**" (*air traffic control (ATC) clearance*) nënkupton autorizimin për një mjet fluturues që të vazhdojë operimin sipas kushteve të specifikuara nga një njësi e kontrollit të trafikut ajror;

54. "**Leje nga qendra pritëse**" (*downstream clearance*) nënkupton një leje të lëshuar për një avion nga një njësi e kontrollit të trafikut ajror që nuk është autoriteti kontrollues aktual i atij avioni;

55. "**Lundrim zonal** (RNAV)" (*area navigation (RNAV*) nënkupton një metodë lundrimi e cila lejon operimin e avionit në çdo rrugë të dëshiruar të fluturimit brenda mbulimit të pajisjeve navigacionale të vendosura në tokë ose hapësirë, ose brenda kufijve të kapacitetit së të pajisjeve të avionit, ose një kombinim të tyre;

56. "**Mbikëqyrje automatike e ndërvarur – me transmetim** (ADS-B)" (*automatic dependent surveillance — broadcast)*, nënkupton një mënyrë me anë të së cilës avionët, automjetet e aerodromit dhe objekte të tjera, mund të transmetojnë dhe/ose të marrin automatikisht të dhëna të tilla si identifikimi, pozicionimi dhe të dhëna shtesë, nëpërmjet transmetimit të të dhënave;

57. "**Mbikëqyrje automatike e ndërvarur – me kontratë** (ADS-C)" nënkupton një mënyrë me anë të së cilës kushtet e marrëveshjes ADS-C do të shkëmbehen ndërmjet sistemit të terrenit dhe mjeteve fluturuese, nëpërmjet një transmetimi të dhënash, që do të specifikojë kushtet për nisjen e raporteve ADS-C, dhe çfarë të dhënash do të përfshihen në raport;

58. "**avion**" (*aircraft)* nënkupton çdo mjet që përfiton mbështetje në atmosferë nga veprimet e ajrit, përveç veprimeve të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës;

59. "**Natë**" nënkupton orët ndërmjet fundit të muzgut dhe fillimit të agimit. Muzgu përfundon në mbrëmje kur qendra e diskut të diellit është 6 gradë nën horizont dhe fillon në mëngjes kur qendra e diskut të diellit është 6 gradë nën horizont;

60. "**Ngjitja optimale**" (*cruise climb*) nënkupton teknikën e ngjitjes së një avioni që rezulton në një rritje neto të lartësisë ndërkohë që pesha e avionit ulet.

61. "**Nivel**" nënkupton një term të përgjithshëm që ka lidhje me pozicionin vertikal të një avioni në fluturim dhe sipas rastit nënkupton, lartësi gjeometrike, barometrike apo nivel fluturimi;

62. "**Niveli i tranzitit**" (*transition level)* nënkupton nivelin më të ulët të fluturimit në dispozicion për përdorim mbi lartësinë e tranzicionit;

63. "**Niveli i lundrimit**" (*cruising level*) nënkupton një nivel fluturimi të ruajtur përgjatë një pjese të konsiderueshme të një fluturimi;

64. "**Niveli i fluturimit** (FL)" (*flight level (FL))* nënkupton një sipërfaqe me presion atmosferik konstant e cila është e lidhur me një të dhënë specifike presioni, 1 013,2 hectopaskals (hPa), dhe është e ndarë nga sipërfaqe të tjera nga intervale të caktuara të presionit;

65. "**Njësia e kontrollit të trafikut ajror"** (*air traffic control unit*) nënkupton një term të përgjithshëm i cili sipas rastit nënkupton, qendrën e kontrollit të zonës, njësinë e kontrollit të afrimit apo kullën e kontrollit të aerodromit;

66. "**Njësia e kontrollit të afrimit**" (*approach control unit)* nënkupton një njësi të krijuar për të ofruar shërbimin e kontrollit të trafikut ajror për fluturimet e kontrolluara që mbërrijnë në, apo nisen nga, një ose më shumë aerodrome;

67. "**Njësi e Shërbimeve të Trafikut Ajror-SHTA**" (*air traffic services (ATS) unit)* është një term i përgjithshëm që nënkupton, sipas rastit, një njësi të kontrollit të trafikut ajror, qendrën e informacionit të fluturimit, njësinë e shërbimit të informacionit të fluturimit të aerodromit apo zyrën e raportimit të shërbimeve të trafikut ajror;

68. "**Operimi me afrim me instrument**" (*instrument approach operation)* nënkupton një afrim dhe ulje duke përdorur instrumentet për guidë navigacionale bazuar në një procedurë afrimi instrumentale. Ekzistojnë dy metoda për ekzekutimin e operimeve të afrimit me instrument:

a) një operim i afrimit me instrument dydimensional (2D), duke përdorur vetëm gurdë navigacionale laterale; dhe

b) një operim i afrimit me instrument tri dimensione (3D), duke përdorur udhëzime navigacion ale laterale dhe vertikale.

69. "**Parashikim**" (*forecast)* nënkupton një deklaratë të kushteve të parashikuara meteorologjike për një kohë apo periudhe të caktuar, për një zonë të caktuar ose pjesë të hapësirës ajrore;

70. "**Personeli sensitiv i sigurisë**" (*safety-sensitive personnel)* nënkupton personat të cilët mund të rrezikojnë sigurinë e aviacionit në qoftë se i kryejnë detyrat dhe funksionet e tyre në mënyrën jo të duhur duke përfshirë, por jo vetëm, anëtarët e ekuipazhit të fluturimit, personelin e mirëmbajtjes së avionëve, personelin e operimeve të aerodromit, të shpëtimit, personelin zjarr fikës dhe të mirëmbajtjes, personelin e pashoqëruar të cilit i është lejuar aksesi në zonën e lëvizjes dhe kontrollorët e trafikut ajror;

71. "**Përdorimi problematik i substancave**" nënkupton përdorimin e një ose më shumë substanca psikoaktive nga ana e personelit të aviacionit në një mënyrë të tillë që:

a) përbën rrezik direkt për përdoruesin ose rrezikon jetën, shëndetin ose mirëqenien e të tjerëve; dhe/ose

b) shkakton ose e përkeqëson një problem ose çrregullim fizik, social, mendor ose profesional;

72. "**Pengesë**" (*obstacle)* nënkupton të gjitha objektet e fiksuara (të përkohshëm ose të përhershëm) ose lëvizëse ose pjesët e tyre, që:

a) janë të vendosur në një zonë të destinuar për lëvizjen në sipërfaqe të avionëve; ose

b) shtrihen mbi një sipërfaqe të caktuar të destinuar për mbrojtjen e avionëve në fluturim; ose

c) qëndrojnë jashtë këtyre sipërfaqeve të përcaktuara dhe që janë vlerësuar si një rrezik për lundrimin ajror;

73. "**Plani i fluturimit**" (*flight plan)* nënkupton informacionin specifik që i është dërguar një njësie të shërbimeve të trafikut ajror, në lidhje me fluturimin e planifikuar ose një pjesë të një fluturimi të një mjeti fluturues;

74. "**Plani aktual i fluturimit** (CPL)" (*current flight plan (CPL*) nënkupton planin e fluturimit, duke përfshirë ndryshimet, nëse ka, të sjella nga lejet pasuese;

75. "**Plani i fluturimit i dorëzuar** (FPL)" (*filed flight plan - FPL*) nënkupton planin e fluturimit siç është dërguar në një njësi SHTA nga piloti ose një përfaqësues i caktuar, pa ndryshimet e mëvonshme;

76. "**Plan fluturimi që përsëritet**" (*repetitive flight plan)* nënkupton një plan fluturimi të lidhur me një seri fluturimesh individuale të përsëritur shpesh, të operuar rregullisht, me karakteristika bazike identike, të dërguar nga një operator për t'u ruajtur dhe përdorur në mënyrë të përsëritur nga njësia e shërbimit të trafikut ajror (SHTA/ATS).

77. "**Pikë raportimi**" (*reporting point)* nënkupton një vend të caktuar gjeografik në raport me të cilin mund të raportohet pozita e një avioni;

78. "**Pikë e rëndësishme**" (*significant point)* nënkupton një vendndodhje të përcaktuar gjeografike të përdorur në përcaktimin e një rruge SHTA apo itinerarin e fluturimit të një avioni dhe/ose për qëllime të tjera të navigimit dhe të SHTA-së;

79. "**Pistë**" (*runway)* nënkupton një zonë të caktuar drejtkëndore në një aerodrom të ndërtuar në tokë të përgatitur për ulje dhe nisje të avionëve;

80. "**Pika e transferimit të referencave navigacionale**" *(change-over point)* nënkupton pikën në të cilën një avion që lundron në një segment rruge SHTA të përcaktuar duke iu referuar mbulimeve në shumë drejtime të radiove dhe që kanë frekuencë shumë të lartë, pritet të transferojë referencën e tij kryesore të lundrimit nga pajisja prapa avionit për te pajisja tjetër përpara e avionit;

81. "**Pika e transferimit të kontrollit**" (*transfer of control point)* nënkupton një pikë të përcaktuar e vendosur përgjatë shtegut të fluturimit të një mjeti fluturues, në të cilën përgjegjësia për ofrimin e shërbimit të kontrollit të trafikut ajror të mjetit fluturues transferohet nga një njësi e kontrollit ose pozicion i kontrollit te një tjetër;

82. "**Piloti në komandë**" (*pilot-in-command)* nënkupton pilotin e caktuar nga operatori, ose në rastin e aviacionit të përgjithshëm nga pronari, si drejtuesin që është në komandë dhe i ngarkuar me kryerjen e sigurt të fluturimit;

83. "**Pozicioni i pritjes jashtë pistës**" (*runway-holding position)* nënkupton një pozicion të përcaktuar që ka për qëllim të mbrojë pistën, sipërfaqen e kufizuar nga pengesat, apo një zonë të ndjeshme/kritike ILS (*instrument landing system*)/MLS (*microwave landing system*), në të cilën avionët që bëjnë rulim dhe automjetet duhet të ndalen dhe të presin, përveç kur autorizohen ndryshe nga kulla e kontrollit të aerodromit;

84. "**Presion-lartësie**" (*pressure-altitude)* nënkupton një presion atmosferik të shprehur në terma të lartësisë gjeometrike që i korrespondon atij presioni në Atmosferën Standarde, siç përcaktohet në aneksin 8, pjesa 1 të Konventës së Çikagos;

85. "**Procedura instrumentale e afrimit** (IAP)" (*instrument approach procedure)* nënkupton një seri manovrash të paracaktuara duke iu referuar instrumenteve të fluturimit me mbrojtje të përcaktuar nga pengesat në pikën fillestare të afrimit, ose kur është e zbatueshme, që nga fillimi i një rruge të përcaktuar mbërritje në një pikë në të cilën mund të përfundojë një ulje dhe pas kësaj, nëse një ulje nuk është përfunduar, në një pozicion në të cilin zbatohen kriteret e shmangies së pengesave në fluturim.

Procedurat instrumentale të afrimit klasifikohen si më poshtë:

a) Procedura e *Afrimit pa precizion* (NPA) nënkupton një procedure afrimi instrumentale e dizajnuar për operimet e afrimit me instrument 2D, Mode A;

b) *Procedura e afrimit me udhëzim vertikal (APV)* nënkupton një procedure të afrimit me instrument PBN e dizajnuar për operimet e afrimit me instrument (3D), Mode A;

c) *Procedura afrimit me precizion (PA)* nënkupton një procedure afrimi instrumentale bazuar në sisteme navigacionale (ILS, MLS, GLS dhe SBAS Cat 1) të dizajnuara për operimet e afrimit me instrument 3D, Mode A ose B;

86. "**Punë ajrore**" (*aerial work*) është operimi i një avioni, në të cilin ai përdoret për shërbime të specializuara, të tilla si: bujqësi, ndërtim, fotografim, studim, vëzhgim dhe patrullim, kërkim-shpëtim, reklamime ajrore, etj.;

87. "**Publikimi i Informacionit Aeronautik** (AIP)" nënkupton një publikim të lëshuar nga OSHLA me autoritetin e AAC-së dhe që përmban informacion aeronautik të një karakteri të përhershëm thelbësor për lundrimin ajror;

88. "**Pragu i pistës**" (*threshold)* nënkupton fillimin e asaj pjese të pistës që përdoret për ulje;

89. "**Qendra e kontrollit të zonës**-QKZ" (*area control centre*-ACC) nënkupton një njësi të vendosur për të siguruar shërbimin e kontrollit të trafikut ajror për fluturimet e kontrolluara në zonat e kontrollit nën juridiksionin e saj;

90. "**Qendra e informacionit të fluturimit**" (*flight information centre*) nënkupton një njësi të ngritur për të siguruar shërbimin e informacionit të fluturimit dhe shërbimin paralajmërues;

91. "**Radar i mbikëqyrjes sekondare** (SSR)" nënkupton një sistem radari mbikëqyrje i cili përdor transmetues/marrës dhe transponderë;

92. "**Radar mbikëqyrje**" nënkupton një pajisje radari të përdorur për të përcaktuar pozicionin e një avioni në shtrirje dhe azimut;

93. "**Radar**" nënkupton një pajisje radio zbuluese që ofron informacion mbi shtrirjen, azimutin dhe/ose lartësinë e objekteve;

94. "**Radio stacion kontrolli ajër–tokë**" (*air-ground control radio station*) nënkupton një stacion të telekomunikacionit aeronautik që ka përgjegjësinë kryesore për përpunimin e komunikimit në lidhje me operimin dhe kontrollin e mjetit fluturues në një zonë të caktuar;

95. "**Radiotelefoni**" nënkupton një formë të radio komunikimit me funksion primar shkëmbimin e informacionit në formën e fjalës;

96. "**Rajoni i informacionit të fluturimit**" (*flight information region)* nënkupton një hapësirë ajrore me dimensione të përcaktuara brenda të cilit ofrohet shërbimi i informacionit të fluturimit dhe shërbimi i gatishmërisë;

97. "**Raportim në ajër**" (*air-report)* nënkupton një raport nga një mjet fluturues në fluturim i përgatitur në përputhje me kërkesat për raportimin e pozicionit dhe raportimin operacional dhe/ose meteorologjik;

98. "**Re me impakt operacional**" (*cloud of operational significance*) nënkupton një re me lartësinë e bazës së resë nën 1500 m (5 000 ft) ose më poshtë se lartësia minimale e sektorit më të lartë, cilado që është më e madhe, ose pavarësisht lartësisë së një reje kumulmbuese ose një re kumuluese e lartë në çdo lartësi;

99. "**Rulim ajror**" (*air-taxiing*) nënkupton lëvizjen e një helikopteri/me nisje dhe ulje vertikale VTOL mbi sipërfaqen e një aerodromi, normalisht me efekt në terren dhe me një shpejtësi në terren zakonisht më pak se 37 km/h (20 KTS);

100. "**Rulimi**" (*taxiing)* nënkupton lëvizjen e një avioni në sipërfaqen e aerodromit ose një vend operacional nën autoritetin e vet, me përjashtim të nisjes dhe uljes;

101. "Rrugë lidhëse" (*taxiway)* nënkupton një shteg të përcaktuar në një aerodrom në tokë i ngritur për rulimin e avionit dhe ka për qëllim të sigurojë një lidhje ndërmjet një pjese të aerodromit me një tjetër, duke përfshirë:

a) Korridori hyrës në vendqëndrim nënkupton një pjesë të vendqëndrimit të përcaktuar si një rruge rulimi dhe që ka për qëllim të sigurojë akses vetëm te vendqëndrimi i avionit.

b) rruga lidhëse e vendqëndrimit nënkupton një pjesë të sistemit të një rruge rulimi të vendosur mbi një vendqëndrim që ka për qëllim të sigurojë një rrugë kalimi përmes vendqëndrimit.

c) rruga lidhëse e daljes së shpejtë nënkupton një rrugë rulimi të lidhur me një pistë në një kënd të ngushtë dhe e dizajnuar për të lejuar aeroplanët në ulje që të dalin në shpejtësi më të larta se sa ato të arritura në dalje të tjera rrugësh rulimi duke minimizuar kohën e qëndrimit në pistë.

102. "**Rrethi i trafikut të aerodromit**" (*aerodrome traffic circuit)* nënkupton një rrugë të përcaktuar në të cilën duhet të fluturojë avioni që operon në afërsi të një aerodromi;

103. "**Rrezja vizuale e pistës** (RVR)" (*runway visual range)* nënkupton rrezen që e lejon pilotin e një avioni në qendër të linjës së një piste të shohë shenjat në sipërfaqe të pistës apo dritat që e kufizojnë pistën ose që identifikojnë linjën qendrore të saj;

104. "**Rrugë ajrore**" (*airway)* nënkupton një zonë të kontrollit ose pjesë të saj e krijuar në formën e një korridori;

105. "**Saktësi**" (*accuracy*) nënkupton shkallën e konformitetit ndërmjet vlerës së parashikuar ose të matur dhe vlerës së vërtetë;

106. "**Sail plane**" (Planer) nënkupton një avion më të rëndë se ajri i cili mbështetet në fluturim nga reagimi dinamik i ajrit kundrejt sipërfaqes së tij fikse që ndihmojnë ngritjen, fluturimi i lirë i së cilës nuk varet nga një motor, duke përfshirë avionët pa motor të varur, paragliders apo avionë të tjerë të ngjashëm ose një fluturues të varur, fluturues me deltaplan dhe pajisje të tjera të ngjashme.

107. "**Segment korridori ajror**" (*route segment)* nënkupton një korridor ajror apo pjesë të korridorit ajror ku zakonisht fluturohet pa një ndalesë të ndërmjetme;

108. "**Sistem i shmangies së përplasjeve ajrore** (ACAS)" (*airborne collision avoidance system)* nënkupton një sistem të mjetit fluturues i bazuar në sinjalet e transponderit të radarit të mbikëqyrjes sekondare (SSR), që vepron në mënyrë të pavarur nga pajisjet e bazuara në tokë, për të këshilluar pilotin për konflikte të mundshme me mjete fluturues të tjerë që janë të pajisur me transponder SSR;

109. "**Stacion aeronautik**" (*aeronautical station*) nënkupton një stacion në tokë në shërbimin lëvizës aeronautik. Në disa raste, një stacion aeronautik mund të jetë i vendosur, për shembull, në bordin e një anije ose në një platformë në det;

110. '**Substanca psikoaktive** (*psychoactive substance*) nënkupton alokol, opioidem kanabisoide, qetësues dhe hipnotizues, kokainë, dhe

psikostimulantë të tjerë, halucinogjenë dhe tretësira të tyre, ku kafeina dhe duhani përjashtohen.

111. "**Shërbimi i kontrollit të aerodromit**" (*aerodrome control service*) nënkupton shërbimin e kontrollit të trafikut ajror për trafikun e aerodromit;

112. "**Shërbim i lëvizshëm aeronautik**" (*aeronautical mobile service*) nënkupton një shërbim lëvizës midis stacioneve aeronautike dhe stacioneve të mjetit fluturues, ose ndërmjet stacioneve të mjetit fluturues, në të cilin mjetet e shpëtimit mund të marrin pjesë; Stacionet radio transmetuese për gjetjen e pozicionit në rast emergjencash mund të marrin pjesë në këtë shërbim nëpërmjet frekuencave të përcaktuara për urgjenca dhe rrezik.

113. "**Shërbimi këshillues i trafikut ajror**" (*air traffic advisory service*) nënkupton një shërbim të ofruar brenda hapësirës ajrore të këshilluar për të siguruar ndarjen – aq sa është praktikisht e mundur - ndërmjet mjeteve fluturues që operojnë me plane fluturimi IFR;

114. "**Shërbim i Kontrollit të Trafikut Ajror**" (*air traffic control service*) nënkupton një shërbim të ofruar me qëllimin për të:

a) parandaluar përplasjet:

1. ndërmjet mjeteve fluturuese; dhe

2. në zonën e manovrimit ndërmjet mjeteve fluturuese dhe pengesave; dhe

b) përshpejtuar dhe mbajtur një fluks të rregullt të trafikut ajror;

115. "**Shërbim i trafikut ajror** (SHTA/ATS)" (*air traffic service*) është një term i përgjithshëm i cili nënkupton sipas rastit shërbimin e informacionit të fluturimit, shërbimin e gatishmërisë, shërbimi këshillues të trafikut ajror, shërbimin e kontrollit të trafikut ajror (shërbimin e kontrollit të zonës, shërbimin e kontrollit në afrim ose shërbimin e kontrollit të aerodromit);

116. "**Shërbimi i mbikëqyrjes së shërbimeve të trafikut ajror**" nënkupton një shërbim të ofruar direkt nëpërmjet një sistemi mbikëqyrje SHTA;

117. "**Shërbimi i gatishmërisë**" (*alerting service*) nënkupton një shërbim të ofruar për të njoftuar organizatat e duhura në lidhje me mjetet fluturues në nevojë për ndihmën e kërkim shpëtimit, dhe për të asistuar të tilla organizata sipas kërkesës;

118. "**Shërbimi i kontrollit të afrimit**" (*approach control service)* nënkupton shërbimin e kontrollit të trafikut ajror për fluturimet e kontrolluara në ardhje ose në nisje;

119. "**Shërbimi i kontrollit të zonës**" (*area control service*) nënkupton një shërbim të kontrollit të trafikut ajror për fluturimet e kontrolluara në zonat e kontrollit;

120. "**Shërbimi automatik i informacionit të terminalit** (SHAIT/ATIS)" (*automatic terminal information service*) nënkupton ofrimin automatik të informacionit aktual dhe rutinë për avionët në ardhje dhe nisje përgjatë 24-orëve, ose për një periudhë të caktuar kohore përgjatë 24-orëve:

a) "Transmetim të dhënash – shërbimi automatik i informacionit në terminal (D-(SHAIT/ATIS)) "nënkupton ofrimin e (SHAIT/ATIS) nëpërmjet transmetimit të të dhënave;

b) "Me zë – shërbimi automatik i informacionit në terminal (Voice- (SHAIT/ATIS))" nënkupton ofrimin e (SHAIT/ATIS) me anë të transmetimeve të vazhdueshme dhe të përsëritura me zë;

121. "**Shërbimi i radio navigimit**" (*radio navigation service)* nënkupton një shërbim për ofrimin e informacionit udhëzues apo të dhënat e pozicionit për operimin e efektshëm dhe të sigurt të avionëve të mbështetur nga një ose më shumë pajisje radio navigacionale;

122. "**Shërbim i informacionit të fluturimit**" (*flight information service)* nënkupton një shërbim të ofruar për të dhënë këshillim dhe informacion të dobishëm për kryerjen e fluturimit në mënyrë të sigurt dhe efikase;

123. "**Shikueshmëria nga ajri**" (*flight visibility)* nënkupton shikueshmërinë përpara nga kabina e një mjeti fluturues në fluturim;

124. "**Shikueshmëria nga toka**" (*ground visibility)* nënkupton shikueshmërinë në një aerodrom, siç raportohet nga një vëzhgues i akreditуar ose nga sisteme automatike;

125. "**Shikueshmëria**" nënkupton shikueshmërinë për qëllime aeronautike e cila është më e madhe se:

a) distanca më e madhe në të cilën një objekt i zi i dimensioneve të përshtatshme, i vendosur pranë tokës, mund të shihet dhe të njihet kur vëzhgohet në një sfond të ndritshëm;

b) distanca më e madhe në të cilën dritat në afërsi të 1000 cd mund të shihen dhe të identifikohen në një sfond të pandriçuar;

126. "**Territori**" nënkupton zonat e tokës dhe ujërat territoriale ngjitur me to nën sovranitetin, kontrollin, mbrojtjen ose mandatin e një shteti;

127. "**Mode (SSR)**" nënkupton identifikuesin konvencional në lidhje me funksionet specifike të sinjaleve të lëshuara nga një interogator SSR. Ka katër tipa të specifikuar në aneksin 10 të ICAO: A, C, S dhe Intermode;

128. "**Trafik ajror**" nënkupton të gjitha mjetet fluturues në fluturim apo që operojnë në zonën e manovrimit të një aerodromi;

129. "**Trafiku i aerodromit**" nënkupton të gjithë trafikun në zonën e manovrimit të një aerodromi dhe të gjithë avionët që fluturojnë në afërsi të aerodromit. Një avion që vepron në afërsi të një aerodromi përfshin, por nuk është i kufizuar vetëm në avionë që hyjnë apo largohen prej rrethit të trafikut të aerodromit;

130. "**Rruga"** (*track)* nënkupton projektimin mbi sipërfaqen e tokës të rrugës së një avioni, drejtimi i së cilës në çdo pikë shprehet në gradë nga veriu (i vërtetë, magnetik ose rrjeti koordinativ) nga i cili shtegu nga çdo pikë është shprehur zakonisht në gradë nga Veriu;

131. "**Vendqëndrim**" (*apron)* nënkupton një zonë të caktuar, e krijuar për të sistemuar avionët me qëllim ngarkimin ose zbarkimin e pasagjerëve, postës ose ngarkesave, furnizimin me karburant, parkimin apo mirëmbajtjen;

132. "**Vendi i operimit**" (*operating site)* nënkupton një vendndodhje të zgjedhur nga operatori ose piloti në komandë për ulje, nisje dhe /ose operacionet e ngarkim shkarkimit.;

133. "**Vëzhgim i mjetit fluturues**" (*aircraft observation)* nënkupton vlerësimin e një ose më shumë elementëve meteorologjike të bëra nga një mjet fluturues në fluturim;

134. "**VFR**" nënkupton simbolin e përdorur për rregullat vizuale të fluturimit. Ky shkurtim do të ketë këtë kuptim në të gjitha aktet nënligjore në të cilat përdoret;

135. "**VMC**" nënkupton simbolin e përdorur për kushtet meteorologjike vizuale.

136. "**Zonë e trafikut të aerodromit**" (*aerodrome traffic zone*) nënkupton një hapësirë ajrore të dimensioneve të përcaktuara e vendosur përreth një aerodromi për mbrojtjen e trafikut të aerodromit;

137. "**Zonë kontrolli**" (*control area)* nënkupton një hapësirë ajrore të kontrolluar që shtrihet lart nga një kufi i caktuar mbi tokë;

138. "**Zonë kontrolli**" *(control zone*) nënkupton një hapësirë ajrore të kontrolluar që shtrihet lart nga sipërfaqja e tokës në një kufi të caktuar të sipërm;

139. "**Zonë e rrezikshme**" (*danger area*) nënkupton një hapësirë ajrore të dimensioneve të përcaktuara brenda së cilës aktivitete të rrezikshme për fluturimin e avionëve mund të ekzistojnë në momente të caktuara;

140. "**Zona e uljes**" (*landing area)* nënkupton atë pjesë të zonës lëvizjes të përcaktuar për uljen ose ngritjen e avionëve;

141. "**Zonë e manovrimit**" (*manoeuvring area)* nënkupton atë pjesë të aerodromit që përdoret për nisjen, uljen dhe rulimin e avionëve, duke përjashtuar vendqëndrimin (*apron*);

142. "**Zonë malore**" (*mountainous area)* nënkupton një zonë me profil terreni të thyer ku ndryshimet në lartësimin e terrenit i kalojnë 900 m (3000 ft) brenda një distance prej 18.5 km (10,0 NM);

143. "**Zona e lëvizjes**" (*movement area)* nënkupton atë pjesë të një aerodromi që përdoret për nisjen, uljen dhe taksimin e avionëve, e përbërë nga zona e manovrimit dhe vendqëndrimi/et e avionëve (*apron*);

144. "**Zonë e ndaluar**" (*prohibited area)* nënkupton një hapësirë ajrore të dimensioneve të përcaktuara, mbi zonat tokësore apo ujërat territoriale të një shteti, brenda të cilave fluturimi i avionëve është i ndaluar;

145. "**Zonë e detyrueshme e radios** (RMZ)" (*radio mandatory zone)* nënkupton një hapësirë ajrore të dimensioneve të përcaktuara ku pajisja me dhe operimi i radios është i detyrueshëm;

146. "**Zonë e kufizuar**" (*restricted area)* nënkupton një hapësirë ajrore të dimensioneve të përcaktuara, mbi zonat tokësore apo ujërat territoriale të një shteti, brenda të cilave fluturimi i avionëve është i kufizuar në përputhje me disa kushte të caktuara;

147. "**Zona e sinjalit**" (*signal area)* nënkupton një zonë të aerodromit të përdorur për shfaqjen e sinjaleve tokësore;

148. "**Zona e detyrueshme me transponder** (TMZ)" (*transponder mandatory zone)* nënkupton një hapësirë ajrore të dimensioneve të përcaktuara ku mbajtja dhe operimi i transponderave që raportojnë presion-lartësi është i detyrueshëm;

149. "**Zyra e raportimit të shërbimeve të trafikut ajror (ARO)**" (*air traffic services (ATS) reporting office*) nënkupton një njësi të ngritur me

qëllimin e marrjes së raporteve në lidhje me shërbimet e trafikut ajror dhe planet e fluturimit të dorëzuara përpara nisjes;

150. "Zonë kritike" (*critical area)* nënkupton një zonë me dimensione të përcaktuara që shtrihet rreth pajisjes tokësore të një afrimi instrumental preciz brenda së cilës prania e mjeteve ose avionëve do të shkaktojë shqetësime të papranueshme të sinjaleve udhëzuese;

151. "Zonë e ndjeshme" (*sensitive area)* nënkupton një zonë që shtrihet përtej zonës kritike ku parkimi ose lëvizja, ose të dyja, të avionëve ose mjeteve do të ndikojnë në sinjalin udhëzues në masën që mund të paraqitet si një shqetësim i papranueshëm për avionët që përdorin sinjalin;

152. "**Hapësira-U e hapësirës ajrore**" nënkupton një zonë gjeografike të sistemeve të avionëve pa pilot ("UAS") të përcaktuar nga shteti, ku operimet UAS lejohen të kryhen vetëm me mbështetjen e shërbimeve të Hapësirës-U;

153. "**Shërbimi i Hapësirës-U**" nënkupton një shërbim që mbështetet në shërbimet digjitale dhe automatizimin e funksioneve të krijuara për të mbështetur aksesin e sigurt, efikas dhe të mbrojtur në hapësirën ajrore të hapësirës-U për një numër të madh UAS.

Neni 3
Pajtueshmëria

Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të sigurojë pajtueshmërinë me rregullat dhe parashikimet e përcaktuara në aneksin e kësaj Rregulloreje, pa rënë ndesh me dispozitat e fleksibilitetit të përfshira në VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil".

Neni 4
Përjashtimet për operimet e veçanta

1. Autoriteti i Aviacionit Civil mundet, me iniciativën e tij ose bazuar në aplikimet e enteve të interesuara, të lejojnë përjashtime për ente individuale ose kategori entesh për secilën nga kërkesat e kësaj Rregulloreje për aktivitetet e mëposhtme me interes publik dhe për trajnimin e nevojshëm për t'i kryer këto aktivitete në mënyrë të sigurt:

a) misionet e policisë dhe të doganave;

b) mbikëqyrja e trafikut dhe misionet e ndjekjes;

c) misionet e kontrollit mjedisor të kryera nga, ose për llogari të autoriteteve publike;

d) kërkimi dhe shpëtimi;

e) fluturimet mjekësore;

f) evakuimet;

g) fikja e zjarrit;

h) përjashtimet e nevojshme për të garantuar sigurinë e fluturimeve të titullarëve të shtetit, ministrave dhe funksionarëve të tjerë të ngjashëm.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil që autorizon këto përjashtime, kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, do të informojë EASA për natyrën e përjashtimeve të shumtën dy muaj pas miratimit të përjashtimit.

3. Ky nen nuk afekton nenin 3 dhe mund të aplikohet në rastet kur aktivitetet e listuar në paragrafin 1, nuk mund të kryhen si trafik ajror operacional apo kur ato nuk mund të përfitojnë nga dispozitat fleksibel të parashikuara në këtë Rregullore.

Ky nen nuk do të afektojë minimumet operacionale të helikopterëve të përfshira në aprovimet specifike të dhëna nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në përputhje me aneksin V, të urdhrit të Ministrit nr. 59, datë 30 janar 2020 "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore", apo ndryshimet e tij në fuqi, përafrim i Rregullores së Komisionit Evropian nr. 965/2012, të ndryshuar.

Neni 4a
Frekuenca shumë e lartë (VHF) frekuenca e emergjencës

1. Pa cenuar paragrafin 2, Autoriteti i Aviacionit Civil siguron që frekuenca e emergjencës VHF (121.500 MHz) të përdoret vetëm për qëllime emergjente të specifikuara në pikën SERA. 14095 d) të aneksit;

2. Mund të lejohet në mënyrë përjashtimore përdorimi i frekuencës së emergjencës VHF të referuar në paragrafin 1 për qëllime të tjera përveç atyre të specifikuara në pikën SERA. 14095 (d) të aneksit, nëse ato kufizohen në atë që është e nevojshme për të arritur qëllimin e tyre dhe në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi në avionët në gjendje të vështirë ose emergjence dhe në operimet e njësive të shërbimeve të trafikut ajror.

Neni 5
Ndryshimet

1. Në vijim të hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje dhe maksimalisht deri në datën e fillimit të zbatimit të saj, Autoriteti i Aviacionit Civil, duhet të:

a) të njoftojnë zyrtarisht ICAO-n që të gjithë ndryshimet e njoftuara më parë në lidhje me standardet e ICAO-s dhe praktikat e rekomanduara që mbulohen nga kjo Rregullore janë tërhequr, me përjashtim të atyre që lidhen me sigurinë esenciale dhe interesat e politikave të shtetit shqiptar në përputhje me nenin 10 të udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin nr. 5, datë 3.6.2010 "Kuadri Rregullativ në QVE", i ndryshuar.

b) të njoftojnë ICAO për ndryshimet që përfshihen në suplementin e aneksit të kësaj Rregulloreje.

2. Në përputhje me aneksin 15 të ICAO-s, transpozuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportin nr. 296, datë 29 korrik 2021 "Për miratimin e rregullores mbi shërbimin e informacionit aeronautik në Republikën e Shqipërisë", Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të publikojë nëpërmjet Publikimit të Informacionit Aeronautik ndryshimet që i janë njoftuar ICAO-s në përputhje me shkronjën (b) të paragrafit 1 të këtij neni, si dhe të gjitha dispozitat e tjera të krijuara për nevojat kombëtare të mbrojtjes ajrore dhe vlerësimet e sigurisë në përputhje me shkronjën (a) të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 6
Monitorimi i ndryshimeve

1. Në vijim të hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të caktojë një proces të përhershëm:

a) për të siguruar që të gjitha ndryshimet e miratuara në kuadrin e Konventës së Çikagos me rëndësi për fushëveprimin e kësaj Rregulloreje janë monitoruar dhe analizuar; dhe

b) kur është e nevojshme, edhe në vijim të ndryshimeve të zbatuara në BE, të zhvillojë propozime për ndryshime në aneksin e kësaj Rregulloreje.

2. Parashikimet e nenit 5 të kësaj rregulloreje në lidhje me tërheqjen dhe njoftimin e ndryshimeve dhe publikimin në Publikimin e Informacionit Aeronautik, si dhe të nenit 7 që ka të bëjë me ndryshimet e aneksit të kësaj rregulloreje do të zbatohen sipas rastit.

Neni 7
Ndryshimet e aneksit

1. Aneksi do të ndryshohet në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportin, nr. 5, datë 3.6.2010, "Kuadri Rregullativ në QVE", apo çdo përditësim të tij në fuqi në kohën e zbatimit.

2. Ndryshimet e referuara në paragrafin 1 mund të përfshijnë, por nuk do të kufizohen vetëm në, ndryshimet e kërkuara për të siguruar qëndrueshmërinë e dispozitave ligjore gjatë zgjerimit të ardhshëm të kësaj Rregulloreje, për të përfshirë dispozitat me rëndësi jo vetëm të aneksit 2, por edhe të anekseve dhe dokumenteve të tjera të ICAO-s, ose azhurnimet e anekseve dhe dokumenteve të ICAO, ose ndryshimet me rëndësi të Rregulloreve të Bashkimit Evropian të adoptuara në legjislacionin shqiptar.

Neni 8
Kërkesat e sigurisë

Në vijim të hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje dhe pa rënë ndesh me nenin 7, në mënyrë që të ruhen nivelet ekzistuese të sigurisë ose të përmirësohen ato, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të sigurojë që brenda kontekstit të një procesi të menaxhimit të sigurisë që adreson të gjitha aspektet e zbatimit të kësaj Rregulloreje, të kryejë një vlerësim të sigurisë për planin e zbatimit, duke përfshirë identifikimin e rrezikut, vlerësimin e riskut dhe masat për zbutjen e tij, duke iu paraprirë ndryshimeve të procedurave të aplikuara më parë. Masa të tilla mund të përfshijnë zbatimin e nenit 3.

Neni 9
Dispozitat kalimtare dhe të fundit

1. Nëse para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje janë miratuar dispozita të tjera që plotësojnë një standard të ICAO-s, ato do të vlerësohen nga AAC për të siguruar që ato janë në përputhje me këtë Rregullore.

2. Për qëllim të këtij neni, dispozita të tilla shtesë, që plotësojnë një standard ICAO nuk duhet të përbëjnë një ndryshim në kuadrin e Konventës së Çikagos. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të

publikojë këto dispozita shtesë, si dhe çdo çështje tjetër për të cilën merret vendim sipas kësaj rregulloreje, përmes publikimeve të tyre të informacionit aeronautik. Kur është e zbatueshme, AAC duhet gjithashtu të informojë Komisionin dhe EASA-n kur parashikimet shtesë janë miratuar.

3. Parashikimet e SERA.6005 do të zbatohen pas hyrjes në fuqi dhe zbatimit të kuadrit rregullator për hapësirën-U, transpozim i Rregullores Zbatuese të Komisionit 2021/664 "Për një kuadër rregullator për hapësirën-U".

4. Parashikimet e nenit 4a, SERA.3210, SERA.8005. SERA.8012, SERA.8015, SERA.9005, SERA.9010, SERA.12005, SERA.13010, SERA.14095, do të zbatohen 6 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Brenda kësaj periudhe, ngarkohet AAC dhe ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror të marrin masat e nevojshme për përshtatjen me kërkesat e cituara.

ANEKSI
RREGULLAT E AJRIT

SEKSIONI 1
FLUTURIMI MBI DET TË HAPUR

SERA.1001 Të përgjithshme

a) Për fluturim mbi det të hapur, rregullat e specifikuara në aneksin 2 të ICAO-s duhet të zbatohen pa përjashtim. Për qëllimet e vazhdimësisë dhe operimit të pandërprerë të shërbimeve të trafikut ajror, në veçanti brenda Blloqeve Funksionale të Hapësirës Ajrore, dispozitat e aneksit 11 të ICAO-s mund të zbatohen në hapësirën ajrore mbi det të hapur në një mënyrë që është në përputhje me mënyrën se si këto dispozita zbatohen mbi territorin e Republikës Shqipërisë. Kjo dispozitë vlen pa cenuar operimet e avionëve shtetërore sipas nenit 3 të Konventës së Çikagos. Kjo dispozitë vlen pa përjashtuar përgjegjësitë e shtetit shqiptar për të siguruar që operimet e mjeteve fluturues brenda Rajoneve të Informacionit të Fluturimit brenda të cilave ata janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror në përputhje me marrëveshjet rajonale të ICAO-s për lundrimin ajror janë kryer në një mënyrë të sigurt, të shpejtë dhe efikase.

b) Për ato pjesë në det të hapur ku shteti shqiptar ka pranuar, në bazë të një marrëveshjeje rajonale të ICAO-s për lundrimin ajror, përgjegjësinë për të ofruar shërbime të trafikut ajror, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të caktojë ofruesin e SHTA-së për ofrimin e këtyre shërbimeve.

SEKSIONI 2
ZBATUESHMËRIA DHE PAJTUESHMËRIA

SERA.2001 Zbatueshmëria

Pa cenuar, SERA 1001 më sipër, ky aneks adreson në përputhje me nenin 1, në veçanti përdoruesit e hapësirës ajrore dhe avionët;

a) që fluturojnë nga, brenda apo për në territorin e RSH-së;

b) që kanë kombësi dhe shenjat e regjistrimit të Republikës së Shqipërisë, që vepron në çdo hapësirë ajrore për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me rregullat e publikuara nga shteti që ka juridiksionin mbi territorin që po fluturohet.

Ky aneks do të zbatohet gjithashtu nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Shqipërisë, Ofruesit e Shërbimeve të Lundrimit Ajror, operatorët e aerodromeve dhe personelin përkatës të shërbimeve në tokë të angazhuar me operimet e avionëve.

SERA.2005 Pajtueshmëria me rregullat e ajrit

Operimi i një avioni në fluturim, në zonën e lëvizjes së një aerodromi ose në një vend operimi duhet të jetë në përputhje me rregullat e përgjithshme, dispozitat e aplikueshme lokale dhe, përveç kësaj, kur avioni është në fluturim ose me:

a) rregullat vizuale të fluturimit; ose

b) rregullat e fluturimit me instrument.

SERA.2010 Përgjegjësitë

a) Përgjegjësia e pilotit në komandë

Piloti në komandë i një avioni si në rastin kur e manovron vetë avionin, por edhe kur e manovron piloti i dytë, është përgjegjës për operimin e avionit, në përputhje me këtë Rregullore, megjithatë, piloti në komandë mund t'i shmanget këtyre rregullave në rrethana që e bëjnë shmangien absolutisht të domosdoshme në interes të sigurisë.

b) Veprimet para-fluturimit

Përpara fillimit të një fluturimi piloti në komandë i avionit duhet të familjarizohet me të gjithë informacionin e vlefshëm në dispozicion për fluturimin e parashikuar. Veprimi para-fluturimit për fluturimet larg nga afërsia e një aerodromi dhe

për të gjitha fluturimet IFR, duhet të përfshijë një studim të kujdesshëm të parashikimeve dhe raporteve të fundit të motit; të marrë në konsideratë kërkesat për karburant dhe një kurs alternativ të veprimit nëse fluturimi nuk mund të kompletohet siç është planifikuar.

SERA.2015 Autoriteti i pilotit në komandë të një avioni

Piloti në komandë i një avioni është autoriteti më i lartë për mbarëvajtjen dhe drejtimin e avionit gjatë kohës që është në komandë.

SERA.2020 Përdorimi problematik i substancave psikoaktive

Asnjë person funksioni i të cilit është i rëndësishëm për sigurinë në operim (personeli i rëndësishëm për sigurinë) nuk duhet të ndërmarrë funksione, ndërkohe që është nën ndikimin e ndonjë substance psikoaktive, për shkak të së cilës cenohet performanca njerëzore. Asnjë person i tillë nuk duhet të përdorë ose keqpërdorë këto lloj substancash.

SEKSIONI 3
RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE SHMANGIA E PËRPLASJES

KAPITULLI 1
MBROJTJA E PERSONAVE DHE PRONËS

SERA.3101 Neglizhenca ose papërgjegjshmëria në operimin e avionit

Një avion nuk duhet të operohet në mënyrë neglizhence ose të papërgjegjshme që të rrezikojë jetën ose pronën e të tjerëve.

SERA.3105 Lartësitë minimale

Përveçse kur është e nevojshme për t'u ngritur ose ulur, ose përveçse kur është dhënë leje nga Autoriteti i Aviacionit Civil, avioni nuk duhet të fluturojë mbi zonat e populluara të qyteteve, qytezave apo vendbanimeve ose mbi grumbullime njerëzish në ambient të hapur, përveçse nëse një lartësi të tillë që do ta lejojë, në rast të shfaqjes së një emergjence, të kryejë një ulje pa rrezikuar në një shkallë të lartë personat apo pronën në sipërfaqe. Lartësitë minimale për fluturimet VFR janë ato të specifikuara në SERA.5005 (f) dhe nivelet minimale për fluturimet IFR janë ato të specifikuara në SERA.5015 (b).

SERA.3110 Nivelet e lundrimit (Cruising)

Nivelet e lundrimit në të cilat një fluturim ose një pjesë e një fluturimi duhet të kryhet duhet të jenë sipas:

a) niveleve të fluturimit, për fluturimet në ose mbi nivelin më të ulët të përdorshëm të fluturimit ose, kur është e zbatueshme, mbi lartësinë tranzitore ;

b) lartësive barometrike, për fluturimet nën nivelin më të ulët të përdorshëm të fluturimit ose, kur është e zbatueshme, në ose nën lartësinë tranzitore.

SERA.3115 Hedhja e objekteve ose spërkatja

Hedhja e objekteve ose spërkatja nga një avion në fluturim, duhet të zhvillohet vetëm në përputhje me:

a) legjislacionin kombëtar në fuqi të Republikës së Shqipërisë për operimet e avionëve të rregulluara nga shteti shqiptar; dhe

b) siç përcaktohet nga çdo informacion përkatës, këshillim dhe /ose leje të dhënë nga njësia përkatëse e shërbimeve të trafikut ajror.

SERA.3120 Rimorkimi

Një avion apo një objekt tjetër do të tërhiqet nga një avion vetëm në përputhje me:

a) legjislacionin kombëtar në fuqi të Republikës së Shqipërisë për operimet e avionëve të rregulluara nga shteti shqiptar; dhe

b) siç përcaktohet nga çdo informacion përkatës, këshillim dhe/ose leje të dhënë nga njësia përkatëse e shërbimeve të trafikut ajror.

SERA.3125 Zbritja me parashutë

Zbritja me parashutë, përveç zbritjeve të emergjencës, do të bëhet vetëm në përputhje me:

a) legjislacionin kombëtar në fuqi të Republikës së Shqipërisë për operimet e avionëve të rregulluara nga shteti shqiptar; dhe

b) siç përcaktohet nga çdo informacion përkatës, këshillim dhe/ose leje të dhënë nga njësia përkatëse e shërbimeve të trafikut ajror.

SERA.3130 Fluturimi akrobatik

Fluturimet akrobatike do të kryhen vetëm në përputhje me:

a) legjislacionin kombëtar në fuqi të Republikës së Shqipërisë për operimet e avionëve të rregulluara nga shteti shqiptar; dhe

b) siç përcaktohet nga çdo informacion përkatës, këshillim dhe ose leje të dhënë nga njësia përkatëse e shërbimeve të trafikut ajror.

SERA.3135 Fluturimet në formacion

Avionët nuk duhet të fluturojnë në formacion përveçse kur është rënë dakord më përpara midis pilotëve në komandë të avionëve që marrin pjesë në fluturim dhe, për fluturimin në formacion në hapësirën ajrore të kontrolluar, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Këto kushte përfshijnë:

a) një nga pilotet në komandë duhet të jetë lideri i fluturimit;

b) formacioni vepron si një avion i vetëm në lidhje me lundrimin dhe raportimin e pozicionit;

c) ndarja midis avionëve në fluturim do të jetë përgjegjësi e liderit të fluturimit dhe pilotëve në komandë të avionëve të tjerë në fluturim dhe do të përfshijë periudhat e tranzicionit, kur avionët janë duke manovruar për të arritur ndarjen e tyre brenda formacionit dhe gjatë bashkimit dhe ndarjes; dhe

d) për avionët shtetëror duhet të ketë një distancë maksimale anësore, gjatësore dhe vertikale midis çdo avioni dhe liderit të fluturimit në përputhje me Konventën e Çikagos. Për avionët e tjerë, jo shtetërorë, duhet të mbahet një distancë jo më tepër se 1 km (0,5 nm) anësore dhe gjatësore, dhe 30 m (100 ft) vertikalisht nga udhëheqësi i fluturimit nga secili avion.

SERA.3140 Balonë e lirë pa pilot

Një balonë e lirë pa pilot duhet të operohet në mënyrë të tillë që të minimizojë rreziqet ndaj personave, pronës apo mjeteve të tjerë fluturues dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në shtojcën 2.

SERA.3145 Zonat e ndaluara dhe zona të kufizuara

Avionët nuk duhet të fluturojnë në një zonë të ndaluar, ose në një zonë të kufizuar, të dhënat e të cilave janë publikuar në mënyrë të rregullt, përveçse në përputhje me kushtet e kufizimeve ose me lejen e Autoritetit të Aviacionit Civil mbi territorin e të cilit janë përcaktuar këto zona.

KAPITULLI 2
SHMANGIA E PËRPLASJEVE

SERA.3201 Të përgjithshme

Asgjë në këtë Rregullore nuk e shfajëson pilotin në komandën e një avioni nga përgjegjësia për të vepruar, duke përfshirë manovrat për shmangien e përplasjes bazuar në zgjidhjet e sugjeruara nga pajisjet ACAS, për shmangien e përplasjeve.

SERA.3205 Afërsia

Një avion nuk duhet të operojë në një afërsi të tillë sa të shkaktojë një rrezik përplasje me avionët e tjerë.

SERA.3210 Përparësi

a) Avioni që ka përparësi duhet të ruajë drejtimin e tij dhe shpejtësinë.

b) Një avion që është në dijeni se aftësia për të manovruar e një tjetër avioni është e cenuar, duhet të hapë rrugën për këtë të fundit.

c) Një avion që është i detyruar të mos ndërpresë rrugën e një avioni tjetër sipas rregullave të mëposhtme duhet të shmangë të fluturuarit sipër, nën ose përballë avionit tjetër, përveç rasteve nëse arrin të kalojë duke ruajtur distancën e sigurisë dhe merr parasysh efektin e turbulencave të avionit.

1) *Afrimi ballë për ballë.* Kur dy avionë janë duke u afruar me njëri tjetrin ballë për ballë ose në një mënyre të përafërt dhe ekziston rreziku i përplasjes, secili duhet të ndryshojë drejtimin e tij në të djathtë.

2) Konvergimi. Kur dy avionë po fluturojnë drejt së njëjtës pikë në hapësirë afërsisht në të njëjtin nivel fluturimi, avioni që e ka tjetrin në të djathtën e tij do t'i hapë rrugën këtij të fundit, përveç rasteve më poshtë:

i. avionët me motor më të rëndë se ajri do t'i japin prioritet aeroplanëve, *sailplanes* (planerat) dhe balonave;

ii. aeroplanët duhet t'i japin prioritet planerave *(sailplanes)* dhe balonave;

iii. planerat *(sailplanes)* duhet t'i japin prioritet balonave;

iv. avionët me motor duhet t'i japin prioritet avionëve që shihen duke tërhequr avionë apo objekte të tjera.

3) *Parakalimi.* Një avion parakalues është një avion që i afrohet një tjetri nga pas në një vijë që formon një kënd prej më pak se 70 gradë me planin e simetrisë së këtij të fundit, d.m.th. është në një pozitë të tillë në lidhje me avionin tjetër, që natën nuk është në gjendje të dallojë dritat e lundrimit të avionit në të majtë (port) ose në të djathtë *(starboard).* Një avion që është duke u parakaluar ka përparësi dhe avioni parakalues edhe nëse ngjitet, zbret ose është në fluturim horizontal, duhet të mbajë distancën e nevojshme nga rruga e avionit tjetër duke ndryshuar drejtimin e tij në të djathtë, dhe pavarësisht ndryshimeve në vijim të pozicioneve relative të dy avionëve avioni parakalues nuk do të përjashtohet nga ky detyrim

deri sa të ketë kaluar avionin tjetër dhe të jetë në një distancë të largët nga ky i fundit.

i. Parakalimi i planerave (sailplanes). Një planer që parakalon një tjetër planer mund të ndryshojë kursin e tij në të djathtë ose në të majtë.

4) *Ulja.* Një avion në fluturim, ose që operon në tokë ose ujë, duhet t'i hapë rrugën avionit që është duke u ulur ose që është në fazën finale të afrimit me qëllim uljen.

i. Kur dy ose më shumë mjete fluturues më të rëndë se ajri po i afrohen një aerodromi ose një vend operimi me qëllim uljen, mjeti fluturues në nivelin më të lartë duhet t'i japë përparësi mjetit fluturues në nivel më të ulët, por ky i fundit nuk do të përfitojë nga ky rregull për t'i prerë rrugën një mjeti fluturues tjetër që është në fazat e fundit të afrimit për ulje, ose që ta parakalojë atë avion. Megjithatë, mjetet fluturues me motor më të rëndë se ajri duhet t'i japin përparësi planerave.

ii. *Ulje urgjence.* Një mjet fluturues që është në dijeni se një avion tjetër po bën ulje të detyruar, duhet t'i hape rrugën këtij të fundit.

5. *Ngritja.* Një avion që po bën rulim në zonën e manovrimit të një aerodromi duhet t'i japë përparësi një avioni që po ngrihet apo po përgatitet të ngrihet.

d) Lëvizja në sipërfaqe e avionëve, personave dhe automjeteve.

1) Në rast të rrezikut të përplasjes mes dy avionëve që po bëjnë rulim në zonën e lëvizjes së një aerodromi ose pjesëve ekuivalente të një zone operimi, kushtet e më poshtme duhet të zbatohen:

i. kur dy avionë po afrohen ballë për ballë me njëri tjetrin, ose përafërsisht kështu, secili duhet të ndalojë ose kur është e mundur të ndryshojë kursin e tij djathtas në mënyrë që të ruajnë distancë e sigurisë nga njëri-tjetri.

ii. kur dy avionë po drejtohen drejt së njëjtës pikë, ai që ka tjetrin në të djathtën e tij do të japë përparësi;

iii. një avion i cili është duke u parakaluar nga një avion tjetër, do të ketë përparësi dhe avioni parakalues duhet të mbajë distance e sigurisë nga avioni tjetër.

2) Në një aerodrom të kontrolluar një avion që bën rulim në zonën e manovrimit duhet të ndalojë dhe të qëndrojë në të gjitha pozicionet e pritjes në pistë përveç nëse i është dhënë një leje e qartë për të hyrë apo kaluar pistën nga kulla e kontrollit të aerodromit.

3) Një avion që bën rulim në zonën e manovrimit duhet të ndalojë dhe të qëndrojë te të gjithë dritat sinjalizuese të ndalimit dhe mund të vazhdojë më tej në përputhje me pikën 2 kur dritat të jenë të fikur.

4) Lëvizja e personave dhe automjeteve në aerodrome:

i. lëvizja e personave ose automjeteve, përfshirë avionët e rimorkiuar, në zonën e manovrimit të një aerodromi duhet të kontrollohet nga kulla e kontrollit të aerodromit sipas nevojës për të shmangur rrezikun për ta ose për avionët që janë duke u ulur; duke bërë rulim apo duke u nisur.

ii. Në kushtet ku procedurat e shikueshmërisë së ulët janë në veprim:

A) Personat dhe mjetet që operojnë në zonën e manovrimit të një aerodromi duhet të kufizohen në minimumin e nevojshëm, dhe vëmendje e veçantë do t'u kushtohet kërkesave për mbrojtjen e hapësirave të ndjeshme dhe kritike të pajisjeve ndihmëse të radionavigimit.

B) Në përputhje me parashikimet e pikës (iii), metoda ose metodat për të ndarë mjetet dhe avionët që lëvizin në rrugët lidhëse do të përcaktohen nga ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror ("OSHLA") dhe të miratohen nga AAC duke marrë parasysh pajisjet ndihmëse në dispozicion;

C) kur operimet e instrumenteve me precizion ILS dhe MLS të kategorisë II dhe III po zhvillohen bashkërisht në të njëjtën pistë në mënyrë të vazhdueshme, duhet të mbrohen zonat kritike apo sensitive të ILS ose MLS që janë me shtrënguese.

iii. mjeteve të emergjencës që shkojnë t'i japin asistence një avioni në rrezik, do t'i jepet përparësi ndaj çdo lëvizjeje tjetër të trafikut në sipërfaqe.

iv. Në varësi të dispozitave në (iii), automjeteve në zonën e manovrimit do t'u kërkohet të jenë në përputhje me rregullat e mëposhtme:

A. mjetet dhe mjetet që tërheqin avionët duhet t'u japin përparësi avionëve që janë duke u ulur, duke u ngritur ose ruluar *(taxiing);*

B. automjetet duhet t'i japin përparësi automjeteve të tjera që po rimorkiojnë një avion;

C. automjetet duhet t'i japin përparësi automjeteve të tjera në përputhje me udhëzimet e njësisë së shërbimeve të trafikut ajror;

D. pavarësisht dispozitave të A, B dhe C, automjetet dhe automjetet që tërheqin avionët duhet të veprojnë në përputhje me udhëzimet e dhëna nga kulla e kontrollit të aerodromit.

SERA.3215 Dritat që duhet të shfaqen nga avioni

a) Përveç rasteve të parashikuara në pikën (e), natën të gjithë mjetet në fluturim duhet të shfaqin:

1. Dritat kundër-përplasjes të cilat kanë si funksion që ta bëjnë avionin e dukshëm për të tjerët; dhe

2. përveç balonave, dritat e navigimit të cilat kanë si funksion që t'i tregojnë rrugën relative të mjetit fluturues një vëzhguesi. Dritat e tjera nuk do të ndizen në qoftë se ekziston mundësia që të ngatërrohen me dritat e navigimit;

b) Përveç rasteve të parashikuara në pikën (e), gjatë natës:

1. të gjithë avionët që lëvizin në zonën e lëvizjes së një aerodromi duhet të shfaqin dritat e navigimit të cilat kanë për funksion të tregojnë rrugën përkatëse të avionit për një vëzhgues dhe dritat e tjera nuk do të ndizen në qoftë se ekziston mundësia që ato të ngatërrohen me dritat e navigimit;

2. përveçse kur janë të palëvizshëm dhe të ndriçuar në mënyrë të përshtatshme, të gjithë avionët në zonën e lëvizjes së një aerodromi duhet të shfaqin dritat të cilat kanë për funksion të tregojnë, aq sa është e mundur, skaje të strukturës së tyre;

3. të gjithë avionët që qarkullojnë ose tërhiqen në zonën e lëvizjes së një aerodromi duhet të shfaqin drita që synojnë të tërheqin vëmendjen ndaj avionit; dhe ;

4. të gjithë avionët në zonën e lëvizjes së një aerodromi, motorët e të cilëve janë ndezur, duhet të shfaqin dritat të cilat e tregojnë këtë fakt.

c) Përveç rasteve të parashikuara në pikën (e), të gjithë avionët në fluturim dhe të pajisur me drita antipërplasje, për të përmbushur kërkesën e (a)(1) duhet t'i shfaqin këto drita edhe gjatë ditës.

d) Përveç rasteve të parashikuara në pikën (e), të gjithë avionët:

1. që po bëjnë *taxing* ose po rimorkiohen në zonën e lëvizjes së një aerodromi dhe janë të pajisur me drita antipërplasje, në përputhje me kërkesat e (b)(3); ose

2. në zonën e lëvizjes së një aerodromi dhe të pajisur me drita në përputhje me kërkesat e (b)(4);

duhet t'i shfaqin këto drita edhe gjatë ditës.

e) Një pilot do të lejohet të fikë ose të zvogëlojë intensitetin e dritave që ndizen dhe fiken të vendosura për të përmbushur kërkesat e pikave (a), (b), (c) dhe (d), nëse:

1. ndikojnë negativisht në kryerjen e suksesshme të detyrave; ose

2. mund t'i shkaktojnë një vëzhguesi të jashtëm verbëri.

SERA.3220 Fluturimet instrumentale të simuluara

Një mjet fluturues nuk duhet të fluturojë në kushtet të simuluara instrumentale përveç rasteve kur:

a) në avion janë instaluar komanda të dyfishta tërësisht funksionale; dhe

b) një pilot shtesë i kualifikuar (në këtë rast i quajtur një pilot sigurie) zë vend në një sedilje kontrolli për të vepruar si pilot sigurie për personin i cili është duke fluturuar në kushte të simuluara instrumentale. Piloti i sigurisë duhet të ketë shikueshmëri të mjaftueshme përpara dhe në secilin krah të avionit, ose një vëzhgues kompetent në komunikim me pilotin të sigurisë, duhet të zërë një pozicion në avion prej të cilit fusha e shikueshmërisë së vëzhguesit të plotësojë në mënyrë të mjaftueshme atë të pilotit të sigurisë.

SERA.3225 Operimet në dhe në afërsi të aerodromit

Një mjet fluturues që operon në ose në afërsi të aerodromit, duhet të:

a) vëzhgojë trafikun tjetër të aerodromit me qëllim shmangien e përplasjes;

b) përshtatet me ose të shmange modelin e formuar të trafikut nga avionët e tjerë në operim;

c) me përjashtim të balonave, të bëjë të gjithë kthesat në të majtë, kur afrohet për ulje dhe pasi është ngritur, përveçse nëse është vendosur ndryshe apo udhëzohet nga Kontrolli i Trafikut Ajror;

d) me përjashtim të balonave, ulet dhe ngrihet me erën kundra përveçse në qoftë se siguria, konfigurimi i pistës, apo elementë të trafikut ajror përcaktojnë se një drejtim tjetër është i preferuar.

SERA.3230 Operimet mbi ujë

a) Kur dy avionë ose një avion dhe një mjet detar po i afrohen njëri-tjetrit dhe ekziston rreziku i përplasjes, avioni duhet të vazhdojë duke treguar kujdes ndaj rrethanave dhe kushteve ekzistuese, duke përfshirë kufizimet e mjetit përkatës.

1. *Konvergimi.* Një avion i cili ka një tjetër mjet ajror apo një mjet detar në të djathtën e tij do të

japë përparësi në mënyrë që të ruajë distancën e duhur.

2. *Afrimi ballë për ballë.* Një avion i cili afrohet ballë për ballë, ose përafërsisht kështu, me një tjetër avion tjetër ose një mjet detar, duhet të ndryshojë drejtimin e tij në të djathtë që të ruajë distancën e sigurisë.

3. *Parakalimi.* Avioni ose mjeti detar e cili është duke u parakaluar ka përparësi, dhe ai që po parakalon duhet të ndryshojë drejtimin e tij që të ruajë distancën e duhur.

4. *Ulja dhe ngritja.* Një avion në ulje ose në nisje nga uji duhet, aq sa e ka të mundur, të ruajë distancën e sigurisë nga të gjitha mjetet detare dhe të shmange pengimin e lundrimit të tyre.

b) Dritat që do të shfaqen nga avioni mbi ujë. Gjatë natës apo gjatë çdo periudhe tjetër të përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të gjithë avionët mbi ujë, duhet të shfaqin dritat siç kërkohet nga Konventa mbi Rregulloret Ndërkombëtare për Parandalimin e Përplasjeve në Det, 1972, përveçse nëse kjo nuk është e mundur për ta. Në rastin e fundit ata duhet t'i shfaqin dritat në mënyrën më të përafërt të mundshme në karakteristika dhe pozicionin me atë të kërkuar nga rregulloret ndërkombëtare.

KAPITULLI 3
SINJALET

SERA.3301 Të përgjithshme

a) Sapo të ketë vëzhguar ose marrë ndonjë nga sinjalet në shtojcën 1, avioni duhet të ndërmarrë veprime të tilla siç mund të kërkohet nga interpretimi i sinjalit të dhënë në atë shtojcë

b) Sinjalet e shtojcës 1, kur përdoren, do të kenë kuptimin e përcaktuar në të. Ato duhet të përdoren vetëm për qëllimin e përcaktuar dhe nuk duhen përdorur sinjale të tjera të ngjashme me to për të mos u ngatërruar.

c) Një sinjalizues/mareshali i tokës është përgjegjës për ofrimin e sinjaleve standarde në mënyrë të qartë dhe të saktë duke përdorur sinjalet e treguar në shtojcën 1.

d) Vetëm personat e trajnuar, kualifikuar dhe të miratuar në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të Bashkimit Evropian apo kombëtar duhet të kryejnë funksionet e një sinjalizuesi / drejtues parkimi.

e) Sinjalizuesi/mareshali i tokës duhet të veshin një jelek të veçantë identifikimi fluoreshent për të lejuar ekuipazhin e fluturimit që të identifikojë personin përgjegjës për operimet në vend parkim.

f) Shkopinjtë fluoreshentë të ditës, pallaskat apo dorezat fluoreshente, do të përdoren për të gjithë sinjalizimet nga i gjithë stafi që vepron në tokë gjatë orëve të ditës. Shkopinjtë ndriçues duhet të përdoren gjatë natës ose kur është shikueshmëri e ulët.

KAPITULLI 4
KOHA

SERA.3401 Të përgjithshme

a) Koha e Koordinuar Universale (UTC) do të përdoret dhe do të shprehet në orë dhe minuta dhe, kur kërkohet, në sekonda të ditës 24-orëshe duke filluar në mesnatë.

b) Një verifikim l i kohës duhet të kryhet përpara operimit të një fluturimi të kontrolluar dhe në momente të tjera gjatë fluturimit, sipas nevojës.

c) Kudo që koha përdoret në aplikimin e komunikimeve me transmetim të dhënash, ajo duhet të jetë e saktë brenda 1 sekonde të UTC.

d) Koha në shërbimet e trafikut ajror

1) Kulla e kontrollit të Aerodromit duhet, përpara se një avion të bëjë rulim për t'u ngritur, t'i sigurojë pilotit kohën e saktë, vetëm nëse është rënë dakord që piloti ta marrë kohën nga burime të tjera. Gjithashtu, njësitë e shërbimeve të trafikut ajror duhet të informojë mjetet fluturues me kohën e saktë sipas kërkesës nga piloti. Kontrolli i kohës do t'i jepet të paktën sipas minutës më të afërt.

SEKSIONI 4
PLANET E FLUTURIMIT

SERA.4001 Dorëzimi i një plani të fluturimit

a) Informacioni në lidhje me një fluturim të planifikuar ose pjesë të fluturimit, që do t'i jepet njësive të shërbimeve të trafikut ajror, do të jetë në formën e një plani fluturimi. Termi 'Plani i fluturimit" është përdorur për të nënkuptuar, sipas rastit, informacione të plota për të gjithë elementët e përfshirë në përshkrimin e planit të fluturimit, duke mbuluar të gjithë rrugën e fluturimit, apo informacionin e kufizuar të kërkuar, ndër të tjera, kur qëllimi është të merret leje për një pjesë të vogël të një fluturimi, siç mund të jetë kalimi i një

rruge ajrore, për t'u ngritur nga, ose për t'u ulur në një aerodrom të kontrolluar.

b) Një plan fluturimi do të dorëzohet përpara operimit të:

1) çdo fluturimi ose pjesë të tij që do t'i ofrohet shërbimi i kontrollit të trafikut ajror;

2) çdo fluturimi IFR brenda hapësirës ajrore kështilluese;

3) çdo fluturimi brenda ose në zona, apo përgjatë rrugëve të përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, për të lehtësuar dhënien e informacionit të fluturimit, shërbimin e gatishmërisë dhe kërkim shpëtimit;

4) çdo fluturimi brenda ose në zona, apo përgjatë rrugëve të përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, për të lehtësuar koordinimin me njësitë përkatëse ushtarake apo me njësitë e shërbimeve të trafikut ajror në shtetet kufitare në mënyrë që të shmanget nevoja e interceptimit të avionit me qëllim identifikimin e tij;

5) çdo fluturimi që kalon përtej kufijve ndërkombëtarë, përveçse kur është vendosur ndryshe nga shtetet e interesuara;

6) çdo fluturimi i planifikuar për të operuar gjatë natës, nëse largohet nga afërsia e një aerodromi.

c) Një plan fluturimi duhet t'i dorëzohet, përpara nisjes, zyrës së raportimit të shërbimeve të trafikut ajror ose, gjatë fluturimit, t'i transmetohet njësisë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror ose stacionit tokë-ajër të kontrollit të radios, përveçse kur është rënë dakord për dorëzimin e planeve të përsëritura të fluturimit.

d) Përveçse kur një kohë më e shkurtër është përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për fluturimet e brendshëm VFR, një plan fluturimi për çdo fluturim të planifikuar për të operuar përtej kufijve ndërkombëtarë, ose që do t'i ofrohet shërbimi i kontrollit të trafikut ajror ose shërbimi kështillues i trafikut ajror duhet të paraqitet të paktën gjashtëdhjetë minuta përpara nisjes, ose, nëse paraqitet gjatë fluturimit, në një kohë që do të bëjë të mundur marrjen e tij nga njësia përkatëse e shërbimeve të trafikut ajror të paktën dhjetë minuta përpara se avioni parashikohet të arrijë:

1) pikën e synuar të hyrjes në një zonë kontrolli ose zonë kështilluese; ose

(2) pikën e kalimit të një rruge ajrore ose rruge të kështilluar.

SERA.4005 Përmbajtja e planit të fluturimit

a) Një plan fluturimi duhet të përfshijë informacionin në lidhje me pikat e mëposhtme që konsiderohen si të rëndësishme nga Autoriteti i Aviacionit Civil:

1) Identifikimi i avionit

2) Rregullat e fluturimit dhe lloji i fluturimit

3) Numri dhe tipi/et e avionëve dhe kategoria e turbulencës

4) Pajisjet

5) Aerodromi i nisjes apo vendi i operimit

6) Kohë e parashikuar e fillimit të lëvizjes

7) Shpejtësia e lundrimit (*cruising speed(s)*)

8) Niveli i lundrimit (*cruising level(s)*)

9) Rruga që do të ndiqet

10) Aerodromi destinacionit apo vendi i operimit dhe koha e parashikuar e fluturimit nga aerodromi i ngritjes deri në aerodromin e mbërritjes

11) Aerodromi ose vendi i operimit rezervë

12) Sasia e karburantit

13) Numri total i personave në bord

14) Pajisjet e urgjencës dhe mbijetesës

15) Informacione të tjera.

b) Për planet e fluturimit të paraqitura gjatë fluturimit, aerodromi apo vendi i operimit i ngritjes, i paraqitur, do të jetë vendi nga i cili do të kërkohet informacion shtesë rreth fluturimit, nëse kërkohet. Përveç kësaj, informacioni duhet të sigurohet në vend të kohës së vlerësuar të lëvizjes, duhet të jetë koha mbi pikën e parë të rrugës për të cilën lidhet plani i fluturimit.

SERA.4010 Plotësimi i një plani fluturimi

a) Një plan fluturimi do të përmbajë informacion, sipas rastit, për elementët me rëndësi, deri në dhe duke përfshirë, aerodromin/et apo vendin/et e operimit rezervë në lidhje me të gjithë itinerarin ose pjesën për të cilën është dorëzuar plani i fluturimit.

b) Gjithashtu, do të përmbajnë informacion, sipas rastit, për të gjithë elementët e tjerë kur është kërkuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose kur konsiderohet e nevojshme nga personi që dorëzon planin e fluturimit.

SERA.4015 Ndryshimi i planit të fluturimit

a) Sipas dispozitave të SERA.8020 (b) të gjitha ndryshimet e paraqitura të planit të fluturimit për një fluturim IFR, ose një fluturim VFR të operuar si fluturim i kontrolluar, duhet t'i raportohen sa më shpejt të jetë e mundur njësisë përkatëse të

shërbimeve të trafikut ajror. Për fluturimet e tjera VFR, ndryshimet domethënëse të një plan fluturimi duhet t'i raportohen sa më shpejt të jetë e mundur njësisë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror.

b) Informacioni i dorëzuar përpara nisjes në lidhje me kohëzgjatjen e karburantit apo numrin total të personave në bord, nëse nuk është korrekt në kohën e nisjes, përbën një ndryshim domethënës të planit të fluturimit dhe si i tillë duhet të raportohet.

SERA.4020 Mbyllja e një plani fluturimi

a) Një raport mbërritje duhet t'i bëhet personalisht, nëpërmjet radiotelefonisë, *data-link* ose me mënyra të tjera të përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në momentin më të parë të mundshëm pas uljes, njësisë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror në aerodromin e mbërritjes për çdo fluturim për të cilin është dorëzuar një plan fluturimi që mbulon të gjithë fluturimin ose pjesën e mbetur të një fluturimi deri në aerodromin e destinacionit.

1) Paraqitja e një raporti të mbërritjes nuk është e nevojshme pas uljes në një aerodrom ku ofrohen shërbimet e trafikut ajror në qoftë se komunikimi në radio apo sinjalet vizuale tregojnë që ulja është vëzhguar.

b) Kur një plan fluturimi është paraqitur vetëm për një pjesë të një fluturimi, që nuk përfshin pjesën e mbetur të fluturimit drejt destinacionit, ai duhet të mbyllet, kur kërkohet, nëpërmjet një raporti të caktuar dërguar njësisë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror.

c) Kur në aeroportin ose vendin e operimit të mbërritjes nuk ka njësi të shërbimeve të trafikut ajror, kur kërkohet, raporti i mbërritjes duhet t'i bëhet sa më shpejt të jetë e mundur pas uljes dhe me një nga mjetet më të shpejtë në dispozicion njësisë më të afërt të shërbimeve të trafikut ajror.

d) Kur pajisjet e komunikimit në aerodromin e mbërritjes apo vendin e operimit konsiderohen si të papërshtatshme dhe nuk ka zgjidhje rezervë për trajtimin e raporteve të mbërritjes në terren, do të ndërmerren veprimet e mëposhtme. Menjëherë para uljes avioni duhet, në qoftë se është e mundur, t'i transmetojë njësisë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror, një mesazh të ngjashëm me një raport mbërritje, në qoftë se kërkohet një raport i tillë. Normalisht, ky transmetim duhet t'i bëhet stacionit aeronautik në shërbim të njësisë të shërbimeve të trafikut ajror që mbulon rajonin e informacionit të fluturimit në të cilën po operon mjeti fluturues.

e) Raportet e mbërritjes të bëra nga avioni duhet të përmbajnë elementet e mëposhtme të informacionit:

1) identifikimin e avionit;

2) aerodromi i nisjes apo vendi operimit i nisjes;

3) aerodromi i destinacionit apo vendi i operimit i destinacionit (vetëm në rastin e një ulje të ndryshuar);

4) aerodromi i mbërritjes apo vendi i operimit i mbërritjes;

5) koha e mbërritjes.

SEKSIONI 5
KUSHTET VIZUALE METEOROGJIKE, RREGULLAT E FLUTURIMEVE VIZUALE, RREGULLAT SPECIALE VFR DHE ATO TË FLUTURIMEVE INSTRUMENTALE

SERA.5001 Shikueshmëria VMC dhe distanca minimale nga retë

Shikueshmëria VMC dhe distanca minimale nga retë janë të paraqitura në tabelën S5-1.

Tabela S-5(1)(*)

Fasha e lartësisë	Klasifikimi i Hapësirës	Shikueshmëria nga ajri	Distanca nga retë
Në dhe mbi 3050m (10000ft)AMSL	A(**)B CDE F G	8km	1500m horizontalisht 300m(1000ft)vertikalisht
Nën 3050m (10000ft) AMSLdhe mbi 900 m (3000 ft) AMSL, ose mbi 300 m (1000 ft) mbi tokë, cilido që është më lart	A(**)B CDE F G	5km	1500m horizontalisht 300m(1000ft)vertikalisht
Në dhe nën 900 m (3000 ft)AMSL, ose	A(**)B CDE	5km	1500m horizontalisht 300m(1000ft)vertikalisht

300m (1000ft) mbi tokë, cilido që është me lart	F G	5km(***)	Pa re dhe me terrenin në shikim

(*) Kur lartësia gjeometrike e lartësisë tranzitore është më e ulët se 3050 m (10 000 ft) AMSL, FL 100 duhet të përdoret në vend të 10 000 ft.

(**) Minimumet e VMC në hapësirën ajrore të Klasit A janë të përfshira si udhëzim për pilotet dhe nuk nënkuptojnë pranimin e fluturimeve VFR në hapësirën e Klasit A.

(***) Kur është e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil:

a) Shikueshmëritë e fluturimit të reduktuara në jo me pak se 1 500 m mund të lejohen për fluturime të cilët operojnë:

(1) Me shpejtësi 140 kts IAS, ose më pak, për të dhënë mundësi të mjaftueshme për vëzhgimin e trafikut tjetër ose çdo pengese, në kohë për të shmangur përplasjen.

(2) Në rrethana në të cilat mundësia e përballjes me trafik tjetër është e ulet normalisht, p.sh. në zonat me volum të ulët trafiku dhe për punë ajrore në nivele të ulëta.

b) Helikopterët mund të lejohen të operojnë në më pak se 1 500 m por jo më pak se 800 m shikueshmëri në fluturim në qoftë se manovrohen me një shpejtësi që jep mundësinë e mjaftueshme për të vëzhguar trafikun ose çdo pengesë në kohë për të shmangur përplasjen.

SERA.5005 Rregullat e fluturimit vizual

a) Përveçse kur operojnë si një fluturim VFR special, fluturimet VFR duhet të kryen në mënyrë të tillë që avioni të fluturojë në kushte shikueshmërie dhe distancë nga retë të barabartë me ose më të mëdha se ato që janë specifikuar në tabelën S5-1.

b) Përveç rastit kur është siguruar një leje VFR speciale nga njësia e kontrollit të trafikut ajror, fluturimet VFR nuk do të ngrihen ose ulen në një aerodrom brenda një zone kontrolli, ose të hynë në zonën e trafikut të aerodromit ose në cirkuitin e trafikut të aerodromit kur kushtet meteorologjike të raportuara në atë aerodrom janë nën minimumet e mëposhtme:

1) Baza e reve është më pak se 450 m (1 500 ft); ose

2) Shikueshmëria e terrenit është më pak se 5 km.

c) Kur është e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, fluturimet VFR gjatë natës mund të lejohen në kushtet e mëposhtme:

1) Në qoftë se avioni largohet nga afërsia me aerodromin, një plan fluturimi duhet të paraqitet në përputhje me SERA.4001(b)(6);

2) Kur është e mundur fluturimet duhet të vendosin dhe të mbajnë komunikim me radio, të ndërsjellët, në kanalin e duhur të komunikimit SHTA/ATS.

3) Shikueshmëria VMC dhe distanca minimale nga retë duhet të aplikohet siç është e specifikuar në tabelën S5-1, vetëm se:

i. Baza e reve nuk duhet të jetë më pak se 450 m (1 500 ft);

ii. dispozitat për shikueshmërinë e reduktuar të fluturimit të specifikuara në tabelën S5-1(a) dhe (b) nuk aplikohen;

iii. Në hapësirat ajrore të klasit B, C, D, E, F dhe G, në dhe nën 900 m (3 000 ft) AMSL ose 300 m (1 000 ft) mbi terrenin, cilido të jetë më lart, piloti duhet të mbajë vazhdimisht në shikim terrenin; dhe

iv. Për zona malore, shikueshmëria më e lartë VMC dhe distanca minimale nga retë mund të përcaktohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

4) Përveçse kur është e nevojshme për ngritje ose ulje, ose përveçse kur është autorizuar specifikisht prej Autoritetit të Aviacionit Civil, një fluturim VFR natën duhet të fluturojë në një nivel që nuk është nën lartësinë minimale të fluturimit të vendosur nga Shteti në hapësirën e të cilit po fluturohet, ose, kur nuk është përcaktuar një lartësi fluturimi minimale:

i. Mbi terren të lartë ose në zonat malore, në një nivel i cili është të paktën 600 m (2 000 ft) mbi pengesën më të lartë që ndodhet brenda një rrezeje prej 8 km nga pozicioni i parashikuar i avionit.

ii. Në vende të tjera, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën (i) në një nivel i cili është të paktën 300 m (1 000 ft) mbi pengesën më të lartë që ndodhet brenda një rrezeje prej 8 km nga pozicioni i parashikuar i avionit.

d) fluturimet VFR nuk do të operohen:

1) Me shpejtësi tansonike dhe supersonike, përveçse kur janë autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

2) Mbi FL 195. Përjashtimet nga kjo kërkesë zbatohen kur:

i. Një hapësirë ajrore e rezervuar është përcaktuar nga shteti shqiptar, kur kjo është

praktike, në të cilën fluturimet VFR mund të lejohen;

ii. Hapësira ajrore deri në dhe përfshirë nivelin e fluturimit 285, kur trafiku VFR në atë hapësirë ajrore është autorizuar nga njësia e shërbimit të trafikut ajror përgjegjëse në përputhje me procedurat e autorizimit të përcaktuara nga AAC dhe të publikuara në publikimin e informacionit aeronautik;

e) Autorizimi për fluturimet VFR për të operuar mbi FL 285 nuk duhet të jepet kur mbi FL 290 aplikohet një minimum ndarje vertikale prej 300 m (1 000 fto).

f) Përveçse kur është e nevojshme për ngritje ose ulje, ose përveçse kur lejohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, një fluturim VFR nuk duhet të fluturojë:

1) Mbi zonat e populluara të qyteteve, qytezave, vendbanimeve, grumbullimet e njerëzve në ambient të hapur, në një lartësi më pak se 300 m (1000 ft) nga pengesa më e lartë brenda një rrezeje prej 600 m nga avioni;

2) Në vende të tjera nga ato të përcaktuara në pikën (1), në një lartësi më pak se 150 m (500 ft) nga toka ose uji, ose 150 m (500 ft) nga pengesa më e lartë brenda një rrezeje prej 150 m (500 ft) nga avioni.

g) Përveçse kur është përcaktuar në lejen e dhënë nga kontrolli i trafikut ajror ose përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, fluturimet VFR në nivelin ekonomik të fluturimit kur operohen mbi 900 m (3 000 ft) nga toka ose uji, ose një e dhënë më e lartë siç është përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, duhet të kryhen në një nivel ekonomik të përshtatshëm me trajektoren siç është përcaktuar në tabelën e niveleve të lundrimit ekonomik *(cruising levels)* në shtojcën 3.

h) Fluturimet VFR duhet të jenë në përputhje me dispozitat e seksionit 8;

1) Gjatë operimit brenda hapësirave të klasave B, C dhe D;

2) Kur janë pjesë e trafikut të aerodromit në aerodromet e kontrolluara; ose:

3) Gjatë operimit si fluturime VFR speciale.

i) Një fluturim VFR që operon brenda për brenda ose në zona, ose përgjatë rrugëve të përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në përputhje me SERA 4001(b)(3) ose (4), duhet të mbajë komunikim me zë ajër-tokë të vazhdueshëm në kanalin e duhur të komunikimit të njësisë të shërbimeve të trafikut ajror që ofron shërbimin e informacionit të fluturimit, dhe t'i raportojë kësaj njësie pozicionin sipas nevojës.

j) Një avion që operohet në përputhje me rregullat vizuale të fluturimit, i cili kërkon të kalojë në operim në përputhje me rregullat me instrument të fluturimit, duhet:

1) nëse një plan fluturimi është dorëzuar, të komunikojë ndryshimet e nevojshme, që t'i shtohen planit aktual të fluturimit; ose:

2) Siç kërkohet nga SERA 4001(b), t'i dorëzojë një plan fluturimi sa më shpejt që të jetë e mundur njësisë së duhur të shërbimeve të trafikut ajror dhe të marrë një leje përpara se të vazhdojnë operim IFR kur ndodhet në hapësirë ajrore të kontrolluar.

SERA.5010 VFR speciale në Zonat e Kontrollit

Fluturimet speciale VFR mund të autorizohen të operojnë brenda një zone kontrolli të kontrolluar, kur iu është dhënë leje nga kontrolli i trafikut ajror. Përveçse kur është dhënë leje nga Autoriteti i Aviacionit Civil për helikopterë në raste të veçanta, si në rastin e, por jo vetëm, fluturimeve të operacioneve të policisë, mjekësore, kërkim-shpëtimit dhe ato për shuarjen e zjarrit, kushtet shtesë të mëposhtme duhet të aplikohen:

a) Fluturime të tilla speciale VFR mund të kryhen vetëm gjatë ditës, përveçse kur është autorizuar ndryshe nga Autoriteti Aviacionit Civil:

b) Nga piloti:

1) I larguar nga retë dhe të ketë terrenin në shikim

2) Shikueshmëria në fluturim nuk është më pak se 1500 m ose, për helikopterët, jo më pak se 800 m;

3) Fluturon me shpejtësi 140 kts IAS ose më pak për të dhënë mundësinë reale për të vëzhguar trafikun tjetër dhe çdo pengesë, duke pasur kohë të mjaftueshme për të shmangur një përplasje; dhe

c) Një njësi e kontrollit të trafikut ajror nuk do të japë një leje speciale VFR për avionët për t'u ngritur

d) ose ulur në një aerodrom brenda një zone kontrolli, ose për të hyrë në zonën e trafikut të aerodromit ose cirkuitin e trafikut të aerodromit kur kushtet meteorologjike të raportuara në atë aerodrom janë nën minimalen e mëposhtme:

1) Shikueshmëria e terrenit është më pak se 1 500 m, ose për helikopterët, me pak se 800 m;

2) Baza e reve është më pak se 180 m (600 ft).

SERA.5015 Rregullat e Fluturimit me Instrument (IFR) – Rregullat që iu aplikohen të gjitha fluturimeve IFR

a) Pajisjet e avionit

Avioni duhet të jetë i pajisur me instrumentet e përshtatshme dhe me pajisjet e duhura të lundrimit për rrugën që do të fluturohet, dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të operimeve të ajrit.

b) Nivelet minimale

Përveçse kur është e nevojshme për ngritje ose ulje, ose kur është autorizuar në mënyrë specifike nga Autoriteti i Aviacionit Civil, një fluturim IFR duhet të kryhet në një nivel i cili nuk është nën lartësinë minimale të fluturimit të përcaktuar nga shteti shqiptar mbi territorin e të cilit po fluturohet, ose, nëse nuk është përcaktuar një lartësi minimale fluturimi:

1. Mbi terren të lartë ose zona malore, në një nivel që është të paktën 600 m (2000 ft) mbi pengesën më të lartë që ndodhet brenda një rrezeje prej 8 km nga pozicioni i përafërt i avionit;

2. Kudo tjetër, ndryshe nga çfarë përcaktohet në (1), në një nivel që është të paktën 300 m (1000 ft) mbi pengesën më të lartë që ndodhet brenda një rrezeje prej 8 km rreze nga pozicioni i përafërt i tij;

c) Kalimi nga fluturim IFR në fluturim VFR

1. Një avion që zgjedh ta ndryshojë operimin e fluturimit nga në përputhje me rregullat e fluturimit me instrument, në përputhje me rregullat vizuale të fluturimit, duhet të njoftojë në mënyrë specifike njësinë e duhur të trafikut ajror që fluturimi IFR është anuluar dhe t'i komunikojë ndryshimet që i duhen bërë planit ekzistues të fluturimit.

2. Kur një avion që është duke operuar nën rregullat e fluturimit me instrument fluturon në, ose përballet me kushte meteorologjike vizuale, nuk do ta anulojë operimin në IFR, përveçse në qoftë se është parashikuar dhe planifikuar që fluturimi të vazhdohet për një periudhë të arsyeshme kohe në kushte meteorologjike vizuale të pandërprera.

3. Ndryshimi nga fluturimi IFR në fluturim VFR do të pranohet vetëm nëse mesazhi i iniciuar nga piloti në komandë, i cili përmban në mënyre specifike shprehjen "anuloj planin tim IFR të fluturimit", së bashku nëse ka edhe ndryshime të tjera që duhen t'i bëhen planit të tij të fundit të fluturimit, është marrë nga një njësi e trafikut ajror. Shërbimi i trafikut ajror nuk duhet të iniciojë asnjë ftesë në mënyrë direkte apo indirekte për të ndryshuar nga fluturimi IFR në VFR.

SERA.5020 IFR - Rregullat që i aplikohen fluturimeve IFR brenda hapësirës ajrore të kontrolluar

a) Fluturimet IFR duhet të kryen në përputhje me dispozitat e Seksionit (ose Pjesës) 8 gjatë operimit në hapësirë ajrore të kontrolluar.

b) Një fluturim IFR duke operuar në fluturim ekonomik *(cruising flight)* në hapësirën e kontrolluar duhet të fluturojë në nivel ekonomik ose, në qoftë se është autorizuar nga njësia e shërbimit të trafikut ajror të përdorë teknikat ekonomike të ngjitjes, midis dy niveleve ose mbi një nivel, të përzgjedhur nga tabela e niveleve ekonomike në shtojcën 3 (apendiks 3), vetëm se lidhja midis niveleve dhe udhëve të përshkruara nuk duhet të zbatohet kur është e përcaktuar ndryshe në lejen e kontrollit të trafikut ajror ose është përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil në publikimet e informacionit aeronautik.

SERA.5025 IFR- Rregullat e zbatuara në fluturimet IFR jashtë hapësirës ajrore të kontrolluar

a) Nivelet ekonomike të fluturimit

Një fluturim IFR që është duke operuar në nivelin ekonomik të fluturimit jashtë hapësirës ajrore të kontrolluar duhet të fluturojë në nivelin ekonomik që i përshtatet trajektores së tij të përcaktuar në tabelën e niveleve ekonomike në shtojcën 3, përveçse kur është përcaktuar ndryshe nga Autoriteti i Aviacionit Civil për fluturime në ose nën 900 m (3 000 ft) mbi nivelin e detit.

b) Komunikimet

Një fluturim IFR që është duke operuar jashtë hapësirës ajrore të kontrolluar, por brenda zonave ose në zona, ose përgjatë rrugëve, të përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me SERA.4001(b)(3) ose (4), duhet të mbajë një komunikim zanor ajër-tokë në kanalin e duhur të komunikimit, dhe të vendosë komunikim të ndërsjellët, sipas nevojës, me njësinë e shërbimeve të trafikut ajror që ofron shërbimin e informacionit të fluturimit.

c) Raportimet e pozicionit

Një fluturim IFR që po operon jashtë hapësirës ajrore të kontrolluar dhe i kërkohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil të mbajë nën monitorim komunikim zanor ajër-tokë në kanalin e duhur të komunikimit dhe të vendosë komunikim të

ndërsjellët, sipas nevojës, me njësinë e shërbimeve të trafikut ajror që ofron shërbimet e informacionit të fluturimit, duhet të raportojë pozicionin, siç përcaktohet në SERA.8025 për fluturimet e kontrolluara.

SEKSIONI 6
Klasifikimi i hapësirës ajrore

SERA.6001 Klasifikimi i hapësirave ajrore

a) Hapësira ajrore duhet të dezignohet sipas nevojës, në përputhje me klasifikimin e hapësirës ajrore në vijim dhe në përputhje me shtojcën 4:

1. *Klasi A*. Lejohen vetëm fluturimet IFR. Të gjitha fluturimeve iu ofrohet shërbimi i kontrollit të trafikut ajror dhe janë të ndarë nga njëri tjetri. Komunikimi i vazhdueshëm zanor ajër-tokë është i detyrueshëm për të gjitha fluturimet. Të gjitha fluturimet do t'i nënshtrohen lejeve të kontrollit të trafikut ajror.

2. *Klasi B*. Janë të lejuara fluturimet IFR dhe VFR. Të gjitha fluturimeve iu ofrohet shërbimi i kontrollit të trafikut ajror dhe janë të ndarë nga njëri tjetri. Komunikimi i vazhdueshëm zanor ajër-tokë është i detyrueshëm për të gjitha fluturimet. Të gjitha fluturimet i nënshtrohen lejeve të kontrollit të trafikut ajror.

3. *Klasi C*. Janë të lejuara fluturimet IFR dhe VFR. Të gjitha fluturimeve iu ofrohet shërbimi i kontrollit të trafikut ajror dhe fluturimet IFR janë të ndara nga fluturimet e tjera IFR dhe nga fluturimet VFR. Fluturimet VFR janë të ndarë nga fluturimet IFR dhe marrin informacion për trafikun në lidhje me fluturimet e tjerë VFR dhe këshillim për shmangien e trafikut, kur e kërkojnë atë. Komunikimi zanor ajër-tokë i vazhdueshëm është i detyrueshëm për të gjitha fluturimet. Për fluturimet VFR një limit shpejtësie prej 250 kts e përcaktuar si shpejtësi ajrore (IAS) aplikohet nën 3050 m (10 000 ft) AMSL, përveçse kur është miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për llojet e avionëve, të cilët për arsye teknike ose të sigurisë, nuk mund të mbajnë atë shpejtësi. Të gjitha fluturimet do t'i nënshtrohen lejeve të kontrollit të trafikut ajror.

4. *Klasi D*. janë të lejuara fluturimet IFR dhe të gjithë fluturimeve iu ofrohet shërbimi i kontrollit të trafikut ajror. Fluturimet IFR janë të ndara nga fluturimet e tjera IFR, marrin informacion mbi trafikun në lidhje me fluturimet VFR dhe këshillim për shmangien e trafikut kur e kërkojnë. Fluturimet VFR marrin informacion mbi trafikun në lidhje me të gjithë fluturimet e tjera dhe këshillim për shmangie të trafikut kur e kërkojnë. Komunikim zanor ajër-tokë i vazhdueshëm është i detyrueshëm për të gjithë fluturimet dhe një limit shpejtësie prej 250 kts IAS i aplikohet të gjitha fluturimeve nën 3050 m (10 000 ft) AMSL, përveçse kur është miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për llojet e avionëve, të cilët për arsye teknike ose të sigurisë, nuk mund të mbajnë atë shpejtësi. Të gjitha fluturimet i nënshtrohen lejeve të kontrollit të trafikut ajror.

5. *Klasi E*. Janë të lejuara fluturimet IFR dhe VFR. Fluturimeve IFR iu ofrohet shërbimi i kontrollit të trafikut ajror dhe janë të ndara nga fluturimet e tjera IFR. Të gjithë fluturimet marrin informacion mbi trafikun ajror, për sa është e mundur. Komunikimi zanor ajër-tokë i vazhdueshëm është i nevojshëm për të gjitha fluturimet IFR. Një limit shpejtësie prej 250 kts IAS aplikohet të gjitha fluturimeve nën 3050 m (10 000 ft) AMSL përveçse kur është miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për llojet e avionëve, të cilët për arsye teknike ose të sigurisë, nuk mund të mbajnë atë shpejtësi. Të gjithë fluturimet IFR do t'i nënshtrohen lejeve të kontrollit të trafikut ajror. Klasi E nuk duhet të përdoret për zonat e kontrollit.

6. *Klasi F*. Janë të lejuara fluturimet IFR dhe VFR. Të gjitha fluturimeve IFR do t'iu jepet shërbimi këshillues i trafikut ajror dhe të gjitha fluturimet do të marrin shërbimin e informacionit të fluturimit në qoftë se e kërkojnë atë. Komunikimi zanor ajër-tokë i vazhdueshëm është i detyrueshëm për të gjitha fluturimet IFR që marrin pjesë në shërbimin e këshillimit dhe të gjitha fluturimet IFR duhet të jenë në gjendje të vendosin komunikim zanor ajër-tokë. Një limit shpejtësie prej 250 kts IAS aplikohet fluturimeve nën 3050 m (10 000 ft) AMSL përveçse kur është miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për llojet e avionëve, të cilët për arsye teknike ose të sigurisë, nuk mund të mbajnë atë shpejtësi. Leja e kontrollit të trafikut ajror nuk është e nevojshme.

7. *Klasi G*. Fluturimet IFR dhe VFR janë të lejuara dhe marrin shërbimin e informacionit të fluturimit në qoftë se e kërkojnë atë. Të gjitha fluturimet IFR duhet të jenë në gjendje që të vendosin komunikim zanor ajër–tokë. Një limit

shpejtësie prej 250 kts IAS i aplikohet të gjithë fluturimeve nën 3050 m (10 000 ft) AMSL përveçse kur është miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për llojet e avionëve, të cilët për arsye teknike ose të sigurisë, nuk mund të mbajnë këtë shpejtësi. Leja e kontrollit të trafikut ajror nuk është e nevojshme.

8. Implementimi i klasit *F* duhet konsideruar si një mase e përkohshme deri në momentin që mund të zëvendësohet nga një klasifikim alternativ.

b) Klasifikimi i hapësirës ajrore do të bëhet në përputhje me nevojat e shtetit shqiptar, por e gjithë hapësira ajrore mbi FL 195 do të klasifikohet hapësirë ajrore e klasit C.

SERA.6005 Kërkesat për komunikimet, transponderin SSR dhe njoftuesin elektronik (*electronic conspiquity*) në hapësirën ajrore të hapësirës-U

a) Zona e detyrueshme radio (RMZ)

1. Fluturimet VFR që operojnë në pjesë të hapësirës ajrore të klasave E, F ose G dhe fluturimet IFR që operojnë në pjesë të hapësirës ajrore të klasave F ose G të përcaktuara si zonë e detyrueshme radio (RMZ) nga autoriteti kompetent, duhet të kenë vëzhgim të vazhdueshëm të komunikimit zanor ajër-tokë dhe të vendosin komunikim të dyanshëm, sipas nevojës, në kanalin e duhur të komunikimit, përveç rasteve kur janë në përputhje me dispozitat alternative të përcaktuara për atë hapësirë të caktuar ajrore nga OSHLA.

2) Para hyrjes në zonën e detyrueshme të radios, një thirrje paraprake që përmban përcaktimin e stacionit që thirret, shenjën e thirrjes, llojin e avionit, pozicionin, nivelin, synimet e fluturimit dhe informacione të tjera të përcaktuara nga AAC, duhet të kryhet nga pilotët në kanalin e duhur të komunikimit.

b) Zona e detyrueshme e transponderit (TMZ)

Të gjitha fluturimet që operojnë në hapësirën ajrore të përcaktuar nga autoriteti kompetent si zonë e detyrueshme për transponderët (TMZ) do të mbajnë dhe operojnë transponder SSR të aftë për të operuar në modalitetet A dhe C ose në modalitetin S, përveç rasteve kur janë në përputhje me dispozitat alternative të përshkruara për atë hapësirë të caktuar ajrore nga OSHLA.

c) Hapësira ajrore e hapësirës-U (kërkesat për hapësirën ajrore të Hapësirës-U do të jenë të zbatueshme pas hyrjes në fuqi të rregullave bazë për këtë hapësirë dhe përcaktimit të asaj hapësire)

Avionët me pilot që operojnë në hapësirën ajrore të përcaktuar nga autoriteti kompetent si hapësirë ajrore e hapësirës-U, dhe të cilëve nuk u ofrohet një shërbim i kontrollit të trafikut ajror nga OSHLA, do të bëhen vazhdimisht të dukshëm elektronikisht për ofruesit e shërbimeve të hapësirës U.

d) Hapësirat ajrore të përcaktuara si zona të detyrueshme për radio, zona të detyrueshme për transponder ose hapësirë ajrore e hapësirës-U do të shpallen në mënyrën e duhur në publikimet e informacionit aeronautik.

SEKSIONI 7
SHËRBIMET E TRAFIKUT AJROR

SERA.7001. Të përgjithshme – objektivat e shërbimeve të trafikut ajror

Objektivat e shërbimeve të trafikut ajror duhet të jenë:

a) Të parandalojë përplasjet midis avionëve;

b) Të parandalojë përplasjen midis avionëve në zonën e manovrimit dhe pengesave në atë zonë;

c) Të shpejtojë dhe të mbajë një fluks të rregullt të trafikut ajror;

d) Të sigurojë këshillim dhe informacion të dobishëm për sigurinë dhe operimin efikas të fluturimeve;

e) Të lajmërojë organizmat e duhura për avionët në nevojë për kërkim dhe shpëtim, dhe të ndihmojë këto organizata siç kërkohet.

SERA 7002 Informacion për rrezik përplasje kur shërbimi i trafikut ajror bazohet në mbikëqyrje me radar apo mjete identifikimi të ngjashme

a) Kur një fluturim i kontrolluar i identifikuar po shkon drejt një pike konflikti me një mjet fluturues të panjohur, e cila konsiderohet rrezik përplasje, piloti i fluturimit të kontrolluar, për sa të jetë e mundur:

1. Të informohet për mjetin fluturues të panjohur, dhe nëse e kërkon piloti ose nëse e gjykon kontrollori, duhet t'i sugjerohet një manovër shmangie, dhe;

2. Të njoftohet kur konflikti nuk ekziston më.

SERA.7005 Koordinimi midis operatorit të avionit dhe shërbimeve të trafikut ajror

a) Njësitë e shërbimeve të trafikut ajror, në përmbushjen e objektivave të tyre, duhet të marrin në konsideratë kriteret për operatoret e avionëve që

burojnë nga detyrimet e këtyre të fundit, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për Operimet e Ajrit, dhe, në qoftë se kërkohet nga operatoret e avionëve, duhet të vendosin në dispozicion të tyre ose të përfaqësuesve të përcaktuar informacionin në fjalë, në formën që e disponojnë, i cili do t'u mundësojë operatorëve ose përfaqësuesve të tyre të përcaktuar të kryejnë detyrat e tyre.

b) Kur kërkohet nga një operator avioni, mesazhet (përfshirë raportet e pozicionit) e marra nga njësitë e shërbimeve të trafikut ajror dhe të lidhura me operimin e avionit për të cilin shërbimi i kontrollit operacional sigurohet nga ai operator avioni, duhet, për aq sa është e mundur, t'i vendosen në dispozicion menjëherë të operatorit të avionit ose një përfaqësues të zgjedhur, në përputhje me procedurat e rëna dakot në nivel lokal.

SEKSIONI 8

Shërbimi i kontrollit të trafikut ajror

SERA.8001 Aplikimi

Shërbimi i kontrollit të trafikut ajror duhet t'iu ofrohet:

a) Të gjitha fluturimeve IFR në hapësirën ajrore të klasit A, B, C, D dhe E;

b) Të gjitha fluturimeve VFR në hapësirën ajrore të klasit B, C dhe D;

c) Të gjitha fluturimeve speciale VFR;

d) Të gjithë trafikut të aerodromit në aerodromet e kontrolluara.

SERA.8005 Operimi i shërbimit të kontrollit të trafikut ajror

a) Në mënyrë që të ofrojë shërbimin e kontrollit të trafikut ajror, një njësi e kontrollit të trafikut ajror duhet:

1) Të pajiset me informacion për lëvizjen e planifikuar të secilit avion, ose devijime prej kësaj, dhe me informacionin më të fundit mbi progresin aktual të secilit avion;

2) Të përcaktojë, mbi bazën e informacionit të marrë, pozicionet relative të avionëve në dijeni të njeri tjetrit;

3) Të lëshojë një ose më shumë nga sa vijon: leje (*clearance*), udhëzime ose informacion me qëllim parandalimin e përplasjeve midis avionëve nën kontrollin e tij dhe të përshpejtojë dhe të mbajë një fluks të rregullt të trafikut;

4) Të koordinojë lejet sipas nevojës me njësite e tjera:

i. sa herë që një avion mund të jetë në konflikt me trafikun që është nën mbikëqyrjen e këtyre njësive të tjera;

ii. Përpara transferimit të kontrollit të një avioni njësive të tjera.

b) Lejet e dhëna nga njësite e kontrollit të trafikut ajror duhet të sigurojnë ndarje:

1) Midis të gjitha fluturimeve në hapësirat ajrore të klasit A dhe B;

2) Midis të gjitha fluturimeve IFR në hapësirat ajrore të klasit C, D dhe E;

3) Midis të gjitha fluturimeve IFR dhe VFR në hapësirën ajrore të klasit C;

4) Midis fluturimeve IFR dhe fluturimeve speciale VFR;

5) Midis fluturimeve speciale VFR përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

përveçse, kur kërkohet nga piloti i një avioni dhe pranohet nga piloti i avionit tjetër dhe nëse kjo lejohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, për rastet e listuar nën b) më sipër, në hapësirat ajrore të klasit D dhe E, një fluturim mund të lejohet me kusht që të ruajë ndarjen e vet për një pjesë të caktuar të fluturimit nën 3050m (10000ft) gjatë ngritjes ose zbritjes, gjatë ditës në kushte meteorologjike vizuale.

c) Përveç rasteve të operimeve në pista paralele ose thuajse paralele, si në pikën ATS.TR.255 të aneksit IV të urdhrit të ministrit nr. 193, datë 6.10.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre", ose kur një reduktim në ndarjen minimale në afërsi të aerodromeve mund të aplikohet, ndarja nga një njësi e kontrollit të trafikut ajror "KTA/ATC" do të merret nga të paktën një prej rasteve në vijim:

1) Ndarja vertikale, e arritur duke caktuar nivele të ndryshme të përzgjedhura nga tabela e niveleve optimale të fluturimeve në shtojcën 3, përveç kur lidhja midis niveleve për t'u ndjekur siç përshkruhet në të nuk do të aplikohet kur është përcaktuar ndryshe në publikimet e informacionit aeronautik ose në lejet (*clearance*) e KTA/ATC (kontrollit të trafikut ajror). Ndarja minimale vertikale duhet të

jetë e plotë 300 m (1 000 ft) deri në dhe duke e përfshirë FL 410 dhe 600 m (2 000 ft) mbi këtë nivel. Informacioni gjeometrik i lartësisë nuk do të përdoret për të vendosur ndarjen vertikale;

2) Ndarja horizontale, e arritur duke siguruar:

i. Ndarjen gjatësore, duke mbajtur një interval midis avionëve që operojnë përgjatë trajektoreve të njëjta, që takohen në një pikë ose reciproke, të shprehur në kohë ose në distancë; ose

ii. Ndarja anësore, duke i mbajtur avionët në rrugë të ndryshme ose në zona gjeografike të ndryshme.

SERA.8010 Minimumi i ndarjes

a) Përzgjedhja e minimumit të ndarjes për aplikim brenda një pjese të caktuar të hapësirës ajrore duhet të bëhet nga OSHLA përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror dhe të miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Për trafikun që do kalojë nga një hapësirë ajrore në hapësirat ajrore ngjitur dhe për rrugët që janë më afër kufirit të përbashkët se sa ndarja minimale e aplikueshme në këto rrethana, përzgjedhja e ndarjes minimale duhet të bëhet me konsultim midis OSHLA-ve përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror në hapësirat ajrore fqinje.

c) Detajet e ndarjes minimale të përzgjedhur dhe të zonave në të cilat do aplikohet duhet t'i njoftohen:

1) Njësive të shërbimeve të trafikut ajror të interesuar; dhe

2) pilotëve dhe operatorëve të avionëve nëpërmjet publikimeve të informacionit aeronautik, kur ndarja bazohet në përdorimin nga avionët e pajisjeve lundruese ndihmëse specifike dhe të teknikave specifike të lundrimit ajror.

SERA.8012 Aplikimi i ndarjeve minimale të trages së mjetit fluturues

a) Njësitë e kontrollit të trafikut ajror do të zbatojnë minimumin e ndarjes së turbulencës (*wake turbulence*) për avionët në fazat e afrimit dhe nisjes së fluturimit në ndonjë nga rrethanat e mëposhtme:

1) një avion po operon direkt pas një avioni tjetër në të njëjtën lartësi mbi nivelin e detit ose më pak se 300 m (1 000 ft) poshtë tij;

2) të dy avionët po përdorin të njëjtën pistë ose pistë paralele të ndarë me më pak se 760 m (2 500 ft);

3) një avion po kalon pas një avioni tjetër në të njëjtën lartësi mbi nivelin e detit ose më pak se 300 m (1 000 ft) poshtë tij.

b) Paragrafi (a) nuk do të zbatohet për fluturimet VFR mbërritëse dhe për fluturimet IFR mbërritëse që kryejnë afrime vizuale kur avioni ka raportuar se e sheh avionin paraardhës dhe është udhëzuar ta ndjekë dhe mbajë ndarjen vetë prej tij. Në ato raste, njësia e kontrollit të trafikut ajror do ta paralajmërojë për turbulencë *(wake turbulence).*

SERA.8015 Lejet e kontrollit të trafikut ajror

a) Lejet e kontrollit të trafikut ajror duhet të bazohen vetëm në kriteret në vijim për ofrimin e shërbimit të kontrollit të trafikut ajror:

1) Lejet do të jepen vetëm për përshpejtimin dhe ndarjen e trafikut ajror dhe do të bazohen në kushtet e njohura të trafikut që afektojnë sigurinë në operimet e mjeteve fluturues. Kushte trafiku të tilla përfshijnë jo vetëm mjetet fluturues në ajër dhe në zonën e manovrimit mbi të cilën po ushtrohet kontroll, por edhe çdo trafik për shkak të automjeteve ose pengesa të tjera që nuk janë instaluar në mënyrë të përhershme në zonën e manovrimit në përdorim;

2) Njësitë KTA (ATC) do t'i japin këto leje KTA (ATC) sipas nevojës për të parandaluar përplasjet dhe për të përshpejtuar dhe mbajtur një ecuri trafiku të rregullt:

3) Lejet KTA(ATC) do të jepen brenda një kohe të tillë që siguron që ato i janë transmetuar mjetit fluturues duke i lënë kohën e nevojshme për të vepruar në përputhje me to.

b) Operimet që kanë nevojë për leje:

1) një leje e kontrollit të trafikut ajror duhet të merret përpara se të operohet një fluturim i kontrolluar, ose një pjesë të fluturimit si fluturim i kontrolluar. Një leje e tillë duhet të kërkohet përmes dorëzimit të një plani fluturimi pranë një njësie të kontrollit të trafikut ajror.

2) Piloti në komandë i një avioni duhet të informojë kontrollin e trafikut ajror nëse një leje e kontrollit të trafikut ajror nuk është e pranueshme në këto raste, kontrolli i trafikut ajror duhet të lëshojë një leje të ndryshuar, nëse është e mundur.

3) Kurdoherë që një avion ka kërkuar një leje që kërkon përparësi, një raport që shpjegon nevojën për përparësi duhet të paraqitet, nëse kërkohet nga njësia përkatëse e kontrollit të trafikut ajror.

4) *Mundësia e ndryshimit të lejes gjatë fluturimit.* Nëse, përpara nisjes, është parashikuar që, në varësi të

kohëzgjatjes së karburantit dhe në varësi të ndryshimit të lejes në fluturim mund të merret një vendim për të vazhduar në një aerodrom me destinacion tjetër, njësitë e duhura të kontrollit të trafikut ajror duhet të njoftohen për këtë nëpërmjet përfshirjes në planin e fluturimit të informacionit që lidhet me rrugën e ndryshuar (kur është e njohur) dhe destinacionin e ndryshuar.

5) Një avion që operon në një aerodrom të kontrolluar nuk duhet të bëjë rulim në zonën e manovrimit pa leje nga kulla e kontrollit të aerodromit dhe duhet të veprojë në përputhje me çdo udhëzim të dhënë prej asaj njësie.

6) Kur është duke vektorizuar ose caktuar një rrugë direkte që nuk përfshihet në planin e fluturimit, një kontrollor i trafikut ajror që ofron shërbimin e survejimit SHTA (ATS) do të lëshojë leje (*clearance*) të tilla që klierencat e pengesave të përshkruara ekzistojnë gjatë gjithë kohës derisa avioni të arrijë në pikën ku piloti i ribashkohet rrugës së planit të fluturimit ose i bashkohet një rrugë SHTA (ATS) ose procedure instrumentale të publikuar ."

c) Lejet për fluturimet transonike

1) Leja e kontrollit të trafikut ajror në lidhje me fazën e përshpejtimit transonik të një fluturimi supersonik duhet të zgjatet minimalisht deri në fund të asaj faze.

2) Leja e kontrollit të trafikut ajror në lidhje me uljen e shpejtësisë dhe zbritjen e një avioni nga lundrimi supersonik në fluturim subsonik duhet të synojë të sigurojë zbritje të pandërprerë të paktën gjatë kësaj faze.

d) Përmbajtja e lejeve

Një leje e kontrollit të trafikut ajror duhet të përmbajë:

1) Identifikimin e avionit siç tregohet në planin e fluturimit;

2) Limitin e lejes;

3) Rrugën e fluturimit

i. Korridori i fluturimit duhet të detajohet në secilën leje kur konsiderohet e nevojshme; dhe

ii. fraza "I lejuar via korridorit të fluturimit të planizuar" nuk do të përdoret kur jepet një leje e re.

4) Nivelin/et e fluturimit për të gjithë rrugën ose pjesë të saj dhe ndryshimet e niveleve nëse kërkohet;

5) Çdo udhëzim ose informacion i nevojshëm për çështje të tjera, të tilla si slotet për nisjet ATFM nëse është e aplikueshme, manovrat e afrimit ose nisjes , komunikimet dhe koha e skadimit të lejes *(clearance)*.

e) Përsëritja (*read-back*) e lejeve (*clerance*), udhëzimeve dhe informacionit që lidhet me sigurinë e operimit.

1. Ekuipazhi i fluturimit duhet t'i përsëritë kontrollorit të trafikut ajror pjesët e lejes të kontrollit të trafikut ajror të lidhura me sigurinë dhe udhëzimet të cilat janë transmetuar me zë. Elementët më poshtë duhet të përsëriten gjithmonë:

i. Lejet e kontrollit të trafikut ajror për rrugën;

ii. Lejet dhe udhëzimet për të hyrë; për t'u ulur; për t'u ngritur nga; për të qëndruar në pritje; për të kaluar; për të ruluar dhe kthyer mbrapsht në çdo pistë; dhe

iii. Pista në përdorim, konfigurimet e altimetrit, kodet SSR, kanalet e komunikimit të caktuara rishtazi, udhëzimet e nivelit, udhëzimet e drejtimit dhe shpejtësisë; dhe

iv. Nivelet tranzitore, të raportuara nga kontrollori ose të përfshira në transmetimet ATIS.

2. Udhëzime ose leje të tjera, duke përfshirë lejet e kushtëzuara dhe udhëzimet për rulim, duhet të përsëriten ose të vërtetohet marrja e tyre në një mënyrë që të tregojë qartë që janë kuptuar dhe që do të zbatohen.

3. Kontrollori duhet të dëgjojë përsëritjen për t'u siguruar që konfirmimi i marrjes së lejes ose udhëzimit është bërë në mënyrë korrekte nga ekuipazhi i fluturimit dhe duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të korrigjuar çdo mospërputhje të konstatuar gjatë përsëritjes.

4. Përsëritja me zë nga marrësi i mesazheve të CPDLC nuk duhet të kërkohet, përveçse kur është e specifikuar nga OSHLA.

ea) Ndryshimet në leje përsa i përket korridorit ose nivelit

1. Kur jepet një leje që mbulon një ndryshim të kërkuar për korridorin e fluturimit ose nivelin, lloji i saktë i ndryshimit do të përfshihet në leje.

2. Kur kushtet e trafikut nuk do ta lejojnë lejimin e një ndryshimi të kërkuar, do të përdoret termi "jo në gjendje" (*UNABLE*). Kur është e justifikuar nga rrethanat, do të ofrohet një korridor ose nivel alternativ.

eb) Leje të lidhura me altimetrinë

1. Për fluturimet në zonat në të cilat është vendosur një lartësi barometrike tranzitore, pozicioni vertikal i mjetit fluturues, përveçse siç

përcaktohet në pikë (5) më poshtë, duhet të shprehet në termat e lartësive barometrike në ose nën nivelin tranzitor dhe në termat e niveleve të fluturimit në ose mbi nivelin tranzitor. Ndërkohë që kalon përmes shtresës/nivelit tranzitor pozicioni vertikal do të shprehet në termat e niveleve të fluturimit kur ngjitet dhe në termat e lartësive barometrike kur zbret.

2. Ekuipazhit të fluturimit do t'i jepet niveli tranzitor në kohën e duhur përpara se ta rrijë atë gjatë zbritjes.

3. Me përjashtim të rasteve kur dihet që avioni e ka marrë tashmë informacionin në një transmetim të drejtuar, një vlerë e përcaktuar e altimetrit QNH (QNH *altimeter setting*) do të përfshihet në:

i. lejen *(clearance)* e zbritjes, kur lejohet së pari të ulet në një lartësi mbi nivelin e detit nën nivelin tranzitor;

ii. lejen *(clearance)* e afrimit ose lejen për të hyrë në zonën e trafikut të aerodromit (*traffic circuit)*;

iii. lejen *(clearance)* për të vijuar rulimin për avionët që largohen.

4. Një QFE i altimetrit do t'i jepet mjetit fluturues kur kërkohet ose periodikisht në mënyrë të rregullt në përputhje me marrëveshjet lokale.

5. Kur një avioni i është dhënë leje për të zbritur ose kur një avion është informuar se pista është në dispozicion për t'u ulur në aerodromet AFIS dhe se avioni po përfundon afrimin e tij duke përdorur presionin atmosferik në lartësinë ortometrike të aerodromit (QFE), pozicioni vertikal i atij avioni do të shprehet në terma të lartësisë mbi lartësinë ortometrike të aerodromit gjatë asaj pjese të fluturimit të tij për të cilin mund të përdoret QFE, përveçse që duhet të shprehet edhe në terma të lartësisë mbi lartësinë ortometrike të pragut të pistës:

i. për pistat instrumentale nëse pragu i pistës është 2 m (7ft) ose më shumë nën nivelin e aerodromit; dhe

ii. për pistat e afrimit me precizion.

ec) Lejet e kushtëzuara

Frazeologjia e kushtëzuar, siç është "mbrapa mjetit fluturues në ulje" ose "mbas mjetit fluturues në nisje", nuk do të përdoren për lëvizjet që afektojnë pistën/at aktive, përveç rasteve kur mjetet fluturues ose automjetet në fjalë janë parë nga kontrollori i duhur dhe piloti. Mjeti fluturues ose automjeti që shkaktojnë kushtëzimin e lejes të lëshuar do të jenë mjeti fluturues/automjeti i parë që të kalojnë përballë mjetit tjetër fluturues në fjalë. Në të gjitha rastet një leje e kushtëzuar do të jepet sipas rendit në vijim dhe do të konsistojë në:

1) shenja e thirrjes;

2) kushti;

3) leja; dhe

4) një përsëritje të përmbledhur të kushtit;

f) Koordinimi i lejeve

1) Një leje e kontrollit të trafikut ajror duhet të koordinohet midis njësive të kontrollit të trafikut ajror për të mbuluar të gjithë rrugën e një avioni ose një pjesë të përcaktuar të saj, siç është përshkruar nga dispozita 2 deri te 6.

2) Një avion duhet t'i jepet leje për të gjithë rrugën deri në aeroportin e parë të planifikuar të uljes:

i) Kur ka qenë e mundur përpara nisjes, të koordinohet leja midis të gjitha njësive nën kontrollin e të cilave do të kalojë avioni; ose

ii) Kur ka siguri të mjaftueshme që do të vendoset koordinimi paraprak midis njësive të njëpasnjëshme nën kontrollin e të cilave do të vijë avioni.

3) Kur koordinimi siç parashikohet në pikën 2 nuk është arritur ose nuk është bërë paraprakisht, avioni duhet të lejohet vetëm deri në atë pikë ku koordinimi është i garantuar në mënyrë të arsyeshme; përpara se të arrijë në atë pikë, ose kur të arrijë në atë pikë, avioni duhet pajiset me leje të mëtejshme, udhëzimet e pritjes do të jepen në mënyrën e duhur.

4) Kur është përcaktuar nga njësia e shërbimeve të trafikut ajror, avionët duhet të kontaktojnë një njësi vijuese të shërbimit të kontrollit të trafikut ajror, me qëllimin për të marrë një leje vijuese përpara transferimit të pikës së kontrollit.

i. Avioni duhet të mbajë komunikimin e ndërsjellët të nevojshëm me njësinë aktuale të kontrollit të trafikut ajror ndërsa merr një leje vijuese (*downstream*).

ii. Një leje e lëshuar si leje vijuese duhet të jetë e identifikuar qartësisht si e tillë për pilotin.

iii. Përveçse kur është koordinuar, lejet vijuese nuk duhet të ndikojnë në profilin fillestar të fluturimit të avionit në të gjitha hapësirat, përveç asaj të njësisë së kontrollit të trafikut ajror përgjegjëse për dhënien e lejes vijuese.

5) Kur një avion planifikon të niset nga një aerodrom brenda një zone kontrolli për të hyrë në një zonë tjetër kontrolli, brenda një periudhe prej

30 minutash, ose një periudhe tjetër të përcaktuar siç është rëne dakord midis qendrave të kontrollit të zonës të përfshira, koordinimi me qendrën e kontrollit të zonës vijuese duhet të bëhet përpara lëshimit të lejes së nisjes.

6) Kur një avion planifikon të largohet nga një zonë kontrolli për fluturim jashtë hapësirës ajrore të kontrolluar, dhe në vijim do të rifutet në të njëjtën ose tjetër zonë kontrolli, mund të jepet një leje e vlefshme nga pika e nisjes deri në aeroportin e planifikuar për uljen e parë. Kjo leje ose ndryshimet e saj do të jetë e zbatueshme vetëm për ato pjesë të fluturimit që kryhen brenda hapësirës ajrore të kontrolluar.

SERA.8020 Zbatimi i planit të fluturimit

a) Me përjashtim të rasteve të parashikuara në (b) dhe (d) një avion duhet t'i përmbahet planit aktual të fluturimit ose pjesës së aplikueshme të një plani aktual fluturimi që është paraqitur për një fluturim të kontrolluar, përveçse nëse është bërë një kërkesë për ndryshim dhe është marrë leja nga njësia e duhur e kontrollit të trafikut ajror, ose nëse është krijuar një situatë urgjence e cila kërkon veprim të menjëhershëm nga avioni. Në këtë rast, në momentin që e lejojnë rrethanat, pasi të jetë ushtruar autoriteti i urgjencës, piloti duhet të njoftojë njësinë e duhur të shërbimeve të trafikut duhet të njoftohet për veprimin që u ndërmor dhe se ky veprim u krye nën autoritetin e urgjencës.

1) Përveçse kur është autorizuar ndryshe nga Autoriteti i Aviacionit Civil, ose drejtuar nga njësia e duhur e kontrollit ajror, fluturimet e kontrolluar duhet, për sa të jetë e mundur:

i) Kur ndodhen në një rrugë të përcaktuar SHTA(ATS), të operojnë përgjatë vijës së përcaktuar qendrore të asaj rruge; ose

ii) Kur ndodhet në çdo rrugë tjetër, të operojë direkt midis mjeteve navigacionale dhe/ose pikave që e përcaktojnë atë rrugë.

2) Përveç rasteve të autorizuara ndryshe nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose të udhëzuara nga njësia e kontrollit të trafikut ajror, një avion që operon përgjatë një korridori ajror të përcaktuar me mjete navigacionale shumëdrejtimshme me frekuencë të lartë (VOR), duhet të ndryshojë referencën e tij navigacionale nga mjeti paraardhës në atë pasardhës ose sa më afër të jetë e mundur pikës së ndërrimit të referencës navigacionale të vendosur.

3) Devijimi nga kërkesat në (1) duhet t'i njoftohet njësisë së duhur të shërbimeve të trafikut ajror.

b) *Ndryshimet e paplanizuara:* Kur një fluturim i kontrolluar devijon në mënyrë të padëshiruar (të paqëllimshme) nga plani aktual i fluturimit, duhet të ndërmerren veprimet më poshtë:

1) Devijimi prej trajektores: nëse avioni nuk është në trajektore, duhet të ndërmerren veprime menjëherë për të rregulluar drejtimin e avionit për ta rikthyer në trajektore sa më shpejt të jetë e mundur.

2) Ndryshimet në shpejtësinë e vërtetë (*true airspeed*) të avionit: nëse shpejtësia e vërtetë mesatare në nivelin ekonomik të fluturimit, midis pikave të raportimit, ndryshon ose pritet të ndryshojë me plus ose minus 5% të shpejtësisë së vërtetë të avionit nga ajo e deklaruar në planin e fluturimit, duhet të informohen njësitë e duhura të shërbimeve të trafikut ajror.

3) Ndryshime në kohën e parashikuar: nëse koha e parashikuar për pikën e ardhshme të aplikueshme të raportimit, për kufirin e rajonit të informacionit të fluturimit ose për aerodromin e mbërritjes, cilido vjen më përpara, rezulton të jetë gabim me më shume se 2 minuta nga ajo që i është njoftuar shërbimeve të trafikut ajror, ose periudhë kohe e tillë siç është përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, një kohë e parashikuar e ndryshuar duhet t'i njoftohet sa më shpejt që të jetë e mundur njësisë së duhur të shërbimeve të trafikut ajror.

4) Gjithashtu, kur një marrëveshje ADS-C është në fuqi, njësia e shërbimeve të trafikut ajror duhet të njoftohet automatikisht via data link sa herë që ka ndryshime përtej vlerave limit të përcaktuara në kontratën në fuqi të ADS-C.

c) Ndryshimet e kërkuara. Kërkesat për ndryshim të planit të fluturimit duhet të përfshijnë informacionin më poshtë:

1) Ndryshimi i nivelit të fluturimit: identifikimi i avionit; niveli i ri i kërkuar i fluturimit dhe shpejtësia e fluturimit në këtë nivel, parashikimet kohore të rishikuara (kur është e aplikueshme) në kufijtë e rajonit të informacionit të fluturimit vijues.

2) Ndryshimi i rrugës:

i. Destinacioni i pandryshuar: identifikimi i avionit; rregullat e fluturimit, përshkrimi i rrugës së re të fluturimit përfshirë të dhënat e planit të fluturimit të lidhura me të, duke filluar me pozicionin prej të cilit ndryshimi i kërkuar i rrugës fillon; parashikimet

kohore të rishikuara; çdo informacion tjetër me rëndësi në lidhje me këtë.

ii. Destinacioni i ndryshuar: identifikimi i avionit; rregullat e fluturimit, përshkrimi i rrugës së ndryshuar të fluturimit për në aerodromin e rishikuar të mbërritjes përfshirë të dhënat e planit të fluturimit të lidhura me këtë, duke filluar me pozicionin prej të cilit ndryshimi i kërkuar i rrugës fillon; parashikimet kohore të rishikuara, aerodromet rezervë; çdo informacion tjetër me rëndësi në lidhje me këtë.

d) *Përkeqësimi i motit nën VMC*. Kur bëhet e qartë që fluturimi në VMC në përputhje me planin e tij aktual të fluturimit nuk do të jetë i mundur nga ana praktike, një fluturim VFR që operon si fluturim i kontrolluar duhet:

1) Të kërkojë një leje të rishikuar që e lejon avionin të vazhdojë në VMC për në aerodromin e mbërritjes ose atë rezervë, ose për të dalë nga hapësira në të cilën kërkohet një leje e kontrollit të trafikut ajror; ose

2) Nëse nuk mund të merret leje në përputhje me a), të vazhdojë të operojë në VMC dhe të njoftojë njësinë e duhur të kontrollit të trafikut ajror për veprimin që po ndërmerret për t'u larguar nga hapësira në fjalë ose për t'u ulur në aerodromin e përshtatshëm më të afërt; ose

3) Nëse po operon brenda një zone kontrolli, të kërkojë autorizim për të operuar si fluturim VFR special; ose

4) Të kërkojë leje për të operuar në përputhje me rregullat e fluturimit me instrument.

SERA.8025 Raportimet e pozicionit

a) Përveçse kur është përjashtuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose nga njësia e duhur e shërbimeve të trafikut ajror nën kushtet e përcaktuara nga ai autoritet, një fluturim i kontrolluar duhet t'i raportojë njësisë së duhur të shërbimeve të trafikut ajror, sa më shpejt të jetë e mundur, kohën dhe nivelin e kalimit të secilës pikë të përcaktuar për raportim të detyrueshëm, së bashku me çdo informacion tjetër të kërkuar. Raportet e pozicionit duhen bërë në mënyrë të ngjashme në lidhje me pikat të tjera kur kërkohet nga njësia e shërbimeve të trafikut ajror. Në mungesë të pikave të përcaktuara të raportimit, raportet e pozicionit duhet të bëhen në intervale të përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose të përcaktuara nga njësia e duhur e shërbimeve të trafikut ajror.

1) Fluturimet e kontrolluar të cilat i japin informacion rreth pozicionit njësisë së duhur të shërbimeve të trafikut ajror nëpërmjet komunikimit me data-link do të japin vetëm raportime të pozicionit në formë zanore vetëm nëse iu kërkohet.

2) Kur një fluturim i kontrolluar është përjashtuar nga detyrimi për të raportuar në pikat e raportimit të detyrueshëm të pozicionit, pilotët duhet, përveçse nëse raportimi i automatizuar i pozicionit është në fuqi, të ribëjë raportimin me zë ose:

i. Kur instruktohet të veprojë kështu;

ii. kur kështillohet që shërbimi i mbikëqyrjes SHTA ka përfunduar; ose

iii. kur kështillohet që identifikimi i mbikëqyrjes SHTA ka humbur.

3) Formati i raporteve të pozicionit duhet të jetë në përputhje me shtojcën 5, pika A';

SERA.8030. Përfundimi i kontrollit

Një fluturim i kontrolluar duhet, përveçse kur po ulet në një aerodrom të kontrolluar, të njoftojë njësinë e duhur të kontrollit të trafikut ajror në momentin që nuk është më subjekt i shërbimit të kontrollit të trafikut ajror.

SERA.8035. Komunikimet

a) Një avion që operon si një fluturim i kontrolluar duhet të mbajë komunikim zanor ajër–tokë të vazhdueshëm në kanalin e duhur të komunikimit, dhe të vendosë komunikim të dyanshëm sipas nevojave me, njësinë e duhur të kontrollit të trafikut ajror, përveçse siç mund të jetë vendosur nga OSHLA përkatëse në lidhje me avionët që janë pjesë e trafikut të aerodromit në një aerodrom të kontrolluar.

1) kërkesa që një avion të mbaje monitorim të komunikimit zanor ajër–tokë do të qëndrojë në fuqi kur të jetë vendosur CPDLC.

b) Republika e Shqipërisë duhet të zbatojë dispozitat e duhura në lidhje me dështimet e komunikimit, siç janë miratuar nën autoritetin e Konventës së Çikagos.

SEKSIONI 9
SHËRBIMI I INFORMACIONIT TË FLUTURIMIT

SERA.9001 Aplikimi

a) Shërbimi i informacionit të fluturimit duhet të jepet nga njësite e duhura të shërbimeve të trafikut

ajror për të gjithë avionët të cilët mund të afektohen nga ky informacion për të cilët:

1) Ofrohet shërbimi i kontrollit të trafikut ajror; ose

2) Janë të njohur për njësitë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror.

b) Marrja e shërbimit të informacionit të fluturimit nuk e liron pilotin në komandë prej përgjegjësive, dhe piloti në komandë duhet të marri vendimin final që lidhet me çdo ndryshim të sugjeruar të planit të fluturimit.

c) Aty ku njësite e shërbimeve të trafikut ajror ofrojnë si shërbimin e informacionit të fluturimit ashtu dhe shërbimin e kontrollit të trafikut ajror, ofrimi i shërbimit të kontrollit të trafikut ajror do të ketë përparësi mbi ofrimin e shërbimit të informacionit të fluturimit kurdoherë që ofrimi i shërbimit të kontrollit të trafikut ajror e kërkon diçka të tillë.

SERA.9005 Objekti i shërbimit të informacionit të fluturimit

a) Shërbimi i informacionit të fluturimit do të përfshijë ofrimin e:

1) Informacionit SIGMET dhe AIRMET;

2) Informacionit që lidhet me aktivitetin vullkanik para shpërthimit, shpërthime vullkanike dhe retë e hirit vullkanik;

3) Informacionit që lidhet me lëshimin në atmosferë të materialeve radioaktive ose substancave kimike toksike;

4) Informacionit për ndryshimet në disponueshmërinë e shërbimeve të radio navigimit;

5) Informacionit për ndryshimet e kushteve të aerodromeve dhe infrastrukturës të lidhur me to, përfshirë informacionin për gjendjen e zonave të lëvizjes të aerodromit kur ato janë të prekura nga bora, akulli ose thellësi të konsiderueshme të ujit;

6) Informacionit për balonat e lira pa njeri;

7) Informacionit mbi konfigurimin dhe gjendjen anormale të avionit;

8) çdo informacion tjetër që mund të ndikojë në sigurinë në operim.

b) Shërbimi i informacionit të fluturimit që i jepet fluturimeve duhet të përmbajë, përveç informacionit të përcaktuar në (a), ofrimin e informacionit në lidhje me:

1) Kushtet e motit të raportuara ose të parashikuara në aerodromet e nisjes, të destinacionit apo ato rezervë;

2) Rreziqet e përplasjes, për avionët që operojnë në hapësirat ajrore të klasit C, D, E, F dhe G;

3) për fluturimin mbi zonat ujore, kur është e mundur dhe kur kërkohet nga piloti, informacione si shenja e thirrjes në radio, pozicioni, trajektorja reale, shpejtësia, etj duhet të jenë në dispozicion.

4) mesazhe, duke përfshirë lejet, të marra nga njësitë e tjera të shërbimeve të trafikut ajror për t'u transmetuar tek avionët.

c) Shërbimi i informacionit të fluturimit që i jepet fluturimeve VFR duhet të përmbajë, përveç informacionit të përcaktuar në (a), ofrimin e informacionit të disponueshëm që i përkasin trafikut dhe kushteve meteorologjike përgjatë itinerarit të fluturimit që mund ta bëjnë operimin nën rregullat vizuale të fluturimit të pamundur.

d) AFIS i siguruar për fluturimet duhet të përfshijë, përveç artikujve përkatës të përshkruar në pikat (a) dhe (b), edhe sigurimin e informacionit në lidhje me:

1) risqet e përplasjes midis avionëve, mjeteve dhe personave që veprojnë në zonën e manovrimit;

2) pista në përdorim.

SERA.9010 Shërbimi automatik i informacionit të terminalit (ATIS)

a) Përdorimi i mesazheve SHAIT/ATIS në transmetim direkt kërkesë/përgjigje

1) Kur kërkohet nga piloti, mesazhet që aplikohen duhet të transmetohen nga njësia e duhur e shërbimeve të trafikut ajror.

2) Kurdoherë që ofrohen ATIS-Zanor dhe/ose digjital:

i) Avioni duhet të konfirmojë marrjen e informacionit në momentin e vendosjes së komunikimit me njësinë e shërbimeve të trafikut ajror që jep shërbimin e kontrollit të afrimit, kullën e kontrollit të aerodromit ose Shërbimin e Informacionit të Fluturimit të Aerodromit (AFIS), sipas rastit; dhe

ii) Njësia e duhur e shërbimeve të trafikut ajror duhet, kur i përgjigjet një avioni që konfirmon marrjen e një mesazhi ATIS ose në rastin e një avioni në ardhje në çdo kohe tjetër siç mund të jetë e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të pajisë avionin me konfigurimin aktual të altimetrit.

3) Informacioni i përfshirë në një ATIS aktual, marrja e të cilit është konfirmuar nga avioni i interesuar, nuk është e nevojshme të përfshihet në një transmetim direkt tek avioni, me përjashtim të

konfigurimit të lartësimatësit, i cili duhet të jepet në përputhje me pikën (2).

4) Nëse një avion konfirmon marrjen e një ATIS që nuk është më aktual, njësia SHTA do të duhet të ndërmarrë një nga veprimet e mëposhtme:

i. komunikojë avionit çdo element të informacionit që duhet të përditësohet;

ii. udhëzojë avionin të marrë informacionin aktual ATIS.

b) ATIS për avionët në ardhje dhe nisje

Mesazhet ATIS që përfshijnë informacionin si për mbërritjen ashtu dhe për nisjen duhet të përmbajnë elementët e informacionit në vijim sipas rendit të listës më poshtë:

1) Emri i aerodromit;

2) Treguesi i mbërritjes dhe/ose nisjes;

3) Lloji i kontratës, nëse komunikimi është nëpërmjet ATIS digjital;

4) Numri rendor i informacionit

5) Koha e vëzhgimit, nëse duhet;

6) Lloji/et e mënyrës së parashikuar të afrimit;

7) Pista/t në përdorim, statusi i sistemit të bllokimit në ulje që përbën një rrezik potencial, nëse ka;

8) Kushte sinjifikative të sipërfaqes së pistës dhe nëse duhet, kualiteti i frenimit;

9) Vonesa e pritjes, nëse duhet;

10) Niveli tranzitor, nëse aplikohet;

11) Informacion tjetër operacional me rëndësi;

12) Drejtimi i erës në sipërfaqe (në gradë magnetike) dhe shpejtësia, përfshirë ndryshimet e konsiderueshme dhe, nëse sensorët e erës në sipërfaqe, të lidhur specifikisht me pjesët e pistës/ave në përdorim, janë të disponueshëm dhe informacioni kërkohet nga operatorët e avionit, përcaktimin e pistës dhe pjesëve të pistës të cilave i referohet informacioni;

13) Shikueshmëria dhe nëse aplikohet dhe RVR[1], dhe nëse shikueshmëria/sensorët RVR të lidhur specifikisht me pjesët e pistës/pistave në përdorim janë të disponueshme dhe informacioni kërkohet nga operatorët, përcaktimin e pistës dhe pjesën e pistës së cilës i referohet informacioni;

14) Kushtet aktuale të motit[1];

15) Reja nën 1500 m (5000ft) ose nën lartësinë minimale më të lartë të sektorit, cilado është më e madhe, kumulonimbus, nëse qielli është i errësuar, shikueshmëria vertikale kur është e disponueshme[1];

16) Temperatura e ajrit;

17) Pika e vesës;

18) Vlerat e presionit atmosferik;

19) Çdo informacion në dispozicion në lidhje me fenomene meteorologjike të rëndësishme në zonat e afrimit dhe ngjitjes përfshirë ndryshimet e papritura të shpejtësisë dhe drejtimit të erës (*wind shear*), dhe informacion me rëndësi operacionale për motin aktual;

20) Raporte të motit (METAR ose SPECI) të cilat përcaktojnë dhe ndryshimet sinjifikative që pritet të ndodhin, kur është në dispozicion; dhe

21) Udhëzime specifike ATIS.

c) ATIS për avionët në mbërritje

Mesazhet ATIS që përmbajnë informacionin e mbërritjes duhet të përfshijnë vetëm elementet në vijim sipas rendit të listës më poshtë:

1) emrin e aerodromit;

2) treguesi i mbërritjes;

3) lloji i kontratës, nëse komunikimi është nëpërmjet D-ATIS;

4) numri rendor i informacionit;

5) koha e vëzhgimit, nëse duhet;

6) lloji i afrimit/eve që pritet/en;

7) pista/t kryesore të uljes; statusi i sistemit të frenimit që përbën një rrezik të mundshëm, nëse ka;

8) kushtet sinjifikative të sipërfaqes së pistës dhe nëse duhet, lehtësia e frenimit;

9) vonesa e pritjes, nëse duhet;

10) niveli i tranzitit, nëse aplikohet;

11) informacion tjetër operacional me shumë rendësi;

12) Drejtimi i erës në sipërfaqe (në gradë magnetike) dhe shpejtësia, përfshirë ndryshimet e konsiderueshme dhe, nëse sensorët e erës në sipërfaqe që lidhen specifikisht me pjesët e pistës/ave në përdorim janë të disponueshëm dhe informacioni kërkohet nga operatorët e avionit, përcaktimin e pistës dhe pjesës së pistës së cilës i referohet informacioni;

13) Shikueshmëria dhe kur aplikohet, RVR[1], dhe nëse shikueshmëria/sensorët RVR të lidhur

[1] Këto elementë zëvendësohen nga termi "CAVOK" kur kushtet në vijim ndodhin në të njëjtën kohë në momentin e observimit: a) shikueshmëria: 10 km ose më shumë, dhe shikueshmëria më e ulët e paraportuar; b) jo re me impakt operacional, dhe; (c) jo kushte moti sinjifikative për aviacionin.

[1] Këto elementë zëvendësohen nga termi "CAVOK" kur kushtet në vijim ndodhin në të njëjtën kohë në

specifikisht me pjesët e pistës/pistave në përdorim janë të disponueshme dhe informacioni kërkohet nga operatorët, përcaktimin e pistës dhe pjesën e pistës së cilës i referohet informacioni;

14) Kushtet aktuale të motit[1];

15) Reja nën 1 500 m (5 000 ft) ose nën lartësinë minimale më të lartë të sektorit, cilado që është më e madhe, kumulonimbus, nëse qielli është i errësuar, shikueshmërinë vertikale kur është e disponueshme[1];

16) Temperaturë e ajrit;

17) Pika e vesës;

18) Vlerat e presionit atmosferik;

19) Çdo informacion në dispozicion për fenomenet meteorologjike të rëndësishme në zonën e afrimit përfshirë luhatjet e papritura të drejtimit dhe shpejtësisë së erës, dhe informacionin me rëndësi operacionale për motin aktual;

20) Raporte të motit (METAR ose SPECI) të cilat përcaktojnë dhe ndryshimet sinjifikative që pritet të ndodhin, kur është në dispozicion; dhe

21) Udhëzime specifike të ATIS.

d) ATIS për avionët në nisje

Mesazhet ATIS që përfshijnë vetëm informacionin për nisjen duhet të përmbajnë elementet në vijim të informacionit si pas rendit të listës më poshtë:

1) emri i aerodromit;

2) treguesi i nisjes;

3) lloji i kontratës, nëse komunikimi është nëpërmjet D-ATIS;

4) numri rendor i informacionit;

5) koha e vëzhgimit, nëse duhet;

6) Pista/t që do të 3 përdoret/n për ngritje; statusi i sistemit të frenimit që përbën një rrezik të mundshëm, nëse ka

7) Kushtet sinjifikative të sipërfaqes së pistës/ave që do të përdoren për ngritje dhe nëse duhet, lehtësia e frenimit;

8) Vonesat në nisje, nëse vlen të përmendet;

9) niveli i tranzitimit, nëse aplikohet;

10) informacion tjetër thelbësor me karakter operacional;

11) Drejtimi i erës në sipërfaqe (në gradë magnetike) dhe shpejtësia, përfshirë ndryshimet e konsiderueshme dhe, nëse sensorët e erës në sipërfaqe që lidhen specifikisht me pjesët e pistës/ave në përdorim janë të disponueshme dhe informacioni është kërkuar nga operatoret e avionit, përcaktimin e pistës dhe pjesës së pistës së cilës i referohet informacioni;

12) Shikueshmëria dhe kur aplikohet, RVR[1], dhe nëse shikueshmëria/sensorët RVR të lidhur specifikisht me pjesët e pistës/pistave në përdorim janë të disponueshme dhe informacioni kërkohet nga operatorët, përcaktimin e pistës dhe pjesën e pistës së cilës i referohet informacioni;

13) Kushtet aktuale të motit[1];

14) Reja nën 1 500 m (5 000 ft) ose nën lartësinë minimale më të lartë të sektorit, cilado që është më e madhe, kumulonimbus, nëse qielli është i errësuar, shikueshmëria vertikale kur është e disponueshme[1];

15) Temperaturë e ajrit;

16) Pika e vesës;

17) Konfigurimi/et e vlerës së presionit atmosferik;

18) Çdo informacion në dispozicion për fenomenet meteorologjike të rëndësishme në zonën e ngjitjes përfshirë luhatjet e papritura të drejtimit dhe shpejtësisë së erës;

19) Raporte të motit (METAR ose SPECI) të cilat përcaktojnë dhe ndryshimet sinjifikative që pritet të ndodhin, kur është në dispozicion; dhe

20) Udhëzime specifike ATIS.

SEKSIONI 10
SHËRBIMI I GATISHMËRISË *(ALERTING SERVICE)*

SERA.10001 Aplikimi

a) Shërbimi i gatishmërisë do të ofrohet nga njësitë e shërbimeve të trafikut ajror:

1) Për të gjithë avionët që iu jepet shërbimi i kontrollit të trafikut ajror;

2) Në çdo rast që është e mundur, të gjithë avionëve të tjerë që kanë paraqitur një plan fluturimi ose që janë të njohur nga shërbimet e trafikut ajror; dhe

3) Për çdo avion që dihet ose besohet të jetë subjekt i një ndërhyrjeje të paligjshme.

b) Vetëm nëse përcaktohet ndryshe nga Autoriteti i Aviacionit Civil, mjetet fluturues të pajisur me radiokomunikim të dyanshëm të përshtatshëm duhet të raportojnë përgjatë periudhës kohore 20–40 minuta në vijim të kohës

momentin e observimit: a) shikueshmëria: 10 km ose më shumë, dhe shikueshmëria më e ulët e paraportuar; b) jo re me impakt operacional, dhe; (c) jo kushte moti sinjifikative për aviacionin.

së kontaktit të fundit, pavarësisht qëllimit të këtij kontakti, vetëm për të treguar që fluturimi po vazhdon sipas planit. Ky raport duhet të përfshijë identifikimin e mjetit fluturues dhe fjalët "Operimet normale".

c) Mesazhi "Operimet normale" do t'i transmetohet ajër-tokë një njësie SHTA të përshtatshme.';

SERA.10005 Informacioni për avionin që operon në afërsi të një avioni në gjendje emergjence

a) Kur është përcaktuar nga një njësi e shërbimeve të trafikut ajror që një avion është në gjendje emergjence, avionët e tjerë që dihet që janë në afërsi të avionit të përfshirë duhet, përveçse siç është parashikuar në (b), të njoftohen për llojin e emergjencës sa më shpejt të jetë e mundur.

b) Kur një njësi e shërbimeve të trafikut ajror është në dijeni ose beson se një avion po i nënshtrohet ndërhyrjes së paligjshme, nuk duhet bërë referim në komunikimin ajër-tokë të shërbimeve të trafikut ajror për llojin e emergjencës përveçse kur situata është referuar në fillim nga komunikimi i avionit të përfshirë dhe është e sigurt që referenca e bërë nuk do të përkeqësojë situatën.

SEKSIONI 11
NDËRHYRJET E PALIGJSHME, EMERGJENCAT DHE INTERCEPTIMI

SERA.11001 Të përgjithshme

a) Në rastin e një avioni i cili dihet ose besohet të jetë në gjendje emergjence, përfshirë të qenët subjekt i një ndërhyrje të paligjshme, njësitë e shërbimeve të trafikut ajror duhet t'i japin avionit vëmendje maksimale, asistencë dhe prioritet mbi çdo avion tjetër siç mund të jetë nevoja bazuar në rrethanat.

b) Veprimet e mëtejshme të kontrollit të trafikut ajror do të kushtëzohen nga qëllimet e pilotit, situata e përgjithshme e trafikut dhe dinamika aktuale e situatës.

SERA.11005 Ndërhyrjet e paligjshme

aa) Një mjet fluturues i cili është objekt i një ndërhyrje të paligjshme do të përpiqet ta vendosë transponderin te Kodi 7500 dhe të njoftojë njësinë e duhur SHTA për çdo rrethanë sinjifikative të lidhur me ndërhyrjen e paligjshme dhe për çdo devijim nga plani aktual i fluturimit i nxitur nga rrethanat, në mënyrë që njësia SHTA të mundet t'i japë prioritet mjetit fluturues dhe të minimizojë konfliktin me mjetet e tjerë fluturues.

ab) Nëse një mjet fluturues është objekt i ndërhyrjes së paligjshme, piloti në komande do të përpiqet ta ulë mjetin fluturues sa më shpejt të jetë e mundur në aerodromin e përshtatshëm më të afërt ose në një aerodrom të dedikuar të caktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, përveçse nëse rrethanat në bordin e mjetit fluturues diktojnë për të vepruar ndryshe.

b) Kur në një mjet fluturues ndodh një ndërhyrje e paligjshme ose dyshohet për një të tillë, njësite SHTA duhet t'i përgjigjen me shpejtësi kërkesave të avionit. Informacioni me rëndësi që lidhet me operimin e sigurt të fluturimit duhet të vazhdojë të transmetohet dhe duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme për të përshpejtuar kryerjen të gjitha fazave të fluturimit, sidomos uljen e sigurt të avionit.

c) Kur në një avion ndodh një ndërhyrje e paligjshme ose dyshohet për një të tillë, njësitë SHTA duhet, në përputhje me procedurat e rëna dakord në nivel lokal, të informojnë menjëherë Autoritetin e Aviacionit Civil, Forcat Ajrore, Policinë, Administratën e Aeroportit, NATO, dhe të shkëmbejnë informacionin e nevojshme me operatorin e mjetit fluturues ose përfaqësuesin e caktuar.

SERA.11010 Avionët që kanë humbur orientimin ose të paidentifikuar

Avioni që ka humbur orientimin ose është i pa identifikuar:

a) Në momentin që një njësi e shërbimeve të trafikut ajror merr informacion për një avion që ka humbur orientimin duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm siç janë përshkruar në (1) dhe (3) për të ndihmuar avionin dhe për t'i ofruar siguri fluturimit të tij.

1) Nëse pozicioni i avionit nuk dihet, njësia e shërbimeve të trafikut ajror, duhet:

i. Të përpiqet të vendosë komunikim të ndërsjellët me avionin, përveç nëse një komunikim i tillë ekziston tashmë;

ii. Të përdorë të gjitha mundësitë në dispozicion për të përcaktuar pozicionin e tij;

iii. Të njoftojë njësitë e tjera të shërbimeve të trafikut ajror në zonat e të cilave mund të ketë humbur orientimin avioni ose mund të humbë orientimin, duke marrë në konsideratë të gjithë

faktorët që mund të kenë ndikuar në navigimin e avionit në rrethanat që ka qenë;

iv. Të informojë, në përputhje me procedurat e rëna dakord nivel lokal, njësitë kompetente ushtarake dhe t'i pajisi ata me planin e fluturimit në fjalë dhe të dhëna të tjera që i përkasin avionit të humbur;

v. Të kërkojë nga njësitë e përmendura në (iii) dhe (iv) dhe nga avionët e tjerë në fluturim çdo lloj ndihme që të vendosë komunikim me avionin e humbur dhe të përcaktojë pozicionin e tij.

2) Kërkesat në (1)(iv) dhe (1)(v) aplikohen edhe për njësite e shërbimeve të trafikut ajror të njoftuara në përputhje me (1)(iii).

3) Kur pozicioni i avionit është përcaktuar, njësia e shërbimeve të trafikut ajror duhet:

i. Të këshillojë avionin për pozicionin dhe veprimet korrigjuese që do të merren. Kjo këshillë duhet të jepet menjëherë kur njësia e shërbimit të trafikut ajror është në dijeni që ka një mundësi për interceptim ose rrezik tjetër për sigurinë e avionit; dhe

ii. Të pajisë, sipas nevojës, njësitë e tjera të shërbimeve të trafikut ajror dhe njësitë e duhura ushtarake me informacione me rëndësi në lidhje me avionin e humbur dhe për çdo këshillë që i është dhënë avionit.

b) Në momentin që një njësi e shërbimeve të trafikut ajror vendoset në dijeni të një avioni të paidentifikuar në zonën e tij, duhet të përpiqet të përcaktojë identitetin e avionit kurdoherë që kjo është e nevojshme për dhënien e shërbimeve të trafikut ajror ose është kërkuar nga autoritetet kompetente ushtarake në përputhje me procedurat e rëna dakord në nivel lokal. Për të përmbushur sa më sipër, njësia e shërbimeve të trafikut ajror duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm duke marrë parasysh rrethanat:

1) Të përpiqet të vendosë komunikim të ndërsjellët me avionin;

2) Të kërkojë informacion për fluturimin nga njësitë e tjera të shërbimeve të trafikut ajror brenda rajonit të informacionit të fluturimit dhe të kërkojë ndihmën e tyre për të vendosur komunikim të ndërsjellët me avionin;

3) Të kërkojë informacion për fluturimin nga njësitë e tjera të shërbimeve të trafikut ajror që shërbejnë në rajonet fqinje të informacionit të fluturimit dhe të kërkojë ndihmën e tyre për të vendosur komunikim të ndërsjellët me avionin;

4) Të përpiqet ta marrë informacionin nga avionë të tjerë që ndodhen në atë zonë;

5) Njësia e shërbimeve të trafikut ajror duhet, sipas nevojës, të njoftojë njësinë kompetente ushtarake menjëherë sapo është përcaktuar identiteti avionit.

c) Në rastin e një avioni që ka humbur orientimin ose të paidentifikuar, mundësia që avioni të jetë subjekt i një ndërhyrjeje të paligjshme duhet të merret parasysh. Kur njësia e shërbimeve të trafikut ajror vlerëson se një avion që ka humbur orientimin ose i paidentifikuar mund të jetë subjekt i një ndërhyrjeje të paligjshme, Autoritetet përgjegjëse të përcaktuara nga shteti shqiptar duhet të njoftohet menjëherë, në përputhje me procedurat e rëna dakord në nivel lokal.

SERA.11012 Karburanti në nivel minimal dhe urgjenca për karburant

a) Kur një pilot raporton për gjendjen e karburantit në nivel minimal, kontrollori do ta informojë pilotin sa më shpejt të jetë e mundur për çdo vonesë që pritet ose që nuk pritet të ketë vonesa.

b) Kur niveli i karburantit e bën deklarimin e situatës së rrezikut të nevojshme, piloti, në përputhje me SERA.14095, do ta deklarojë atë duke përdorur sinjalin e radiotelefonisë (MAYDAY). Është preferuese që ta përsërisë 3 herë, e ndjekur nga natyra e situatës së rrezikut (Karburant).

SERA.11013 Degradimi i performancës së mjetit fluturues

a) Kurdoherë që, si rezultat i dështimit ose degradimit të navigimit, komunikimeve, lartësi matësit, kontrollit të fluturimit ose sistemeve të tjera, performanca e mjetit fluturues degradon poshtë nivelit të kërkuar në hapësirën ajrore në të cilën po operon, ekuipazhi i fluturimit do të informojë pa vonesë njësinë përkatëse KTA(ATC). Kur dështimi ose degradimi afekton ndarjen minimale në përdorim, kontrollori do të veprojë për të vendosur një tip tjetër ndarje ose ndarje minimale.

b) Degradimi ose dështimi i sistemit RNAV.

Kur një mjet fluturues nuk i përmbush specifikimet e kërkuara nga korridori ose procedura RNAV, si rezultat i një dështimi ose degradimi të sistemit RNAV, një leje e rishikuar do të kërkohet nga piloti.

c) Humbja e performancës së navigimit vertikal të kërkuar për hapësirën ajrore me ndarje vertikale minimale të reduktuar (RVSM)

1) Piloti do ta informojë kontrollin e trafikut ajror (KTA), sa më shpejt të jetë e mundur, për çdo rrethane në të cilën kriteret e performancës për navigim vertikal për hapësirën ajrore RVSM nuk mund të ruhen. Në të tilla raste, piloti duhet të marrë një leje KTA(ATS) të rishikuar përpara se të fillojë ndonjë devijim nga korridori dhe/ose niveli i fluturimit i lejuar, kur është e mundur. Kur një leje KTA(ATS) e rishikuar nuk mund të merret përpara këtij devijimi, piloti duhet të marrë një leje të rishikuar sa më shpejt të jetë e mundur pas devijimit.

2) Gjatë operimeve në, ose transitit vertikal përmes hapësirës ajrore RVSM me një mjet fluturues të paaprovuar për operime RVSM, piloti duhet të raportojë statusin "i pa-aprovuar" si në vijim:

i. në thirrjen e parë në çdo kanal brenda hapësirës ajrore RVSM;

ii. në të gjitha kërkesat për ndryshim niveli; dhe

iii. në të gjitha përsëritjet e lejeve të nivelit.

3) Kontrollorët e trafikut ajror duhet të konfirmojnë në mënyrë të qartë marrjen e mesazheve nga mjetet fluturues që raportojnë status të paaprovuar RVSM.

4) Degradimi i pajisjeve të mjetit fluturues — raportuar nga piloti:

i. Kur informohen nga piloti i një mjeti fluturues të aprovuar RVSM që po operon në hapësirë ajrore RVSM se pajisjet e mjetit fluturues nuk i përmbushin me kriteret RVSM, Kontrolli i Trafikut Ajror do ta konsiderojë mjetin fluturues si jo të aprovuar për RVSM.

ii. Kontrolli i Trafikut Ajror do të veprojë menjëherë për të vendosur një ndarje vertikale minimale prej 600 m (2000 ft) ose një ndarje horizontale të përshtatshme nga të gjithë mjetet e tjerë fluturues të interesuar që po operojnë në hapësirë ajrore RVSM. Një mjet fluturues i konsideruar jo i aprovuar RVSM normalisht do të nxirret jashtë nga hapësira RVSM nga Kontrollori i Trafikut Ajror kur kjo është e mundur.

iii. Pilotët duhet ta informojnë Kontrollin e Trafikut Ajror sa më shpejt të jetë e mundur për çdo rivendosje të funksionit normal të pajisjeve që i përmbush kriteret RVSM.

iv) Qendra e parë ACC që merr dijeni për një ndryshim të statusit RVSM të një mjeti fluturues do të koordinojë me qendrat ACC fqinje, si të jetë e përshtatshme.

5) Turbulencë e fortë-e paparashikuar:

i. Kur një mjet fluturues që po operon në hapësirë ajrore RVSM përballet me turbulencë të fortë për shkak të motit ose vorbullës së valës dhe piloti mendon se do të ketë impakt në aftësinë e mjetit fluturues për të ruajtur nivelin e fluturimit të lejuar, piloti do të informojë kontrollin e trafikut ajror. Kontrolli i trafikut ajror do të caktojë ose një ndarje horizontale të përshtatshme ose një ndarje vertikale minimale të shtuar.

ii. Kontrolli i trafikut ajror duhet, brenda mundësive, të akomodojë kërkesat e piloteve për ndryshime të nivelit të fluturimit dhe/ose korridorit të fluturimit dhe do të japin informacion për trafikun, sipas kërkesës.

iii. Kontrolli i trafikut ajror do të kërkojë raporte nga mjete fluturues të tjerë për të vendosur nëse RVSM duhet të pezullohet komplet apo brenda një brezi niveli fluturimi specifik dhe/ose zone.

iv. Qendra ACC që po e pezullon RVSM duhet t'i koordinojë me qendrat ACC fqinje këtë/këto pezullim(e) dhe çdo përshtatje të nevojshme në lidhje me kapacitetet e sektorit, si të jetë e përshtatshme, për të siguruar një rrjedhje të rregullt të transferimit të trafikut.

6) Turbulencë e fortë — e parashikuar:

i. Kur një parashikim meteorologjik parashikon turbulencë të fortë brenda hapësirës ajrore RVSM, Kontrolli i trafikut ajror do të vendosë nëse RVSM duhet të pezullohet dhe, nëse po, për sa kohë dhe për cilin nivel/e specifik/e fluturimit dhe/ose zonë specifike.

ii. Në rastet kur RVSM do të pezullohet, qendra e ACC që po e pezullon RVSM do të koordinojë me qendrat ACC fqinje në lidhje me nivelet e fluturimit të përshtatshëm për transferimin e trafikut, përveçse nëse një skeme kontigjence për caktimin e niveleve të fluturimit është vendosur me letër marrëveshje. Qendra ACC që pezullon RVSM do të koordinojë gjithashtu kapacitetet e aplikueshme të sektorit me qendrat ACC, si të jetë e përshtatshme;

SERA.11014 Këshillimet për shmangien e konfliktit ACAS (RA)

ACAS II duhet të përdoret gjatë fluturimit, përveçse siç përcaktohet në listën e pajisjeve

minimale të specifikuar në urdhrin e ministrit nr. 59, datë 30.1.2020 "Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore" që transpozon Rregulloren e Komisionit Evropian nr. 965/2012[1], në një mënyrë të tillë që mundëson prodhimin e indikacioneve RA për ekuipazhin e fluturimit kur konstatohet afërsi e tepërt me një avion tjetër. Kjo nuk do të aplikohet nëse kufizimi i indikacioneve në RA Mode (duke përdorur vetëm indikacionet këshilluese të trafikut ose ekuivalenten) është aktivizuar nga një procedure jo-normale ose si rezultat i kushteve që e kufizojnë performancën.

a) Në rastin e një ACAS RA, pilotët duhet:

1) të përgjigjen menjëherë duke ndjekur RA, siç përcaktohet, përveçse nëse të vepruarit kështu do të vendoste në rrezik avionin;

2) të ndjekin RA edhe nëse ka një konflikt midis RA dhe një instruksioni SHTA (ATC) për të manovruar;

3) të mos manovrojnë në drejtimin e kundërt të një RA-je;

4) sa më shpejt të jetë e mundur, kur e lejon ngarkesa e punës së ekuipazhit të fluturimit, të njoftojnë njësinë e duhur SHTA (ATC) për çdo RA që kërkon një devijim nga leja ose instruksioni aktual SHTA (ATC);

5) të veprojnë menjëherë në përputhje me çdo RA të ndryshuar;

6) t'i kufizojnë ndryshimet e rrugës së fluturimit në minimumin e mundshëm të nevojshëm për të qenë në përputhje me RA-të;

7) t'i rikthehen menjëherë kushteve të lejes ose instruksionit SHTA (ATC) kur konflikti të jetë zgjidhur; dhe

8) të njoftojnë SHTA (ATC) kur i rikthehen lejes aktuale;

b) Kur një pilot raporton një ACAS RA, kontrollori nuk duhet të përpiqet të modifikojë rrugën e fluturimit të avionit deri në momentin që piloti raporton "*Clear of Conflict*".

c) Në momentin që një pilot devijon nga leja ose instruksioni i tij ATC në përputhje me një RA, ose një pilot raporton një RA, kontrollori ndalon së qeni përgjegjës për ofrimin e ndarjes midis atij avioni dhe çdo avioni tjetër të afektuar si pasojë direkt e manovrës të influencuar nga RA. Kontrollori do ta rimarrë përgjegjësinë për ofrimin e ndarjes për të gjithë avionët e afektuar kur:

1) Kontrollori e konfirmon marrjen e një raporti nga ekuipazhi i fluturimit se avioni i është rikthyer lejes aktuale; ose

2) Kontrollori e konfirmon marrjen e një raporti nga ekuipazhi i fluturimit se avioni po i rikthehet lejes aktuale dhe lëshon një leje të ndryshuar, marrja e së cilës konfirmohet nga ekuipazhi i fluturimit.

SERA.11015 Interceptimi

a) Përveç interceptimit dhe shërbimit të shoqërimit të ofruar me kërkesë të një avioni, interceptimi i avionëve civilë duhet të kryhet në përputhje me rregullat e duhura dhe direktivat administrative të leshura nga shteti shqiptar në përputhje me Konventën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, dhe në veçanti me nenin 3(d) sipas të cilit shtetet anëtare të ICAO zotohen, kur nxjerrin rregullore për avionët e tyre shtetërorë, të kujdesen për sigurinë e navigimit të avionëve civilë.

b) Piloti në komandë i një avioni civil, kur interceptohet, duhet:

1) të ndjekë menjëherë udhëzimet e dhëna nga avioni interceptues, duke interpretuar dhe duke iu përgjigjur sinjaleve vizuale në përputhje me specifikimet në tabelat S11-1 dhe S11-2;

2) të njoftojë, nëse është e mundur, njësinë e duhur të shërbimeve të trafikut ajror;

3) të përpiqet të vendosë komunikim nëpërmjet radios me avionin interceptues ose me njësinë e duhur të kontrollit të interceptimit, duke bërë një thirrje të përgjithshme në frekuencën e emergjencës 121,5 MHz, duke dhënë identitetin e avionit të interceptuar dhe llojin e fluturimit; nëse nuk ka komunikim dhe nëse është e mundur, të përsërisë këtë thirrje në frekuencën e emergjencës 243 MHz;

4) nëse është i pajisur me transponder SSR, të përzgjedhë Mode A, Kodi 7700, përveçse kur është udhëzuar ndryshe nga njësia e duhur e shërbimeve të trafikut ajror;

5) nëse është i pajisur me ADS-B ose ADS-C, të përzgjedhë funksionalitetin e duhur të emergjencës, nëse është e mundur, përveçse kur është udhëzuar ndryshe nga njësia e duhur e shërbimeve të trafikut ajror.

[1] Rregullorja e Komisionit Evropian nr. 965/2012 e 5 tetorit 2012 që përcakton kriteret teknike dhe procedurat administrative të lidhura me operimet ajrore në përputhje me Rregulloren e Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian (KE) 216/2008 (OJ L 296, 25.10.2012, p. 1)

Tabela S11-1. Sinjalet e filluara nga avioni interceptues dhe përgjigjet nga avioni i interceptuar

Seria	Sinjalet e avionit interceptues	Kuptimi	Përgjigja e avionit të interceptuar	Kuptimi
1	DITË ose NATË – Avioni lëviz krahët dhe tregon dritat e navigimit me intervale të çrregullta (dhe dritat e uljes në rastin e një helikopteri) nga një pozicion pak më lart dhe përpara, dhe zakonisht në të majtë të avionit të interceptuar (ose në të djathtë nëse mjeti i interceptuar është helikopter) dhe, pas njohjes, një kthesë të ngadaltë niveli, normalisht në të majtë (ose në të djathtë në rastin e një helikopteri) në drejtimin e dëshiruar. *Shënim 1* *Kushtet meteorologjike ose terreni mund të kërkojnë që avioni interceptues të ndryshojë pozicionet dhe drejtimin e parashikuar më sipër, në serinë 1* *Shënim 2* *Nëse avioni i interceptuar nuk ka mundësi të ruajë ritmin e avionit interceptues, ky i fundit duhet të fluturojë një seri lëvizjesh të tipit race-track dhe të tundë krahët sa herë që kalon avionin e interceptuar*	Jeni interceptuar. Më ndiqni mua.	DITË ose NATË — Avioni tund krahët, duke ndezur dritat e navigimit në intervale të çrregullta që vazhdojnë	Kuptova, do të bindem.
2	DITË ose NATË – Një manovër e papritur shkëputje nga avioni i interceptuar që konsiston në një ngjitje prej 90 gradë ose më shumë pa kaluar vijën e fluturimit të avionit të interceptuar			
3	DITË ose NATË – Lëshimi i pajisjeve të uljes (nëse ka), duke treguar dritat e qëndrueshme të uljes dhe duke fluturuar mbi pistën në përdorim ose, nëse mjeti iinterceptuar është një helikopter, duke fluturuar mbi zonën e uljes të helikopterit.	Mund të vazhdoni	DITE ose NATE — Avioni tund krahët	Kuptova do të bindem.
	Në rastin e helikopterëve, helikopteri interceptues bën një afrim për ulje, duke ndenjur pezull mbi zonën e uljes	Ulu në këtë aerodrom.	DITË ose NATË - Po lëshoj pajisjet e uljes (nëse ka), duke treguar dritat e qëndrueshme të uljes dhe duke ndjekur avionin interceptues dhe, nëse, pas mbi fluturimit mbi pistën në përdorin ose në zonën e uljes të helikopterëve, ulja konsiderohet e sigurt, vazhdoj uljen	Kuptova do të bindem.

Tabela S11-2. Sinjalet e dhëna nga avioni i interceptuar dhe përgjigjet nga avioni interceptues

Seria	Sinjalet e Avionit *Të Interceptuar*	Kuptimi	Përgjigja e Avionit Interceptues	Kuptimi
4	DITË OSE NATË – Ngritja e mjeteve të uljes (nëse ka) dhe pulsimi i dritave të uljes kur kalon mbi pistën në përdorim ose në zonën e uljes të helikopterit në një lartësi më të madhe se 300 m (1 000 ft), por që nuk kalon 600 m (2 000 ft) (në rastin e një helikopteri, në lartësi që kalon 50 m (170 ft), por jo më lart se 100 m (330 ft) mbi nivelin e aerodromit, dhe vazhdon të rrotullohet në pistën në përdorim ose në zonën e uljes të helikopterëve, Nëse nuk është e mundur të pulsojë dritat e uljes, pulso çdo drite tjetër që është e mundur.	Aerodromi që keni caktuar është i papërshtatshëm.	DITË ose NATË - Nëse është e dëshiruar që avioni i interceptuar të ndjekë avionin interceptues në një aerodrom tjetër, avioni interceptues ngre pajisjet e uljes (nëse ka) dhe përdor sinjalet e Serisë 1 të përcaktuara për avionin interceptues. Nëse vendoset për lëshimin e avionit të interceptuar, avioni interceptues përdor sinjalet e Serisë 2 të përcaktuara për avionin interceptues	Kuptova, më ndiq. Kuptova, ju mund të vazhdoni.
5	DITË ose NATË – Ndezja dhe fikja e rregullt e të gjitha dritave në dispozicion, por në një mënyrë të tillë që të jetë ndryshe nga pulsimi i dritave	Nuk mundem të bindem	DITË ose NATË - Përdorni sinjalet e Serisë 2 të përshkruara për përgjimin e avionëve.	Kuptova.

6	DITË ose NATË — Pulsim jo i rregullt i të gjitha dritave në dispozicion	Në rrezik.	DITE ose NATE—Përdor sinjalet e Serisë 2 të parashikuar për avionët zbulues	Kuptova.

c) Nëse ndonjëri prej udhëzimeve të marra me radio prej ndonjë prej burimeve bie ndesh me ato të dhëna nga avioni interceptues me sinjale vizuale, avioni i interceptuar duhet të kërkojë sqarim të menjëhershëm ndërkohë që vazhdon t'i bindet udhëzimeve vizuale të dhëna nga avioni interceptues.

d) Nëse ndonjë prej udhëzimeve të marra me radio prej ndonjë prej burimeve bie ndesh me ato të dhëna nga avioni interceptues me radio, avioni i interceptuar duhet të kërkojë menjëherë sqarim ndërkohë që vazhdon t'iu bindet udhëzimeve me radio të dhëna nga avioni interceptues.

e) Nëse është vendosur kontakti me radio gjatë interceptimit, por komunikimi në një gjuhë të përbashkët nuk është i mundur, duhet të bëhen përpjekje për të përçuar udhëzimet, konfirmimet e marrjes së udhëzimeve dhe informacionin thelbësor duke përdorur frazat dhe mënyrën e të lexuarit të tyre të përcaktuar në tabelën S11-3 dhe duke e transmetuar çdo fjali 2 herë:

Tabela S11-3

Frazat për përdorim nga avioni interceptues			**Frazat për përdorim nga avioni interceptuar**		
Fraza	Shqiptimi(1)	Kuptimi	Fraza	Shqiptimi(1)	Kuptimi
CALL SIGN	KOL SA-IN	What is your call sign?	CALL SIGN (callsign)(2)	KOL SA-IN (callsign)	My call sign is (call sign)
FOLLOW	FOL-LO	Follow me	WILCO	VILL-KO	Understood, will comply
DESCEND	DEE-SEND	Descend for landing	_____		
			CANNOT	KANNNOTT	Unabletocomply
YOU LAND	YOU LAAND	Land at this aero-drome	REPEAT	REE-PEET	Repeat your instructionnn
			AM LOST	AM LOSST	Position unknown
PROCEED	PRO-SEED	You may proceed			
			MAYDAY	MAYDAY	I am indistress
			HIJACK(3)	HI-JACK	I have been hijacked
			LAND (placename)	LAAND (placename)	I request to land at(placename)
			DESCEND	Dee-SEND	I require descent

f) Në momentin që një njësi e shërbimeve të trafikut ajror ka dijeni që një avion po interceptohet në zonën e tij të përgjegjësisë, duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm duke marrë në konsideratë rrethanat:

1) Përpiqet të vendosë komunikim të ndërsjellët me avionin e interceptuar me çdo mundësi, duke përfshirë radio frekuencën në rast urgjence 121,5 MHz, përveçse nëse ky komunikim ekziston;

2) Të informojë pilotin e avionit të interceptuar për interceptimin;

3) Të vendosë kontakt me njësinë e kontrollit të interceptimit duke mbajtur komunikim të ndërsjellët me avionin zbulues, dhe t'i japë informacionin e caktuar për sa i përket avionit;

4) Të transmetojë mesazhet midis avionit interceptues ose njësisë të kontrollit të interceptimit dhe avionit të interceptuar, siç është e nevojshme;

5) Në koordinim të ngushtë me njësinë e kontrollit të interceptimit të marrë të gjitha masat për sigurinë e avionit të interceptuar;

6) Të njoftojë njësitë e shërbimeve të trafikut ajror që iu shërbejnë rajoneve të informacionit të fluturimit fqinje nëse duket se avioni ka devijuar nga këto rajone të informacionit të fluturimit fqinje.

g) Në momentin që një njësi e shërbimeve të trafikut ajror ka dijeni që një avion po interceptohet jashtë zonës së saj të përgjegjësisë, duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm duke marrë në konsideratë rrethanat:

1) Të informojë njësinë e shërbimeve të trafikut ajror që shërben në hapësirën ajrore në të cilën po ndodh interceptimi, duke i ofruar kësaj njësie me informacion të disponueshëm që do të ndihmojë në identifikimin e avionit dhe t'i kërkojë këtij të fundit të marrë masa në përputhje me (f);

2) Të transmetojë mesazhet midis avionit të interceptuar dhe njësisë kompetente të shërbimeve të trafikut ajror, njësisë të kontrollit të interceptimit ose avionit interceptues.

SEKSIONI 12
SHËRBIMET E LIDHURA ME METEOROLOGJINË – VËZHGIME TË AVIONËVE DHE RAPORTIMET NËPËRMJET KOMUNIKIMEVE ZANORE

SERA.12001 Llojet e vëzhgimeve të avionëve

a) Vëzhgimet e mëposhtme të avionëve duhet të bëhen në çdo fazë të fluturimit:

1) Vëzhgimet speciale të avionëve; dhe

2) Vëzhgime të tjera jo rutinë të avionëve.

SERA.12005 Vëzhgimet speciale të avionëve

a) Vëzhgimet speciale duhet të bëhen dhe të raportohen nga të gjithë avionët atëherë kur paraqiten ose hasen rrethanat e mëposhtme:

1) Turbulencë e rëndë ose e moderuar; ose

2) Akullim i rëndë ose i moderuar; ose

3) Valë malore (*mountain wave*) e rëndë; ose

4) Stuhi me rrufe, pa breshër, të errëta, të vendosura, të përhapura ose të vendosura në një linjë; ose

5) Stuhi me rrufe, me breshër, të errëta, të vendosura, të përhapura ose të vendosura në një linjë; ose

6) Stuhi e madhe pluhuri ose rërë; ose

7) Re të hirit vullkanik; ose

8) Aktivitet vullkanik para shpërthimit ose një shpërthim vullkanik; ose,

9) veprimi i frenimit të pistës nuk është aq i mirë sa raportohet.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të përcaktojë, sipas nevojës, kushte të tjera të cilat duhet të raportohen nga të gjithë avionët kur hasen ose vëzhgohen.

c) Ekuipazhet e fluturimit duhet të përpilojnë raportimet duke përdorur formatet e bazuar në modelin AIREP SPECIAL të detajuar në pikën A të shtojcës 5. Ato raportime duhet të jenë në përputhje me instruksionet e detajuara për raportim, siç përcaktohet në pikën 2 të shtojcës 5.

1) Instruksionet e detajuara, përfshi formatet e mesazheve dhe frazeologjinë që detajohen në shtojcën 5, duhet të përdoren nga ekuipazhi i fluturimit kur transmetojnë raportime nga ajri dhe nga njësia SHTA nëse i ritransmetojnë këto raportime.

2) Raportimet speciale nga ajri të avionëve të cilat përmbajnë vëzhgime rreth aktiviteteve vullkanike duhet të shkruhen në formatin përkatës të raportimeve speciale të avionëve për aktivitetet vullkanike. Formatet të cilat bazohen në modelin për raportimet speciale nga ajri të aktiviteteve vullkanike të pasqyruara në pikën B të shtojcës 5, duhet t'u jepen personelit të fluturimit që operojnë në korridoret ajrore të cilat mund të preken nga retë e hirit vullkanik.

SERA.12010 Vëzhgime të tjera jo rutinë të avionëve

Kur kushte të tjera meteorologjike që nuk janë të përshkruara në SERA.12005 (a), për shembull, ndryshimet në shpejtësinë/drejtimin e erës, janë hasur, dhe në opsionin e pilotit në komandë mund të ndikojnë sigurinë ose të afektojnë në mënyrë të konsiderueshme në efikasitetin e veprimeve të tjera të avionit, piloti në komandë duhet të informojë njësinë kompetente të shërbimeve të trafikut ajror sa më shpejt të jetë e mundur.

SERA.12015 Raportimi i vëzhgimeve të avionëve me komunikim zanor

a) Vëzhgimet e avionëve duhet të raportohen gjatë fluturimit në momentin që vëzhgimi është kryer ose më pas, sa më shpejt të jetë e mundur.

b) Vëzhgimet e avionëve duhet të raportohen si raport-ajror dhe duhet të bëhen në përputhje me specifikimet teknike në shtojcën 5.

SERA.12020 Shkëmbimi i raportimeve ajrore.

a) Njësitë e shërbimeve të trafikut ajror duhet të transmetojnë, sa më shpejt të jetë e mundur, raportime ajrore speciale dhe jo rutinë tek:

1) Avionët e tjerë të përfshire;

2) Zyrën përkatëse të vëzhgimeve meteorologjike (MVO) sipas pikës 3 të shtojcës 5; dhe

3) Njësi të tjera të shërbimeve të trafikut ajror të përfshira.

b) Transmetimet për avionët duhet të përsëriten në një frekuencë dhe të vazhdohen për një

periudhë kohe që duhet të përcaktohen nga ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror

SEKSIONI 13
TRANSPONDERAT SSR

SERA.13001 Operimi i një transponderi SSR

a) Nëse një mjet fluturues ka një transponder funksional SSR, piloti duhet të operojë transponderin gjatë gjithë kohës së fluturimit, pavarësisht nëse ky mjet fluturues është brenda apo jashtë hapësirave ku radari i mbikëqyrjes sekondar (SSR) përdoret për dhënien e shërbimit të trafikut ajror.

b) Pilotët nuk duhet të operojnë vetinë IDENT përveç nëse i kërkohet nga shërbimi i trafikut ajror.

c) Me përjashtim të fluturimit në hapësira ajrore të përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil ku mbajtja e transponderit është e detyrueshme, mjetet fluturuese të cilat nuk kanë energji elektrike të mjaftueshme janë të përjashtuara nga detyrimi për operimin gjatë gjithë kohës së transponderit.

SERA.13005 Procedura e vendosjes së kodeve të Mode A për transponderin SSR

a) Për të treguar që është në gjendje emergjence, piloti i një mjeti fluturues të pajisur me transponder SSR do të:

1) Përzgjedhë kodin 7700 për të treguar një situatë emergjence, me përjashtim të rastit nëse shërbimi i kontrollit të trafikut ajror e ka udhëzuar pilotin të operojë transponderin në një kod specifik. Në rastin e fundit, piloti mundet gjithsesi të përzgjedhë kodin 7700 kurdoherë që ka një arsye specifike për të besuar që ky do të ishte veprimi më i mirë i mundshëm.

2) Përzgjedhë kodin 7600 për të treguar gjendjen e dështimit të komunikimit me radio;

3) Përpiqet të përzgjedhë kodin 7500 për të treguar gjendjen e ndërhyrjes së jashtëligjshme. Në varësi të rrethanave, në vend të këtij kodi mund të përdoret kodi 7700.

b) Me përjashtim të rasteve të përmendura më sipër, piloti do të:

1) Përzgjedhë kodet ashtu siç instruktohet nga njësia e SHTA; ose

2) Në mungesë të instruksioneve nga SHTA në lidhje më përzgjedhjen e kodeve SSR, të përzgjedhë kodin 2000 ose një kod tjetër të përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, ose

3) Në rast se nuk merr shërbimin e trafikut ajror, të përzgjedhë kodin 7000 me qëllim përmirësimin e dallimit të një mjeti fluturues të pajisur me mjete të përshtatshme, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

c) Kur vëzhgohet në ekran që kodi i pasqyruar është ndryshe nga ai i përcaktuar për atë mjet fluturues:

1) pilotit do t'i kërkohet të konfirmojë kodin e përzgjedhur dhe, nëse e justifikon situata, të ripërzgjedhë kodin e duhur; dhe

2) nëse mospërputhja mes kodit të pasqyruar dhe kodit të përcaktuar vazhdon, pilotit mund t'i kërkohet të ndalojë operimin e transponderit të mjetit fluturues. Qendra tjetër e kontrollit dhe njësitë e tjera që ndikohen të cilat përdorin radarët e mbikëqyrjes sekondarë (SSR) dhe/ose multilateration (MLAT) për dhënien e shërbimit të trafikut ajror, duhet të informohen në përputhje me rrethanat.

SERA.13010 Informacioni i përfituar nga presioni i lartësisë barometrike

a) Nëse një mjet fluturues ka një pajisje funksionale të Mode C, piloti do të operojë në mënyrë të vazhdueshme këtë tip përveç rastit nëse urdhërohet ndryshe nga kontrolli i trafikut ajror

b) Përveç se kur përcaktohet ndryshe nga Autoriteti i Aviacionit Civil, verifikimi i informacionit të nivelit që vjen nga lartësi-presioni, do të kryhet të paktën një herë nga secila njësi SHTA e pajisur në mënyrë të përshtatshme në kontaktin fillestar me avionin në fjalë ose, nëse kjo nuk është e mundur, sa më shpejt të jetë e mundur pas kësaj.

SERA.13015 Procedura e vendosjes e transponderit SSR të Mode S të identifikimit të mjetit fluturues

a) Mjetet fluturuese me Mode S të cilët kanë vetinë e identifikimit të mjetit fluturues do të transmetojnë identifikimin e mjetit fluturues siç specifikohet në zërin 7 të planit të fluturimit të ICAOs ose, regjistrimin e mjetit fluturues në rast se nuk është mbushur një plan fluturimi.

b) Nëse vëzhgohet në ekrane që identifikimi i mjetit fluturues i transmetuar nga një mjet fluturues i pajisur me Mode S është ndryshe nga ajo çfarë pritet prej këtij mjeti fluturues, pilotit do t'i kërkohet të konfirmojë dhe, nëse është e

nevojshme, të ripërzgjedhë identifikimin korrekt të mjetit fluturues.

c) Nëse, në vazhdim të konfirmimit nga piloti që ka vendosur në mënyrë korrekte identifikimin e avionit në vetinë identifikuese të Mode S, mospërputhja vazhdon kontrollori do të ndjekë hapat e mëposhtëm:

1) Informon pilotin për vazhdueshmërinë e mospërputhjes;

2) Nëse është e mundur, korrigjon etiketën e cila tregon identifikimin e avionit në ekran; dhe

3) Njofton njësinë tjetër të kontrollit dhe njësitë e tjera të interesuara, të cilat përdorin Mode S për qëllim identifikimi, që identifikimi i mjetit fluturues transmetuar prej tij është i pasaktë.

SERA.13020 Dështim i transponderit SSR kur pajisja me një transponder funksional është i detyrueshëm

a) Nëse kemi dështim të transponderit mbas nisjes, njësite e kontrollit të trafikut ajror do të përpiqen të sigurojnë vazhdimësinë e fluturimit në aerodromin e destinacionit sipas planit të fluturimit. Megjithatë, pilotët mund të duhet të veprojnë në përputhje me kufizime specifike.

b) Në rastin e një transponderi i cili ka dështuar dhe nuk mund të riparohet përpara nisjes, pilotet do të:

1) Informojnë sa më shpejt të jetë e mundur shërbimin e trafikut ajror, mundësisht përpara se të paraqitet plani i fluturimit;

2) Vendosin në fushën 10 të planit të fluturimit ICAO, nën SSR, karakterin "N", për të treguar "mosfunksion të plotë të transponderit" ose, në rast të dështimit të pjesshëm të transponderit, vendosin karakterin që korrespondon me pjesën funksionale të tij: dhe

3) Veprojnë në përputhje me çdo procedurë të publikuar për të kërkuar një përjashtim nga kërkesat e mbajtjes së një transponderi funksional SSR.

SEKSIONI 14
PROCEDURA E KOMUNIKIMIT ME ZË

SERA.14001 Të përgjithshme

Frazeologjia e standardizuar do të përdoret në të gjitha situatat për të cilat është specifikuar. Vetëm kur frazeologjia e standardizuar nuk shërben për një transmetim të synuar, atëherë do të përdoret gjuha e zakonshme.

SERA.14005 Kategoritë e mesazheve

a) Kategoritë e mesazheve që trajtohen nga shërbim i lëvizshëm aeronautik, si dhe rendi i prioritetit në vendosjen e komunikimeve dhe transmetimin e mesazheve do të jetë sipas tabelës S14-1.

Tabela S14-1

Kategoria e mesazheve dhe sinjalet radiotelefonike sipas shkallës së prioritetit	Sinjali radiotelefonik
a) Thirrjet e rrezikut (*distress*), mesazhet e rrezikut dhe trafiku në rrezik	MAYDAY
b) Mesazhet e urgjencës, përfshi mesazhet paraprirë nga sinjalet mjekësore të transportit	PAN PAN ose PAN PAN MEDICAL
c) Komunikimet në lidhje me gjetjen e drejtimit	_____
d) Mesazhet e sigurisë në fluturim	_____
e) Mesazhet meteorologjike	_____
f) Mesazhet e rregullta në fluturim	_____

b) Mesazhet e rrezikut dhe trafiku në rrezik do të trajtohen sipas dispozitave në pikën SERA.14095.

c) Mesazhet e urgjencës dhe trafiku në urgjencë, duke përfshirë mesazhet paraprirë nga sinjalet e transportit mjekësor, do të trajtohen sipas dispozitave të pikës SERA.14095.

SERA .14010 Mesazhet e sigurisë në fluturim

Mesazhet e sigurisë në fluturim do të përfshijnë mesazhet e mëposhtme:

a) mesazhet e lëvizjes dhe kontrollit;

b) mesazhet që kanë një interes direkt për një mjet fluturues në fluturim, të cilat janë iniciuar

nga operatori i mjetit fluturues ose nga një mjet fluturues;

c) këshilla meteorologjike të cilat kanë një interes direkt për një mjet fluturues në fluturim ose gati për nisje (të komunikuara individualisht ose në transmetim në ajër);

d) mesazhe të tjera që i interesojnë një mjeti fluturues në fluturim ose gati për nisje.

SERA.14015 Gjuha që duhet të përdoret në komunikimin ajër-tokë

a) Komunikimet radiotelefonike ajër-tokë do të kryen në gjuhën angleze ose në gjuhën që përdoret normalisht nga stacioni në tokë.

b) Gjuha angleze do të jetë e vlefshme, me kërkesë nga çdo mjet fluturues, nga të gjitha stacionet në tokë që i shërbejnë aerodromeve të përcaktuara dhe korridoreve ajrore që përdoren nga shërbime ajrore ndërkombëtare. Përveçse kur përcaktohet ndryshe nga Autoriteti i Aviacionit Civil për raste të veçanta, gjuhngleze do të përdoret për komunikimet ndërmjet njësisë të SHTA dhe mjeteve fluturuese, në aerodrome me më shumë se 50 000 lëvizje ndërkombëtare IFR në vit. Autoriteti i Aviacionit Civil brenda datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, nëse gjuha angleze nuk është gjuha e vetme që përdoret për komunikimet ndërmjet njësisë të SHTA dhe mjeteve fluturuese në këto lloj aerodromesh, mund të vendosin të mos e aplikojnë kërkesën për përdorimin e gjuhës angleze dhe të informojnë Komisionin Evropian në për këtë. Në atë rast, Autoriteti i Aviacionit Civil, do të kryejë një studim, jo më vonë se hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, mbi mundësinë për të kërkuar përdorimin e gjuhës angleze për komunikimet ndërmjet njësisë SHTA dhe mjeteve fluturuese në ato aerodrome për arsye të sigurisë, për të shmangur inkursionet pa leje të mjeteve fluturuese në pista të okupuara ose rreziqe të tjera për sigurinë, duke marrë në konsiderate dispozitat e aplikueshme të BE-së dhe ligjet kombëtare në përdorimin e gjuhëve. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet ta bëjë atë studim publik dhe kur është e aplikueshme, të përcjellë konkluzionet tek EASA dhe Komisioni Evropian.

c) Gjuhët në dispozicion në një stacion të caktuar në tokë do të jenë pjesë e Publikimeve të Informacionit Aeronautik (AIP), si dhe informacioneve të tjera aeronautike të publikuara të cilat kanë lidhje me këtë lloj infrastrukture.

SERA.14020 Gërmëzimi i fjalëve në radiotelefoni

Kur emrat e duhur, shkurtime të shërbimeve dhe fjalë për të cilat shqiptimi është në dyshim germëzohen në radiotelefoni, do të përdoret alfabeti në tabelën S14-2.

Tabela S14-2. **Germëzimi alfabetik në radiotelefoni**

Letter	Word	Approximate pronunciation (Latin alphabet representation)
A	Alfa	AL FAH
B	Bravo	BRAH VOH
C	Charlie	CHAR LEE *or* SHAR LEE
D	Delta	DELL TAH
E	Echo	ECK OH
F	Foxtrot	FOKS TROT
G	Golf	GOLF
H	Hotel	HO TELL
I	India	IN DEE AH
J	Juliett	JEW LEE ETT
K	Kilo	KEY LOH

Letter	Word	Approximate pronunciation (Latin alphabet representation)
L	Lima	LEE MAH
M	Mike	MIKE
N	November	NO VEM BER
O	Oscar	OSS CAH
P	Papa	PAH PAH
Q	Quebec	KEH BECK
R	Romeo	ROW ME OH
S	Sierra	SEE AIR RAH
T	Tango	TANG GO
U	Uniform	YOU NEE FORM *or* OO NEE FORM
V	Victor	VIK TAH
W	Whiskey	WISS KEY
X	X-ray	ECKS RAY
Y	Yankee	YANG KEY
Z	Zulu	ZOO LOO

In the approximate representation using the Latin alphabet, syllables to be emphasized are underlined.

SERA.14025 Parimet që udhëheqin identifikimin e korridoreve SHTA (ATS) përveç korridoreve standarde të nisjes (SID) dhe ardhjes (STAR)

a) Përdorimi i treguesve të korridoreve SHTA në komunikime

1) Në komunikimet me zë, germa bazike e një treguesi duhet të shqiptohet sipas alfabetit të germëzimit të përcaktuar në tabelën S14-2.

2) Në rastin kur përdoren parashtesat K,U ose S, në komunikimin me zë ato do të shqiptohen si më poshtë:

i. K-KOPTER

ii. U-UPPER

iii. S-SUPERSONIC

b) Fjala "*kopter*" duhet të shqiptohet si te fjala "*helicopter*" dhe fjalët "*upper*" dhe "*supersonic*" njësoj si në gjuhën angleze.

SERA.14026 Pikat e rëndësishme

Normalisht gjuha e folur që emëron pikat e rëndësishme të cilat shënojnë një mjet të radionavigimit ose – pesë germa unike të germëzuara "emri i kodifikuar" për pikat e rëndësishme të cilat nuk shënojnë mjete të radio navigimit, do të përdoret për t'iu referuar pikave të rëndësishme në komunikimin me zë. Nëse nuk është përdorur gjuha e folur që emëron vendin e mjetit të radio navigimit, ajo do të zëvendësohet nga një tregues i kodifikuar e cila, në komunikimin zanor, do të shqiptohet sipas germëzimit alfabetik.

SERA.14030 Përdorimi i treguesve për korridoret standarde instrumentale të nisjes dhe ardhjes

Treguesit në gjuhën e folur do të përdoren në komunikimin me zë për korridoret instrumentale të nisjes dhe ardhjes.

SERA.14035 Transmetimi i numrave në radiotelefoni

a) Transmetimi i numrave

1) Të gjithë numrat e përdorur për transmetimin e shenjave të thirrjes së avionëve, kurset, pistën, drejtimin dhe shpejtësinë e erës do të transmetohen duke shqiptuar çdo numër veçmas.

i. Nivelet e fluturimit do të transmetohen duke shqiptuar çdo numër veçmas, përveç rastit të niveleve të fluturimit që mbarojnë me dy zero.

ii. Të dhënat e matësit të lartësisë do të transmetohen duke shqiptuar çdo numër veçmas, përveç rastit kur e dhëna është 1000hPa, e cila do të shqiptohet si "One Thousand" (një mijë)

iii. Të gjithë numrat të cilët përdoren në transmetimin e kodeve të transponderit do të transmetohen duke shqiptuar çdo numër veçmas përveç rastit kur kodi i transponderit përmban vetëm mijëshe. Në këtë rast numri i parë i mijëshes do të shqiptohet shoqëruar nga fjala "thousand" (mijë).

2) Të gjithë numrat të cilët përdoren në transmetimin e informacioneve të ndryshëm nga pika (a)(1) do të transmetohen duke shqiptuar çdo numër veçmas, përveç numrave të cilët përmbajnë qindëshe apo mijëshe të plota të cilat do të transmetohen duke shqiptuar çdo shifër sipas numrave të qindësheve apo mijësheve shoqëruar nga fjalët "hundred" (qind) ose "thousand" (mijë). Kombinimi i mijësheve dhe qindësheve të plota do të transmetohen duke shqiptuar çdo shifër në numër mijëshesh shoqëruar nga fjala "thousand" (mijë) dhe ndjekur nga numri i qindësheve shoqëruar nga fjala "hundred" (qind).

3) Në rastet kur është e nevojshme për të sqaruar numrin e transmetuar si mijëshe e plotë/ose qindëshe e plotë, numri do të transmetohet duke shqiptuar çdo shifër veçmas.

4) Kur japin informacionin në lidhje me drejtimin relativ të një objekti ose për trafikun në konflikt sipas termave të treguesit të orës, informacioni do të jepet duke shqiptuar shifrat së bashku si për shembull "TEN O'CLOCK" (ORA DHJETË) ose "ELEVEN O'CLOCK" (ORA NJËMBËDHJETË).

5) Numrat që përmbajnë pikë dhjetore do të transmetohen siç përshkruhet në pikën (a) (1) së bashku me pikën dhjetore në sekuencën e duhur, duke e shoqëruar me fjalën "DECIMAL".

6) Të gjashtë shifrat e një treguesi numerik do të përdoren për të identifikuar kanalin e transmetimit në komunikimet radiotelefonike VHF, përveç rasteve kur të dy shifrat e fundit (e pesta dhe e gjashta) janë zero, ku në këtë rast do të përdoren vetëm katër shifrat e para.

SERA.14040 Shqiptimi i numrave

Kur gjuha e komunikimit është Anglishtja, numrat do të transmetohen duke përdorur shqiptimin e treguar në tabelën S-14

Tabela S14-3

Numeral or numeral element	Pronunciation
0	ZE-RO
1	WUN
2	TOO
3	TREE
4	FOW-er
5	FIFE
6	SIX
7	SEV-en
8	AIT
9	NIN-er
10	TEN
11	EE-LE-VEN
12	TWELF
Decimal	DAY-SEE-MAL
Hundred	HUN-dred
Thousand	TOU-SAND

SERA.14045 Teknika e transmetimit

a) Transmetimet do të kryen në mënyrë të përmbledhur dhe të saktë me një ton normal bisede.

b) Fjalët dhe frazat e mëposhtme do të përdoren në komunikimet radiotelefonike sipas nevojës dhe do të kenë kuptimin e përcaktuar tabelën S14-4.

FRAZA	**KUPTIMI**
ACKNOWLEDGE (PRANOJ)	"Më lër të kuptoj që ju kini marrë dhe kuptuar këtë mesazh."
AFFIRM (POHOJ)	'Po"
APPROVED (APROVUAR)	"Leja për veprimet e propozuara është garantuar."
BREAK (PUSHIM)	"Unë tregoj nëpërmjet kësaj ndarjen ndërmjet pjesëve të mesazhit.""
BREAK BREAK (PUSHIM/PUSHIM)	"Unë tregoj nëpërmjet kësaj ndarjen ndërmjet, mesazheve të transmetuara avionëve të ndryshëm në një situatë të ngarkuar ."
CANCEL (ANULO)	"Anuloj lejen e transmetuar më parë ."
CHECK (KONTROLL)	"Ekzaminoj një sistem apo një procedurë."
CLEARED (I LEJUAR)	"I autorizuar të procedosh nën kushte specifike."
CONFIRM (KONFIRMO)	"Unë kërkoj verifikimin e: (lejeve, instruksioneve, veprimeve, informacioneve)."
CONTACT (KONTAKTO)	"Stabilizo komunikimin me ……."
CORRECT (SAKTË)	"e vërtetë " ose "e saktë".
CORRECTION (KORRIGJOJ)	"Një gabim është bërë në këtë transmetim (ose në një mesazh). Versioni korrekt është……."
DISREGARD (SHPËRFILLE)	"Injoroje."
HOW DO YOU READ (SI MË DËGJON)	"Si është dëgjueshmëria e transmetimit tim?" (shiko pikën SERA.14070(c))
I SAY AGAIN (PO E PËRSËRIS)	"Unë po e përsëris për sqarim ose për ta theksuar."
MAINTAIN (MBAJ)	"Vazhdo sipas kushteve të specifikuara" ose të vazhdosh atë që po bën.
MONITOR (MONITORO)	"Përgjo në (frekuencë)."
NEGATIVE (MOHOJ)	"jo" *ose* "Leja nuk ju garantohet" *ose* "kjo nuk është e saktë" *ose* "I pamundur të..".
OVER (MBYLLA)	"Transmetimi im ka përfunduar, dhe unë pres një përgjigje prej jush."
OUT (DOLA)	"Ky shkëmbim transmetimesh ka përfunduar dhe nuk pres prej jush një përgjegjës."
READ BACK (PËRSËRITE)	"Përsërit të gjithën, ose një pjesë specifike, të këtij mesazhi te mua ekzaktësisht siç e ke marrë."
RECLEARED (RILEJUAR)	"Një ndryshim është bërë në lejen tuaj të fundit dhe kjo leje e re i zë vendin lejes së mëparshme ose një pjese së saj."
REPORT(RAPORTO)	"Më kalo mua informacionin e mëposhtëm…."
REQUEST (KËRKESË)	"Do të më pëlqente të di…" *ose* "unë kërkoj të marr.…."
ROGER (KUPTOVA)	"Unë kam marrë të gjithë mesazhin tuaj të fundit."."
SAY AGAIN (THUAJ PRAPË)	"Përsërit të gjithin, ose një pjesë të caktuar, të mesazhit tuaj."
SPEAK SLOWER (FOL MË NGADALË)	"Redukto ritmin e të folurit."
STANDBY (NË PRITJE)	"Prit dhe unë do të bëj një thirrje."
UNABLE (I PAMUNDUR)	"Unë nuk mund të veproj sipas kërkesës suaj, instruksion apo leje."
WILCO (PAJTOHEM)	*(Shkurtimi i fjalës pajtohem me")* "Unë e kuptova mesazhin dhe do të veprojë sipas saj."
WORDS TWICE (PËRSËRIS DY HERË)	(a) *Si një kërkesë:* "Komunikimi është i vështirë. Të lutem dërgo çdo fjalë, ose grup fjalësh dy herë." (b) *Si informacion:* "Meqenëse komunikimi është i vështirë, çdo fjalë ose grup fjalësh në këtë mesazh duhet të dërgohet dy herë."

SERA.14050 Shenjat e thirrjes radiotelefonike të mjeteve fluturuese

a) Shenja e thirrjes e plotë:

Shenja e thirrjes e një mjeti fluturues në radiotelefoni do të jetë një nga tipat e mëposhtëm:

1) Tipi (a) – karakteret të cilat korrespondojnë me shenjën e regjistrimit të një mjeti fluturues; ose

2) Tipi (b) – treguesi telefonik i operatorit të mjetit fluturues, i ndjekur nga 4 karakteret e fundit të shenjës së regjistrimit të mjetit fluturues;

3) Tipi (c) – treguesi telefonik i operatorit të mjetit fluturues i ndjekur nga identifikimi i mjetit fluturues.

b) Shenjat e thirrjes të shkurtuara

Shenjat e thirrjes të një mjeti fluturues në radiotelefoni të treguara në pikën (a), me përjashtim të tipit (c), mund të shkurtohen sipas kushteve të përcaktuara në pikën SERA.14055(c). Shenjat e thirrjeve të shkurtuara do të jenë sipas formës së mëposhtme:

1) Tipi (a) – karakteri i parë i regjistrimit dhe së paku dy karakteret e fundit të shenjës së thirrjes;

2) Tipi (b) – treguesi telefonik i operatorit të mjetit fluturues, i ndjekur nga së paku dy karakteret e fundit të shenjës së thirrjes;

3) Tipi (c) – nuk ka formë të shkurtuar.

SERA.14055 Procedurat e radiotelefonisë

a) Një mjet fluturues nuk do të ndryshojë tipin e shenjës së thirrjes radiotelefonike gjatë fluturimit, përveç përkohësisht kur instruktohet nga një njësi e kontrollit të trafikut ajror në interes të sigurisë. Përveç për arsye të sigurisë, asnjë transmetim nuk do t'i drejtohet një mjeti fluturues gjatë kohës së nisjes, gjatë pjesës së fundit të finales së afrimit ose menjëherë mbas uljes duke ruluar në pistë.

b) Vendosja e komunikimeve radiotelefonike

1) Shenjat e thirrjes radiotelefonike të plota do të përdoren gjithmonë kur vendoset komunikimi. Kur vendoset komunikimi, mjetet fluturuese do të fillojnë thirrjen e tyre nga tregues i stacionit që po thërritet, duke u ndjekur nga treguesi i stacionit që po thërret.

2) Përgjigja ndaj thirrjeve të mësipërme do të përdorë shenjën e thirrjes të stacionit thirrës, ndjekur nga shenja e thirrjes e stacionit përgjigjes, e cila do të

konsiderohet si një ftesë e stacionit thirrës për të vazhduar me transmetimin. Për transferimet e komunikimit brenda një njësie të kontrollit të trafikut ajror (SHTA/ATS), shenja e thirrjes së njësisë së kontrollit të trafikut ajror (SHTA/ATS) mund të neglizhohet nëse autorizohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

3) Komunikimet do të fillojnë me një thirrje dhe një përgjigje kur është e dëshirueshme për vendosjen e kontaktit, përveç se, kur është e qartë se stacioni i thirrur do të marrë thirrjen, stacioni thirrës mund të transmetojë mesazhin, pa pritur për një përgjigje nga stacioni i thirrur.

c) Komunikimet radiotelefonike pasuese

1) Shenjat e thirrjes radiotelefonike të shkurtuara, siç përshkruhet në pikën SERA.14050(b), do të përdoren vetëm mbasi komunikimi është vendosur në mënyrë të kënaqshme dhe është siguruar që nuk mund të ketë mundësi për keqkuptim. Një mjet fluturues mund të përdorë shenjën e thirrjes së shkurtuar vetëm nëse stacioni aeronautik i është drejtuar në këtë mënyrë.

2) Kur lëshohen lejet SHTA/ATC dhe përsëriten leje të tilla, kontrollorët dhe pilotët do të shtojnë gjithmonë shenjën e thirrjes të mjetit fluturues për të cilën aplikohet leja. Për raste të tjera, vazhdimësia e komunikimeve të dyanshme mbas vendosjes së kontaktit do të lejohet pa identifikime të mëtejshme ose thirrje deri në mbylljen e kontaktit.

SERA.14060 Transferimi i komunikimeve VHF

a) Një mjet fluturues do të këshillohet nga njësia e përshtatshme e SHTA të transferohet nga një frekuencë radiofonike tek një tjetër sipas procedurave të rëna dakot. Në mungesë të kësaj këshille, mjeti fluturues do të njoftojë njësinë SHTA përpara se të ndodhë ky transferim.

b) Kur stabilizohet kontakti fillestar, ose kur e lë një frekuencë VHF, një mjet fluturues do të transmetojë një informacion të tillë siç përshkruhet nga Ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror përgjegjës për ofrimin e shërbimit dhe aprovuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

SERA.14065 Procedura e radiotelefonisë për ndryshimin e kanalit të komunikimit ajër-tokë me zë

a) Përveç kur përshkruhet ndryshe nga Ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror përgjegjës për ofrimin e shërbimit dhe i aprovuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, thirrja fillestare te një njësi e SHTA mbas një ndryshimi të kanalit të

komunikimit ajër-tokë me zë do të përmbajë elementët e mëposhtëm:

1) Emërtimin e njësisë SHTA që thirret;

2) Shenjën e thirrjes dhe, për mjetet fluturuese të kategorisë së rëndë të turbulencës, fjala "HEAVY" ose "SUPER" nëse ky mjet fluturues është identifikuar si i tillë nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

3) Nivelin, duke përfshirë nivelet që po kalohen apo të lejuara, nëse nuk po mban nivelin e lejuar;

4) Shpejtësinë, nëse është caktuar nga kontrolli i trafikut ajror; dhe

5) Element të tjerë, siç kërkohet nga OSHLA përgjegjëse për ofrimin e shërbimit dhe të aprovuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Pilotët do të japin informacion për nivelin brenda 30 metra apo 100ft siç lexohet në lartësimatësin e pilotit.

c) Thirrja fillestare për kullën e kontrollit të aerodromit

Për mjetet fluturuese që u ofrohet shërbimi i kontrollit të aerodromit, thirrja fillestare do të përmbaje:

1) Emërtimin e njësisë SHTA që thërritet;

2) Shenjën e thirrjes dhe, për mjetet fluturuese të kategorisë së rëndë të turbulencës, fjala "HEAVY" ose "SUPER" nëse ky mjet fluturues është identifikuar si i tillë nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

3) Pozicioni; dhe

4) Elemente të tjerë, siç kërkohet nga OSHLA përgjegjës për ofrimin e shërbimit dhe të aprovuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

SERA.14070 Procedurat e testeve

a) Forma e transmetimeve test do të jetë si më poshtë:

1) Identifikimi i stacionit të thirrur;

2) Identifikimi i stacionit thirrës;

3) Fjalët "RADIO CHECK";

4) Frekuenca që po përdoret.

b) Përgjigja ndaj një transmetimi test do të jetë si më poshtë:

1) Identifikimi i stacionit që kërkon test;

2) Identifikimi i stacionit që po përgjigjet;

3) Informacionin në lidhje me dëgjueshmërinë e stacionit që po kërkon transmetimin test.

c) Kur kryen teste, do të përdoret shkalla e dëgjueshmërisë si më poshtë:

Shkalla e dëgjueshmërisë

1) 1 –I padëgjueshëm

2) 2- I dëgjueshëm herë pas here

3) 3- I dëgjueshëm por me vështirësi

4) 4- I dëgjueshëm

5) 5- I dëgjueshëm plotësisht.

SEAR.14075 Shkëmbimi i komunikimeve

a) Komunikimet do të jenë të përmbledhura dhe të qarta, duke përdorur frazeologji standarde sa herë që është e mundshme.

1) Kur transmetohet nga një mjet fluturues, pohimi i marrjes së një mesazhi do të përfshijë shenjën e thirrjes së mjetit fluturues.

2) Kur pohimi i marrjes është transmetuar nga një njësi SHTA tek një mjet fluturues, ajo do të përmbajë shenjën e thirrjes së mjetit fluturues, ndjekur nga shenja e thirrjes së njësisë së SHTA, nëse konsiderohet e nevojshme.

b) Fundi i një bisede.

Një bisedë radiotelefonike do të mbyllet nga njësia SHTA pritëse ose nga mjeti fluturues duke përdorur shenjën e tij të thirrjes.

c) Korrigjimet dhe përsëritjet.

1) Kur është bërë një gabim gjatë një transmetimi, do të thuhet fjala "CORRECTION" (korrigjoj), grupi apo fraza e fundit korrekte do të përsëritet, dhe pastaj do të transmetohet versioni korrekt.

2) Nëse korrigjimi mund të bëhet më mirë nëse përsëritet i gjithë mesazhi, fraza "CORRECTION, I SAY AGAIN" (korrigjoj, them përsëri) do të përdoret përpara se mesazhi të transmetohet për herë të dytë.

3) Nëse stacioni marrës është në dyshim në lidhje me saktësinë e mesazhit të marrë, do të kërkohet një përsëritje e plotë ose e pjesshme.

4) Nëse kërkohet përsëritja e të gjithë mesazhit, do të thuhen fjalët "SAY AGAIN" (Thuaje përsëri). Nëse kërkohet përsëritja vetëm e një pjese do të përdoret fraza "SAY AGAIN ALL BEFORE..." (Thuaje Përsëri të Gjithën para...)-fjala e parë e dëgjuar në mënyrë të kënaqshme; ose "SAY AGAIN..." (Thuaje Përsëri…)-(fjalën para pjesës që mungon) "TO..." (deri…)-fjalën mbas pjesës që mungon)" ose "thuaje përsëri të gjithën mbas…. - fjala e fundit e dëgjuar në mënyrë të kënaqshme.

d) Nëse mbas kontrollit të korrektësisë së një përsëritje, janë vërejtur pjesë jo korrekte, fjalët "'NEGATIVE I SAY AGAIN" (negative po e përsëris përsëri), do të transmetohen mbas

përmbylljes së përsëritjes, ndjekur nga version korrekt i pjesës në fjalë.

SERA.14080 Monitorimi i komunikimeve/ orët e shërbimit

a) Gjatë fluturimit, mjeti fluturues do të mbajë nën mbikëqyrje siç kërkohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil dhe nuk do të ndalojë monitorimin, përveç për arsye sigurie, pa informuar njësinë e SHTA përkatëse.

1) Fluturimet e gjata mbi ujë të mjeteve fluturuese ose për fluturime në zona të përcaktuara në të cilën kërkohet mbajtja e transmetuesit të lokalizimit të emergjencës (ELT), do të kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme frekuencën e emergjencës në VHF 121,5MHz, përveç atyre periudhave kohore në të cilën mjetet fluturuese kryejnë komunikime në kanale të tjerë VHF ose kur kufizimet e pajisjeve në bordin e mjetit fluturues ose detyrat e pilotëve në kabinë nuk e lejojnë mbikëqyrjen e dy kanaleve njëkohësisht.

2) Mjetet fluturuese do të kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme frekuencën e emergjencave në VHF 121.5MHz në zona apo në korridore ajrore ku ekziston mundësia e një interceptimi ndaj mjetit fluturues apo situata të tjera të rrezikshme, si dhe është vendosur si kërkesë nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Stacionet aeronautike do të mbajnë nën monitorimin e vazhdueshëm kanalin e emergjencave VHF 121.5MHz gjatë orëve të shërbimit të njësive te të cilat është e instaluar. Nëse dy apo më shumë stacione janë të vendosura krah për krah, kjo kërkesë do të plotësohet nëse të paktën njëra prej tyre do ta mbaje nën mbikëqyrje këtë frekuencë.

c) Nëse është e nevojshme për një mjet fluturues apo njësi SHTA të pezullojë operimet për ndonjë arsye, ku është e mundur do të informojnë stacionet e tjera të interesuara, duke njoftuar kohën në të cilën operimet do të rifillojnë. Kur operimet do të rifillojnë, stacionet e tjera të interesuara do të njoftohen po ashtu. Nëse është e nevojshme që operimet të pezullohen më gjatë në kohë se lajmërimi i parë, një kohë e rishikuar e kohës së rifillimit do të transmetohet, nëse është e mundur, në ose sa më pranë kohës të specifikuar më parë.

SERA.14085 Përdorimi i transmetimeve pa përgjigje

a) Nëse një mjet fluturues dështon të vendose kontakt në një kanal të përcaktuar, në kanalin e mëparshëm të përdorur apo në një kanal tjetër të përshtatshëm për atë korridor, dhe dështon të vendose komunikim me njësinë e duhur të shërbimit të trafikut ajror, një njësi tjetër të shërbimit të trafikut ajror ose mjete të tjera fluturuese duke përdorur të gjitha mënyrat e mundshme, ky mjet fluturues do të transmetojë mesazhin e tij dy herë në kanalin(et) e përcaktuara, të paraprirë nga fraza "TRANSMITTING BLIND" (TRANSMETUAR PA PËRGJIGJE), dhe nëse është e nevojshme, të përfshije të adresuarin/it të cilit/ëve iu drejtohet ky mesazh .

b) Nëse një mjet fluturues e ka të pamundur të vendose komunikim për shkak të dështimit të marrësit, do të transmetojë raportime sipas kohëve të skeduluara, ose pozicionet, në kanalin në përdorim të paraprirë nga fraza "TRANSMITTING BLIND DUE TO RECEIVER FAILURE" (DUKE TRANSMETUAR PA PËRGJIGJE PËR SHKAK TË DËSHTIMIT TË MARRËSIT).

Mjeti fluturues do të:

1) Transmetojë mesazhin e synuar, duke e përsëritur atë plotësisht;

2) Këshillon kohën në të cilën do të transmetohet mesazhi tjetër;

3) Nëse i ofrohet shërbimi i trafikut ajror, të transmetojë informacionin që kishte si qëllim piloti në komandë në lidhje me vazhdimësinë e fluturimit.

SERA.14087 Përdorimi i teknikave të përcjelljes së komunikimeve

a) Nëse një njësi e shërbimit të trafikut ajror nuk ka qenë në gjendje të vendosë kontakt me një mjet fluturues mbas thirrjeve në frekuencat në të cilat besohet se ky mjet fluturues mund të jetë duke dëgjuar, do të:

1) Kërkojë njësive të tjera të shërbimit të trafikut ajror (SHTA/ATS) për të ndihmuar, duke thirrur mjetin fluturues dhe përcjellë informacion mbi trafikun, nëse është e nevojshme; dhe

2) Kërkojë mjeteve fluturuese në korridoret ajrore të përpiqen të vendosin kontakt me mjetin fluturues dhe përcjellin informacion mbi trafikun, nëse është e nevojshme.

b) Dispozitat e pikës (a) po ashtu do të aplikohen:

1) Sipas kërkesës së njësisë së interesuar të shërbimit të trafikut ajror ;

2) Nëse komunikimi i pritshëm nga një mjet fluturues nuk është marrë brenda një periudhe kohore të tillë që mund të dyshohet të ketë ndodhur dështimi i komunikimit.

SERA.14090 Procedurat specifike të komunikimit

a) Lëvizja e automjeteve

Frazeologjia për lëvizjen e automjeteve, përveç traktorëve–tërheqës, në zonën e manovrimit do të jetë e njëjtë si ajo që përdoret për lëvizjen e mjeteve fluturuese, me përjashtim të instruksioneve të rulimit, ku në një rast të tillë fjala "PROCEED" (PROCEDO) do të zëvendësojë fjalën "TAXI" (RULO) kur komunikohet me automjetet.

b) Shërbimi këshillues i trafikut ajror

Shërbimi këshillues i trafikut ajror nuk jep "leje" por vetëm "informacion këshillues" dhe do të përdorë fjalën "këshillë" ose "sugjeroj" kur një shkalle veprimesh i propozohen një mjeti fluturues.

c) Indikacioni i kategorisë së rëndë të turbulencës

1) Për mjetin fluturues në kategorinë e rëndë të turbulencës, fjala "e rëndë" do të përfshihet menjëherë mbas shenjës së thirrjes së mjetit fluturues në kontaktin fillestar radiotelefonik ndërmjet këtij mjeti dhe njësisë së shërbimit të trafikut ajror (SHTA/ATS).

2) Për mjete fluturuese të veçanta në kategorinë e rëndë të turbulencës, siç identifikohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, fjala "SUPER" do të përfshihet menjëherë mbas shenjës së thirrjes së mjetit fluturues në kontaktin fillestar radiotelefonik ndërmjet këtij mjeti dhe njësisë së shërbimit të trafikut ajror (SHTA/ATS).

d) Procedurat në lidhje me devijimet nga koha.

Kur piloti inicion komunikimin me kontrollin e trafikut ajror (KTA/ATC), një përgjigje e shpejtë mund të merret duke thënë "WEATHER DEVIATION REQUIRED" (KËRKOHET DEVIJIM NGA KOHA), për të treguar që dëshirohet prioriteti në këtë frekuencë dhe për përgjigje nga Kontrolli i Trafikut Ajror. Kur është e nevojshme, piloti do të iniciojë komunikimet duke përdorur thirrjen e urgjencës "PAN PAN" (preferohet thënia tri herë).

SERA.14095 Procedurat e komunikimit radiotelefonik të mjeteve fluturuese në rrezik dhe urgjencë

a) Të përgjithshme

1) Trafiku në rrezik dhe urgjencë do të përfshijë të gjitha mesazhet radiotelefonike në lidhje me kushtet respektive të rrezikut dhe urgjencës. Kushtet e rrezikut dhe urgjencës janë përkufizuar si:

i. Rrezik: një gjendje e të qenët të kërcënuar nga një rrezik serioz dhe/ose real dhe që kërkon ndihmë të menjëhershme.

ii. Urgjencë: një gjendje për sa i përket sigurisë së një mjeti fluturues ose automjeti tjetër, ose e një personi në bord ose brenda rrezes së shikimit, por që nuk kërkon ndihme të menjëhershme.

2) Sinjali radiotelefonik i rrezikut "MAYDAY" dhe Sinjali radiotelefonik i urgjencës "PAN PAN" do të përdoren në fillimin e komunikimit të parë të rrezikut apo urgjencës respektivisht. Në fillimin e çdo komunikimi të mëtejshëm të trafikut në rrezik apo urgjencë, do të jetë e pranueshme të përdoren sinjalet radiotelefonike të rrezikut dhe urgjencës.

3) Iniciuesi i mesazheve të cilët i drejtohen një mjeti fluturues në rrezik ose në gjendje urgjence do të kufizojë në minimum numrin dhe volumin dhe përmbajtjen e këtyre mesazheve siç kërkohet nga rrethanat.

4) Nëse nuk është bërë konfirmim i marrjes së mesazheve të rrezikut ose urgjencës nga njësia SHTA së cilës i është drejtuar mjeti fluturues, njësitë e tjera SHTA do të japin ndihmë siç përcaktohet në pikën (b)(2) dhe (b)(3) respektivisht.

5) Trafiku në rrezik dhe urgjencë do të mbahet normalisht në frekuencën në të cilën është iniciuar ky trafik deri sa të konsiderohet që një ndihmë më e mire mund t'i jepet nga transferimi i këtij trafiku në një frekuencë tjetër.

6) Në rastet e komunikimeve të rrezikut dhe urgjencës, në përgjithësi, transmetimet radiotelefonikë do të bëhen të ngadalshme dhe të qarta, çdo fjalë do të shqiptohet saktësisht për të lehtësuar përkthimin.

b) Komunikimet radiotelefonike të rrezikut

1) Veprimet e një avioni në rrezik

Përveçse paraprihet nga sinjali radiotelefonik i rrezikut "MAYDAY" sipas pikës (a)(2), i preferueshëm të thuhet tri herë, mesazhi i rrezikut i cili dërgohet nga një mjet fluturues në rrezik, do të:

i. Jetë në frekuencën ajër-tokë në përdorim në atë moment;

ii. Të ketë sa më shumë të jetë e mundur të elementëve me poshtë të folur sa më qartë dhe, nëse është e mundur, sipas radhës së mëposhtme:

A. Emrin e njësisë SHTA së drejtuar (nëse kushtet dhe koha e lejon);

B. Identifikimin e mjetit fluturues;

C. Natyrën e gjendjes së rrezikut;

D. Qëllimin e pilotit në komandë;

E. Pozicionin aktual, niveli dhe kursi.

2) Veprimet nga njësia SHTA që i është drejtuar ose nga njësia e parë SHTA që ka konfirmuar marrjen e mesazhit të rrezikut.

Njësia SHTA që i është drejtuar një mjet fluturues në rrezik ose njësia SHTA e parë që ka konfirmuar marrjen e mesazhit të rrezikut, do të:

i. Bëjë menjëherë konfirmimin e mesazhit të rrezikut;

ii. Marrë nën kontroll komunikimet ose në mënyrë specifike dhe të qartë transferon përgjegjësinë, duke këshilluar mjetin fluturues nëse është bërë ky transferim; dhe

iii. Marrë masa të menjëhershme për të siguruar që i gjithë informacioni i nevojshëm është vënë në dispozicion, sa më shpejt që të jetë e mundur tek:

A) Njësia SHTA që i është drejtuar;

B) Operatori i mjetit fluturues të interesuar, ose përfaqësuesi i tij, sipas marrëveshjeve të rëna dakot më parë.

iv) Lajmëron njësitë e tjera SHTA, sipas nevojës, në mënyrë që të ndalojë transferimin e trafikut në frekuencën e komunikimit të avionit në rrezik.

3) Imponimi i heshtjes

i. Mjeti fluturues në rrezik ose njësia e SHTA që kontrollon trafikun në rrezik, do të lejohet të imponojë "heshtjen", qoftë në të gjitha stacionet e shërbimeve mobile (të lëvizshme) në zonë ose në çdo stacion i cili interferon me trafikun në rrezik. Ajo duhet të përcjellë këto instruksione "te të gjitha stacionet" ose te një stacion i vetëm, në varësi të kushteve. Në çdo rast të mësipërm, ajo do të përdorë:

A. "STOP TRANSMITTING" (Ndalo transmetimin)

B. Sinjalin radiotelefonik të rrezikut "MAYDAY"

ii. Përdorimi i sinjaleve të specifikuara në pikën (b)(3)(i) do të rezervohen për avionët në rrezik dhe për njësitë e shërbimit të trafikut ajror (SHTA) që kontrollojnë trafikun në rrezik.

4) Veprimi nga të gjithë njësitë e tjera të shërbimit të trafikut ajror/mjetet fluturuese të tjera.

i. Komunikimet e rrezikut do të kenë prioritet absolut ndaj të gjitha komunikimeve të tjera dhe njësitë e shërbimit të trafikut ajror/mjetet fluturuese, të cilat janë në dijeni të situatës, nuk do të transmetojnë në frekuencën përkatëse, përveç kur:

A. Rreziku është zgjidhur ose trafiku nën rrezik është ndërprerë;

B. Trafiku në rrezik është transferuar në frekuenca të tjera;

C. Njësia e shërbimit të trafikut ajror që kontrollon komunikimet i jep leje të transmetojë;

D. Është ai vetë që do të japë ndihmë.

ii. Çdo njësi e shërbimit të trafikut ajror/mjet fluturues i cili ka njohuri për trafikun në rrezik, dhe që nuk mund të ndihmojë vetë mjetin fluturues në rrezik, do të vazhdojë të dëgjojë këtë trafik deri në momentin ku është e qartë që i është dhënë ndihma.

5. Përfundimi i komunikimeve të rrezikut dhe të heshtjes.

i. Nëse një mjet fluturues nuk është në gjendje rreziku, ai do të transmetojë një mesazh i cili anulon kushtet e rrezikut.

ii. Kur njësia e shërbimit të trafikut ajror e cila ka kontrolluar komunikimet e trafikut në rrezik, informohet që gjendja e rrezikut nuk ekziston më, ajo do të marrë veprime të menjëhershme për të siguruar që ky informacion i është vendosur në dispozicion, sa më shpejt që të jetë e mundur:

A. Njësive SHTA të interesuara;

B. Operatorit të mjetit fluturues të interesuar, ose përfaqësuesit të tij, sipas marrëveshjeve paraprake.

iii. Komunikimet e rrezikut dhe rrethanat e heshtjes do të përfundojnë duke transmetuar një mesazh, përfshirë fjalët: "DISTRESS TRAFFIC ENDED" (TRAFIKU NË RREZIK PËRFUNDOI), në frekuencën apo frekuencat të cilat janë përdorur për trafikun në rrezik. Ky mesazh do të iniciohet vetëm nga njësia e SHTA që kontrollon komunikimet kur, mbas marrjes së mesazhit të përshkruar në pikën (b)(5)(i), është autorizuar të bëjë këtë nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

c) Komunikimet radiotelefonike të urgjencës.

1. Veprimet e një mjeti fluturues i cili raporton një situate urgjence përveçse siç përcaktohet në pikën (c) (4).

Përveçse paraprihet nga sinjali radiotelefonik i urgjencës "PAN PAN" sipas pikës (a)(2), ku preferohet të thuhet tri herë dhe secila fjalë e grupit të shqiptohet si në gjuhën franceze "*panné*", mesazhi i urgjencës që dërgohet nga një mjet fluturues i cili raporton një situate urgjence do të:

i. Jetë në frekuencën ajër-tokë në përdorim në atë moment.

ii. Përfshijë sa më shumë prej elementeve më poshtë, të folur në mënyrë të qartë dhe nëse është e mundur, sipas radhës së mëposhtme:

A. Emri i njësisë së SHTA së drejtuar

B. Identifikimi i mjetit fluturues;

C. Natyra e situatës së urgjencës;

D. Qëllimi i pilotit në komandë;

E. Pozicioni aktual, niveli dhe kursi;

F. Çdo informacion tjetër i dobishëm.

2) Veprimet e Njësisë SHTA të drejtuar ose njësia e parë SHTA që e konfirmon mesazhin e urgjencës.

Njësia e SHTA së cilës i është drejtuar një mjet fluturues që raporton një situatë urgjence ose njësia e parë ATS, e cila ka konfirmuar mesazhin e urgjencës, do të:

i. konfirmojë mesazhin e urgjencës;

ii. veprojë menjëherë për të siguruar që i gjithë informacioni i nevojshëm i është vendosur në dispozicion sa më shpejt të jetë e mundur:

A. njësisë SHTA të interesuar;

B. Operatorit të mjetit fluturues të interesuar, ose përfaqësuesit të tij, sipas një marrëveshje paraprake;

iii. nëse është e nevojshme ushtron kontroll të komunikimeve

3) Veprimet nga të gjitha njësitë e tjera shërbimit të trafikut ajror/mjetet fluturuese.

Komunikimet e urgjencës kanë prioritet ndaj komunikimeve të tjera me përjashtim të komunikimeve të rrezikut dhe të gjitha njësitë shërbimit të trafikut ajror/mjetet fluturuese do të kujdesen që të mos interferojnë me transmetimet e trafikut në urgjencë.

4) Veprimet e një mjeti fluturues që përdoret për transport mjekësor

i. Përdorimi i sinjaleve që përshkruhen në pikën (c)(4)(ii) do të tregojnë që mesazhi në vijim i përket një transporti mjekësor të mbrojtur sipas Konventës së Gjenevës 1949 dhe Protokolleve shtesë

ii. Me qëllim të lajmërimit dhe identifikimit të një mjeti fluturues i përdorur për transport mjekësor, një transmetim i sinjalit radiotelefonik të urgjencës "PAN PAN, i preferueshëm të thuhet tri herë dhe secila fjalë e grupit të shqiptohet si në gjuhën Franceze "*panné*", do të ndiqet nga sinjali radiotelefonik për transportin mjekësor "MAY-DEE-CAL", shqiptuar si në gjuhën Franceze "*medical*". Përdorimi i sinjaleve të përshkruar më sipër do të tregojnë që mesazhi në vijim i përket një transportuesi mjekësor të mbrojtur.

Mesazhi do të përfshije të dhënat e mëposhtme:

A. Shenjën e thirrjes ose mënyra të tjera të njohura identifikimi të transportuesve mjekësorë;

B. Pozicioni i transportuesve mjekësor;

C. Numri dhe tipi i transportuesve mjekësor;

D. Korridori ajror i synuar;

E. Parashikimi kohor në rrugë dhe i nisjes dhe mbërritjes, sipas rastit; dhe

F. Çdo informacion tjetër si lartësia barometrike e fluturimit, radiofrekuencat e mbikëqyrura, gjuhët e përdorura dhe kodet dhe tipat e radarëve sekondare të mbikëqyrjes.

5) Veprimet nga njësitë SHTA të adresuara, ose nga stacione të tjera që marrin një mesazh nga transportuesit mjekësor.

Dispozitat sipas pikës (c)(2) dhe (c)(3) do t'i aplikohen sipas rastit te njësitë SHTA të cilat kanë marrë një mesazh nga transportuesit mjekësor.

d) Siç përcaktohet në nenin 4a, frekuenca e emergjencës VHF (121,500 MHz) do të përdoret për qëllime të mirëfillta emergjence, duke përfshirë cilindo nga sa vijon:

1) të sigurojë një kanal të qartë midis avionëve në rast të vështirë ose emergjence dhe një stacioni tokësor kur përdoren kanalet normale për avionët e tjerë;

2) të sigurojë një kanal komunikimi VHF midis avionëve dhe aerodromeve, që zakonisht nuk përdoren nga shërbimet ajrore ndërkombëtare, në rast të një gjendje emergjence që lind;

3) të sigurojë një kanal të përbashkët komunikimi VHF midis avionëve, qoftë civilë ose ushtarakë, dhe midis avionëve të tillë dhe shërbimeve sipërfaqësore, të përfshira në operacione të përbashkëta kërkimi dhe shpëtimi, përpara se të ndryshohet kur është e nevojshme në frekuencën e duhur;

4) të sigurojë komunikim ajër-tokë me avionët kur dështimi i pajisjeve ajrore parandalon përdorimin e kanaleve të rregullta;

5) të sigurojë një kanal për funksionimin e transmetuesve të lokalizimit të emergjencave dhe për komunikimin midis mjeteve mbijetuese dhe avionëve të përfshirë në operacionet e kërkimit dhe shpëtimit;

6) të sigurojë një kanal të përbashkët VHF për komunikimin midis avionëve civilë dhe avionëve përgjues ose njësive të kontrollit të përgjimit dhe midis avionëve civilë ose përgjues dhe njësive të shërbimeve të trafikut ajror në rast të përgjimit të avionëve civilë.

SHTOJCA 1
SINJALET

1. SINJALET E RREZIKUT DHE TË URGJENCËS

1.1 Të përgjithshme

1.1.1 Pavarësisht dispozitave në 1.2 dhe 1.3, një avion në rrezik duhet të përdorë çdo mënyrë në dispozicion për të tërhequr vëmendjen, për të bërë të ditur pozicionin e tij dhe të kërkojë ndihmë.

1.1.2 Procedurat e transmetimit të telekomunikacionit për sinjalet e rrezikut dhe të urgjencës duhet të jenë në përputhje me Seksionin 14.

1.2 Sinjalet e rrezikut

1.2.1 Sinjalet e mëposhtme, kur përdoren së bashku ose veçmas, tregojnë se kërcënon një rrezik i rëndë dhe që pritet të ndodhë, dhe kërkohet ndihmë e menjëhershme:

një sinjal i dhënë nëpërmjet radiotelegrafisë ose çdo metode tjetër sinjalizuese i formuar nga grupi i sinjalit SOS (.. .- - - . .. në kodin mors);

a) një sinjal rreziku radiotelefonik i përbërë nga fjala e folur MAYDAY;

b) Një mesazh rreziku i dërguar nëpërmjet *data-link*, i cili transmeton qëllimin e fjalës MAYDAY;

c) plumba gjurmues ose fishekzjarrë me dritë të kuqe, të gjuajtur njëri pas tjetrit në intervale të shkurtra;

d) një fishekzjarr me parashutë që emeton dritë me ngjyrë të kuqe.

e) vendosja e transponderit në Mode A Kodi 7700

1.3 Sinjalet e urgjencave

1.3.1 Sinjalet e mëposhtëm, kur përdoren së bashku ose veçmas, tregojnë se një avion kërkon të njoftojë se është në vështirësi të cilat e detyrojnë të ulet pa kërkuar ndihmën e menjëhershme:

a) ndezje dhe fikje të përsëritura të dritave të uljes;

b) ndezje dhe fikje të përsëritura të dritave të navigimit në një mënyrë të tillë që të dallohen nga dritat e navigimit pulsuese.

1.3.2 Sinjalet e mëposhtëm, kur përdoren së bashku ose veçmas, tregojnë se mjeti fluturues ka një mesazh shumë urgjent për të transmetuar në lidhje me sigurinë e një anije, aeroplani ose mjeti tjetër, apo për persona në bord ose brenda rrezes së shikimit:

a) një sinjal i dhënë nëpërmjet radiotelegrafisë ose me çdo metodë tjetër sinjalizuese e përbërë nga grupi XXX (-..- -..- -..- në kodin Mors);

b) një sinjal urgjence radiotelefonik i përbërë nga fjalët e folura PAN, PAN;

c) Një mesazh urgjence i dërguar nëpërmjet *data-link i cili transmeton* qëllimin e fjalës PAN, PAN.

2. SINJALET VIZUALE QË PËRDOREN PËR TË PARALAJMËRUAR NJË AVION TË PAAUTORIZUAR QË ËSHTË DUKE FLUTURUAR BRENDA APO QË ËSHTË GATI TË HYJË NË NJË ZONË TË KUFIZUAR, TË NDALUAR APO TË RREZIKSHME

2.1. Kur sinjalet vizuale përdoren për të paralajmëruar avionët e paautorizuar që janë duke fluturuar brenda ose gati për të hyrë në një zonë të kufizuar, zonë të ndaluar apo të rrezikshme ditën ose natën, një seri sinjalizimesh do të lëshohen nga toka në intervale prej 10 sekondash, të cilat kur shpërthejnë tregojnë drita të kuqe dhe drita jeshile, ose yje për t'i treguar një avioni të paautorizuar që ai është duke fluturuar brenda apo që është gati të hyjë në një zonë të kufizuar, zonë të ndaluar ose zonë të rrezikut, dhe se avioni duhet të ndërmarrë veprime korrektuese sipas nevojës.

3. SINJALET PËR TRAFIKUN E AERODROMIT

3.1 Sinjalet me drita dhe piroteknike

3.1.1 Udhëzimet

Drita		Sinjale të emetuar nga kulla e kontrollit drejt mjetit fluturues.	
Drejtuar drejt avionëve në fjalë (shih figurën A1-1).		në fluturim	në tokë
	Dritë e gjelbër e vazhduar	Jeni të autorizuar të uleni	Jeni të autorizuar të ngriheni
	Drite e kuqe e vazhduar	Jepini përparësi mjetit tjetër dhe vazhdoni të qëndroni në rreth	Ndaloni
	Seri pulsimesh me drita të gjelbra	Rikthehuni për ulje (Autorizimi për ulje dhe *taxiing* do të komunikohet më vonë)	Jeni të autorizuar të ruloni (*taxiing*)
	Seri pulsimesh me drita të kuqe	Aeroport i pasigurt, mos u ulni	Bëni rulimin (*taxiing*) jashtë zonës së uljes në përdorim
	Seri pulsimesh me drita të bardha	Uluni në këtë aerodrom dhe vazhdoni drejt apron (Autorizimi për ulje dhe *taxiing* do të komunikohet më vonë)	Rikthehuni në pikën e nisjes në aerodrom
Fishekzjarr me ngjyrë të kuqe		Çfarëdo qofshin udhëzimet e mëparshme mos kryeni ulje për momentin	



3.1.2 Konfirmim nga avioni/mjeti fluturues

a) në fluturim:

1) gjatë orëve me dritë të ditës

- duke lëkundur krahët e avionit me përjashtim kur merr kthesën finale të uljes

2) në orët e errësirës

- me ndezje fikje të dritave të uljes dy herë, ose nëse avioni nuk është i pajisur me ndezje fikje dy herë të dritave të navigimit.

b) kur është në tokë:

1) gjatë orëve me dritë të ditës

- duke lëvizur aleronët ose strukturën në bishtin e avionit për ndryshime horizontale në kursin e avionit;

2) gjatë orëve të errësirës

- me ndezje fikje dy herë të dritave të uljes, ose nëse avioni nuk është i pajisur me to, ndezje fikje dy herë të dritave të navigimit.

3.2 Sinjale vizuale në tokë

3.2.1 Ndalimi i uljes

3.2.1.1 Kur një panel katror i kuq horizontal me diagonale të verdha (Figura A1-2) shfaqet në zonën sinjalizuese tregon që uljet janë të ndaluara dhe ndalimi është i detyruar të zgjasë.

Figure A1-2

3.2.2 Nevoja për masa të veçanta kujdesi gjatë afrimit ose gjatë uljes

3.2.2.1 Kur një panel i kuq katror horizontal me një diagonale të verdhë (Figura A1-3) shfaqet në zonën sinjalizuese tregon se për shkak të gjendjes së keqe të zonës së manovrimit, ose për arsye të tjera, kujdes i veçantë duhet ushtruar gjatë afrimit në ulje ose gjatë uljes.

Figure A1-3

3.2.3 Përdorimi i pistave ose i *taxiway*-ve

3.2.3.1 Kur figura horizontale e dy rrathëve të lidhur nga një shirit (figura A1-4) shfaqet në zonën e sinjaleve tregon që mjeteve ajrore iu kërkohet të ulen, të ngrihen dhe të bëjnë *taxiing* vetëm në pista dhe në *taxiways*.

Figure A1-4

3.2.3.2 Kur e njëjta formë me dy rrathë të lidhur horizontalisht nga një shirit por me një vizë të zezë vertikale brenda secilit rreth (figura A1-5) shfaqet në zonën e sinjaleve tregon që avionit i kërkohet të ulet dhe të ngrihet mbi pistë vetëm, por manovrimet e tjera nuk duhet të kufizohen vetëm me pistat ose me rrugët lidhëse (*taxiways*).

Figure A1-5

3.2.4 Pistat ose rrugët lidhëse (*taxiways*) të mbyllura

3.2.4.1 Kryqëzim shiritash me të njëjtën ngjyrë me kontrast, e bardhë në pista dhe e verdhe në rrugët lidhëse (*taxiways*) (figura A1-6), e pozicionuar horizontalisht mbi pista dhe rrugët lidhëse (*taxiways*) ose pjesë të tyre tregojnë një zonë të papërshtatshme për lëvizjen e avionëve.

Figure A1-6

3.2.5 *Udhëzimet për ulje ose ngritje*

3.2.5.1 Një T e uljes horizontale e bardhe ose portokalli (figura A1-7) tregon drejtimin që duhet të marrë një avion për ulje dhe ngritje, i cili duhet të jetë në drejtimin paralel me boshtin e T-së, në drejtim të kryqëzimit.

Shënim. Në përdorim gjatë natës, T e shtrirë është e shndritshme ose e ndriçuar me drita të bardha.



Figure A1-7

3.2.5.2 Një grup me dy shifra (figura A1-8) i shfaqur vertikalisht në ose afër kullës së kontrollit të aerodromit i tregon avionit në zonën e manovrimit drejtimin për ngritje, e shprehur në njësi prej 10 gradë me 10 gradët më të afërta të busullës magnetike.

Figure A1-8

3.2.6 Trafiku i krahut të djathtë

3.2.6.1 Kur shfaqet në një zonë sinjalesh ose horizontalisht në fund të pistës, një shigjetë e kthyer djathtas me ngjyrë të dukshme (figura A1-9) tregon drejtimin djathtas që duhet marrë përpara uljes dhe mbas ngritjes.



Figure A1-9

3.2.7 Zyra e raportimit të shërbimeve të trafikut ajror

3.2.7.1 Shkronja C e shfaqur vertikalisht në të zezë në një sfond të verdhë (figura A1-10) tregon vendndodhjen e zyrës së raportimit të shërbimeve të trafikut ajror.

Figure A1-10

3.2.8 Fluturime të *sailplane* (*planerave*) në operim

3.2.8.1 Një kryq i dyfishtë i bardhë, i vendosur horizontalisht (figura A1-11) në zonën e sinjaleve tregon që aerodromi po përdoret nga *sailplanes* (*planera*) dhe fluturime të tyre (*sailplanes*) po kryhen.



Figure A1-11

4. SINJALET E MARESHALIT TË AERODROMIT

4.1 Sinjalet nga një sinjalizues/mareshal kundrejt mjetit fluturues

4.1.1 Sinjalet në përdorim nga personi sinjalizues/mareshali me duar të ndriçuara sipas rastit për të lehtësuar vëzhgimin nga piloti, dhe duke i qëndruar përballë avionit, do të jenë:

a) për avion me krahë të palëvizshme, në anën e majtë të avionit, ku shihet më mirë nga piloti; dhe

b) për helikopterët, aty ku personi sinjalizues/mareshali mund të shihet më mirë nga piloti.

4.1.2 Përpara përdorimit të sinjaleve të mëposhtëm, personi sinjalizues/mareshali duhet të sigurojë që zona në të cilën avioni do të udhëzohet nuk ka objekte me të cilat një avion mund të përplaset, duke qenë në përputhje me SERA.3301(a).

	1. Stunt ajri/udhëzues (*1) Ngrini dorën e djathtë mbi nivelin e kokës me shkopin e drejtuar lart; lëvizni shkopin e dorës së majtë duke treguar poshtë drejt trupit.
	**2. Identifiko portën** Ngrini krahët e shtrirë plotësisht drejt sipër kokës me shkopinj të drejtuar lart.

	3. Vazhdo deri te sinjalizuesi tjetër ose sipas udhëzimeve të kullës/kontrollit në tokë Drejtoni të dy krahët lart; lëvizni dhe shtrini krahët nga jashtë në anët e trupit dhe drejtojeni me shkopinj në drejtim të zonës së sinjalizuesit/marshallorit ose taksisë tjetër.
	4. Vazhdo drejt Përkulni krahët e zgjatur në bërryla dhe lëvizni shkopinjtë lart e poshtë nga lartësia e gjoksit tek koka.
	**5(a) Kthehu majtas (prej pikëshikimit të pilotit)** Me krahun e djathtë dhe shkopin e zgjatur në një kënd 90 gradë me trupin, bëni sinjalin "eja përpara" me dorën e majtë. Shpejtësia e lëvizjes së sinjalit tregon për të pilotuar shpejtësinë e rrotullimit të avionit.
	5 (b) Kthehu djathtas (prej pikëshikimit të pilotit) Me krahun e majtë dhe shkopin e zgjatur në një kënd 90 gradë me trupin, bëni sinjalin "eja përpara" me dorën e djathtë. Shpejtësia e lëvizjes së sinjalit tregon për të pilotuar shpejtësinë e rrotullimit të avionit.
	**6(a) Ndalesë normale** Zgjatni plotësisht krahët dhe shkopinjtë në një kënd 90 gradë me trupin dhe lëvizni ngadalë mbi kokë derisa shkopinjtë të kryqëzohen.

	**6 (b) Stop emergjencë** Zgjatni menjëherë krahët dhe shkopinjtë në majë të kokës, duke kryqëzuar shkopinjtë
	7 (a) Vendos frenat Ngrini dorën pak mbi lartësinë e shpatullave me pëllëmbën e hapur. Siguroni kontaktin me sy me ekuipazhin e fluturimit dhe mbyllni dorën grusht. Mos lëvizni derisa të merrni konfirmimin "thumbs up" (OK 👍) nga ekuipazhi i fluturimit.
	7 (b) Lësho frenat Ngrini dorën pak mbi lartësinë e shpatullave me dorën të mbyllur në grusht. Siguroni kontaktin me sy me ekuipazhin e fluturimit dhe hapni dorën. Mos lëvizni derisa të merrni konfirmimin "thumbs up"(OK 👍) nga ekuipazhi i fluturimit.
	8 a)Takot/bllokuesi i rrotave vendosur Me krahët dhe shkopinjtë e shtrirë plotësisht sipër kokës, lëvizni shkopinjtë nga brenda me një lëvizje "goditëse" derisa shkopinjtë të prekin. Sigurohuni që të merret konfirmimi nga ekuipazhi i fluturimit.
	8 b) Takot/ bllokuesi i rrotave hequr Me krahët dhe shkopinjtë e shtrirë plotësisht sipër kokës, lëvizni shkopinjtë nga jashtë me një lëvizje "goditëse". Mos i hiqni bllokuesit derisa të autorizohen nga ekuipazhi i fluturimit.

	9. Ndiz motor(ët) Ngrini krahun e djathtë në nivelin e kokës me shkopin e drejtuar lart dhe filloni një lëvizje rrethore me dorën; në të njëjtën kohë, me krahun e majtë të ngritur mbi nivelin e kokës, tergoni motorin për t'u ndezur.
	10. Fik motorët Zgjate krahun me shkopin përpara trupit në nivelin e shpatullës dhe lëvize shkopin drejt lartësisë së shpatullës së djathtë me një lëvizje të prerjes në mes të fytit.
	11. Ngadalëso Lëvizni krahët e zgjatur poshtë në një gjest 'miratues" duke lëvizur shkopinjtë lart e poshtë nga beli tek gjunjët.
	**12. Ngadalëso motorin/at në anën e treguar** Me krahët poshtë dhe shkopinjtë drejt tokës, tundni shkopin e djathtë ose të majtë lart e poshtë duke treguar motorin(ët) përkatësisht në anën e majtë ose të djathtë që duhet të ngadalësohen.
	13. Ec prapa Me krahët përpara trupit në lartësinë e belit, rrotulloni krahët në një lëvizje përpara. Për të ndaluar lëvizjen prapa, përdorni sinjalin 6(a) ose 6(b).

	14 a). Kthehu duke u prapësuar (për bishtin drejt anës së djathtë të përparme) Drejtoni krahun e majtë me shkop poshtë dhe sillni krahun e djathtë nga pozicioni vertikal i sipërm në pozicionin horizontal përpara, duke përsëritur lëvizjen e krahut të djathtë.
	14 b). Kthehu duke u prapësuar (për bishtin drejt derës) Drejtoni krahun e djathtë me shkop poshtë dhe sillni krahun e majtë nga pozicioni vertikal i sipërm në pozicionin horizontal përpara, duke përsëritur lëvizjen e krahut të majtë.
	15. Pozitive/çdo gjë e qartë(*2) Ngrini krahun e djathtë në nivelin e kokës me shkopin e drejtuar lart ose shfaqni dorën me "thumbs up" (bravo lart); krahu i majtë mbetet anash gjurit.
	16. Prit(*3) Zgjatni plotësisht krahët dhe shkopinjtë në një kënd 90 gradë me trupin.
	17. Lëviz lart(*3) Zgjatni plotësisht krahët dhe shkopinjtë në një kënd 90 gradë me trupin dhe, me pëllëmbët e kthyera lart, lëvizni duart lart. Shpejtësia e lëvizjes tregon shkallën e ngritjes

	**18. Lëviz poshtë**(*3) Zgjatni plotësisht krahët dhe shkopinjtë në një kënd 90 gradë me trupin dhe, me pëllëmbët e kthyera poshtë, lëvizni duart poshtë. Shpejtësia e lëvizjes tregon shkallën e zbritjes.
	19(a). Lëviz horizontalisht në të majtë (nga pikëshikimi i pilotit) (*3) Zgjat krahun horizontalisht në një kënd 90 gradë në anën e djathtë të trupit. Lëvizni krahun tjetër në të njëjtin drejtim me një lëvizje gjithëpërfshirëse.
	19(b). Lëviz horizontalisht në të djathtë (nga pikëshikimi i pilotit) (*3) Zgjatni krahun horizontalisht në një kënd 90 gradë në anën e majtë të trupit. Lëvizni krahun tjetër në të njëjtin drejtim me një lëvizje gjithëpërfshirëse.
	20. Ulu (*3) Kryqëzoni krahët me shkopinjtë poshtë dhe përpara trupit.
	21. Mbaj pozitën/rri në pritje Zgjatni plotësisht krahët dhe shkopinjtë poshtë në një kënd 45 gradë në anët. Mbani këtë pozicionin derisa avioni të jetë qartë për manovrën e ardhshme

	22. Lësho mjetin fluturues Kryeni një përshëndetje standarde me dorën e djathtë dhe/ose shkop për të nisur (*dispatch*) avionin. Mbani kontaktin me sy me ekuipazhin e fluturimit derisa avioni të ketë filluar të rulojë (to taxi).
	23. Mos prek komandat (sinjal komunikimi servis/teknik) Zgjatni krahun e djathtë plotësisht mbi kokë dhe mbyllni grushtin ose mbajeni shkopin në pozicion horizontal; krahu i majtë mbetet anash gjurit.
	**24. Lidh energjinë në tokë (sinjal komunikimi servis/teknik)** Mbajini krahët plotësisht të shtrirë mbi kokë; hapni dorën e majtë horizontalisht dhe lëvizni majat e gishtave të dorës së djathtë brenda dhe prekni pëllëmbën e hapur të dorës së majtë (duke formuar një "T"). Gjatë natës, shkopinjtë e ndriçuar mund të përdoren gjithashtu për të formuar "T" mbi kokë.
	**25. Shkëput burimin e ushqimit (sinjal komunikimi servis/teknik)** Mbajini krahët e shtrirë plotësisht mbi kokë me majat e gishtave të dorës së djathtë duke prekur pëllëmbën e hapur horizontale të dorës së majtë (duke formuar një "T"); pastaj largojeni dorën e djathtë nga e majta. Mos e shkëputni energjinë derisa të autorizohet nga ekuipazhi i fluturimit. Gjatë natës, shkopinjtë e ndriçuar mund të përdoren gjithashtu për të formuar "T" mbi kokë.
	**26. Negative (sinjal komunikimi servis/teknik)** Mbani krahun e djathtë drejt në 90 gradë nga supi dhe drejtojeni shkopin poshtë në tokë ose shfaqni dorën me "gishtin e madh poshtë"; dora e majtë mbetet anash gjurit.

	27. Vendos komunikimin nëpërmjet interfonisë (sinjal komunikimi servis/teknik) Zgjatni të dy krahët në 90 gradë nga trupi dhe lëvizni duart në të dy veshët
	28. Hap ose mbyll shkallet (sinjal komunikimi servis/teknik) (*4) Me krahun e djathtë anash dhe krahun e majtë të ngritur mbi kokë në një kënd 45 gradë, lëvizni krahun e djathtë me një lëvizje gjithëpërfshirëse drejt majës së shpatullës së majtë.
*(*1) Ky sinjal jep një tregues nga një person i pozicionuar në majë të krahut të avionit, për pilotin/marshallerin/operatorin e shtytjes, se lëvizja e avionit në/fikur një pozicion parkimi do të ishte e papenguar.* *(*2) Ky sinjal përdoret gjithashtu si sinjal komunikimi teknik/shërbues.* *(*3) Për përdorim për helikopterët fluturues.* *(*4) Ky sinjal është menduar kryesisht për avionët me grup shkallësh integrale në pjesën e përparme.*	

4.2 Nga piloti i një avioni tek personi sinjalizues/mareshali

4.2.1 Sinjalet e mëposhtme janë ideuar për t'u kryer nga piloti në kabinën e pilotimit me duart lehtësisht të dukshme nga sinjalizuesi/mareshali, dhe të ndriçuara sipas nevojës për të lehtësuar shikimin e tyre nga sinjalizuesi/mareshali.

	(a)Frenat e aktivizuara: ngrini krahun dhe dorën, gishtat të jenë të shtrirë, horizontalisht përpara fytyrës, pastaj bëje dorën grusht.
	(b)Frenat e çaktivizuara: ngrini krahun, dorën e mbledhur grusht, horizontalisht përpara fytyrës, pastaj shtrini gishtat.
	(c)Vendos bllokuesin e rrotave/takot: krahët e ngritur, pëllëmbët e duarve të dukshme, lëviz krahët drejt vetes për t'i kryqëzuar përpara fytyrës.
	(d)Hiq bllokuesit e rrotave/takot: duart e kryqëzuara përpara fytyrës, pëllëmbët e duarve të dukshme nga jashtë, hapi krahët
	(e) Gati për të ndezur motorin: ngri numrin e duhur të gishtave në një dorë duke cilësuar numrin e motorit që do të ndizet

4.3 Sinjalizime të tipit "teknik"

4.3.1 Sinjalizimet e tipit teknik (sinjal komunikimi servis/teknik) duhet të përdoren vetëm kur përmbajtja e tyre nuk mund të transmetohet në komunikim verbal.

4.3.2 Sinjalizuesi duhet të garantojë që për çdo sinjalizim të tipit teknik kryhet marrja e tyre nga ana e ekuipazhit të fluturimit.

5. SINJALE MANUALE STANDARDE TË EMERGJENCËS

Për komunikime emergjence ndërmjet personelit në tokë dhe ekuipazhit të fluturimit ose të kabinës së mjetit ajror të përfshirë në këtë emergjence, janë të përcaktuar dhe të shfaqur si më poshtë sinjalet manuale. Sinjalizimi kryhet normalisht, kur i drejtohet ekuipazhit të fluturimit, nga një vendndodhje që gjendet ballazi dhe në të majtë të mjetit ajror ose, nëse i referohet ekuipazhit të kabinës, nga pozicione të tjera të përshtatshme që lehtësojnë komunikimin.

	1. REKOMANDIM PËR EVAKUIM Rekomandohet evakuimi bazuar në vlerësimin nga personeli përgjegjës i shërbimit të emergjencës në tokë. Krahu i zgjatur nga trupi dhe i mbajtur horizontalisht me dorën e ngritur lart në nivelin e syve. Krahu lëviz sipas sinjalit "më ndiq" ose "afrohu" duke i dhënë një kënd për prapa. Krahu tjetër mbahet i pa lëvizur pas trupit. Nata - e njëjta gjë me shkopinjtë
	2. REKOMANDIM PËR NDALIM Rekomandohet të pezullohet evakuimi që po kryhet. Ndalo lëvizjen e mjetit ajror ose veprimtari të tjera që po kryhen. Krahët para kokës - të kryqëzuara në kyçet e dorës Nata - e njëjta gjë me shkopinjtë.
	3. EMERGJENCA NËN KONTROLL Nuk ka prova nga jashtë të kushteve të rrezikshme ose, "Çdo gjë në rregull". Krahët e shtrirë nga jashtë dhe poshtë në një kënd 45 gradë me trupin. Krahët lëvizen nga brenda poshtë belit njëkohësisht derisa kyçet e duarve kryqëzohen, pastaj zgjaten nga jashtë në pozicionin e fillimit.
	4. Zjarr Lëviz dorën e djathtë me një lëvizje 'si ventilator' nga supi tek gjuri, ndërsa në të njëjtën kohë tregoni me dorën e majtë zonën e zjarrit. Nata - e njëjta gjë me shkopinjtë.

SHTOJCA 2
1. KLASIFIKIMI I BALONAVE TË LIRA PA PILOT

Balonat e lira pa pilot do të klasifikohen si: (SHIH FIGURËN AP2-1)

a) *të lehta:* një balonë e lirë pa ekuipazh e cila mban një ngarkesë prej një ose më shumë pakosh me një peshë prej më pak se 4 kg, e pa kualifikuar si një balonë e rëndë sipas pikave c) 2, 3 ose 4 më poshtë; ose

b) *mesatare:* një balonë e lirë pa ekuipazh e cila mban një ngarkesë prej dy ose më shumë pakosh me një peshë 4 deri 6 kg, përveç nëse kualifikohet si një balonë e rëndë në përputhje me (c) (2), (3) ose (4) më poshtë; ose

c) *e rendë:* një balonë e lirë pa ekuipazh e cila mban një ngarkesë që:

1) ka një peshë prej 6 kg ose më tepër; ose

2) përfshin një pako prej 3 kg ose më tepër; ose

3) përfshin një pako prej 2 kg ose më tepër brenda një hapësire me densitet më shumë se 13 g/cm^2; ose

4) përdor një litar ose pajisje tjetër për ndërprerjen e lëvizjes së ngarkesës që kërkon një forcë prej 230 N ose më tepër për të veçuar ngarkesën nga balona.

2. Rregullat e përgjithshme të operimit

2.1 Një balonë e lirë pa pilot nuk do të operojë pa autorizimin përkatës nga Autoriteti i Aviacionit Civil, kur hedhja bëhet nga Shqipëria, ose pa autorizimin e shtetit prej të cilit është lëshuar.

2.2 Një balonë e lirë pa pilot, ndryshe nga balona e lehtë e përdorur vetëm për qëllime meteorologjike dhe që operon në mënyrën e përshkruar nga autoriteti përkatës, nuk do të kalojë përmes territorit të një Shteti tjetër pa autorizimin përkatës nga ai Shtet.

2.3 Autorizimi i referuar në pikën 2.2 duhet të merret para lëshimit të balonës nëse ka pritshmëri të arsyeshme, kur planifikohet kalimi, që balona mund të lëvizë mbi territorin e një shteti tjetër. Një autorizim i tillë mund të merret për një seri fluturimesh balonash ose për një tip të caktuar fluturimi, p.sh., fluturime për qëllime kërkimesh atmosferike.

2.4 Një balonë e lirë pa pilot do të kalojë në përputhje me kushtet e specifikuara nga shteti ku është regjistruar dhe shteti ku pritet të mbikalojë.

2.5 Një balonë e lirë pa pilot nuk do të operojë në një mënyrë të tillë që prek balonën ose ndonjë pjesë të saj, duke përfshirë ngarkesën e vet, me sipërfaqen e tokës, krijon një rrezik për njerëzit ose mjetet që nuk kanë lidhje me lëvizjen e saj.

2.6 Një balonë e lirë e rëndë pa pilot nuk do të operojë mbi hapësira detare pa koordinimin e mëparshëm me OSHLA-të.



3. KUFIZIMET E OPERIMIT DHE KËRKESAT MBI PAJISJET

3.1 Një balonë e lirë e rëndë pa pilot nuk do të kalojë pa autorizim nga OSHLA-të përkatëse në ose përmes çdo niveli nën 18000 m (60000 ft) *pressure-altitude* në të cilin:

a) ka re ose fenomene penguese për më shumë se 4 oktas mbulim; ose

b) shikueshmëria horizontale është më pak se 8 km.

3.2 Një balonë e lirë e rëndë ose e mesme pa pilot nuk do të lëshohet në një mënyrë që e lejon atë të fluturojë më poshtë se 300 m (1000 ft) mbi hapësirat e qyteteve ose vendbanimeve ose mbi zona grumbullimi njerëzish që nuk kanë lidhje më operimin saj.

3.3 Një balonë e lirë e rëndë pa pilot nuk do të operojë po të mos:

a) jetë e pajisur me të paktën dy pajisje ose sisteme të ndërprerjes së fluturimit, automatike ose që drejtohen me telekomandë, që operojnë të pavarura nga njëra-tjetra;

b) për balonat me presion zero polietileni, të ketë të paktën dy metoda, sisteme, pajisje, ose kombinime të tyre, që funksionojnë të pavarura nga njëra-tjetra që janë shfrytëzuar për ndërprerjen e fluturimit të membranës së balonës;

c) jetë e pajisur membrana e balonës ose me një radar reflektues ose material reflektues që do të paraqesë një pasqyrim mbi sipërfaqen e radarit që operon në një rang frekuence nga 200 deri në 2 700 MHz, dhe/ose balona të jetë e pajisur me një pajisje tjetër të tillë që të lejojë gjurmimin e vazhdueshëm nga operatori përtej rangut të radarit të instaluar në tokë.

3.4 Një balonë e lirë e rëndë pa pilot nuk do të operojë në kushtet e mëposhtme:

a) në një zonë ku është në përdorim pajisja SSR e instaluar në tokë, po të mos jetë i pajisur me një transponder radar survejimi sekondar, me aftësi për të raportuar lartësinë *(pressure-altitude*) i cili operon vazhdimisht nën një kod të caktuar ose i cili mund të ndizet kur duhet nga stacioni gjurmues; ose

b) në një zonë ku është në përdorim pajisja ADS-B e instaluar në tokë, po të mos jetë i pajisur me një transmetues ADS-B, me aftësi për të raportuar lartësinë *(pressure-altitude*), i cili operon vazhdimisht nën një kod të caktuar ose i cili mund të ndizet kur duhet nga stacioni gjurmues.

3.5 Një balonë e lirë pa pilot që është e pajisur me një antenë në formë rrjete që kërkon një force prej më shumë se 230 N për ta frenuar në çdo pikë nuk do të operojë po të mos ketë antena të ngjyrosur shenjat ose shiritat e sinjalizimit që i janë bashkëngjitur në interval jo më shumë se 15 m.

3.6 Një balonë e lirë e rëndë pa pilot nuk do të operohet nën lartësinë *(pressure-altitude*) 18000m (60000ft) natën ose gjatë çdo periudhe të përshkruar nga autoriteti kompetent i AAC, nëse balona, pajisjet e saj dhe ngarkesa, pavarësisht të ndashme apo jo gjatë operimit, nuk janë ndriçuar.

3.7 Një balonë e lirë e rëndë pa pilot që është e pajisur me një pajisje suspansioni (ndryshe nga një parashutë e ngjyrosur e dukshme) më shumë se 15 m e gjatë nuk do të operohet gjatë natës, nën lartësinë 18000 m (60000 ft) (*pressure altitude*), përveçse kur pajisja është e ngjyrosur me shirita të alternuara me ngjyra të dukshme ose shenja të ngjyrosura bashkëngjitur.

4. PËRFUNDIMI I FLUTURIMIT

4.1 Operatori i një balone të lirë të rëndë pa pilot duhet të aktivizojë pajisjet përkatëse të përfundimit të fluturimit të kërkuara sipas pikave 3.3 a) dhe b) më sipër:

a) kur bëhet e ditur që kushtet e motit janë më pak të këqija se ato të rekomanduara për operim;

b) nëse një keqfunksionim ose ndonjë arsye tjetër e bën të rrezikshëm operimin për trafikun ajror, personat ose objektet mbi sipërfaqen e tokës; ose

c) para hyrjes së paautorizuar në hapësirën ajrore mbi territorin e një shteti tjetër.

5. NJOFTIMI I FLUTURIMIT

5.1 Njoftimi i parafluturimit

5.1.1 Njoftimi i hershëm i fluturimit të planifikuar i një balone të lirë mesatare apo të rëndë pa pilot duhet të bëhet te njësia përkatëse e shërbimit të trafikut ajror jo më pak se 7 ditë para datës së fluturimit të planifikuar.

5.1.2 Njoftimi i fluturimit të planifikuar duhet të përfshijë një informacion të tillë si më poshtë siç kërkohet nga njësitë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror:

a) identifikimi i fluturimit të balonës ose kodi i emrit;

b) klasifikimi dhe përshkrimi i balonës;

c) kodi SSR, adresa e avionit ose frekuenca NDB siç duhet;

d) emri dhe numri i telefonit të operatorit;

e) vendi i lëshimit;

f) koha e llogaritur e lëshimit (ose koha e nisjes dhe përfundimit të lëshimeve të shumëhershme);

g) numri i balonave të lëshuara dhe intervali i planifikuar midis lëshimeve (nëse ka lëshime të shumta);

h) drejtimi i pritshëm i ngjitjes;

i) niveli i fluturimit (lartësia sipas presionit atmosferik);

j) koha e llogaritur e kalimit të 18000m (60000ft) lartësi sipas presionit atmosferik ose e arritjes së nivelit të fluturimit nëse është 18000m (60000 ft) ose më poshtë, së bashku me vendndodhjen e llogaritur;

Shënim. -Nëse operimi konsiston në lëshime të vazhdueshme, koha do të jetë ajo e llogaritur për të parin dhe të fundit në seritë që do të arrijnë nivelin përkatës (p.sh. 122136Z–130330Z).

k) data dhe ora e llogaritur e përfundimit të fluturimit dhe vendndodhja e zonës së planifikuar të mbërritjes. Në rastin e balonave që kryejnë fluturime të gjata, data dhe ora e përfundimit të fluturimit dhe vendi i mbërritjes nuk mund të planifikohen me saktësi, do të përdoret termi "kohëzgjatje".

5.1.3 Çdo ndryshim në informacionin e paralëshimit i njoftuar në përputhje me 5.1.2 më sipër do të përcillet te njësia përkatëse e shërbimeve të trafikut ajror jo më pak se 6 orë para kohës së llogaritur të lëshimit, ose në rastin e investigimeve të çrregullimeve diellore ose kozmike që përfshijnë një element kritik kohor, jo më pak se 30 minuta para kohës së llogaritur të nisjes së operimit.

5.2 Njoftimi i lëshimit

5.2.1 Menjëherë pasi një balonë e lirë mesatare apo të rëndë pa pilot është lëshuar, operatori do të njoftojë njësinë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror për sa më poshtë:

a) identifikimin e fluturimit të balonës;

b) vendin e lëshimit;

c) kohën aktuale të lëshimit;

d) kohën e llogaritur në të cilën kalohet lartësia 18000m (60000ft) ose kohën e llogaritur në të cilën arrihet niveli i fluturimit nëse është në ose nën 18000 m (60 000 ft), dhe vendndodhjen e llogaritur; dhe

e) çdo ndryshim në informacionin e mëparshëm njoftohet në përputhje me pikat 5.1.2 g) dhe h).

5.3 **Njoftimi i anulimit të fluturimit**

5.3.1 Operatori duhet të njoftojë njësinë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror menjëherë sapo të bëhet e ditur që fluturimi i planifikuar i një balone të lirë mesatare apo të rëndë pa pilot, i njoftuar më parë në përputhje me pikën 5.1, është anuluar.

6. REGJISTRIMI DHE RAPORTIMET E POZICIONIT

6.1 Operatori i një balone të lirë të rëndë pa pilot që operon në ose nën lartësinë 18000 m (60000 ft) do të monitorojë trajektoren e fluturimit të saj dhe do të përcjellë raportet e pozicionit të saj siç kërkohet nga shërbimet e trafikut ajror.

Operatori do të regjistrojë pozicionin e balonës çdo 2 orë, po të mos kërkohen nga shërbimet e trafikut ajror raporte të tilla në intervale më të shpeshta.

6.2 Operatori i një balone të lirë të rëndë pa pilot që operon mbi lartësinë 18000 m (60000 ft) do të monitorojë ecurinë e fluturimit të saj dhe do të përcjellë raportet e pozicionit të saj siç kërkohet nga shërbimet e trafikut ajror.

Operatori do të regjistrojë pozicionin e balonës çdo 24 orë, po të mos kërkohen nga shërbimet e trafikut ajror raporte të tilla në intervale më të shpeshta..

6.3 Nëse një pozicion nuk mund të regjistrohet sipas pikave 6.1 dhe 6.2 më sipër, operatori menjëherë duhet të njoftojë njësinë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror. Ky njoftim do të përfshijë pozicionin e fundit të regjistruar. Njësia përkatëse e shërbimeve të trafikut ajror do të njoftohet menjëherë sapo gjurmimi i balonës të jetë rivendosur.

6.4 Një orë para fillimit të zbritjes së planifikuar të një balone të lirë të rëndë pa ekuipazh, operatori do të përcjellë te njësia përkatëse e shërbimeve të trafikut ajror informacionin e mëposhtëm lidhur me balonën:

a) pozicioni korrent gjeografik;

b) niveli korrent (*pressure altitude);*

c) koha e parashikuar e penetrimit të 18000 m (60000 ft) (*pressure altitude)*, nëse aplikohet;

d) koha e parashikuar dhe vendmbërritja e balonës.

6.5 Operatori i një balone të lirë të rëndë pa pilot duhet të njoftojë njësinë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror kur operacioni të ketë përfunduar.

Shtojca 3

Tabela e niveleve të fluturimit

1.1 Nivelet e fluturimit që duhet të ndiqen janë si më poshtë:

Nga 000 gradë te 179 grade						Nga180 Grade te 359 grade					
Fluturime IFR			Fluturime VFR			Fluturime IFR			Fluturime VFR		
Niveli			Niveli			Niveli			Niveli		
FL	Këmbë	Metra	FL	Këmbë	Metra	FL	Këmbë	Metra	FL	Këmbë	Metra
010	1000	300	—	—	—	020	2000	600	—	—	—
030	3000	900	035	3500	1050	040	4000	1200	045	4500	1350
050	5000	1500	055	5500	1700	060	6000	1850	065	6500	2000
070	7000	2150	075	7500	2300	080	8000	2450	085	8500	2600
090	9000	2750	095	9500	2900	100	10000	3050	105	10500	3200
110	11000	3350	115	11500	3500	120	12000	3650	125	12500	3800
130	13000	3950	135	13500	4100	140	14000	4250	145	14500	4400
150	15000	4550	155	15500	4700	160	16000	4900	165	16500	5050
170	17000	5200	175	17500	5350	180	18000	5500	185	18500	5650
190	19000	5800	195	19500	5950	200	20000	6100	205	20500	6250
210	21000	6400	215	21500	6550	220	22000	6700	225	22500	6850
230	23000	7000	235	23500	7150	240	24000	7300	245	24500	7450
250	25000	7600	255	25500	7750	260	26000	7900	265	26500	8100
270	27000	8250	275	27500	8400	280	28000	8550	285	28500	8700
290	29000	8850				300	30000	9150			
310	31000	9450				320	32000	9750			
330	33000	10050				340	34000	10350			
350	35000	10650				360	36000	10950			
370	37000	11300				380	38000	11600			
390	39000	11900				400	40000	12200			
410	41000	12500				430	43000	13100			

(*) Fusha magnetike, ose zonat polare me lartësi më shumë se 70 gradë dhe brenda këtyre shtesave të atyre zonave që mund të paraqitet nga Autoriteti i Aviacionit Civil fusha e rrjetit e përcaktuar nga *network* të vijave paralele me Meridianin e Grwnwich i mbivendosur në tabelën e sterografit polar në të cilin drejtimi drejt Polit të Veriut është i përdorur si Rrjeti i Veriut.

Shtojca 4

Klasat e hapësirës SHTA – Shërbimet e ofruara dhe kërkesat për fluturim

(SERA.6001dheSERA.5025(b) citon)

Klasa	Lloji i fluturimit	Ndarja e dhënë	Shërbimi i ofruar	Limiti shpejtësisë(*)	Kërkesat për kapacitetin e komunikimit me radio	Kërkesë për komunikim zanor të dyanshëm ajër-tokë	Subjekt i një ndarjeje ATC
A	Vetëm IFR	Të gjithë avionët	Shërbimet e kontrollit të trafikut ajror	Nuk aplikohet	Po	Po	Po
B	IFR	Të gjithë avionët	Shërbimet e kontrollit të trafikut ajror	Nuk aplikohet	Po	Po	Po
	VFR	Të gjithë avionët	Shërbimet e kontrollit të trafikut ajror	Nuk aplikohet	Po	Po	Po
C	IFR	IFR nga IFR IFR nga VFR	Shërbimet e kontrollit të trafikut ajror	Nuk aplikohet	Po	Po	Po
	VFR	VFR nga IFR	1)Shërbimi i trafikut ajror për ndarjet nga IFR; 2)Shërbimi i kontrollit të trafikut ajror, VFR/VFR informacioni i trafikut (këshillë për shmangie trafiku me kërkesë)	250kts IAS nën 3050m (10000ft)AMSL	Po	Po	Po
D	IFR	IFR nga IFR	Shërbimi kontrollit të trafikut ajror, informacioni trafikut rreth fluturimeve VFR (këshillë për shmangej trafiku me kërkesë)	250kts IAS nën 3050m(10000ft)AMSL	Po	Po	Po
	VFR	Nil	Shërbimi i kontrollit të trafikut ajror, IFR/VFR dhe VFR/VFR informacion trafikut (këshillë për shmangie trafiku me kërkesë)	250ktsIAS nën 3050m (10000ft) AMSL	Po	Po	Po
E	IFR	IFR nga IFR	Shërbimi I kontrollit të trafikut ajror dhe, kur është praktik, informacion trafikut për fluturimet VFR	250kts IAS nën 3050m(10000ft)AMSL	Po	Po	Po
	VFR	Nil	Informacioni i trafikut kur është praktik	250kts IAS nën 3050m (10000ft) AMSL	Jo(**)	Jo(**)	Jo
F	IFR	IFR nga IFR sa mund të jetë praktik	Shërbim këshillimor të trafikut ajror; Shërbim për informacion fluturimi n.q.s. kërkohet	250kts IAS nën 3050m (10000ft) AMSL	Po(***)	Jo(***)	Jo
	VFR	Nil	Shërbim për informacion fluturimi n.q.s. kërkohet	250kts IAS nën 3050m (10000ft) AMSL	Jo (**)	Jo (**)	Jo
G	IFR	Nil	Shërbim për informacion fluturimi n.q.s. kërkohet	250kts IAS nën 3050m (10000ft) AMSL	Po(**)	Jo (**)	Jo
	VFR	Nil	Shërbim për informacion fluturimi n.q.s. kërkohet	250kts IAS nën 3050m (10000ft) AMSL	Jo (**)	Jo (**)	Jo

(*)Kur niveli i lartësisë të ndryshimit është nën 3050 m(10000 ft)AMSL, FL duhet të përdoret në vend të 10000 ft. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të përjashtojë dhe llojin e avionit i cili për arsye teknike ose sigurie, s'mund të mbajë atë shpejtësi.

(**) Pilotët duhet të mbajnë komunikim zanor ajër-tokë të vazhdueshëm dhe të vendosin komunikim të dyanshëm, siç e nevojshme, në kanalin e duhur të komunikimit RMZ.

(***) Komunikimi ajër-tokë është i domosdoshëm për fluturimet që marrin pjesë, në shërbimin këshillues. Pilotët duhet të mbajnë komunikim zanor ajër-tokë të vazhdueshëm dhe të vendosin një komunikim të dyanshëm, sipas nevojës, në kanalin e duhur të komunikimit RMZ

SHTOJCA 5
SPECIFIKIMET TEKNIKE NË LIDHJE ME VËZHGIMET E MJETEVE FLUTURUES DHE RAPORTIMET ME KOMUNIKIM ZANOR

A. Instruksionet e raportimit

MODEL AIREP SPECIAL

	ITEM	PARAMETER	TRANSMIT IN TELEPHONY as appropriate
	—	Message- type designator — special air-report	[AIREP] SPECIAL
Section 1	1	Aircraft identification	*(aircraft identification)*
	2	Position	POSITION *(latitude and longitude)* OVER *(significant point)* ABEAM *(significant point)* *(significant point) (bearing) (distance)*
	3	Time	*(time)*
	4	Level	FLIGHT LEVEL *(number)* or *(number)* METRES or FEET CLIMBING TO FLIGHT LEVEL *(number)* or *(number)* METRES or FEET DESCENDING TO FLIGHT LEVEL *(number)* or *(number)* METRES or FEET
	5	Next position and estimated time over	*(position) (time)*
	6	Ensuing significant point	*(position)* NEXT
Section 2	7	Estimated time of arrival	*(aerodrome) (time)*
	8	Endurance	ENDURANCE *(hours and minutes)*
Section 3	9	Phenomenon encountered or observed prompting a special air-report: — Moderate turbulence — Severe turbulence — Moderate icing — Severe icing — Severe mountain wave — Thunderstorms without hail — Thunderstorms with hail — Heavy dust/sandstorm — Volcanic ash cloud — Pre-eruption volcanic activity or volcanic eruption	 TURBULENCE MODERATE TURBULENCE SEVERE ICING MODERATE ICING SEVERE MOUTAINWAVE SEVERE THUNDERSTORMS THUNDERSTORMS WITH HAIL DUSTSTORM or SANDSTORM HEAVY VOLCANIC ASH CLOUD PRE-ERUPTION VOLCANIC ACTIVITY or VOLCANIC ERUPTION

1. PËRMBAJTJA E RAPORTIMEVE AJRORE

1.1 **Raportimet e pozicionit dhe raportimet ajrore speciale**

1.1.1 Seksioni 1 i modelit të paraqitur në pikën A është i detyrueshëm për raportime të pozicionit dhe raportimet ajrore speciale, megjithatë artikujt 5 dhe 6 mund të mos merren në konsideratë. Seksioni 2 do të shtohet, i plotë ose pjesërisht, vetëm kur kërkohet nga operatori ose përfaqësuesi i përcaktuar prej tij, ose kur konsiderohet e rëndësishme nga piloti në komandë. Seksioni 3 do të përfshihet në raportimet ajrore speciale.

1.1.2 Kushtet që bëhen shkak për lëshimin e një raporti ajror special do të zgjidhen nga lista e prezantuar në pikën SERA.12005(a).

1.1.3 Në rastin e raportimeve ajrore speciale që përmbajnë informacion mbi aktivitet vullkanik, një raport postfluturimit do të bëhet duke përdorur formatin e raportimit të aktivitetit vullkanik (Modeli VAR) i përfshire në pikën B. Të gjitha elementet që vëzhgohen do të regjistrohen dhe tregohen respektivisht në vendet e duhura në formatin Model VAR.

Raportimet ajrore speciale do të lëshohen sa më shpejt që të jetë e mundur pas vëzhgimit të një fenomeni që e bën të nevojshme nxjerrjen e një raporti ajror special.

2. INSTRUKSIONE RAPORTIMI North'

2.1 **Informacionet që gjenden në një raportim ajror do të raportohen sipas radhës në të cilën janë listuar në modelin e formatit AIREP SPECIAL**.

- Treguesi i tipit të mesazhit. Raporto "SPECIAL" për një raportim ajror special.

Seksioni 1

Artikulli 1 – IDENTIFIKIMI I MJETIT FLUTURUES. Raporto shenjën e thirrjes radiotelefonike të mjetit fluturues siç përshkruhet në pikën SERA.14050.

Artikulli 2 – POZICIONI. Raporto pozicionin në gjerësi (gradë si 2 numerike ose gradë dhe minuta si 4 numerike, ndjekur nga "North"(Veri) ose "South"(Jug) dhe gjatësi (gradë si 3 numerike ose gradë dhe minuta si 5 numerike ndjekur nga "EAST" (Lindje) ose "WEST" (Perëndim), ose si një pikë sinjifikative e identifikuar nga një tregues i koduar (2 deri në 5 karaktere), ose si një pikë sinjifikative e ndjekur nga drejtimi magnetik (3 numerike) dhe distanca në milje nautike nga pika. Parapriji pikës sinjifikative me "ABEAM", nëse aplikohet.

Artikulli 3 – KOHA. Raportojë kohën në orë dhe minuta UTC (4 numerike) përveçse nëse të raportuarit e kohës në minuta kaluar orës (2 numerike) është përcaktuar në bazë të marrëveshjeve rajonale të navigimit ajror. Koha e raportuar duhet të jetë koha aktuale e mjetit fluturues në pozicion dhe jo koha e fillimit ose transmetimit të raportit. Koha do të raportohet gjithmonë në ore dhe minuta UTC kur lëshohet një raportim ajror special.

Artikulli 4 – NIVELI I FLUTURIMIT OSE LARTESIA BAROMETRIKE. Raportojë nivelin e fluturimit me 3 numerike kur është konfigurimi standard i altimetrit të presionit. Raportojë lartësinë barometrike në metra ndjekur nga "METRES" (METRA) ose në këmbë ndjekur nga "FEET" (KEMBË) kur në QNH. Raporto "CLIMBING" (DUKE U NGJITUR) (ndjekur nga niveli) kur po ngjitet ose "DESCENDING" (DUKE ZBRITUR) (ndjekur nga niveli) kur po zbret në një nivel të ri pas kalimit të pikës sinjifikative.

Artikulli 5 – POZICIONI I RADHES DHE PËRFUNDIMI I KOHËS SË PARASHIKUAR MBI. Raporto pikën e raportimit të radhës dhe kohën e parashikuar mbi këtë pikë raportimi, ose raporto pozicionin e parashikuar që do të arrihet një orë më vonë, në përputhje me procedurat e raportimit të pozicionit në fuqi. Përdor të dhënat e specifikuara në artikullin 2 për pozicionin. Raporto kohën e parashikuar mbi këtë pozicion. Raporto kohën në orë dhe minuta UTC (4 numerike) përveçse nëse koha raportohet në minuta kaluar orës (2 numerike) siç përshkruhet në marrëveshjet rajonale të navigimit ajror.

Artikulli 6 – PIKA SINJIFIKATIVE VIJUESE. Raporto pikën sinjifikative vijuese që ndjek "pozicioni i radhës dhe koha e parashikuar mbi".

Seksioni 2

Artikulli 7 – KOHA E PARASHIKUAR E MBËRRITJES. Raporto emrin e aerodromit të parë të synuar për ulje, të ndjekur nga koha e parashikuar e mbërritjes në këtë aerodrom në orë dhe minuta UTC (4 numerike).

Artikulli 8 – Zgjatja e karburantit. Raporto "ZGJATJEN E KARBURANTIT" ndjekur nga zgjatja e karburantit në orë dhe minuta (4 numerike).

Seksioni 3

Artikulli 9 – FENOMENET QË JANË SHKAK PËR NJË RAPORT AJROR SPECIAL. Raporto një prej fenomeneve në vijim të cilin e keni vëzhguar ose me të cilin jeni përballur:

- turbulencë e moderuar si "TURBULENCE MODERATE" (TURBULENCË E MODERUAR), dhe

- turbulencë e rëndë si "TURBULENCE SEVERE" (TURBULENCË E RËNDË).

Specifikimet në vijim aplikohen:

- I/E Moderuar – Kushte gjatë të cilave mund të ndodhin ndryshime modeste në orientimin e mjetit fluturues përkundrejt horizontit dhe/ose lartësinë barometrike, por mjeti fluturues e ruan kontrollin gjatë gjithë kohës. Zakonisht, ka ndryshime të vogla në shpejtësi. Ndryshime në leximet e akselerometrit 0.5 g deri në 1.0 g në qendrën e rëndesës së mjetit fluturues. Vështirësi për të ecur. Pasagjeret i ndjejnë rripat të shtrënguar. Objektet e pa fiksuar janë në lëvizje.

- I/E rëndë – Kushte gjatë të cilave ndodhin ndryshime të papritura në orientimin e mjetit fluturues përkundrejt horizontit dhe/ose të lartësisë barometrike; mjeti fluturues mund të jetë i pakontrollueshëm për periudha të shkurtra kohe. Zakonisht shoqërohet me ndryshime të mëdha në shpejtësi ajrore. Ndryshimet në leximet e akselerometrit janë më të mëdha se 1.0g në qendrën e rëndesës së mjetit fluturues. Pasagjerët e ndjejnë në mënyrë të dhunshme shtrëngimin e rripave të sediljeve. Objektet e pa fiksuar lëvizin me shpejtësi në drejtime të ndryshme.

- akullim i moderuar si "AKULLIM I MODERUAR", akullim i rëndë si "AKULLIM I RËNDË";

Specifikimet në vijim aplikohen:

- I/E moderuar—Kushte gjatë të cilave ndryshimi i kursit dhe/ose lartësisë barometrike mund të konsiderohet i dëshirueshëm.

- I/E rëndë—Kushte në të cilat ndryshimi i menjëhershëm i kursit dhe/ose lartësisë barometrike konsiderohet thelbësor.

- Valer malore e rëndë si "MOUNTAIN WAVE SEVERE" (VALË MALORE E RËNDË);

Specifikimet në vijim aplikohen:

- I/E rëndë— Kushte në të cilat rryma ajrore shoqëruese e drejtuar për poshtë është me shpejtësi 3.0 m/s (600ft/min) ose më shumë dhe/ose haset në turbulencë të rëndë.

- Stuhi me rrufe pa breshër si "THUNDERSTORM" (STUHI ME RRUFE), stuhi me rrufe me breshër si "THUNDERSTORM WITH HAIL" (STUHI ME RRUFE ME BRESHËR);

Specifikimet në vijim aplikohen:

Raporto vetëm stuhi me rrufe të cilat:

- janë të errësuara me mjegull, ose

- janë brenda resë, ose

- janë të shpërndara, ose

- formojnë një rresht me stuhi rrufesh që i paraprijnë një fronti të ftohtë

- Stuhi e rëndë pluhuri ose rëre si "DUSTSTORM HEAVY" (STUHI PLUHURI E RËNDË) ose "SANDSTORM HEAVY" (STUHI RËRE E RËNDË);

- Re hiri vullkanik si "VOLCANIC ASH CLOUD" (RE HIRI VULLKANIK);

- Aktivitet vullkanik para shpërthimit ose një shpërthim vullkanik si "PRE-ERUPTION VOLCANIC ACTIVITY" (AKTIVITET VULLKANIK PARA SHPËRTHIMIT) ose "VOLCANIC ERUPTION" (SHPËRTHIM VULLKANIK);

Specifikimi në vijim aplikohet:

"Aktivitet vullkanik para shpërthimit" në këtë kontekst do të thotë aktivitet vullkanik i pazakontë dhe/ose aktivitet vullkanik në rritje i cili mund të paralajmërojë një shpërthim vullkanik.

2.2 Informacioni i regjistruar në formatin e raportimit të aktivitetit vullkanik (Modeli VAR) nuk është për t'u transmetuar nga RTF, por me të mbërritur në një aerodrom duhet t'i dorëzohet pa vonesë nga operatori ose nga një anëtar i ekuipazhit të fluturimit zyrës meteorologjike të aerodromit. Nëse kjo zyrë nuk është lehtësisht e aksesueshme, formati i plotësuar do të dorëzohet në përputhje me marrëveshjet lokale të rëna dakord ndërmjet Ofruesve të MET dhe SHTA, dhe operatorit të mjetit fluturues.

3. DËRGIMI I INFORMACIONEVE METEOROLOGJIKE TË MARRA NGA KOMUNIKIMET ZANORE

Kur marrin raportime ajrore speciale, njësitë SHTA do t'ia dërgojnë këto raporte pa vonesa zyrës përkatëse të vëzhgimeve meteorologjike (MWO). Për të siguruar asimilimin e raportimeve ajrore në sistemet e automatizuara të vendosura në

tokë, elementët e këtyre raporteve do të transmetohen duke përdorur të dhënat e specifikuara më poshtë dhe sipas radhës së përcaktuar.

- I ADRESUARI. Regjistro stacionin e thirrur dhe, kur është e nevojshme, *relay required*.

- TREGUESI I TIPIT TË MESAZHIT. Regjistro "ARS" për një raportim ajror special.

- IDENTIFIKIMI I MJETIT FLUTURUES. Regjistro identifikimin e mjetit fluturues duke përdorur të dhënat e specifikuara për artikullin 7 të planit të fluturimit, pa hapësirë ndërmjet treguesit të operatorit dhe regjistrimit të mjetit fluturues ose identifikimit të fluturimit, nëse përdoret.

Seksioni 1

Artikulli 0 – POZICIONI. Regjistro pozicionin në gjerësi (gradë si 2 numerike ose gradë dhe minuta si 4 numerike, ndjekur, pa një hapësirë, nga "N"(V) ose "S"(J) dhe gjatësinë (gradë si 3 numerike ose gradë dhe minuta si 5 numerike, ndjekur pa hapësirë nga "E"(L) ose "W"(P), ose si një pikë sinjifikative e identifikuar nga një tregues të koduar (2 deri në 5 karaktere), ose si një pikë sinjifikative e ndjekur nga drejtimi magnetik (3 numerike) dhe distancë në milje nautike (3 numerike) nga pika. Parapriji pikës sinjifikative me "ABEAM", nëse aplikohet.

Artikulli 1 – KOHA. Regjistroje kohën në orë dhe minuta UTC (4 numerike).

Artikulli 2 – NIVELI I FLUTURIMIT OSE LARTËSIA BAROMETRIKE. Regjistro 'F' të ndjekur nga 3 numerike (p.sh., "F310") kur raportohet një nivel fluturimi. Regjistro lartësinë barometrike në metra të ndjekur nga "M" ose në këmbë të ndjekur nga "FT" kur raportohet një lartësi barometrike. Regjistro "ASC" (nivel) në ngjitje ose "DES" (nivel) në zbritje.

Seksioni 2

Artikulli 9 — FENOMENET QË JANË SHKAK PËR NJË RAPORT AJROR SPECIAL. Regjistroje fenomenin e raportuar si më poshtë:

- turbulencë e moderuar si "TURB MOD",
- turbulencë e rëndë si "TURB SEV",
- akullim i moderuar si "ICE MOD",
- akullim i rëndë si "ICE SEV",
- valë malore e rëndë si "MTW SEV",
- stuhi me rrufe pa breshër si "TS",
- stuhi me rrufe me breshër si "TSGR",
- stuhi e rëndë pluhuri ose rëre si "HVY SS",
- re hiri vullkanik si "VA CLD",
- aktivitet vullkanik para shpërthimit ose një shpërthim vullkanik si "VA",
- breshër si "GR",
- re cumulonimbus si "CB".

KOHA E TRANSMETUAR. Regjistroje vetëm kur seksioni 3 është transmetuar.

4. DISPOZITA SPECIFIKE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E NDRYSHIMEVE TË PAPRITURA TË SHPEJTËSISË DHE DREJTIMIT TË ERËS, DHE HIRIT VULLKANIK

4.1 **Raportimi i ndryshimeve të papritura të shpejtësisë dhe drejtimit të erës**

4.1.1 Kur raportohen vëzhgimet e mjeteve fluturues për ndryshime të papritura të shpejtësisë dhe drejtimit të erës të hasura gjatë fazës së ngjitjes dhe afrimit të fluturimit, tipi i mjetit fluturues do të përfshihet në raport.

4.1.2 Kur kushtet e ndryshimeve të papritura të shpejtësisë dhe drejtimit të erës në fazën e ngjitjes ose afrimit të fluturimit janë raportuar ose parashikuar por jo hasur, piloti në komandë do të këshillojë njësinë e duhur SHTA sa më shpejt që të jetë e mundur, përveç rastit kur piloti në komandë ka dijeni se njësia SHTA është këshilluar më përpara nga një mjet fluturues para tij.

4.2 **Raportimi postfluturim i aktivitetit vullkanik**

4.2.1 Me mbërritjen e një fluturimi në një aerodrom, raporti i plotësuar për aktivitet vullkanik do t'i dorëzohet pa vonesa zyrës meteorologjike të aerodromit nga operatori i mjetit fluturues ose një anëtar i ekuipazhit të fluturimit, ose nëse kjo zyrë nuk është lehtësisht e aksesueshme për anëtarët e ekuipazhit të fluturimit në mbërritje, formati i plotësuar do të trajtohet në përputhje me marrëveshjet lokale të rëna dakord ndërmjet ofruesit të SHTA dhe MET, dhe operatorit të mjetit fluturues.

4.2.2 Raporti i plotësuar për aktivitet vullkanik i marrë nga zyra meteorologjike e aerodromit do t'i transmetohet pa vonesë zyrës së vëzhgimit meteorologjik përgjegjëse për ofrimin e vëzhgimit meteorologjik për rajonin e informacionit të fluturimit në të cilin është vëzhguar aktiviteti vullkanik.

B. FORMATI I RAPORTIMEVE AJRORE SPECIALE PËR AKTIVITET VULLKANIK (MODEL VAR)

MODEL VAR: të përdoret për raportime postfluturim

RAPORTI PËR AKTIVITET VULLKANIK

Raportet ajrore janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e rreziqeve të cilat retë e hirit vullkanik përbëjnë për operimet e mjeteve fluturues

OPERATOR:			A/C IDENTIFICATION: (as indicated on flight plan)		
PILOT- IN- COMMAND:					
DEP FROM:	DATE:	TIME; UTC:	ARR AT:	DATE:	TIME; UTC:
ADDRESSEE			AIREP SPECIAL		
Items 1-8 are to be reported immediately to the ATS unit that you are in contact with.					
1) AIRCRAFT IDENTIFICATION			2) POSITION		
3) TIME			4) FLIGHT LEVEL OR ALTITUDE		
5) VOLCANIC ACTIVITY OBSERVED AT (position or bearing, estimated level of ash cloud and distance from aircraft)					
6) AIR TEMPERATURE			7) SPOT WIND		
8) SUPPLEMENTARY INFORMATION SO_2 DETECTED yes ☐ no ☐ Ash encountered yes ☐ no ☐			Other _____ (brief description of activity especially vertical and lateral extent of ash cloud and, where possible, horizontal movement, rate of growth, etc.)		
After landing complete items 9-16 then fax form to: (Fax number to be provided by the meteorological authority based on local arrangements between the meteorological authority and the operator concerned.)					
9) DENSITY OF ASH CLOUD	☐ (a) Wispy		☐ (b) Moderate dense		☐ (c) Very dense
10) COLOUR OF ASH CLOUD	☐ (a) White		☐ (b) Light grey		☐ (c) Dark grey
	☐ (d) black		☐ (e) other _____		
11) ERUPTION	☐ (a) continuous		☐ (b) intermittent		☐ (c) not visible
12) POSITION OF ACTIVITY	☐ (a) Summit		☐ (b) side		☐ (c) Single
	☐ (d) Multiple		☐ (e) Not observed		
13) OTHER OBSERVED FEATURES OF ERUPTION	☐ (a) Lightning		☐ (b) Glow		☐ (c) Large rocks
	☐ (d) Ash fallout		☐ (e) Mushroom cloud		☐ (f) All
14) EFFECT ON AIRCRAFT	☐ (a) Communication		☐ (b) Navigation systems		☐ (c) Engines
	☐ (d) Pitot static		☐ (e) Windscreen		☐ (f) Windows
15) OTHER EFFECTS	☐ (a) Turbulence		☐ (b) St. Elmo's Fire		☐ (c) Other fumes
16) OTHER INFORMATION (Any information considered useful.)'					

SUPLEMENT PËR ANEKSIN

Lista e ndryshimeve të dakordesuara për njoftim të ICAO në përputhje me nenin 5 të kësaj Rregulloreje:

Aneksi 2 i ICAO-s

Diferencat midis kësaj Rregulloreje dhe Standardeve Ndërkombëtare të përfshira në aneksin 2 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, e ndryshuar

Diferenca A2-01	
ICAO Aneksi2 Kapitulli 3 3.2.2.	Dispozitë e re. Implementimi i Rregullores SERA,SERA.3210(b), specifikon: '(b) *Një avion që është në dijeni se aftësia për të manovruar një tjetër avion është e cenuar, duhet të hapë rrugën për këtë të fu*ndit.'
Differenca A2-02	
ICAO Aneksi 2 Kapitulli 3 3.2.3.2 (b)	UM nr..., datë...transpozim i Rregullores (EU) nr. 923/2012, paragrafi SERA.3215(b)(2), specifikon (në shtim të ICAO Standard në aneks 2,3.2.3.2 (b) të tekstit të nënvizuar): '(2) *përveçse kur janë të palëvizshëm dhe të ndriçuar në mënyrë të përshtatshme , të gjithë avionët në zonën e lëvizjes së nj aerodromi duhet të shfaqin dritat të cilat kanë për funksion të tregojnë, aq sa është e mundur, skajet e strukturës së tyre*;'.
Difference A2-03	
ICAO Aneksi 2 Kapitulli 3 3.2.5(c) dhe (d)	UM nr..., datë...transpozim i Rregullores (EU) nr. 923/2012, paragrafi **SERA.3225** ndryshon nga ICAO Standard në aneksin 2, 3.2.5(c) dhe 3.2.5(d) në të cilën specifikohet që nënparagrafët (c) dhe (d) nuk do të aplikohen për balonat: '(c) *me përjashtim të balonave, të bëjë të gjithë kthesat në të majtë, kur afrohet për ulje dhe pasi është ngritur, përveçse nëse është vendosur ndryshe apo udhëzohet nga Kontrolli i Trafikut Ajror;* (d) *me përjashtim të balonave, ulet dhe ngrihet me erën kundra përveçse në qoftë se siguria*, **konfigurimi i pistës, apo elementë të trafikut ajror përcaktojnë se një drejtim tjetër është i\preferuar.'.**
Difference A2-04	
ICAOAneksi2 Kapitulli3 3.3.1.2	Aneksi i ICAO 2, 3.3.1.2 është zëvendësuar me UM nr..., datë...transpozim i Rregullores së Zbatimit (EU) nr. 923/2012 SERA.4001(b). Ndryshimet midis kësaj ICAO Standard dhe kësaj rregulloreje janë si më poshtë: — Përsa i përket fluturimeve të planifikuara VFR që operojnë përgjatë kufijve ndërkombëtarë, rregullorja SERA, (SERA.4001(b)(5)) ndryshon nga Standardi ICAO në aneksin 2, 3.3.1.2(e) me shtesën e tekstit të nënvizuar, si më poshtë: '*çdo fluturimi që kalon përtej kufijve ndërkombëtarë, <u>përveçse kur është vendosur ndryshe nga Shtetet e interesuara.</u>*' — Në lidhje me fluturimet VFR dhe IFR të planifikuara të fluturojnë natën, një kërkesë shtesë është shtuar në rregulloren e SERA, SERA.4001(b)(6) si më poshtë: '(6) *çdo fluturim i planifikuar për të operuar gjatë natës, nëse largohet nga afërsia e një aerodromi*'.
NdryshimiA2-05	
ICAOAneksi2 Kapitulli3 3.2.2.4.	Shtesa e Re. UM nr..., datë...transpozim i Rregullores së Zbatimit (EU) nr. 923/2012, paragrafi SERA.3210(c)(3)(i) ndryshon nga ICAO Standard në aneksin 2,3.2.2.4 duke specifikuar që: ***(i)** Parakalimi i planerave (sailplanes). Një planer që parakalon një tjetër planer mund të ndryshojë kursin e tij në të djathtë ose në të majtë**.;***
Diferenca A2-07	
ICAO Aneksi 2 Kapitulli 4 4.6	ICAO Aneksi 2,4.6, është zëvendësuar me UM nr..., datë...transpozim i Rregullores së Zbatimit (EU) nr. 923/2012 SERA.5005, duke futur kriteret e hapësirës të lirë në (f),si më poshtë: **'(f)** Përveçse kur është e nevojshme për ngritje ose ulje, ose përveçse kur lejohet nga autoriteti kompetent, një fluturim VFR nuk duhet të fluturojë: *(1)Mbi zonat e populluara të qyteteve, qytezave, vendbanimeve, grumbullimet e njerëzve në ambient të hapur, në një lartësi më pak se 300 m (1 000 ft) nga pengesa më e lartë brenda një rrezeje prej 600 m nga avioni;'.* *(2) Në vende të tjera nga ato të përcaktuara në pikën (1), në një lartësi më pak se 150 m (500 ft) nga toka ose uji, <u>ose 150 m (500 ft) nga pengesa më e lartë brenda një rrezeje prej 150 m (500 ft) nga avioni..</u>'*
Diferenca A2-08	
ICAO Aneksi 2 Kapitulli 3 3.8 dhe shtojca 2	Fjalët 'në rrezik' të kapitullit 3, pjesa 3.8, nuk janë të përfshira në rregullore, duke zgjeruar gamën e misioneve të çdo lloj natyre të fluturimeve që kërkojnë këtë shërbim. Gjithashtu dispozitat të përfshira në shtojcën 2 pjesët 1.1 deri te 1.të përfshira gjithashtu dhe ato në shtesën A, nuk janë të përfshira në ligjin kombëtar.

Aneks 3 i ICAO-s
Diferencat midis kësaj Rregullore dhe Standardeve Ndërkombëtare të shprehura në aneksin 3 të ICAO-s i amenduar

Diferenca A3-01	
ICAO Aneksi 3 Kapitulli 5	Dispozitë e re. Pika **SERA.12005** UM nr..., datë...transpozim i (EU) nr. 923/2012 specifikon: '(b) *Autoritetet kompetente duhet të përcaktojnë, sipas nevojës, kushte të tjera të cilat duhet të raportohen nga të gjithë avionët kur hasen ose vëzhgohen*.'.

Aneks 10 i ICAO-s
Diferencat midis kësaj rregullore dhe Standardeve Ndërkombëtare të shprehura në aneksin 10 të ICAO-s i amenduar

Diference A10-01	
ICAO Aneks 10 Volumi II kapitull 5 5.2.1.4.1	ICAO aneksi 10, volumi II, kapitull 5.2.1.4.1 transpozohet në pikën SERA.14035 të UM nr..., datë...transpozim i Rregullores së Zbatimit (EU) nr. 923/2012 me disa diferenca. Diferencat midis ICAO dhe Rregullave të SERA si më poshtë: **SERA. 14035 Transmetimi i numrave në radiotelefoni** a) Transmetimi i numrave 1. Të gjithë numrat e përdorur për transmetimin e shenjave të thirrjes së avionëve, kurset, pistën, drejtimin dhe shpejtësinë e erës do të transmetohen duke shqiptuar çdo numër veçmas. (i) Nivelet e fluturimit do të transmetohen duke shqiptuar çdo numër veçmas, <u>përveç rastit të niveleve të fluturimit që mbarojnë me dy zero.</u> (ii) Të dhënat e matësit të lartësisë do të transmetohen duke shqiptuar çdo numër veçmas, <u>përveç rastit kur e dhëna është 1000hPa , e cila do të shqiptohet si "NJË MIJË"</u> (iii) Të gjithë numrat të cilët përdoren në transmetimin e kodeve të transponderit do të transmetohen duke shqiptuar çdo numër veçmas <u>përveç rastit kur kodi i transponderit përmban vetëm mijëshe. Në këtë rast numri i parë i mijëshes do të shqiptohet shoqëruar nga fjala "MIJË"</u> 2. Të gjithë numrat të cilët përdoren në transmetimin e informacioneve të ndryshëm nga pika (a)(1) do të transmetohen duke shqiptuar çdo numër veçmas, përveç se numrave të cilët përmbajnë qindëshe apo mijëshe të plota të cilat do të transmetohen duke shqiptuar çdo shifër sipas numrave të qindësheve apo mijësheve shoqëruar nga fjalët "QIND" ose "MIJË". Kombinimi i mijësheve dhe qindësheve të plota do të transmetohen duke shqiptuar çdo shifër në numër mijëshesh shoqëruar nga fjala "MIJË" dhe ndjekur nga numri i qindësheve shoqëruar nga fjala "QIND" 3. Në rastet kur është e nevojshme për të sqaruar numrin e transmetuar si mijëshe e plotë/ose qindëshe e plotë, numri do të transmetohet duke shqiptuar çdo shifër veçmas. 4. Kur japin informacionin në lidhje me drejtimin relativ të një objekti ose për trafikun në konflikt sipas termave të treguesit të orës , informacioni do të jepet duke shqiptuar shifrat së bashku si për shembull "ORA DHJETË" ose "ORA NJËMBËDHJETË". 5. Numrat që përmbajnë pikë dhjetore do të transmetohen siç përshkruhet në pikën (a) (1) së bashku me pikën dhjetore në sekuencën e duhur, duke e shoqëruar me fjalën " DECIMAL" 6. Të gjashtë shifrat e një treguesi numerik do të përdoren për të identifikuar kanalin e transmetimit në komunikimet radiotelefonike VHF, përveç rasteve kur të dy shifrat e fundit (e pesta dhe e gjashta) janë zero, ku në këtë rast do të përdoren vetëm katër shifrat e para .
Diferenca A10-02	
Kapitulli 5, par 5.2.1.7.3.2.3	ICAO Aneks 10, Volume II, kapitull 5.2.1.7.3.2.3 transpozohet në pikën SERA.14055 të UM nr..., datë...transpozim i (EU) nr. 923/2012 me një diferencë. Diferenca midis ICAO Standard dhe UM nr..., datë...është si me poshtë: **SERA.14055 Procedurat e Radiotelefonisë** (b)(2) Përgjigja ndaj thirrjeve të mësipërme do të përdore shenjën e thirrjes të stacionit thirrës, ndjekur nga shenja e thirrjes e stacionit përgjigjes, e cila do të konsiderohet si një ftesë e stacionit thirrës për të vazhduar me transmetimin. <u>Për transferimet e komunikimit brenda një njësie ATS, shenja e thirrjes e njësisë SHTAmund të neglizhohet nëse autorizohet nga autoriteti kompetent</u>

ICAO Aneksi 11
Ndryshimet midis kësaj Rregulloreje dhe Standardeve Ndërkombëtare në aneksin 11 të Konventës në Aviacionin Civil Ndërkombëtar, i amenduar

Diferenca A11-01	
ICAO Aneksi11 Kapitulli 2/ Paragrafi 2.26.5	Rregullorja e **SERA, SERA.3401(d)(1)** ndryshon nga ICAO Aneksi 11, standard 2.25.5 duke thënë se **Kontrolli i kohës do t'i jepet të paktën sipas minutës më të afërt.**
Diferenca A11-02	
ICAO Aneksi 11 Par 2.6.1 Kapitulli 2 Paragrafi 2.6.1	Mundësia e përjashtimit. UM nr..., datë...transpozim i Rregullorjes së Zbatimit (BE) nr. 923/2012 paragrafi SERA.6001 lejon avionët të kalojnë limitin e shpejtësisë 250 knot kur janë aprovuar nga autoriteti kompetent për llojet e avionëve, të cilët për arsye teknike apo sigurie, nuk mund të mbajnë dot këtë shpejtësi
Diferenca A11-03	
ICAO Aneksi 11 Kapitulli 3	Dispozitat e Reja. UM nr..., datë...transpozim i Rregullores së Zbatimit (EU) nr. 923/2012, paragrafi **SERA.8005(b), specifikon**: b) Lejet e dhëna nga njësitë e kontrollit të trafikut ajror duhet të sigurojnë ndarje: (1) Midis të gjitha fluturimeve në hapësirat ajrore të Klasit A dhe B; (2) Midis të gjitha fluturimeve IFR në hapësirat ajrore të Klasit C, D dhe E; (3) Midis të gjitha fluturimeve IFR dhe VFR në hapësirën ajrore të Klasit C; (4) Midis fluturimeve IFR dhe fluturimeve speciale VFR; (5) Midis fluturimeve speciale VFR përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe nga Autoriteti i Aviacionit Civil; Përveçse, kur kërkohet nga piloti i një avioni dhe pranohet nga piloti i avionit tjetër dhe nëse kjo lejohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, për rastet e listuar nën b) më sipër, në hapësirat ajrore të klasit D dhe E, një fluturim mund të lejohet me kusht që të ruajë ndarjen e vet për një pjesë të caktuar të fluturimit nën 3 050 m (10 000 ft) gjatë ngritjes ose zbritjes, gjatë ditës në kushte meteorologjike vizuale
Diferenca A11-04 **Difference A11-04**	
ICAO Aneksi 11 Kapitulli 3, par 3.3.4	UM nr..., datë...transpozim i Rregullores së Zbatimit (EU) nr. 923/2012 paragrafi SERA.8015, specifikon (me shtesën e ICAO Standard në aneksin 11, 3.7.3.1 të tekstit të nënvizuar): (e) Përsëritja (*read-back*) e lejeve dhe i informacionit të lidhur me sigurinë (1) Ekuipazhi i fluturimit duhet t'i përsërisë kontrollorit të trafikut ajror pjesët e lejes të kontrollit të trafikut ajror të lidhura me sigurinë dhe udhëzimet të cilat janë transmetuar me zë. Elementët më poshtë duhet të përsëriten gjithmonë: (i) Lejet e kontrollit të trafikut ajror për rrugën; (ii) Lejet dhe udhëzimet për të hyrë; për t'u ulur; për t'u ngritur nga; për të qëndruar në pritje; për të kaluar; për të ruluar dhe kthyer mbrapsht në çdo pistë; dhe (iii) Pista në përdorim, konfigurimet e lartësimatësit, kodet SSR, kanalet e komunikimit të caktuara rishtazi, udhëzimet e nivelit, udhëzimet e drejtimit dhe shpejtësisë; dhe (iv) Nivelet tranzitore, të raportuara nga kontrollori ose të përfshira në transmetimet ATIS.
Diferenca A11-05	
ICAO Aneksi 11 Kapitulli 3	UM nr..., datë...transpozim i Rregullores së Zbatimit (EU) nr. 923/2012, paragrafi SERA.8015(e)(2), specifikon (në shtesë të ICAO Standard në aneksin 11, 3.7.3.1.1 e tekstit të nënvizuar): (2) Udhëzime ose leje të tjera, duke përfshirë lejet e kushtëzuara dhe udhëzimet për rulim, duhet të përsëriten ose të vërtetohet marrja e tyre në një mënyrë që të tregojë qartë që janë kuptuar dhe që do të zbatohen.
Diferenca A11-06	
